

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË
FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

**SEMINARI XXXIX NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

39/1 (KËTU LOGOJA E SEMINARIT)

**THE XXXIX INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN
LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE**

Prishtinë, 2021

KDU: 008(=18):811.18:821.18(05)

FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË

FACULTY OF PHILOLOGY – PRISTINA

FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

FACULTY OF HISTORY-PHILOLOGY – TIRANA

**SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN
SHQIPTARE**

**INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN LANGUAGE, LITERATURE AND
CULTURE**

REVISTË / JOURNAL

39

ISSN 2521-3687

VËLLIMI / VOLUME

1

PRISHTINË, 39 / 2021

Kryeredaktor / Editor in chief;

Shkumbin Munishi

Redaksia / Editorial Board:

Shkumbin Munishi (Prishtinë), Haki Hysenaj (Prishtinë), Anton Berishaj (Prishtinë),
Nermiane Kamberi (Prishtinë), Nuran Malta (Prishtinë), Muhamed Çitaku (Prishtinë), Faton
Ismajli (Prishtinë), Dhurata Shehri (Tiranë), Linda Mëniku (Tiranë), Viola Isufaj (Tiranë),
Mimoza Kore (Tiranë), Flora Koleci (Tiranë), Idriz Metani (Tiranë), Lindita Xhanari
(Tiranë), Lili Sula (Tiranë), Ernestina Halili (Tiranë), Kastriot Gjika (Tiranë) Juli Kolgjini
(New York), Maria S. Morozova (Shën Peterburg)

PËRMBAJTJA

LIGJËRATA	6
------------------------	----------

Rexhep ISMAJLI

UNIONI GJUHËSOR BALLKANIK PËRBALLË DIVERSITETIT TË IDIOMAVE. RASTI I SHQIPES DHE I DISA IDIOMAVE SLLAVE TË JUGUT	7
--	---

Bardh RUGOVA

VENDI I THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE	26
--	----

GJUHËSI / LINGUISTICS	44
------------------------------------	-----------

Anila OMARI

DISA TIPARE TË SHQIPES SË VJETËR (SHEK. XVI-XVII) DHE GJURMËT E TYRE NË SHQIPEN E SOTME	46
---	----

Mensur VOKRRI

E ASHTUQUAJTURA VENDORE NË MESHARIN E BUZUKUT	60
---	----

Edmond CANE

NJË NDIKIM I PANJOHUR LIDHUR ME MARKIMIN E SHUMËSIT TË EMRAVE NË SHQIP	86
--	----

Evalda PACI

DËSHMI DHE GJURMË TË LATINITETIT NË STUDIMET SHQIPTARE (VËSHTRIM HISTORIKO-KRAHASUES)	103
---	-----

Shpëtim ELEZI

ARKAIZMA NË SISTEMIN EMËROR TË SHQIPES LETRARE TË SHEKUJVE XVI-XVIII	120
--	-----

Julie KOLGJINI

REZISTENCA NDAJ PËRULJES GJUHËSORE: MARGJINALIZIMI I NJË VARIANTI
TË SHQIPES 142

Haki HYSENAJ

ZHDUKJA GRADUALE E VARIETETIT GJUHËSOR TË RUGOVËS 155

TRYEZA E DOKTORANTËVE 171

Liridona Mehmeti

LIDHORJA NË RRAFSH HISTORIK 174

BEHAR HOXHAJ

NDRYSHIMET SEMANTIKE TË PARAFJALËS *PËRMBI* TE BUZUKU KRAHASUAR
ME FJALORËT DHE GRAMATIKAT E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË
SHQIPËRISË 185

Majlinda BUSHAJ

ELEMENTE TË SHQIPES SË VJETËR NË KRAHINËN E POSTRIBËS 195

Elsa BOSHKU

TIPOLOGJIA E SHQIPES DHE PRIRJE TË FJALËFORMIMIT 210

REFERIME 226

Flamur SHALA

E ARDHMJIA E SË SHKUARËS SË DËFTORES DHE E TASHMJIA E KUSHTORES
TË FOLJEVE TË GJUHËS SHQIPE 229

LIGJËRATA

Rexhep ISMAJLI

UNIONI GJUHËSOR BALLKANIK PËRBALLË DIVERSITETIT TË
IDIOMAVE. RASTI I SHQIPES DHE I DISA IDIOMAVE SLLAVE TË
JUGUT

Seminari ynë u themelua më 1974, me një edicion që zgjati plot 20 ditë. Në të gjatë viteve çështje si këto që do të shqyrtohen sot diskutoheshin zëshëm edhe nga autoritete të gjuhësisë e të gjuhësisë ballkanike si Agnja V. Desnickaja, Erik P. Hamp, Dalibor Brozović, Haralambie Mihăescu, Norbert Boretzky, Wilfried Fiedler, e të tjerë. Ky Seminar shprehte natyrshëm atë që Fiedler-i në librin e tij të fundit – *Vergleichende Grammatik der Balkansprachen*, ASHAK, Prishtinë, e kishte permblodhur si vijon: shqipja, sipas tipit, shfaq më së shumti aspekte që merren si ballkanike. Prandaj ajo i ka shërbyer atij si pikënisje për hartimin e një gramatike krahasuese të gjuhëve të Ballkanit. Edhe vetë, gjatë gjithë kësaj kohe brenda këtij Seminari, kemi shprehur mendime lidhur me çështje që ndërlidhen me këtë problematikë. Sot do të sjellim këtu vetëm disa momente.

1. Fillet e nocionit të *unionit gjuhësor ballkanik* datojnë prej kohës së sllavistit Jernej Kopitar 1829.¹ Për diçka mund të shtrihet më herët te Johan Thunman 1774,² i cili fliste për përbashkësitë midis shqiptarëve dhe vllehve; sipas tij, afria midis dy popujve sqarohej përmes prejardhjes së përbashkët:

"Ata [shqiptarët] janë... pasardhës të ilirëve të lashtë, ashtu siç janë fqinjët e tyre vllehtë ... fëmijë të trakasve të përzier midis tyre".

Këto pohime për përzierjen në prejardhje ai i mbështeste vetëm në aspektin leksikor – mbi 60 fjalë që përkrijnë midis shqipes e rumanishtes, ndërsa për aspektin gramatikor ai nuk shprehej, sepse nuk i njihte ato gjuhë në këtë aspekt.

Sllavisti Jernej Kopitar u nis nga kjo ide dhe në bazë të krahasimit konkret të tekstit biblik *Djali plangprishës* të shprehur shqip, serbisht, bullgarisht dhe në tri dialekte të rumanishtes –

¹ Kopitar, Jernej 1929: *Albanische, walachische und bulgarische Sprache*, në *Jahrbücher der Literatur*, 46, 1829: 59-106, shih edhe rimartjen te **Bartolomei Kopitari Scriptorum. Pars secunda**. Tomus II MDCCCXXV-MDCCCXXXIV, Operi adorando parvum dr. R. Nahtigal, Laibaci, MCXLV, pp. 227-273.

² Thunmann, J. 1774: *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*, Leipzig.

dako-, a- dhe meglenorumanisht, ku gjeti jo vetëm përkime leksikore, po edhe ngjashmëri të natyrës gramatikore, për të arritur te ky formulim:

*"Kështu që ende deri sot në veri të Danubit në Bukovinë, në Moldavi dhe Zibenbyrgen, në Hungari dhe më tej në të dy anët e Danubit, në Bullgarinë e vërtetë, pastaj në tërë vargun malor të Hemusit, ... nga njëri det në tjetrin, në malet e Maqedonisë, në Pind dhe nëpër tërë Shqipërinë sundon vetëm një formë gjuhësore, por me materie të trefishtë gjuhësore."*³

"Një formë e vetme me tri materie gjuhësore", formulim që shpreh idetë e asaj kohe, por që do të mbetet për shumë kohë orientues.

Sipas tij, në aspektin gramatikor të tri gjuhët kanë të përbashkët prapavendosjen e njëjës shquese si dëshmi për ndërtimin e tyre të njëjtë. Zbërthimi i paskajores përmes lidhore me të ashtu si formimi i futurit me *volo*, del në greqishten e re ashtu si në serbishten.

Sipas Kopitar-it, tri gjuhët e hapësirës ballkanike - shqipja, bullgarishtja dhe rumanishtja, paraqisnin një formë të vetme me materie të trefishtë gjuhësore. Kjo shpinte drejtpërsëdrejti tek ideja se këto gjuhë këtë afri midis tyre do ta kenë trashëguar nga gjuhët e lashta ballkanike ilirishte-trakishte, që u zhvillua më tej në suaza të teorive të substratit të F. Miklosich-i, e që u stërhollua më tej nga F. Miklosich-i në pjesën e dytë të sh. XIX, e të tjerë, sidomos mori shprehjen më konkrete të K. Sandfeld-i 1928, i cili shtoi "*concordances générales en dehors du lexique*" (përkime të përgjithshme jashtë leksikut), si format e njëjta për të shënuar ndërtimet me *ubi* e *que*, përdorimi i dy regjimeve direkte, pastaj konkordanca midis gjuhëve të veçanta ballkanike, si vokativi në rumanishten e bullgarishten, ndërsa ndër konkordancat e përgjithshme gjenden shumë ballkanizma më të imët, e më tej, për të arritur deri në kohën tonë me përdegëzime, të cilat implikojnë vështirime së paku në disa drejtime: të *contact-induced* midis gjuhëve, historiko-krahasues, tipologjik, areal, sociolinguistik-ekologjik, etj., në kohën tonë erdhi e u zgjerua duke nxjerrë në shesh tërë gamën e studimeve gjuhësore të kohës. Sandfeld-i veçonte *mots d'emprunt* (huazime) dhe *concordances en dehors du lexique* (përkime jashtë leksikut).

³ "So daß also, noch bis auf diese Stunde, nördlich der Donau in der Bukowina, Moldau und Walachey, Siebenbürgen, Ungarn, ferner, jenseits der Donau, in der eigentlichen Bulgarey, dann in der ganzen Alpenkette des Hämus, in der ausgedehnten alten Bedeutung dieses Gebirges, von einem meere zum andern, in den gebirgen Macedoniens, im Pindus und durch ganz Albanien *nur eine Sprachform herrscht, aber mit dreierley Sprachmaterie*" (Kopitar 1829: 253).

Sandfeld-i (*Linguistique balkanique* 1928) mendonte afërsisht se kështu duhej ndërtuar një disiplinë më vete studimi për "unitetin gjuhësor" të gjuhëve ballkanike. Ai ishte në vijën e gjuhësisë historike, në suaza të së cilës do të krijohesh hapësirë për gjuhësinë ballkanike.

Nikolai S. Trubeckoj fliste për Sprachbund (lidhje gjuhësore) si për hulumtime të lidhjeve,⁴ ndërsa Roman Jakobson-i përshkruante lidhjet fonologjike.⁵ Trubeckoj e dallonte konceptin *Sprachbund* nga koncepti *Sprachfamilie* qysh në Kongresin e linguistëve 1928, duke theksuar aspektin areal, përkundër aspektit gjenetik, dhe kjo gjeti hapësirë në gjuhësinë historiko-krahasuese ballkanike.

Pas Sandfeld-it pati zhvillime, u themeluan revista si: *Zeitschrift für Balkanologie*, *Linguistique balkanique*, *Revue des études du sud-est-europeen*, etj. U mbajt Kongresi i parë ndërkombëtar i studimeve ballkanike dhe të Europës Juglindore. U botuan monografi: Schaller⁶ 1975, Solta⁷, Asenova⁸, Demiraj⁹, Steinke/Vraciu¹⁰, Feuillet¹¹, Banfi,¹² Soboljev,¹³ Mišeska-Tomić,¹⁴ etj.

2. TEORIA PËR BALLKANIZMAT

Le të themi dy fjalë për tiparet gjuhësore që janë quajtur "ballkanizma". Tradicionalisht konsiderohen ballkanizma tiparet gjuhësore që u përkasin së paku tri gjuhëve të ndryshme të kësaj hapësire, me kusht që ato të jenë të familjeve të ndryshme. S'ka kuptim të flasim për

⁴ Troubetskoy, Nikolai S. 1928: *Proposition 6*, në *Actes du premier Congrès international des linguistes*, Leiden. Për konceptet shih edhe: W. Fiedler: *Einführung in die Balkanphilologie*. In: P. Rehder, W. Fiedler (Hrsg.): *Einführung in die slavischen Sprachen. (Mit einer Einführung in die Balkanphilologie)*. 3., verbesserte und erweiterte Auflage. Wissenschaftliche Buchgesellschaft, Darmstadt 1998, S. 347–364; U. Hinrichs (Hrsg.): *Handbuch der Südosteuropa-Linguistik*. Harrassowitz, Wiesbaden 1999; N. Reiter: *Grundzüge der Balkanologie. Ein Schritt in die Eurolinguistik*. Otto Harrassowitz, Wiesbaden 1994.

⁵ Roman Jakobson: *Über die phonologischen Sprachbünde*. In: *Travaux du cercle linguistique de Prague* 4, 1931, f. 234–240.

⁶ Schaller, Helmuth 1975: *Die Balkansprachen. Eine Einführung*, Heidelberg.

⁷ Solta, Renatus 1980: *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*, Darmstadt.

⁸ Асенова, Петя 1989: *Балканско езиковедие. Основни проблеми на балканския езиков съюз*, Faber, bot.II 2002.

⁹ Demiraj, Shaban 1994: *Gjuhësi ballkanike*, Shkup.

¹⁰ Steinke, Klaus/ Vraciu, Arion 1999: *Introducere în linguistica balcanică*, Iași.

¹¹ Feuillet, Jack 1986: *La linguistique balkanique*, Paris, INALCO, coll. Cahiers balkaniques n° 10, 1986.

¹² Banfi, Emanuele: *Linguistica balcanica*, Zanichelli, Bologna, 1985; Emanuele Banfi, *Storia linguistica del Sud-Est europeo. Crisi della Romania balcanica tra alto e basso medioevo*, Franco Angeli, Milano, 1991.

¹³ Соболев, Андрей (Ed.) 2003-: *Малый диалектологический атлас балканских языков*, München.

¹⁴ Mišeska Tomić, Olga, 2006: *Balkan Sprachbund. Morphosyntactic features*, Springer.

ballkanizma në rastet e veçorive që u përkasin gjuhëve të një familjeje, si maqedonishtes, bullgarishtes e torllakishtes. Ballkanizmat kryesorë sipas Uve Hinrichs¹⁵ janë:

- fonema zanore jobuzore: *нѣм, чѣрѣ*, është
- reduktimi i rasëve: *на града, oraşului, qytetit*
- 'mënyra lokative' e numërimit: *дванадесет, doisprezece, dymbëdhjetë*
- nyja e prapavendosur: *градът, oraşul, qyteti*
- thirrortja: *Иване, Mario, κύριε*
- krahasimi analitik: *но-добре, mai bine, πιο καλο, më mirë*
- dativ adnominal: *баца ми, păru mi, ο πατέρας μου*
- përsëritja e kundrinës: *мене ме викат, l'am vëzut pe Ion, το βλέπο το βιβλίο, e merr autobusin*
- e ardhmja perifrastike me *do*: *ще напиша, o să scriu, θα γράψω, do të shkruaj*
- zëvendësimi i paskajores me lidhore: *да ида, să merg, να πάω, të shkoj*
- huazimet: *коца, coasă, kosë, κοζά*
- sistemi i komplikuar foljor

Po të vazhdojmë më konkretisht del se, ndryshe nga këto fomulime të përgjithshme, dy dialektet e shqipes shfaqin raporte të ndryshme ndaj këtyre tipareve ballkanike në rastet vijuese:

- të zanores *ə* dhe të sistemit zanor në përgjithësi;
- të kohës së ardhme të tipit *volo*;
- të zëvendësimit të paskajores me lidhore dhe
- të huazimeve.

Kjo do të thotë se në interpretimet e tilla toskërishtja duket më “ballkanike” se gegnishtja. Në atë rast kërkohen shpjegime dhe mbështeten hipotezat për qenien e toskërishtes e të dakorumanishtes afër njëra tjetrës, apo për pasjen midis tyre të një nënshtrese të përbashkët. Zhvendosja dhe largimi hapësinor midis tyre do të ketë ndodhur, sipas atyre që mbështesin këtë ide, më vonë. Te këta autorë supozohet se toskërishtja do të ketë lëvizur drejt jugut ose dakorumanishtja drejt veriut.¹⁶ Hipotezat e tilla duan shqyrtim konkret për tiparet e veçanta. Për to kemi diskutuar në ligjëratën e Seminarit të kaluar.

¹⁵ Hinrichs, U. 1999: **Handbuch der Südosteuropä Linguistik**, Harrassowitz, Wiesbaden, 432

¹⁶ Ismajli, R. 2015: **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë.

3. SISTEMI I ZANOREVE

Këtu do ta marrim në vështrim pohimin e ballkanologes së njohur bullgare Petja Asenova (Петя Асенова) të shprehur në librin *Балканско езикознание* sipas botimit të vitit 2002 në faqen 28 për sistemin e zanoreve:

"Gjuhët e Ballkanit në thelb paraqesin një sistem identik të zanoreve, që karakterizohet nga theksi dinamik (ekspirator), mungesa e gjatësisë funksionale, e hundorësisë fonologjike dhe e hapjes fonologjike".

Ngjashëm kanë vepruar autorët K. Steinke dhe A. Vraciu (Steinke, Klaus/ Vraciu, Arifton 1999:98). Duke u nisur nga sistemet zanore të gjuhëve përkatëse standarde ashtu si janë paraqitur ndër vepra apo autorë që ata i konsiderojnë përfaqësues, kanë sjellë pasqyrën vijuese:

greqisht	maqedonisht	bullgarisht	rumanisht	shqip
ι ου	и у	и у	і î u	і y u
ε о	е о	е о	е ă о	е ë о
α	а	а	а	а
Humbert	Lunt	Stojkov	Rosetti	Demiraj
Triandiphyllidis				

Përveç se kemi të bëjmë me gjuhët standarde, që nuk mund të jenë referencë për ballkanizmat, pra, për konceptin e unionit (*Sprachbund*), në këtë pasqyrim kemi dhe paraqitje jo krejtësisht reale: në trekëndëshin e shqipes zanoret *y*, *ë*, *a* paraqiten në vijë të njëjtë vertikale, që do të thotë se përnga vendi i formimit duhet të jenë të tria qendrore, ndërkohë që zanorja *y* e shqipes është e përparme dhe në kundërvënie me *i* si jobuzore, me *u* si jo e prapme, as qendrore, po e përparme, ndërsa *ë* është qendrore e mesme dhe *a* qendrore e ulët; ngatërresa bëhet nëse shihet sistemi i rumanishtes, ku nuk ka zanore buzore të përparme, por ka zanore të ngritjes së lartë qendrore jobuzore (Steinke-Vraciu 1999:98). Më tutje ata pohojnë:

*"... Jemi të mendimit se mungesa e korrelacionit të kuantitetit, të shkallës së hapjes dhe të hundorësisë, ashtu si numri i vogël i fonemave që dalin nga këndeja, në një rajon gjeografik kompakt, paraqesin një veçori të përbashkët të të gjitha gjuhëve që janë atje dhe përbën diçka tipike dhe jo të rastësishme për to. Me të drejtë do të njihet zanorja *ë* edhe ajo si një ballkanizëm" (Steinke-Vraciu 1999:100).*

Më tej konstatojnë se gjuhët ballkanike historikisht kanë dalluar midis tyre në këtë pikë; latinishtja, greqishtja e vjetër dhe protosllavishtja kanë pasur një korrelacion gjatësie, gjithsesi në përmasa e konstelacione të ndryshme për secilën, ndërsa sllavishtja ka pasur dhe zanore hundore. Për shqipen linin vetëm mundësinë e hipotezave, sepse, siç lënë të kuptohet, mungokan të dhënat). Studiuesit e përmendur i japin hapësirë shqyrtimit të mundësisë që zanorja ë të jetë, sipas Cicerone Poghirc-ut, nga substrati trako-dak, gjithë duke e lënë këtë çështje të hapur.¹⁷

Por, siç shihet nga paraqitja e sistemit të shqipes së sotme, ashtu si në dokumentet e para (Buzuku 1555 dallonte në gegnishten e tij veriperëndimore zanore të gjata dhe të shkurta, ashtu siç dallonte edhe Matranga 1591 në arbërishten e tij toske). Gjatësia ishte tipar i shqipes në të dy dialektet. Zhvillimet që diferencuan dy dialektet duan shpjegim tjetër nga ai i unionit, brenda historisë së shqipes. Por edhe aty shtrohet çështja e arealit/ hapësirës brenda së cilës një pjesë e bashkësisë gjuhësore e ruajti gjatësinë pa shkallë të hapjes, ndërsa pjesa tjetër e kombinoi atë me elementin e shkallës së hapjes, gjithsesi edhe në ndërlidhje me hundorësinë.¹⁸ A kemi në atë rast ndonjë bazë për të supozuar kontakte më intensive me sisteme të tjera që nuk e përzgjidhnin atë element të dytë, por as kishin gjatësi?

Autorët, megjithatë, konstatojnë se gegnishtja paraqet një pozitë të veçantë sa i përket sistemit zanor. Pas diskutimeve për sistemet prozodike lidhur me pyetjen nëse ka tipare fonologjike të përbashkëta për gjuhët e Ballkanit, karakteristike për unionin ballkanik, sjellin gjykimin vijues të gjuhëtarit të shquar serb Павле Ивић nga Kongresi ballkanologjik i Sofjes më 1966:

*“Gati se nuk ka tipare karakteristike të përbashkëta për sistemet fonologjike të të gjitha idiomave ballkanike. Ajo që i bashkon shtrihet thuaja gjithandej në gjuhët europiane”.*¹⁹

¹⁷ Cicerone Poghirc beson se zanorja ă shfaqet në hapësirat e trakishtes. Shih *La valeur phonétique de l'oscillation graphique thrace a/e à la lumière des données des langues balkaniques modernes*, në **Studii clasice III**, 1961, ff. 33-37. Steinke/ Vraciu kanë pasiguri lidhur me këtë besim.

¹⁸ Edhe ndër hundoret dallohen të gjatat nga të shkurtat, ndërsa shkalla e hapjes bëhet më evidente. Shih Ismajli, R. 1977: *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, në **Gjurmime albanologjike**, Seria filologjike VII, 1977, Prishtinë 1978, ff. 229-256, rimarrë te **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Prishtinë, 1987, ff. 105-146.

¹⁹ "Il n'y a presque de traits vraiment caractéristiques communs aux systèmes phonologiques de tous les idiomes balkaniques. Ce qui les lie est répandu presque partout dans les langues européennes", në **Actes du Premier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes**, Sofia, 1966, vol VI, Sofia 1968, f. 140).

Dhe kjo e vë në dyshim tërë projektin në këtë ddimension. Dy dialektet kryesore të shqipes në këto pika dallojnë midis tyre. Gegnishtja duket të jetë më pak "ballkanike": ajo ka gjatësi funksionalisht dalluese të zanoreve, ka zanore hundore, ndërsa tipari i hapjes duket të jetë shoqërues i zanoreve të shkurta. Në dokumentet arbëreshe të sh. XVI-XVII (pra toske) janë shënuar gjatësitë e zanoreve, si në shumë pika të toskërishtes ballkanike më herët, edhe në sh. XX, po edhe në dialektet arkaike arvanite.

Sistemi zanor i shqipes duket më kompleks se kaq, vetëm pjesërisht mund të konsiderohet 'ballkanik' në kuptimin e sipër. Shqipja ka zanore të përparme buzore y, që nuk ekziston në gjuhët e tjera ballkanike, pos turqishtes; ajo është më e vjetër se kontaktet e shqipes me turqishten, e cila ka tjetër tip të sistemit zanor. Sistemi i zanoreve të turqishtes është si vijon:

i	ü	ı	u
e	ö		o
a			ā

sistemi zanor i turqishtes

Dallimi midis zanoreve të gjata dhe zanoreve të shkurta në këtë gjuhë vlen vetëm për *a/ā, i/ī e u/ū*. Kemi kundërvënie të zanoreve të përparme [*i, ü, e, ö, a*] me zanoret e prapme [*ı, u, o, ā*]. Zanorja <ı> [u] e turqishtes është e ngritjes së lartë, e prapme, e tërhequr, çka e bën të ndryshme nga zanorja [ə] qendrore dhe e mesme e gjuhëve të Ballkanit, ashtu si nga zanorja <î> e rumanishtes, që është e ngritjes së lartë, por e mesme. Pos kësaj, në turqishten vepron ligji i harmonisë vokaliqe. Si i tillë, ky sistem dallon dukshëm nga sistemet e zanoreve të gjuhëve ballkanike, në të cilat, gjatë përshtatjes së fjalëve turke ndodh që me [ə] të jepen edhe zanorja <ı>, edhe zanorja [ö]. Zanorja <ı> e turqishtes është e ngritjes së lartë, e prapme, e tërhequr, ndërsa [ö] është zanore e përparme e ngritjes së mesme, buzore, të dyja në kontrast me [ə] të gjuhëve të Ballkanit, që është e mesme e qendrore, jobuzore, as e përparme, as e prapme.

shqipja e jugut ka pak a shumë këtë sistem zanorësh (Ismaili 2003: 79):

i (y) | u
e ë o
a

sistemet e zanoreve ballkanike me 5 zanore në macedonishten e gregishten:

i u
e o
a

sistemi i zanoreve të bullgarishtes me një zanore qendrore:

i u
e ъ o
a

sistemi i zanoreve të rumanishtes me dy zanore qendrore:

i î u
e â o
a

në të folmet geqe është i qartë dallimi midis zanoreve të shkurta dhe zanoreve të gjata në pozitë të theksuar, ashtu si dallimi midis zanoreve gojore e hundore:

gojore				hundore			
ī	ȳ	ū		ĩ	ȳ̃	ũ	
ĩ	ȳ̃	ũ		ĩ̃	ȳ̃̃	ũ̃	
ē	̃(ə)	ō		ẽ		-	
ẽ		õ		ẽ̃		-	
ā	ā̃			ā̃	ā̃̃		

Ndërkaq, toskërishtja, sa i përket sistemit të zanoreve, është bërë më "ballkanike" në kohë të vona. Këtu do të hynte shuarja e dallimit të zanoreve *buzore/ jobuzore* te zanoret e përparme të ngritjes së lartë *i/y* në të folme toske, sidomos në arvanitishte, po edhe në disa të folme geqe (p.sh. në të folmen e zonës së Bujanovcit, në të folmen e Dirës, etj.). Mungesa e kundërvënies së buzorësisë te zanoret e përparme të ngritjes së lartë në disa të folme toske mund të shkojë deri në sh. XV; ka dhe të folme geqe që e kanë humbur këtë dallim, por shumë më vonë. Në të dy rastet janë dy burime interaktive për këtë ndryshim: rendimenti funksional brenda sistemit, sipas konceptimit të Martinet-së, dhe kontakti me gjuhët fqinje, në të cilat ajo nuk ekziston. Në sistemin e shqipes zanoret e prapme të ngritjes së lartë e të mesme janë dhe buzore, ndërsa zanoret e përparme, përveç <y>-së, jobuzore. Kjo ka krijuar paqëndrueshmëri dhe ka lënë hapësirë për përshtatje që kanë përfunduar me shuarje të kundërvënies *y/i* ndër të përparmet.

Kemi një pikë krahasimi midis toskërishtes, bullgarishtes e rumanishtes, e që është: zanorja qëndrore <ë, ă, ɐ>. Do shtuar po ashtu se në këtë pikë rumanishtja dallon për shkak se ka dy zanore qëndrore - <î> të lartë dhe <ă> jo të lartë - dhe diftongjet <ea, oa>, pra një sistem të ndryshëm nga i toskërishtes, ashtu si nga sistemi i bullgarishtes-maqedonishtes.²⁰

Sistemi bashkëtingëllor i të gjitha dialekteve të shqipes dallon nga sistemi i gjuhëve të tjera ballkanike sa u përket bashkëtingëlloreve ndërdhëmbore (pos greqishtes), si dhe sa i përket kundërvënies së dy dridhëseve <r/rr> sipas intensitetit/ kuantitetit. Në kuadër të qiellzoreve/ paraqiellzoreve ka dallime të vogla midis të folmeve mbase për pasojë të kontakteve me gjuhët e tjera. Mund të hetohen dallime dhe sa u përket sonanteve, sidomos anësoreve.

Hundorësia e zanoreve në gegnishten ndërlidhet me rotacizmin në toskërishten në fillimet e procesit dhe me tendencën e krijimit të rrokjes së hapur. Atje ku ka ndodhur rotacizmi dallimi /n/ është zgjidhur në vijim dhe me mungesë hundorësie të zanores, por me ndryshim në cilësinë – si centralizim. Tipari i mungesës së nazalizmit do interpretuar si specifik brenda zhvillimeve dialektore dhe nuk lejon supozime për ndonjë ndarje të mëhershme.²¹

Konteksti ballkanik ose tjetër në rastet e tilla ka luftur rol me rëndësi: në toskërishten ka çuar drejt shuarjes së vlerës dalluese të kuantitetit të zanoreve.

Nga përkufizimi i cituar i Acehova-s, që si bazë të përbashkët merrte

1. theksin eksplorator (dinamik);
2. mungesën e gjatësisë funksionale të zanoreve;
3. mungesën e hundorësisë dhe
4. mungesën e tiparit të hapjes fonologjike,

mbetet pak gjë.

²⁰ Për sistemet e rumanishtes shih Emanuel Vasiliu 1965: **Fonologia limbii române**, București, f. 112 dhe pjesa parashkuese; Emanuel Vasiliu 1968: **Fonologia istorică a dialectelor dacoromâne**, București, ed. Academiei Republicii Socialiste România. Sipas Vasiliu-t, koncepti dialekt dakorumun nuk është gjenetik, po më parë tipologjik. "*Dialektet dakorumune, heterogjene nga aspekti i vështirimit gjenealogjik, arrijnë të zhvillohen drejt në 'tipi dakorumun'.* Zhvillimi pra ka shkuar nga diversiteti gjenetik drejt një 'tipi dakorumun'." f. 194.

²¹ Shih Ismajli, R. 1971-1972: *Edhe diçka rreth rotacizmit në gjuhën shqipe*, në **Dituria** 2/3, Prishtinë; Ismajli, R. 1972: *A propos de la quantité vocalique en albanais*, në **Akten des internationalen albanologischen Colloquiums 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl**, Hrsg. von H. Ölberg, Innsbruck 1977: 367-373; shqip *Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara të shqipes*, në **Gjurmime albanologjike, Seria shkencat filologjike**, III, 1973, ff. 57-62.

Po shihet se në gjendjen e sotme theksi në shqipen është i lidhur me temën e fjalës, është ekspirator, dhe paraqet pozitë informative në të cilën kemi dallime midis zanoreve sipas gjatësisë. Involvimi i shkallës së hapjes në kuadër të kuantitetit të zanoreve e ka bërë më komplekse tërë gjendjen dhe ka ndihmuar që zhvillimet të shkojnë drejt dy skajeve: të përgjithësimit të dallimit cilësor, sidomos te zanoret jo të larta, ose drejt zhdukjes së vlerës dalluese të kuantitetit.

4. BALLKANIZMAT MORFOSINTAKSORË

Në listat e Uwe Hinrichs-it 1999 si ballkanizma morfosintaksorë numërohen këto:

- reduktimi i rasëve,
- mënyra e të numëruarit,
- nyja e prapavendosur,
- thirrvoja,
- krahasimi analitik,
- dativi adnominal,
- përsëritja e kundrinës,
- sistemi i komplikuar i foljeve dhe
- disa shtresa leksikore.

Lidhur me këto veçori nuk janë vënë re dallime thelbësore "ballkanike" midis toskërishtes dhe gegnishtes. Ka dallime sa i përket paskajores: gegnishtja ka një paskajore me parafjalën *me/pa punue*, që përdoret në disa funksione edhe pse ka dhe lidhore, ndërsa në toskërishten ekziston privativi *pa punuar*, ndërsa zëvendësimi i paskajores me *me* nga lidhja është i zakonshëm. Ky zëvendësim nuk duket të jetë i vjetër sa rotacizmi. Ndërkaq Beci konsideronte se të dy këto veçori kanë ngjarë para sh. VI. Ne na duket se rotacizmi do të ketë përfunduar nga fundi i sh. VIII. Edhe Bokshi mendonte kështu.²² Ky përfundim mund të arrihet në bazë të konsideratave lidhur me rënien e bashkëtingëllores *-n* fundore tek emrat si *kroi*, *ftoi* në kontrast me *druni/druri*, etj.).

Sipas Bokshit, duke u mbështetur në kohën kur u shfaqën parafjalët *me* dhe *pa*, duhet të nxjerrim përfundimin se tipi i paskajores *me punue* mund të jetë shfaqur në shqipen e

²² Bokshi, Besim 2010: **Periodizimi indryshimeve morfologjike të shqipes**, ASHAK, Prishtinë, f. 129)

përbashkët nga fundi i sh. V, ndërsa zëvendësimi i paskajores me lidhore në toskërishten duhet të jetë më i vonë, midis sh. X e XIII, kohë kur paskajorja me *me* ishte e barabartë me lidhoren, prandaj u bë e mundshme të mbisundonte lidhorja në zonat ku kontaktet me greqishten bizantine ishin më të dendura (Bokshi 2010:166). Në një kuptim, me këtë lidhet dhe çështja e së ardhmes perifrastike e tipit *volo*, që karakterizon toskërishten në raport me gegnishten, e cila dallon të ardhmen e domosdosë me *kam* nga e ardhmja me *do*. Sido që të jetë, diskutimet kanë theksuar se dhe në toskërishten mund të ketë ekzistuar një raport tjetër në këtë aspekt: ekzistenca e një të ardhmeje të tipit *kat bënj* të përdorur nga arbëreshët dhe evidenca e ndërtimeve të ngjashme ndër arvanitë e bëjnë të mundshëm diskutimin për karakterin ballkanik të këtij dallimi dialektor si diçka që ishte krijuar përmes ndikimeve më të vonshme nga konteksti fqinjësor dhe raportet me greqishten bizantine ashtu si me kompleksin e gjuhëve të ballkanizuara, si arumanishtja, maqedonishtja e bullgarishtja. Nuk mund të përjashtohet komponenti roman.

Lidhur me ngjashmëritë midis toskërishtes e rumanishtes ka pasur diskutime të gjera, sidomos sa i përket zanores ë, rotacizmit dhe numërimit nga 11-19 (*un spre zeci – një mbë dhjetë*; këtë e kemi dhe në sllavishten: *edin na desët*: *edinaeset, jedanaest*), ashtu si leksikut të përbashkët. Në bazë të diskutimeve lidhur me afinitetet e veçanta të toskërishtes, me dakorumanishten, janë ngritur hipoteza të ndryshme sa u përket raporteve të tilla në të kaluarën dhe hapësirave ku kanë ndodhur ato (Ismajli 2015).

5. SISTEMI I NYJAVE

Në gjuhët sllave të jugut që kanë një shquese, ajo vjen vetëm prapa dhe bashkë me emrin. Në maqedonishten kemi tri forma të nyjës në shoqërim me deiksin: *-va, -ta, -na; -ot, -ov, -on*:

mashk.	fem.
<i>čovek-ot</i>	<i>žena-ta</i>
<i>čovek-ov</i>	<i>žena-va</i>
<i>čovek-on</i>	<i>žena-na</i>

Në shqipen e në rumanishten nyja është e prapavendosur, por ka dhe një përdorim kopulativ brenda grupit nominal, ashtu si përdorimi i nyjës së përparme, si e pashquar.

Koment: Selman Riza,²³ rimerrte mendimin e Dhimitër Kamardës të vitit 1864 për bashkëpërkimin e nyjës shqese të shqipes me të greqishtes: *hi he to/ i e të* kemi një veçori areale të përbashkët. Në shqipen nyja shqese ishte krijuar nga përemri në pozitë të *paravendosur*, ndërsa më vonë përmes ndryshimeve në renditjen dhe proceset përkatëse sintaksore u bë *e prapavendosur* dhe në ato procese ndodhi që të kemi dhe një nyjë të paravendosur në grup si te gjinorja, apo te mbiemrat (shih Bokshi, Nyjat.).²⁴

Stefan Schmacher tash vonë²⁵ po ashtu vinte me idenë se nyja shqese ishte një fenomen i hershëm areal në Europën jugore dhe se në latinishten e në greqishten ishte krijuar në kohën kur në rasën dhanore kishte rënë *-m* fundore, çka do të ketë ndodhur edhe në shqipen.

Bokshi po ashtu dhe më herët mendonte se nyja shqese u krijua në pozitë të paravendosur dhe jipte shpjegime të hollësishme për proceset që supozonte se do të kenë ndodhur gjatë kalimit në pozitë të prapavendosur. Lidhur me *-n* të kallëzores në shqipen Bokshi, studimi i të cilit nuk referohej nga Schumacher-i, kishte shpjegim tjetër - *-n(ë)* të kallëzores ai e shihte rezultat të shkrirjes **n-+të*, proces më i vonë.

Sipas Bokshit, krijimi i nyjës lidhet me përemrat, siç tregon gjendja ende jo krejt e përfunduar në maqedonishten. Ai mendonte se nyja shqese e prapavendosur u krijua në shqipen, kjo pati mundësi të ndikonte në rumanishten diku në proceset e sh. VII-VIII, ndërsa rumanishtja në bullgarishten-maqedonishten më vonë.

Le të kthehemi te diskutimi ynë themelor. Në fillim të viteve '60 të sh. XX Günther Reichenkron kishte konstatuar:

"Është thënë nga shumë anë se gjuhët e Europës juglindore, që quhen gjuhë ballkanike, paraqesin një radhë tiparesh të përbashkëta... Janë të dyja, karakteri i lashtë indoeuropian i ruajtur në shkallë të ndryshme në gjuhët greke dhe shqipe; të tri gjuhët sllave: bullgarisht, serbokroatisht dhe sllovenisht; romanishtja rumune dhe deri në njëfarë shkalle gjuhët joindoeuropiane turqisht e hungarisht".²⁶

²³ Selman Riza, *Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten*, studimi i përgatitur për Kongresin e ballkanologëve të Sofjes më 1966 si *Sur une concordance grammaticale spécifique de l'albanais avec le grec*, ishte shtypur si material i Komitetit Kombëtar të AISEE-së, por nuk ishte lejuar të çohet në Kongres, as të botohet sa që gjallë autori, për arsye mospajtimesh brenda atij Komiteti. U botua pas vdekjes te *Studime* 10, 2003 dhe në S. Riza, *Vepra IV*, ASHAK, Prishtinë 2004, ff. 91-114.

²⁴ Besim Bokshi 1984: **Prapavendosja e nyjës në gjuhët e Ballkanit**, Rilindja, prishtinë...

²⁵ Stefan Schumacher, 2009: *Lehbeziehungen zwischen Protoalbanisch und balkanischem Latein bzw. Romanisch*, in Oliver Jens Schmitt und Eva Frantz (Hrsgb): **Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung**, München, ff. 37-60, sidomos 56-58.

²⁶ Günther Reichenkron 1962: *Der Typus der Balkansprachen*, në **Zeitschrift für Balkanologie** 1, f. 91.

Në atë kohë ishte politikisht korrekte të flisje për gjuhë serbokroate (brenda saj kuptoheshin ato që sot njihen si serbishte (edhe më herët), kroatishite (edhe më herët), bosnishte dhe malazezishte), por jo edhe vetëm për gjuhë bullgare, sepse kishim edhe gjuhë maqedonase. Sot është politikisht korrekte të flitet për gjuhë *serbe*, gjuhë *kroate*, gjuhë *bosnase* (*bosnisht boshnjakisht*), gjuhë *malazeze*, gjuhë *bullgare*, gjuhë *maqedonase*. Sllovenishtja mbetet jashtë. Në këtë numërim mungojnë *arumanishtja*, *meglenorumanishtja*, *istrorumanishtja*, *dalmatishtja*, *judeospanjishtja*, *romishtja*. Sa janë ballkanike kroatishitja dhe bosnishtja? A ka elemente ballkanike në malazezishte? Sa ballkanike është serbishtja? Duket evidente se në studimet ballkanistike nuk është e drejtë të flitet vetëm për gjuhë, po më tepër për varietete rajonale-dialektore të tyre (janë evidentuar fenomene ballkanike në të folme të Malit të Zi të jugut, ashtu siç ka shumë të tilla në varietetin e serbishtes të nujohur si torlački).

Situata sllavojugore, jashtë domenit të bullgarishtes-maqedonishtes, zbërthehet në *narečja* (dialekte që mund të kuptohen edhe si diçka më shumë): *čakavsko*, *kajkavsko*, që lidhet me sllovenishten, dhe *štokavsko narečje* e përbashkët për kroatishten, serbishten, bosnishten, malazezishten. Por cili është raporti midis *štokavsko narečje* dhe *torlački*? A përbën *torlački narečje* të veçantë, apo është pjesë e *štokavski*? Serbistët mendojnë se bën pjesë në shtokavski. Ç'të themi për tiparet ballkanike që shfaqen në disa zona jugore të Malit të Zi?, cilat janë raportet midis tyre dhe atyre të torllakishtes?

Dialekti i quajtur *prizrensko-timočki*, mendojnë gjuhëtarët serbë, hyri në rrjedhat e *zhvillimeve* ballkanike. Mbase një rol me rëndësi aty do ta ketë luajtur kontakti me idiomat romane të vllëve, apo ndoshta ka edhe diçka tjetër? Fjala është për atë zonë të cilën Павле Ивић e vendoste kështu: fillon diku midis Deçanit e Gjakovës e shkon deri te Zajëçari dhe në kufirin me Bullgarinë e me Maqedoninë.

*“Është e qartë se afërsisht nga sh. XII-XIII të folmet Timok-Lužnica, ndërsa në sh. XIV të folmet Prizren-Moravë e Jugut, kanë dalë nga bashkësia zhvillimore shtokaviane”.*²⁷

Sipas Ивић-it, është për të besuar që kjo gjë ka ndodhur në lidhje me zgjerimin territorial të këtyre të folmeve në lindje dhe juglindje. Ai nuk linte pa përmendur se aty përfshihej territori më parë i banuar nga popullata baritore romane (vllahe), ndërsa ekspansionin e shtetit të nemanjidëve nuk e shihte si faktor të dorës së parë. Ai theksonte po ashtu se këto hapësira politikisht në Mesjetë nuk i përkisnin Serbisë dhe supozonte se do të jetë fjala për lëvizje të

²⁷ Ивић, П. 1956: Дијалектологија српскохрватског језика, Нови Сад, f. 120.

popullatës baritore në kërkim të kullotave të reja. Në këtë rrjedhë nuk kuptohet mbase pohimi i bërë gjetiu se vatra e shpërnguljeve do të ketë pasur drejtim nga Prizreni drejt Timokut, as edhe për faktin se rrjedhat që ai i quan ballkanike në këto të folme janë më afër me të bullgarishtes e të rumanishtes se me të shqipes.

“Është e qartë gjithsesi se dialektet e zonës Prizren-Timok kanë hyrë në sferën zhvillimore të Unionit gjuhësor ballkanik dhe se kjo kthesë nuk është më e vonë se shekulli XV” (ИВИЋ (1956), 121).

E tërë kjo implikon se do të ketë pasur një hapësirë ndarëse, por pse bash rreth kufijve politikë? van Wijk mendonte se kishte një pykë gjuhësore që ndante serbishten nga bullgarishtja dhe në atë hapësirë madje mendohej se ishte folur dikur shqipja që më vonë u shpërngul drejt jugut.²⁸

Historiani i njohur serb Sima Ćirković (Сима Ћирковић), në parathënien për librin **The Serbs**, të botuar te Blackwell 2004, nuk ngurronte që për një mestitull të kësaj paraqitjeje të përmbledhur të adoptonte shprehjen domethënëse të historianit tjetër serb St. K. Pavlović (Ст. К. Павловић)– *Shifting Serbias – Serbitë zhvendosëse (lëvizëse)*, etj. Sipas tij, ky emërtim shprehte faktin se

*“mobiliteti ishte aq i papushueshëm sa për shekuj populli nuk e vendosi dot lidhjen me një territor të caktuar... ”.*²⁹

Fillimisht serbët u ndodhën në rrafshinat në jug të Savës e Danubit, hapësirë kjo e përshtatshme për kolonizim e ekonomi bujqësore; në vijim serbët banuan pjesët malore të Alpeve Dinarike (Travunija, Zahumlje), pastaj u hynë rrugëve nëpër luginat e lumenjve Morava drejt Selanikut, apo drejt Sofjes nëpër Nishava; ishin fqinj me kroatët dhe shtriheshin më vonë deri te lumi Ras (*Rashka* në Sanxhak, sipas *Ars* të lashtë) dhe vetëm pas rënies së Perandorisë Bullgare në vitin 1018 nisën të shtriheshin në Bizant nga Ras e përreth. Pas rënies së Bizantit më 1204 pushtuan hapësirat e Kosovës deri te Mali Shar... Serbia u përtërit nga Habsburgët në vitet 1716-1739, por në hapësirat midis Moravës Perëndimore e Danubit, ndërsa më 1815 u rivendos shteti serb, i cili më 1878 u zgjerua me 4 distrikte dhe më 1913 mori Kosovën dhe Maqedoninë.³⁰

²⁸ van Wijk, 1923: *Taalkundige en historische gegevens betreffende de oudste betrekkingen tussen Serven en Bulgaren*, në *Mededelingen der Koninklijke Akad. van Wetenschappen, Afd. Letterkunde*, deel 55, ser. A, Amsterdam, ff. 55-76.

²⁹ Burimi: “*Mobility was so incessant that for centuries people did not establish lasting links with a definite territory...*”, Sima Ćirković 2004: **The Serbs**, të botuar te Blackwell 2004, f. XXI.

³⁰ Sima Ćirković, **The Serbs**, Blackwell, 2004, f. XXIV, ne themi pushtoi, si në rastin e maqedonisë.

Pra, mund të bëhen dy lloje vërejtjesh: e para, kontaktet intensive midis shqipes dhe varietetit sllav që do të bëhet specifikisht serbishte mund të jenë pak më të vona dhe mund të kenë lëvizur; gjithsesi kontaktet me dialektet serbe kosovsko-resavski, ashtu si me prirensko-timoçi duken më të vjetra, prandaj aty dalin dhe vështirësi diferencimi në raport me rrethimin tjetër sllav të jugut. Kontaktet me varietetet maqedonisht-bullgarisht kryesisht në jug dhe në lindje të hapësirave ku flitej shqipja duan parë dhe në kontekstin që shkaktoi zhvillimet e atyre varieteteve në raport me varietetin sllav më të hershëm; në të dy anët e këtyre variacioneve sllave në hapësirat ku ato do të kenë pasur kontakte me shqipen ka pasur prani të ndjeshme romane (vllahe) për çka flasin gjurmët e shumta toponimike, po edhe të tjera. Nga ana tjetër, të gjithë kishin një raport të caktuar ndaj shtresës kulturore që përfaqësonte Bizanti me greqishten, sidomos në raport me krishtërimin, që te sllavët ndodhi kryesisht në sh. IX, ndërsa tek arbërit kishte ndodhur më herët (ashtu si te romanët). Por vetë shtresëzimi i greqizimeve të asaj dhe të kohëve të mëvona në shqipen shfaq dualizmin dialektor të shqipes.

Gjithsesi kemi një situatë mjaft komplekse. Tërë kësaj i shtohen dy aspekte të tjera: a. në njërin anë kemi aspektin e sundimeve shtetërore sllave, ndërsa, në anën tjetër, b. Raportin e ndryshëm ndaj dy varieteteve të krishtera ndër arbërit, sidomos atje ku dhe kur sllavishtja u bë gjuhë e kishës në veri, ku greqishtja nuk ishte e njohur nga kontaktet e pandërmjetme jashtë kishës.

Sundimet shtetërore sllave në hapësirat jugore e juglindore (pra bullgare) janë shtrirë në sh. IX-XI, ndërsa sundimet sllave të varietetit serb në pjesët veriore, më vonë edhe më në jug, janë kryesisht të sh. XII-XIV. Një pjesë e madhe e leksikut sllav në shqipen vjen nga këto kohë. Del krejt e nevojshme të hetohet sa është e mundur raportet midis shqipes veriore dhe dialekteve serbe staroštokavski. Nuk është madje e vështirë as të bëhet ndonjë shtresëzimi në këtë aspekt për një numër jo të vogël të sllavizmave.

Por probleme të ngjashme të përqëndrimit të tufave të izoglosave mund të ndeshim edhe në rastin e shqipes përgjatë vijës Shkumbin/ via Egnatia, po pastaj edhe brenda hapësirave të gegnishtes. A kemi shpjegime për to? A kemi procese ballkanizimi, apo nyjëtime të natyrave të tjera të bashkësisë së folësve? Të çfarë kohe janë ato?

Tani shtrohet pyetja më tej: a ka Sprachbund apo jo?

Sipas Vladimir Georgiev-it³¹ kemi të bëjmë me një proces afrimi midis gjuhëve të Ballkanit drejt shkrirjes që ka zgjatur tashmë mbi 3 mijë vjet, por që ka mbetur në gjysmë të rrugës. Alexandru Graur,³² Andriotis, N. P.-Kouroumlis, G.³³ etj – mendojnë se nuk kemi union, por procese që duan shpjegime të ndryshme në rrugët e veçanta. Diskutimet kanë qenë të vazhdueshme.

Kështu konkretisht në situatat ballkanike qendrore kërkohen shpjegime për kushtëzimet për ato që u quajten krijime ballkanike. Për të mbetur te domeni i serbishtes juglindore, le të shohim se në sh. XI-XII flitet për prani të madhe vllersh në zonat në lindje të Sofjes deri në Nish, aq sa krijuan mbretërinë vllaho-bullgare. Më tej aty kemi entitete të tjera si *shopë*, *shopishte*, *torllakë*, *torllakishte*, pastaj ndarje dialektore brenda torllakishtes midis *prizrensko-južnomoravski* dhe *zaplanjsko-svrliški* dhe për shkrirje midis *torlački* e *makedonski* në pjesë të Gorës deri te fshati Brod.

Po ta shohim nyjëtimin e shqipes, do të hetojmë një përqëndrim izoglosash në vijën Shkumbin/ via Egnatia, që lidhet me tiparin e rëndësishëm të rotacizmit, e që vështirë se mund të shpjegohet brenda proceseve të Sprachbundit ballkanik.

Pastaj kemi ndarjen toskërishte – labërishte dhe çamërishte, ndërsa në veri të Shkumbinit kemi gegnishten qendrore, pastaj gegnishten veriore, perëndimore e lindore, të ndërthurur me gjuhën e fiseve e të rrafsheve, në një anë, e me ndarjen në gegnishte lindore/perëndimore që ngërthen qendroren.

6. FIEDLER

Në studimet e tij për shqipen vëmendjen e Wilfried Fiedler-it e tërheqin ato që lidhen me sistemin foljor të saj të përkapur në përjasje me gjuhët e tjera të Ballkanit. Në ndërlidhje me këto dy pika do të përmendja studimin e tij të rëndësishëm “*Ist das Albanische ‘dem Typus nach’, die entscheidende Sprache der ganzen balkanischen Gebiets?’*” [A është shqipja “sipas tipit” gjuha vendimtare e të gjithë rajonit të Ballkanit?] Ai propozonte të përshtatej një karakterizim *areal-tipologjik*. Në vijim të Ernst Levy-ut “*Der Bau der europäischen*

³¹ Georgiev, Vladimir 1968 : *Le problème de l'union linguistique balkanique*, në **Actes du premier Congrès International des Études Balkaniques**, Sofia, vol. VI (Linguistique), Sofia, pp. 7-19.

³² Graur, A. 1936: *Coup d'oeil sur la linguistique balkanique*, në **BL IV**, ff. 31-45.

³³ Andriotis, N. P.-Kouroumlis, G. 1968: *Questions de la linguistique balkanique et l'apport de la langue grecque*, në **Actes VI**, Sofia, pp. 21-30.

Sprachen”, Dublin 1942, ai shihte më parë varësitë e ndryshueshmërisë brenda një sistemi gjuhësor dhe pastaj brenda një sistemi të përbashkët të arealit ballkanik. Theksonte pamjaftueshmërinë e konceptit për kuadrin e ‘*Sprachbundit*’ ballkanik me 4 a 5 anëtarë.

“Më tepër jemi të mendimit se Ballkani – krahasuar me rajonet e tjera të pjesës sonë të globit – paraqet vetëm një ngjeshje të izoglosave të të përbashkëtave të kushtëzuara nga interferencat brenda gjuhëve të Europës dhe të hapësirës së afërt”.

Sipas këtij koncepti, do të duhej të shihnim a mos ka diçka si bërthamë areale (*Arealkern*), ku ndikimet e interreferencave do të shiheshin më së qarti. Në atë rast gjuhë ‘*vendimtare*’ nuk do të ishte ajo prej së cilës në radhë të parë shkojnë ndikime drejt gjuhëve fqinje, po e tillë do të ishte

“ajo gjuhë që do të duhej të kishte raporte intensive interference me shumë gjuhë fqinje”.

Se shqipja mund të jetë gjuha ‘*vendimtare*’ ballkanike në kuptimin areal-tipologjik, këtë Fiedler-i përpqej ta mbështeste më së qarti në këtë mënyrë:

“brenda tipave të shënuesve karakteristikë për Ballkanin në përgjithësi, tipat e shënuesve të shqipes do të duhej të kenë tendencë të jenë më të shpeshtë dhe/ ose të dëshmonin një shkallë më të lartë morfologjizimi se në gjuhët fqinje”.

Pas paraqitjes së përmbledhur të orientimeve kryesore në studimet ballkanistike, ai pyeste: çka mbetet nga gjuhësia ballkanike? Do të jetë ajo *Gjuhësi e Europës Juglindore* dhe *Eurolinguistikë*, a do të vazhdojë më tej?

Përgjigjen e tij Fiedler-i përpqej ta formësonte përmes një pyetjeje tjetër: pse nuk i marrim të dy alternativat, pra edhe si Gjuhësi e Europës Juglindore edhe si Eurolinguistikë, por njëherësh edhe si disiplinë më vete?

Në këtë konceptim atij shqipja i dilte si gjuhë e pikënisjes, sepse, në një konceptim tipologjik dhe areal-tipologjik të gjuhëve të Europës Juglindore në raport me shqipen do gjetur një mbështetje. Shtonte se këto kërkime nuk i bënte si studiuesit që te *Sprachbund* shohin një njësi relativisht të mbyllur me 4 ose 5 gjuhë anëtare, po më shumë mendonte se Ballkani ofron një hapësirë interferencash, si dhe rajonet e tjera ku ka interferenca. Prandaj pyeste nëse mund të gjenden bërthama arealësh prej nga vijon ndërtimi më tej? Dhe gjuha ‘*vendimtare*’ nuk do kuptuar ashtu që prej saj në radhë të parë të kenë nisur ndryshimet drejt gjuhëve fqinje, apo vetëm në saje të saj: kjo gjuhë do të duhej të kishte një raport më intensiv ndaj interferencave në aspektin tipologjik relevant dhe për shumë gjuhë fqinje.

Në diskutimet e konceptimeve të veçanta për ballkanistikën, Fiedler-i ndalonte te Henrik Birnbaum-i me orientimin që përbashkësitë në ballkanistikë të shihen kryesisht në tri dimensione:

1. substrat (kryesisht trak e ilir)
2. simbiozë dhe përzierje gjuhësh
3. superstrat (bizantin, turk pas sundimeve të gjata),

por duke theksuar po ashtu se dalin edhe shumë risime specifikisht ballkanike nga ndikimet e greqishtes bizantine, po edhe më shumë nga romaniteti ballkanik.

Se shqipja ka qenë e hapur ndaj gjuhëve të tjera ballkanike, kjo mund të shihet në leksik, siç mund të vërehet tek etimologjitë dhe raportet midis shtresave të ndryshme, por atij nuk i interesonte në këtë rast leksiku. Atij i interesonte në radhë të parë struktura morfologjike dhe morfosintaksore e gjuhëve ballkanike dhe specifikat e shqipes në këtë kuadër. Kërkonte të dinte nëse tiparet tipologjike të gjuhëve të Europës Juglindore mund të karakterizohen në aspektin areal-tipologjik dhe pikërisht nga ky aspekt do ta shohë sistemin foljor.

A paraqesin shqipja dhe gjuhët fqinje një tip të njësishtëm dhe si do të mategj kjo njëshmëri?

Në dikotominë teorike qysh nga A. Schleicher-i në sh. XIX – gjuhë sintetike/ gjuhë analitike atij i dukej se mund të gjenden baza shpjeguese në rastet si reduktimi i rasave dhe në përgjithësi për sistemin emëror, por kjo nuk duket e përshtatshme për sistemin foljor. Ky çift konceptual i dukej atij tepër i papërcaktuar (Grob), prandaj i drejtohej konceptimit të Lehmann-it (1985) lidhur me shkallët e gramatikalizimit. Kështu ai krijonte premisën se shqipja është gjuha ‘*vendimtare*’ ballkanike, sepse në shqipen tiparet shenjuese karakteristike shfaqen më së qarti. Brenda tipareve të atilla për Ballkanin tiparet shenjuese në shqipen duhet të jenë më të shpeshta dhe/ ose do të shfaqin shkallë më të lartë morfologjizimi sesa përkatëset në gjuhët fqinje (f. 13).

Pas kësaj, Fiedler-i kthehej te Агя Десницкая, sipas së cilës mendimi i Edward Sapir-it, pas të cilit çdo gjuhë përmes ndërtimit të saj të veçantë jep një model po të veçantë strukturor, prandaj jo vetëm koncepti i aglutinimit, po edhe koncepti i fleksionit shtrojnë probleme. Sipas saj, ka tipa të ndryshëm të një strukture flektive (f. 14).

Ивић e kishte shtruar dhe çështjen e lëvizjes së popullatave dhe kishte konstatuar se ato kanë ndikuar që të kishte rrafshime në hapësirën që ai e quan serbokroate. Megjithatë ato nuk i transgresojnë vijat e tufave të mëdha të izoglosave. Por a nuk kishte pasur lëvizje të ngjashme ndër romanë në Ballkan?

Po në rastin e shqipes? Teoria për shpërnguljen e toskërishtes qoftë nga Dakia, apo nga zonat e Serbisë juglindore dhe të Maqedonisë verilindore (Nish-Sofje-Shtip) nuk qëndron, sepse nuk jep mundësi të shpjegimit të izoglosave si rotacizmi. Por brenda përbrenda arealeve të veçanta ka pasur lëvizje, pasojat e të cilave duan gjetur nëpër shtresëzime gjuhësore. Shpërngulje ka pasur, siç shihet qartë që shkonin nga zonat në jug të Shkumbinit drejt Greqisë e më tej në Itali, ose nga zonat e mesme drejt Italisë, apo nga zonat veriperëndimore drejt Venedikut. Shpërngulje të fiseve malore nga zonat afër Hercegovinës drejt luginës së Shkodrës e përreth, e më pastaj drejt veriperëndimit, apo të tjerat nga Mirdita e Fandi drejt verilindjes, apo të kelmendasve e të tjerëve drejt veriut, ashtu si të grupeve malësore nëpër hapësirat e ndryshme të rrafshëve të verit deri edhe në Serbinë e sotme, po ashtu mund të dëshmohen edhe mbi bazë dialektore.

Në përgjithësi, nëse nisemi nga konceptimet e Georgiev-it për unionin ballkanik si një fenomen që buron nga afrimi i gjuhëve të kësaj hapësire në 3 mijëvjeçarët e fundit, që ka mbetur në gjysmë të rrugës, atëherë shqipja dhe greqishtja patjetër ofrojnë më tepër mundësi pjesëmarrjeje sepse fliten në këto hapësira në tërë këtë kohë. Të tjerat janë më të vona, rumanishtja, arumanishtja etj. si vazhdimi i romanitetit ballkanik pas sh. VII, sllavishtet pas sh. VII, etj. Të tjerat edhe më vonë. Tufat e mëdha të izoglosave në zonat e torllakishtes flasin për hapësirat ku ndahen/ bashkohen shtokavishtja me ato që njihen si bullgarishte/ maqedonishte, ndërsa zona e migrimëve të shumta rreth Moravës e në jug sikur i japin të drejtë van Wijk-ut për teorinë e tij të pykës midis dy hapësirave të mëdha sllavojugore. Vlleht e mesjetës janë një dëshmi (mbretëria vllaho-bullgare), por as supozimet e Hamp-it për shtrirjen e shqipes në faza më të hershme edhe më në veri në këtë rast nuk duken pa gjasë.

Gjithsesi procedimi sipas gjuhëve të konceptuara pas normativizimeve/standardizimeve të vona dhe sidomos pas krijimit të kufijve shtetërorë modernë nuk duken bazë e mirë për shpjegime në këtë fushë. Lëvizjet dhe përzierjet e popullsive kanë qenë më të mëdha, prandaj edhe bashkekzistenca e tyre në hapësira të shumta ka qenë reale. Ndoshta kështu mund të gjindet filli edhe për vendosjen e konturave për hapësirat mbisunduese sociolinguistike në të cilat janë përvijuar tufat e izoglosave që delimitojnë ndarjet përkatëse dialektore.

Bardh RUGOVA

VENDI I THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE

Në punimin për theksin në Konferencën për Studimet albanistike në Itali kam thënë se ideologjia preskriptive ka bërë që disa probleme gjuhësore të shqipes të kenë shpjegime të gabuara, të cilat, të shndërruara në një formë miti e të marra si të mirëqena, kanë pasur ndikim edhe në shqipen kolokuiale dhe në dinamikat e përgjithshme të zhvillimit të shqipes:

- Shpjegimi i gabuar i kohëve të foljeve¹;
- Trajtimet e futurit dhe të kushtores²;
- Diskutimi për rimarrjen e kundrinës³; dhe, përfundimisht,
- Çështja e vendit të theksit në gjuhën shqipe.

Te gramatikat e sotme të shqipes, ato me të cilat mësojnë studentët në Kosovë e në Shqipëri, pavarësisht studimeve të shumta e të hershme, ende thuhet se më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar janë kohë sinonimike.

Për futurin dhe kushtoren për elaborim të mëtejme mund të shihet ligjërata ime e seminarit të shkuar.

Për rimarrjen e kundrinës mund të shihet Bokshi (2004, 2014), ndërsa Teuta Abrashi e sheh si koncept që nuk lidhet puro me shquarsinë, por me telicitetin dhe specificitetin si kategori semantike.

Miti për theksin, ndërkaq, i bartur disi si memë ndër breza, buron nga konceptime të mëhershme të Dodit (1968 [1963]) dhe përkufizuar më pas nga Dodi e Gjinari (1983), të cilët shpallin se vendi i theksit në shqipen nuk është i qëndrueshëm, lëviz nëpër rrokje, por se ka një prirje për të qenë në rrokjen e parafundit. Problemi kryesor i këtij shpjegimi është se nuk bën dallim mes mbaresave (shumica nga të cilat nuk marrin theks në shqipen) dhe prapashtesave (që marrin theks në shqipen) (shih Canalis 2007, Bozhoviq 2012).

Dodi e Gjinari (1983:129) me metoda tradicionale kujtojnë se vendosja e theksit në prozodinë e shqipes nuk mund të përcaktohet me rregulla gramatikore, duke mos ditur kështu të bëjnë dallimin mes derivacionit dhe infleksionit. Ata vënë shenja barazie mes fjalëve me mbaresa si

¹ Për elaborim të mëtejme shih Ismajli 1980, 1985; Tahiri 2009, Rugova 2009, Rugova, Sejdiu-Rugova 2015

² Për elaborim të mëtejme shih Rugova, Sejdiu-Rugova 2015

³ Për elaborim të mëtejme shih Bokshi 2004, 2014

punë, punës, kumbull, kumbullave dhe me prapashtesa: punë – punoj, baraz- barazi, punëtor - punëtori e kështu me radhë.

Camaj (1984: 26) e pranon këtë shpallje dhe merr shembuj si *fshat - fshatár* si lëvizje të theksit, por shembuj *turí – turíj e nëpúnës – nëpúnësit* (sic) si moslëvizje të theksit - shembull tipik i barazimit të prapashtesave (fshat-ar) me mbaresa (nëpunës-it). Camaj (1984: 8) thotë se vendi i theksit në fjalët e shqipes anon në rrokjen e parafundit të fjalës në trajtën e shquar (li'si, lu'lja, deve'ja v.j.), ndonëse trajtë kanonike është trajta e pashquar.

Në bazë të kësaj, kemi disa interpretime të ngjashme, duke nisur nga që më herët (Boissin 1975:31; Kacorri 1979:195) te autorë të tjerë si Petrucci (1999:116), K. Topalli (1995) dhe, madje, shkarazi edhe Bokshi (2012) që e trajtojnë vendin e theksit të shqipes shqipes si të paqëndrueshëm, por me tendencë në rrokjen e parafundit.

Rusakov (2017: 572), po ashtu, shkarazi e shpall “relativisht të lirë” vendin e theksit në shqipen, por e vëren tendencën për të qenë kolumnal dhe pjesë e stemit të fjalës.

Në librin për mësimin e shqipes për të huaj, Shqip.al (2016: 9) tentimi për ta dëshmuar theksin si në rrokjen e parafundit është marrë, madje, me shembuj në formë jokanonike, në trajtën e shquar: “Theksi i fjalës në gjuhën shqipe, nuk shënohet me shenja diakritike. Ai bie zakonisht në rrokjen e parafundit: vájza, kooperatíva, fári, bári, shqiptími, mënýrë etj. Megjithatë mund të bjerë edhe në rrokje të tjera...” (shih)

Përveç fjalës *mënýrë*, të gjitha të tjerat janë shënuar në trajtën e shquar. Ndërsa nëse e transkriptojmë shqiptimin e fjalës mënýrë, më shpesh ngjan të na dalë në rrokjen e fundit: mëny:r vs mënyr – ë.

Ky qëndrim, kur del edhe si i preskriptuar nëpër libra mësimi, manifestohet në shqiptime të këtilla që mund t'i hasim në opinion: *Majkëll Xh'ekson, Xhoni U'oker, Kompj'uter* e kështu me radhë. Krahaso theksimin te fjalë të ngjashme fonetikisht si *mikrof'on, pip'er, hab'er*.

Pra, jo mikr'ofon, p'iper, h'aber.

Preskriptimi, përmes Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, bën edhe një lëshim fundamental gjatë sinjalizimit të theksit. Në të gjitha rastet, në pozitën e theksit shënimi bëhet me shenjën e theksit akut á– që do të duhej të shënonte zanoret e theksuara më të gjata kundrejt atyre më të shkurtëra që do të shënoheshin me theksin e rëndë à (grave). Në disa gjuhë shënohet gjatësia me makron ā, por jo si theks, puro kur duam ta shënojmë si gjatësi. Pra feudāl (jo aq e gjatë), kundrejt hállë. Në Fjalor nuk bëhet ky dallim, i cili, siç do ta shohim në fund, është kryesori në përshkrimin e vendit të theksit në shqipen.

Në këtë ligjëratë do të mëtohet përshkrimi i vendit të theksit në shqipen, duke u diskutuar të dhënat empirike dhe konceptimet teorike të autorëve të tjerë që kanë bërë hapa përtej metodave

tradicionale dhe, siç do të shohim, do të kemi një pamje krejt tjetër nga ajo e preskribuar në librat e sipërpërmendur.

Po ashtu, një vështrim i thjeshtë në Fjalor mund të na tregojë për fjalë që kanë theks në rrokjen e fundit: shtëpi; të parafundit: lule dhe, madje, edhe të tretën nga fundi: faqeza, qëndrueshëm. Natyrisht, në këtë ligjeratë mëtojmë të diskutojmë se problem nuk është gjithaq te vendi, por, më shumë se kaq, te cilësia e rrokjes që e merr theksin.

Mirëpo, së pari, disa konsiderata teorike në vend të sfondit. Po nisi me diskutimet strukturaliste. Gjuhëtarët dhe gjuhëtarët që moti e kanë analizuar theksin si shquarje të një rrokjeje brenda vargjeve tingullore dhe kanë përcaktuar rregulla pak a shumë të plota për ta përshkruar vendin e theksit (Garde 1993: 9). Për këtë janë meritore posaçërisht gramatikanët e shkollës së Aleksandrisë që kanë ofruar shënime të plota për theksin e greqishtes së vjetër atëbotë. Mësimet e tyre janë edhe sot themel i teorive që vlejnë për shumicën e gjuhëve bashkëkohore evropiane (Garde 1993: 9).

Diku në ato teori mund të lexohet edhe për theksin e lëvizshëm dhe për theksin e qëndrueshëm. Ky dallim elementar qëndron në planin teorik në prosedetë zanorë si forca, intensiteti, lartësia e kështu me radhë (Garde 1993: 11). Për Trubeckojn, theksi lëvizës ka më shumë veçori të përbashkëta me elementët e tjerë dallues prozodikë të tingujve zanorë se theksi i qëndrueshëm. Theksin lëvizës të rusishtes dhe gjatësinë e zanoreve në çekishten, ai i sheh si dy manifestime të së njëjtës dukuri që ai e quan intensitet zanor (ibid.) – në kuptimin pozitiv – negativ (ka, nuk ka). Duket se ai, në fakt, e hedh poshtë fare si dukuri. Ndryshimi i theksit, s'është veçse alternim i zanoreve të forta dhe të buta, thotë ai (Garde 1993:12).

Sidoqoftë, funksioni (në strukturalizëm) i theksit dallon nga funksioni i tipareve dalluese p.sh. zëshmëria, hundorësia, meqë nuk vepron në rrafshin paradigmatic: theksi nuk i kundërvihet jotheksit brenda fjalës, ndryshe nga zanoret. (Garde 1993: 13)

Krahaso: Dy djem – dy vajza; hi (hyj) – hī(ni - hiri).

Te theksi tregon vetëm se cili është elementi i shquar. Është element mbisegmentar.

Në strukturalizëm, raportet ndërmjet dy njësive të përballura në paradigmë i quajmë opozicion (kundërvënie), ndërsa në rrafshin sintagmatik i quajmë kontrast.

Te shembulli sipër hundorësia përbën kundërvënie. Theksi përbën kontrast (Garde 1993: 14). Meqë roli i theksit del të jetë kontrastiv e jo opozicional, atëherë edhe funksioni i tij shfaqet më i komplikuar se i hundorësisë, po e zëmë. (Garde 1993: 15).

Njësia e shquar që e quajmë theks është rrokja (Garde 1993: 16). Mirëpo, siç do ta shohim më pas, njësia e shquar mund të jetë edhe më e imtë se rrokja dhe këtu hyn në punë nocioni i morës. Nocioni i morës, sipas Paul Gardesë, del në gjuhët që kanë lëvizje theksi jo doemos nga rrokja

në rrokje, por edhe nga një pjesë e rrokjes në tjetrën. Prandaj, morë quhet çdo pjesë e rrokjes që mund ta bartë më vete theksin (Garde 1993: 17). Edhe kur flitet për morën ndarja bëhet në të dhënat fonologjike, pavarësisht atyre gramatikore (ibid).

Por çfarë mund të thuhet për vendin e theksit brenda fjalës?

Njësia e theksit (si shenjues - rrokja apo mora) është njësi pa kuptim – varet nga kontrastet fonologjike. Njësia e theksuar ndërkaq (pra si e shenjuar - fjala) ka kuptim, kështu që kufijtë e saj varen nga kriteret gramatikore (Garde 1993: 21). Përshkrimi i vendit të theksit në fjalë në disa gjuhë varet nga kriteret fonologjike (me këtë rast bëhet fjalë për theks të qëndrueshëm) e në disa të tjera nga kriteret gramatikore (theks lëvizës) (ibid).

Po e zëmë në latinishten theksi parafundor varet nga rrokja - nëse ka rrokje të gjatë apo mbyllet me bashkëtingëllore (në të dy rastet bëhet fjalë për njësi dymorëshe), atëherë është në rrokjen e parafundit, në rast tjetër është në rrokjen paraprake, pra në të tretën prej fundit (daktil). E marrim fjalën: diurnus (përditshëm). Në këtë rast nuk na intereson –us a është mbarese a çka është – pra nuk ka asnjë konsideratë gramatikore. Në gjuhë me theks lëvizës – vendi varet nga elementet gramatikore (Garde 1993: 21).

Tutje njësia e shquar mund të jetë përmes një morie elementesh.

Në shqipen kryesisht shquarja e rrokjes apo, siç do ta shohim më pas, e morës, bëhet me gjatësinë. Ndonëse autorë të hershëm e quajnë dinamik, duke e vlerësuar theks që kombinon gjatësinë me intensitetin e lartësinë, Sawicka qysh në vitet tetëdhjetë e konsideron si theks që lidhet me gjatësinë. Sipas saj (Sawicka 2018: 115), theksi i shqipes nuk ka karakter dinamik dhe (2018:117) “gjatësia e artikulimit është factor relevant (ndoshta kryesor) në formimin e theksit në shqipen...”




Fig 1. Oshilogrami dhe spektogrami i fjalës “qyfte” me shqiptim të zakonshëm.




Fig 2. Oshilogrami dhe spektogrami i fjalës “qyfte” me shqiptim pejan.

Mund të shohim oshilogramin dhe spektogramin në Praat të fjalës qyfte me theks të mbështetur në gjatësi (fig. 1) dhe të fjalës qyfte me nyjëtim pejan (fig. 2), me ç’rast kemi theks të intensitetit. Mos m’u kapni për fjale: vetë jam pejan dhe e di se Peja nuk është e njohur për

qofte, por për qebapa dhe duke qenë profesor i shqipes do të duhej ta dija se Fjalori e sanksionon trajtën: qofte si të drejtë.

Te shembulli i dytë, siç mund ta shohim, zanorja e theksuar është për pak më e shkurtër se e-ja e patheksuar, por është dukshëm më intensive. Intensiteti është shkalla e energjisë së pranishme (e forcës nyjëtimore) gjatë shqiptimit të tingullit dhe varet nga amplituda e valës zanore dhe nga frekuenca. Zanoret kanë intensitet të ndryshëm: sa më të hapura janë, janë më intensive. Mirëpo, ndonëse lidhet me amplitudën, nuk është baraz me amplitudën. Intensiteti matet me decibelë që në studimin e të folurit mbështetet në vëllimin e dridhjeve të tejzave të zërit si rezultat i ndryshimeve të shtypjes së ajrit.

Ladefoged (2003:93) na këshillon se matjet e decibelëve në kërkimet fonetike janë të padobishme. Natyrisht, “e padobishme” në këtë rast është fjalë e madhe, gati poetike.

Te matja e ofruar (shembulli pejan) mund ta shohim se gjatësia (matet me milisekonda) e y-së është më e shkurtër se e-ja e patheksuar (në margjina): 541 ms dh 584 ms; ndërsa 84 decibelë ka y-ja e e-ja gati 20 më pak. Y-ja është më zor të matet si gjatësi, për shkak se kishte një aspirim pas zanores: y^h. Të shembulli tjetër, i theksit klasik dinamik, y-ja është afër tri herë më e gjatë se e-ja. Intensiteti është dukshëm nën shembullin e parë.

E bëra këtë digresion në fonetikën akustike sa për të ilustruar veçoritë e theksit në shqipen, para se të thellohem në vendin e theksit.

Meqë u kthjem te shqipja, ta bëjmë një kapërcim tjetër: nga strukturalizmi në gjenerativizëm. Kur studimet tradicionale të shqipes po e krijojnë mitin për theksin – mitin që e përshkrova qëparë, një gjuhëtar amerikan, Gary Lloyd Bevington po ofronte një shpjegim tjetër, dukshëm më të saktë, rrahur në këndvështrimin gjenerativ.

Mu vitin që Dodi do ta jepte përkufizimin për theksin në shqipen, më 1968 (ndonëse fillimisht më ‘63 e jep Dodi) Chomsky dhe Halle do të publikonin “The Sound Pattern of English” dhe do të shkonin përtej koncepteve strukturaliste.

Siç e pamë, strukturalizmi i njeh rrafshin alofonik (pra fonetik), rrafshin fonemik dhe atë morfonemik. Gjenerativizmi nuk e njeh nocionin e fonemës dhe e zëvendëson me underlying forms që duhet të nxjerrin tutje format sipërfaqësore.

Fonologjia gjenerative mëton vendosjen e rregullave, të parimeve dhe të shtrëngesave që mund të prodhojnë forma sipërfaqësore fonetike të gjuhës dhe të skicojnë (modelojnë) dijen e brendshme gjuhësore të folësve nativë (Chapman and Routledge, 2009:77).

Gjenerativizmi ndyshe nga tri nivelet e strukturalizmit, njeh vetëm dy: nivelin underlying fonologjik dhe nivelin sipërfaqësor fonetik. I pari përfshin një tërësi rregullash fonologjike që zbatohen për të nxjerrë përfaqësimet sipërfaqësore fonetike (mc 2007: 101). Konkretisht: një

formë underlying (themelore, pra) mund të nxjerrë më shumë forma sipërfaqësore (alofone, variante).

Studimi “Albanian Phonology” i Bevingtonit është mbrojtur si punim doktore në Universitetin e Masaçusetsit në SHBA më 1970 dhe është rishikuar për botim më 1974 nga SHB “Oto Harasovic” me recension të Hans-Juergen Sasses. Autori ka zgjedhur ta përshkruajë sistemin tingullor të shqipes letrare, sipas shkrimeve në “Zëri i Popullit” dhe shenjat grafike pastaj t’i interpretojë sipas Anastas Dodit. Autori (1974:3) ka pasur ambicien edhe ta ndihmojë standardizimin e shqipes.

Autori amerikan e ka shtruar problemin në këndvështrimin gjenerativ, duke qenë ndër studimet e para të tilla të shqipes, menjëherë pas studimit (edhe ky punim doktore) të Oda Buchholzit për rimarrjen e kundrinës në gjuhën shqipe (1969).

Në studimin për fonologjinë e shqipes, Bevington dy përfaqësimet (sipërfaqësor) dhe underlying (themelor) i ofron në matrica dydimensionale, ku kolonat janë segmentet suksesive fonologjike, ndërsa radhët janë tërësia universale e tipareve fonologjike (1974:4).

Secili zë (entry) në matricë markohet me (+) nëse tipari participon në segment ose me (-) nëse nuk participon. Meqë në nivelin underlying (apo fonologjik) tiparet kanë rol klasifikues, ndiqet sistemi binar. Në nivelin sipërfaqësor (fonetik) vlerat skalare vihen në vend të plusëve dhe të minusëve për disa tipare, të cilët dallueshmëria e tillë arsyetohet nga faktorët fonetikë, apo siç i quan detailed rules (1974:5).

Zgjedhja e trajtimit gjenerativ shmang këndvështrimet poststrukurale, duke mos marrë parasysh varietetet tingullore brenda shqipes dhe me këtë rast nuk përfshihen detailed rules, por vetëm vlerat binare.

Ai këtë e “zgjidh” me mendimin se nëse një komponentë fonologjike përmban dy a më shumë rregulla, specifikimi i zbatimit të rregullave në raport me njëri-tjetrin bëhet i domosdoshëm (1974:6).

Bevington ofron një skemë, sipas tabelave të Dodit, ndërsa theksin e përkufizon (1974:24) si të shqiptuar me forcë më të madhe ekspiratore të një rrokjeje, kundrejt zanoreve të tjera.

Ai, mbështetur në këto parime, nxjerr këtë formulë (1974:24-25):

:

$$(1) \quad V \rightarrow [+stress] \text{ --- } C_0 \left\langle \begin{array}{c} e \\ a \\ o \\ \ddot{e}(C) \\ as \\ ull \end{array} \right\rangle] \text{ Stem } <-V>$$

Pra, Bevingtoni e përcakton theksin e fjalës në stem, duke përkufizuar se theksi i shqipes nuk ndryshon kur ka mbaresa, por bartet në prapashtesa, kështu që forma kanonike e fjalës është themelore në këtë kuadër. Ai sheh se pas stemit, njësi të patheksuara mund të jenë e, a, o, ë (plus bashkëtingëllore dhe as e ull/ur).

Mirëpo, kjo lë disa çështje pezull. Nuk i përfshin ato tema emërore që mbarojnë me zanoret e, a, o të theksuara (krahaso: **pare** - hare, **pata** - hata, **puro** - byro) si iamb, ato që e kanë zanoren ë në rrokjen e theksuar (jastëk) dhe temat njërrrokëshe që nuk marrin theks (shih Bozhoviq 2012:144).

Ideja për prapashtesat mund të sjellë ndonjë paqartësi dhe/ose pasaktësi. Po e zëmë, prapashtesa *-as* nuk merr theks, por trajta *as* në fund të stemit po. Kemi *gjlán-as*, por *ananás*, kur nuk kemi prapashtesim. Në raste të tjera, kemi *heró*, por edhe *kállo*. Kemi, po ashtu, *pará* e *kalá* krahas *brénda* (kur *a*-ja është pjesë e stemit që dmth. se nuk përputhet me skemën e Bevingtonit). Po, ashtu përemri këtë – shqiptimet këtë dhe këtë, me të dytën të sanksionuar të drejtë. Pra, skema e tij nuk është e saktë krejtësisht, por ka vlerë se vëren që theksi i shqipes lidhet jo me fjalën, por me stemin.

Për pozitën fundore të theksit në stemin e fjalës është dakord Friedman (2004), i cili thotë se theksi i shqipes përgjithësisht bie në rrokjen e fundit të stemit, ndonëse “është i paparashikueshëm dhe distinktiv (dallues)”.

Sawicka (1997:73) thotë se në shqipen theksi është në rrokjen e fundit të stemit, por shton se plot sufiksë e marrin theksin.

Hampi (1992: 904) duke theksuar se, historikisht, rumanishtja është latinishte me theks të shqipes, aludon, pak a shumë, për rrokjen e fundit të stemit (për rumanishten shih Ioana Chitoran 2002).

E përmenda edhe Rusakovin, natyrisht, që e pranon rolin e stemit.

Studimet strukturale dhe gjenerative na shpunë më përpara. E kuptuam se çështja e theksit në shqipen nuk është e lidhur me fjalën, por me stemin, ashtu që mbasesat nuk marrin theks, por prapashtesat po. Megjithatë, dolën disa përjashtime.

Për të gjetur zgjidhjen, kemi nevojë për përditësime teorike.

Duke e diskutuar kontributin e Bevingtonit (Rugova 2016) dhe të Stefano Canalisit (Rugova 2020), shkarazi e kemi prekur edhe trajtimin e theksit të shqipes në këndvështrimin sipas teorisë së optimalitetit dhe të teorisë metrike.

Teoria e optimalitetit (shih zërin te Rugova 2019) është trajtim gjuhësor, sipas të cilit, format sipërfaqësore të gjuhës janë reflektime të rezultateve të “garës” ndërmjet kërkesave konkurruese ose “shtrëngesave” (constraint). Një formë është optimale, kur ka më pak shkelje të shtrëngesave, të cilat janë të ranguara në hierarki të veçanta gjuhësore. Shtrëngesat ndryshojnë nga gjuha në gjuhë dhe kanë rangim strikt. Kur një shtrëngesë del mbi një tjetër, prioritet ka shtrëngesa e ranguar më lart. Shkelje edhe mund të ketë, por ato duhet të jenë sa më minimale.

Po e zëmë, morfemat sh dhe zh si parashtesa. Te konteksti *varrim*, sh dhe zh janë konkurrentët për të shënuar kuptimin e kundërt. Sh-ja bën shkeljen e rregullit të përputhjes së zëshmërisë në fillim të fjalës. Sh-ja është e shurdhër, ndërsa v-ja e zëshme. Kjo e bën zh-në kandidatin optimal dhe, prandaj, e kemi të gjeneruar formën *zhvarrim*.

Teoria e optimalitetit është e nxjerrë nga gjuhësia gjenerative që përqendrohet mbi përshkrimet formale dhe hulumtimin për gjetjen e parimeve universale gjuhësore, mbështetur në kërkime empirike të tipologjive gjuhësore dhe të të nxënit të gjuhës së parë. Dallimi është se teoria e optimalitetit parasheh që shtrëngesat universale mund të jenë të shkelshme.

Teoria e optimalitetit është krijuar nga Alan Prince (Prince) dhe Pol Smolenski (Paul Smolensky) (në një artikull të vitit 1993) dhe nuk është teori e përfaqësimeve, por e parimeve gramatikore, ndërsa rezultatet kryesore i ka në fushën e prozodisë. Në shqipen, ka pasur disa artikuj që lidhen me theksin dhe vendin e tij. Ndonëse rezultatet kryesore i ka në fonologji, konsiderohet teori e përgjithshme gramatikore, ndërsa synim primar e ka fokusin mbi parimet gramatikore të përbashkëta për të gjitha gjuhët. Gramatikat e gjuhëve të caktuara, pastaj i nxjerrin opsionet themelore nga kjo tërësi e kufizuar, të cilën disa gjuhëtarë e gjuhëtare e quajnë gramatikë universale. Teoria e optimalitetit, në këtë kuadër, është teori e kapacitetit gjuhësor të njeriut në komunikim.

Tre përbërësit kryesorë të kësaj teorie janë **GEN** (inputi që gjeneron listën e tërë të outputëve të mundshëm); **CON** (kriteri, në formë të shtrëngesave të shkelshme, mbi të cilat do të vendoset për kandidatin) dhe **EVAL** (zgjedhja apo vlerësimi i kandidatit optimal).

Te shembulli me zhvarrim: Gen – pamë sh dhe zh. Con kriteri i zëshmërisë dhe Eval, vlerësimi.

(1) Input: pu.në.-tor, 'worker'

	1-STRESS WORD	FAITH-STRESS I/O	STRESS RIGHT-EDGE
pu.në.-tor	*!		
pu.në.-tor		*	*!
☞ pu.në.-tor		*	
pu.në.-tor		**!	

Fig 3. Në ilustrim, shembulli nga Maynard (1997) i analizës optimale për fjalën punëtor, me ç'rast kandidati punëtor me theksin fundor është kandidati optimal. Theksi nistor shkel rregullën e orientimit në të djathtë që e ka shqipja. Tabllo quhet kjo tabela, gishti tregon kandidatin optimal, ndërsa asteriksi shkeljen, e pikëçuditësja shkeljen vendimtare. Kandidati me dy theksa e shkel rregullën e theksit të fjalës, ai me theks në fillim rregullën e orientimit në të djathtë, ndërsa kandidati pa theks e shkel rregullën e besnikërisë.

Teoria e optimalitetit i shndërron deklaratimet e shenjueshmërisë në substancë aktuale të gramatikës. Dy koncepte (forca shtytëse) e përbëjnë “garën” apo konfliktin: shenjueshmëria (**markedness**) dhe besnikëria (**faithfulness**). Shenjueshmëria është nocion që shërben për të kapur kontrastet gjuhësore, ndërsa besnikëria për t'i shprehur ato. Teoria e optimalitetit, së këndejmi, njeh dy lloje shtrëngesash: të shenjueshmërisë (fonetike) dhe të besnikërisë (fonologjike). Shtrëngesat e shenjueshmërisë kërkojnë që format e outputit të përmbushin kriteret strukturore (p.sh. në formë të rregullave të tilla si obstruenti duhet të jetë i zëshëm pas hundores, nuk mund të ketë një të tog i shurdhër + i zëshëm në fillim të fjalës ose obstruenti nuk mund të jetë i zëshëm në koda te toskërishtja). Shtrëngesat e besnikërisë kërkojnë që outputi t'i ruajë veçoritë e formave të tyre bazike (p.sh. outputi duhet të ruajë çdo segment të pranishëm në input, ose segmentët e outputit duhet të kenë homologë në input).

Universaliteti i shtrëngesave do të thotë që një shtrëngesë nuk nënkuptohet se vlen për secilën gjuhë, por se probabiliteti gjuhësor është i vlefshëm për secilën gjuhë. Po e zëmë, ndarja në bashkëtingëllore të zëshme dhe të pazëshme është koncept universal, pavarësisht nëse në ndonjë gjuhë të caktuar ky element përbën ose jo vlerë dalluese.

I pari që e ka rrahur theksin e shqipes nga këndvështrimi i teorisë së optimalitetit ka qenë Maynard (1997), ndjekur nga Trommer dhe Grim (2004, 2009, 2013). Edhe ky këndvështrim nuk bën shumë tutje nocioneve të Bevingtonit, duke sqaruar se mbaresat flektive të shqipes

nuk janë të theksuara, përveç në rastet si *lúmë – luménj*, por ato janë rimorfologjizuar sipas analogjisë me mbaresën e shumësit *nj*.

Canalis, alumni i Universitetit të Padovas, tani në Universitetin Boazici në Turqi, ka kryer një analizë teorike të theksit të fjalës në shqipen sipas teorisë metrike të fonologjisë (Canalis 2007). Ai, me pak fjalë, ndjek punën e autorëve që janë marrë me theksin e shqipes. Thotë se theksi i shqipes zbatohet në domenin e temës së fjalës (sikur edhe Bevingtoni 1974). Pranon, se theksi i shqipes ka orientim në të djathtë (sikur edhe Maynardi 1997) dhe se varet nga pesha e rrokjes (sikur thotë edhe Maynard 2004, 2009, 2013).


Mirëpo, thekson, njëherësh, se pozita e theksit brenda fjalës në shqipen nuk duhet të kërkohet, thjesht, në nivelin e rrokjes, por më hollësishën, në kuadër të morave dhe të këmbëve metrike të atyre rrokjeve.

Kjo na shpie te fonologjia metrike. Fonologjia metrike është teori e theksit, duke ndarë të thënit në njësi metrike hierarkike si rrokje, këmbë, fjalë. Ka përdorim në shpjegimin e strukturës së rrokjes dhe të kufijve fonologjikë. Struktura metrike e fjalëve dhe e sintagmave përfaqësohet në formë të drurëve metrikë, në ndarje binare të rrokjeve të forta dhe të dobëta. P.sh. te fjala *flu-tur* kemi strukturën rrokje e fortë + rrokje e dobët, por në dhanore fluturave, kemi dy këmbë: *flutur* (e fortë + e dobët) dhe *ave* (e fortë + e dobët), por këmba e fortë *flutur* është e fortë kundruall *-ave*. Meqë rrokja *flu-* është e forta e këmbës së fortë, atëherë quhet *elementi i paracaktuar përfundimtar* (designated terminal element). Kjo mund të zgjerohet tutje në fjalë të tjera, me ç'rast realizohet degëzimi binar te sintagmat dhe e tërë fjalia.

Fonologjia metrike është e lidhur me **elementet mbisegmentore** dhe është relativisht e re në gjuhësi dhe, siç u pa, rëndësi u jepet njësisë më të mëdha se fonema dhe forcës relative ose dobësisë që ka një rrokje kundrejt një tjetre. Po ashtu, trajton edhe strukturën e këmbës metrike dhe ndryshimet theksore. Po e zëmë, në shqipen prapashtesat janë të ndjeshme ndaj theksit: *punë*, *punoj*, *punëtor*, *punëtori*, por nuk janë mbaresat, *punëtor*, *punëtori*, *punëtorëve*.

Këtë do ta ilustrojmë me këtë shembull.

Ip= sintagma infleksionale, Sint. = sintagmë, rrok. = rrokje, d = e dobët, f = e fortë.



Mora, të cilën e përmendëm më parë, është njësi fonologjike që e përcakton peshën e rrokjes. Përgjithësisht, në bazë të numrit të morave brenda rrokjes, kemi rrokje *të lehta* (një morë) dhe *të rënda* (dy mora). Zakonisht, **onseti** i rrokjes nuk ka asnjë morë, ndërsa bërthama mund të ketë një morë, kur kemi rrokje të shkurtër dhe dy kur kemi zanore të gjatë, ose diftong. Në disa gjuhë, edhe bashkëtingëllorja fundore mund të përbëjë një morë. Rrokjet me tri mora konsiderohen super të rënda. Gjuhët, në të cilin rrokjet e rënda e përmbajnë theksin, konsiderohen të ndjeshme në sasi të rrokjes.

Kjo na shpie te pesha e rrokjes. Pesha e rrokjes është koncept i shfrytëzuar për të dalluar shkallët e spikamës rrokjesore, mbështetur në përbërësit segmentorë të rrokjes. Në bazë të kësaj, dallojmë rrokje që në rrafshin metrik janë të rënda dhe që janë të lehta. Një rrokje e lehtë ka një **bërthamë** në formën e një zanoreje të shkurtër dhe një **koda** të përbërë nga një bashkëtingëllore e shkurtër. Në rrafshin e gjatësisë fonologjike kjo është e barabartë me një **morë**. Një rrokje e rëndë ka më shumë mora. Po e zëmë, rrokja *dys*h është rrokje e lehtë, ndërsa /mo:r/ ose dy:- rrokje të rënda.

T'i kthehemi Canalisit dhe shpjegimeve të tij metrike.

Sipas tij, shqipja në morfonologjinë e saj është e ndjeshme ndaj sasisë metrike, apo kuantitetit të rrokjeve, pra nga numri i morave të tyre (pesha) dhe jo ndaj cilësisë së zanoreve në rrokje. Rrokjet mund të jenë të rënda, kur janë të gjata ose të mbyllura, apo kur përmbajnë ndonjë

diftong, e prandaj përbëhen nga dy mora. Mund të jenë të lehta, kur janë të shkurtra dhe të hapura e prandaj përbëhen nga një morë metrike (shih Bozhoviq 2012:1480).

Sipas kësaj, Canalis përkufizon se rregulla e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen do të nënkuptojë se te çdo fjalë e shqipes, theksi vendoset në morën e parë të këmbës së djathtë dymorëshe të temës së fjalës (trok). Pra, sipas tij, të gjithë stemat e shqipes janë paroksitone sa i përket theksit, kështu që, sipas tij, kur stemi mbaron me një rrokje të lehtë, të shkurtër e të hapur, si *punë, borë, yndyrë, brenda*, e kështu me radhë, të dy rrokjet përbëjnë një këmbë trokaike dymorëshe, me theksin paroksiton⁴. Nëse tema mbaron me rrokje të rëndë a diftong, ajo rrokje vetë e përbën një këmbë dymorëshe, e prandaj është e theksuar dhe kemi: *ve'nd, bilbi'l, shtëpi', njeri', bari', kala'*.

Në këtë kuadër, pak është me rëndësi nëse fjalë të tilla si *punë* do të transkriptonen /pu:n/ duke e llogaritur si njërrrokëshe apo /punə/ si dyrrrokëshe. Në të dy rastet përkufizimi i Canalisit do të merrej i saktë. Nëse stemi përfundon me rrokje të mbyllur, pra si njërrrokëshe (shih /pu:n/), atëherë shembulli bartet në kategorinë me fjalë si vend apo bilbil. Mirëpo, kjo nuk është e rëndësishme në këtë moment. Pra, këmba metrike e përcaktuar nga mora, në rastin e parë do të ketë një rrokje me dy mora dhe në rastin e dytë dy rrokje të lehta.

Canalis (2007: 3), përgjithësisht, vëren se vendi i theksit në fjalët e shqipes nuk ndryshon kur ka mbaresa (me përjashtime: *lu'më – lume'nj, dhëndër – dhëndu'rë*); se orientimi është në të djathtë dhe se lëviz kur ka prapashtesa, por jo edhe parashtesa; se stemi është domen relevant i theksit në shqipen dhe se tema që mbaron me zanore jep theksin penultimat (jo e saktë v.j. sepse lule nuk e ka stem e-në), ndërsa ai me bashkëtingëllore jep theksin në elementin fundor (me përjashtimet –ull, -ur dhe ëC (C= bashkëtingëllore).

Si shembuj ofron fjalë të tilla si: *bre'nda, ci'li, pra'pa, ga'ti*, por ofron edhe shembujt e kundërt: *vëlla', shtëpi', tashmë'* (kur ë-ja e merr theksin), *aty', këtu'*.

Ai (Canalis 2007: 8), nisët nga supozimi se theksi i shqipes është i ndjeshëm ndaj sasisë apo peshës së rrokjes, e sheh si trok, se këmbë kryesore është ajo që është në të djathtë dhe se rrokjet që shkojnë përtej stemit janë metrikisht jorelevante në shqipen. Mbi këtë e jep përkufizimin që e përmendëm më lart se në shqipen theksi bie në trokun e djathtë të stemit në morën e parafundit. Pra, jo në nivelin e rrokjes, por brenda rrokjes në nivelin e morës.

Kjo lidhet edhe me situatat kur ka tog zanoresh, në të cilin i theksuar është elementi i parë: *ly'er*, por edhe situatat si *mendu'eshëm*, kur rrokja e theksuar është e treta nga fundi, duke

⁴ Ai fjalën *punë* e lexon si /punə/, me ç'rast ë-ja fundore është rrokje e lehtë, ndërsa u-ja është e rëndë dhe bashkë formojnë trok moraik. Mirëpo, edhe nëse lexohet /pu:n/, u-ja e gjatë ka dy mora dhe theksi bie mbi morën e parë.

pasur morën daktilike U - - . Derisa te ‘ue’ kemi theksimin e elementit të parë, pra trok, elementi –ëm tutje trajtohet si te shembujt e tjerë të tipit emër, vegël, për çka do të diskutojmë sakaq kur e diskutojmë kulmin e rrokjes.

Mund të shihet edhe si element ortotonik, shumë të zakonshme janë parafrjalët e pjesëzat në shqipen, pra njësi pa theks.

Canalis përpiket të shpjegojë rastet ëC si p.sh. *ve’gël*, ku ë-në e sheh intrusive që s’është pjesë e stemit, sepse në paradigëm kemi *vegël – vegla*, për çka ofron krahasimin me *boshçallë’k*, ku ë-ja e merr theksin. Kjo pastaj jep shpjegimin për jastëk – jastëku, ku ë-ja është e theksuar dhe pjesë e stemit e jo intrusive. Kjo ka të bëjë me strukturën e rrokjes (shih Sawicka, Dargiel 2018), me ç’rast ë-ja intrusive vihet për të prishur kulmin e dytë të rrokjes.

Në fund të fjalës, shqipja nuk pranon kulmin e dytë. Komunizmi, por komunizëm. Mund ta pranojë në fillim te fjalë si mbret, ndal, ngop, pra grupet nistore mb, nd, ng, për çka ka një sqarim tjetër që nuk do ta diskutoj këtu për shkak të kohës.

Argumenton edhe rastet –ull, ur, duke kujtuar shembuj në shqipen kolokuiale si sheklli (shekull-shekulli), lepri (lepur – lepur) që e vënë u-në si variant kombinatorik të ë-së me sonantet ll dhe r. Në të folme të shqipes (v.j.) ka edhe shembuj të tillë si *e bukër* (për *e bukur*) sidomor kur në vend të flapit /r/ realizohet varianti /ɾ/ si aproksimant retrofleks. Te shembuj të tillë si *engjëll* (në të folme edhe *engjull*), Canalis (2007: 10) thotë se shpjegimi duhet kërkuar gjetiu e jo në fonotaktikë.

Canalis, njëherësh, thotë se në shqipen standarde nuk ka kundërvënie të gjatësisë – e cila është e pranishme te gegërishtja. Mbi këtë parim, mëton (Canalis 2007: 11) të shpjegojë edhe rastet si káfe (në gegërishten) – kafé (në toskërishten dhe në shqipen standarde). Poende, ë-në në shqipen standarde e sheh si fonemë, jo edhe si shenjues gramatikor (shumësi: dy mekanikë) ose fonetik (kur tregon p.sh. se zanorja e fundit është e gjatë). Për këtë të fundit madje edhe jep shembujt *ly’em*, por *pi’më*, ku ë-ja del pas zanores së gjatë, kurse te togu *ye*, e theksuar është y-ja e jo e-ja, kështu që nuk ka -ë në fund të fjalës në drejtshkrimin e shqipes.

Natyrisht, problemi i turcizmave është pak më i komplikuar se kaq dhe lidhet jo me theksin oksiton dhe paroksiton, por me përshtatjen e huazimit (kaf/e-ja, sikur lul/e-ja, ku stemi është kaf-, apo si formë e plotë e turqishtes kafe-ja, ku stemi është kafe)⁵.

⁵ Ndonëse nuk janë përmendur nga Canalis, do të përmendnim edhe shembuj si *óperë* dhe *kámerë* që në drejtshkrimin e shqipes janë sanksionuar me theks në rrokjen e parë, por me -ë në fund të fjalës. Bëhet fjalë për huazime italiane, ngjashëm si te fjala *muzíkë*, ku theksi është përshtatur me të shqipes. Shembujt, *óperë* dhe *kámerë*, në të vërtetë janë shqiptime të shtresës snobistike që i ka përdorur ato fjalë (patjetër një shtresë që mëton përkatësi më të lartë në hierarkinë kulturore) dhe, si të tilla, janë sanksionuar në drejtshkrimin e shqipes.

Vërejtje përmyllëse:

Venerimet teorike të Bevingtonit, të Maynardit, të Tromerit dhe të Bozhoviqit, e të Canalisit, të mbështetura në teorinë e optimalitetit dhe metrike, e mbështesin qëndrimin për parashikueshmëri të theksit në shqipen, duke e vendosur në rrokjen e fundit të stemit, në morën e parafundit, me orientim të djathtë që do të thotë se mund të paraqitet në prapashtesa, por jo në parashtesa dhe as në mbaresa. Për përjashtimet janë dhënë sqarime.

E ilustruam me shembujt: pu'në /pu:n/, puno'j, punëto'r, punëtori'; dmth punëto'ri, punëto'rin, punëto'rëve, por punëtori'a, punëtori'në, punëtori've (kr ahaso me përpuno'j – shqipja nuk e orienton theksin në të majtë).

Element themelor është se nuk është aq I rëndësishëm vendi, por cilësia e zanores së theksuar. Mirëpo, Canalis nuk e diskuton çështjen e emrave femërorë. Fjalë të tilla si lu'le, nuk e kanë e-në si pjesë të stemit. Trajta e shquar është lulja. Ngjashëm është edhe me rastet si káfé – kafé dhe huazimet e tjera të turqishtes që janë shpjeguar gabimisht si theks oksiton dhe paroksiton (tenxhére – tenxheré). Në raste të tilla nuk bëjmë fjalë për ndryshim theksi, por për trajtën që është pranuar si kanonike (tenxher-e/ja apo tenxhere – ja). Në të dyja rastet është e theksuar rrokja e fundit e fjalës kanonike dhe kemi njësi dymorëshe, me morën e parafundit të theksuar. Përjashtim përbëjnë, siç e shohim te ilustrimi sipas Bevingtonit, fjalë të tilla si: kumbull, deçanas (vetëm kur është prapashtesë – nuk vlen te ndërtimet e tjera p.sh. ananas), lavdishëm (por jastëk), për të cilat Canalis ka ofruar shpjegime (i lavdishëm - e lavdishme – pra ë-ja është formë intrusive që (v.j.) lidhet me strukturën e rrokjes).

Mirëpo, konceptimet më precize të kundruara tutje sipas morave, jo thjesht rrokjeve, dhe interpretimet sipas teorisë së optimalitetit nga autorë/e të dy dekadave të fundit, si Canalis, tregojnë për theks të shqipes që bie në morën e parë të këmbës metrike, pra karakter troku jo në kuptimin e rrokjes, por të morave brenda të së njëjtës rrokje të rëndë. Fjalë të tilla si kalá, njerí e kanë theksin në rrokje të rëndë që formon theks paroksiton moraik. Te fjalë si kumbull kemi rrokje të fundit të lehtë. Njëjtë është edhe te shqiptimi /punə/ - me ç'rast fjala ndahet në dy rrokje, e dyta nga të cilat është e lehtë, e hapur. Njëjtë është edhe te fjalët e tipit: trikó, palltó si dhe te parafjalët dhe pjesëzat e tipit: para, kundër, mbase, duke etj. Kjo do të thotë se rrokja

Ndërkohë, *muzikë* ka përdorim më të gjerë, nga të gjitha shtresat. Ka pasur propozime për ndryshim të kësaj nga Këshilli Ndërkademi.

në shqipen është e ndjeshme në sasinë metrike apo kuantitetin e rrokjes që nënkupton numrin e morave të tyre (pesha) e jo puro nga cilësia e zanores në rrokje.

Pra, vendimtare këtu është se theksi i shqipes është i varur nga pesha e rrokjes dhe se ka orientim në të djathtë.

Bibliografia:

Belluscio, G. (1993). Le vocali toniche dello shqip. Në: *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria*, 7, Serie Albanistica 1, Rende: dell'Università della Calabria, pp. 23-42

Bevington, G. L. (1974). *Albanian Phonology*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Boissin, H. (1975). *Grammaire de l'Albanais Modern*. Paris: Chez L'Auteur

Bokshi, B. (2004). *Për vetorët e shqipes*. Prishtinë: ASHAK

Bokshi, B. (2012). *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*. Prishtinë: ASHAK

Bokshi, B. (2014). *Varia*. Prishtinë: ASHAK

Bozhoviq, Gj. (2012). Theksi i fjalës në morfonologji të shqipes: teoria metrike dhe e optimalitetit. Në B. Rugova (red) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 31/1*. Prishtinë, Universiteti i Prishtinës

Buchholz, O.; Fiedler, W. (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.

Camaj, M. (1984). *Albanian Grammar*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Canalis, S. (2007). To What Extend is Albanian Stress Predictable. Në: A. Biseto, F. Barbieri (red.) *Proceedings of the XXXIII Incontro di gramatika generativa* (fq 1 – 14). Bologna: University of Bologna

Chapman, S.; Routledge C. (red.) (2007). *Key ideas in linguistics and the philosophy of language*. Edinburgh: Edinburgh University Press

Chițoran, I. (2002), "A perception-production study of Romanian diphthongs and glide-voœel sequences". Në: *Journal of the International Phonetic Association*, 32 (2): 203–222

Chomsky, N., Halle, M. (1968). *The Sound Pattern of English*. New York: Harper & Row

Dodi, A. (1968 [1963]). *Fonetika e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Enti i teksteve...

Dodi, A.; Gjinari, J. (1983). *Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare Shqipe*, Tiranë: Akademia e RPS të Shqipërisë

Friedman, V. A. (2004). *Studies on Albanian and Other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini

Hamp, E. (1992). Albanian. Në: Grozdenović J. (red.) *Indo-European Numerals*. Berlin, Neë York: Mouton de Gruyter

- Ismajli, R. (1980) *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja
- Ismajli, R. (1985) *Gjuha shqipe e "Kuvendit të Arbënit" (1706)*. Prishtinë: Rilindja
- Kacorri, Th. (1979). *A Handbook of Albanian*. Sofia: Sofia University "Kliment Ohridski"
- Kager, R. (2001). *Optimality Theory*. Beijing: Foreign Language Teaching and Research Press
- Koffi, E. (2020) "A Comprehensive Review of Intensity and Its Linguistic Applications". Në: *Linguistic Portfolios: Vol. 9* dhe https://repository.stcloudstate.edu/stcloud_ling/vol9/iss1/2
- Ladefoged, P. (2003). *Phonetic Data Analysis. An Introduction to Fieldwork and Instrumental Techniques*. Oxford: Blackwell Publishing
- Maynard K. L. (1997). An Optimality analysis of Albanian word stress. Në: X. Li et al (red) *Papers from the 1997 Mid-America Linguistic Conference* (fq 94 – 100)
- McCarthy, J. J. (2007). *Derivations and Levels of Representations*. Amherst: University of Massachusetts.
- Newmark, L., Hubbard, P., Prifti, P. (1982), *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press.
- Petrucci, P. (1999). *Slavic Features in the History of Romanian*. Munich: Lincom Europa
- Pipa, A. (1978). *Albanian Folk Verse: Structure and Genre*, München: Rudolf Trofenik.
- Rugova, B. (2009). *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: KOHA
- Rugova, B. (2016). "Kontributi i Bevington-it për fonologjinë e shqipes". Në: *Studimet albanistike në Amerikë*. Prishtinë: ASHAK
- Rugova, B. (2019). *Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë*. Prishtinë: ASHAK
- Rugova, B.; Sejdiu-Rugova, L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat
- Rusakov, A. (2017). "Albanian". Në: Kapović, M (red.) *The Indo-European Languages*. London, New York: Routledge
- Sawicka, I. (1988). "Theksi në shqipen". Në: *Seminari 13 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës
- Sawicka, I.; Dargiel, K. (2018). *Struktura e rrokjes shqipe*. Prishtinë: ASHAK
- Tahiri, L. (2009). *Rrëfimi impersonal i Kadaresë*. Shkup: Vatra
- Topalli, K. (1995). *Theksi në gjuhën shqipe*. Tiranë: Shtëpia botuese enciklopedike
- Trommer, J. (2004), *Albanian word stress*. dhe www.unileipzig.de/~jtrummer/alb_stress.pdf.
- Trommer J. (2009), *Stress Uniformity in Albanian morphological argument for cyclicity*. Leipzig: University of Leipzig
- Trommer J. (2013), *Stress Uniformity in Albanian morphological argument for cyclicity*. Në: *Linguistic Inquiry*, MIT Press.

GJUHËSI / LINGUISTICS

KDU 811.18-112(05)

811.18'362:821.1/.2(05)

Anila OMARI

DISA TIPARE MORFO-SINTAKSORE TË SHQIPES SË VJETËR (SHEK. XVI-XVII) DHE GJURMËT E TYRE NË SHQIPEN E SOTME

Abstrakt

Tekstet e vjetra shqipe janë një burim i paçmuar për dokumentimin e gjuhës shqipe në një fazë më të vjetër të saj, në atë të shekujve XVI-XVII. Vërtet kjo periudhë nuk është shumë e hershme në raport me shqipen e sotme, por ajo ruan tipare të fazave më të vjetra, parashkrimore e parahistorike të shqipes. Nga ana tjetër, edhe në këta 4-5 shekuj që kanë kaluar që nga periudha e teksteve më të vjetra shqipe, gjuha ka pësuar ndryshime, nganjëherë largvajtëse, aq sa të ketë vështirësi në të kuptuarit e këtyre teksteve nga përdoruesit e sotëm. Prandaj hulumtimi i gjuhës së teksteve të vjetra si përfaqësuese të një faze më të vjetër të shqipes të fiksuar në shkrim është një pikënisje e domosdoshme qoftë për të rindërtuar fazat më të hershme, të padokumentuara të shqipes, qoftë për të kuptuar dukuri të tipare në dukje “të çuditshme” apo “të parregullta” të gjendjes së sotme. Në këtë kumtesë duam të sjellim disa shembuj të këtyre “anomalive” në sistemin gramatikor të shqipes së sotme që duhen shpjeguar me sistemin e shqipes së vjetër.

Fjalët çelës: tekstet e vjetra shqipe; sistemi i shqipes së shekujve XVI-XVII; tipare morfo-sintaksore; dukuri mbeturinore në shqipen e sotme

Hyrje

Tekstet e vjetra shqipe janë një burim i paçmuar për dokumentimin e gjuhës shqipe në një fazë më të vjetër të saj, në atë të shekujve XVI-XVII. Vërtet kjo periudhë nuk është shumë e hershme në raport me shqipen e sotme, por ajo ruan tipare të fazave më të vjetra, parashkrimore e parahistorike të shqipes. Nga ana tjetër, edhe në këta 4-5 shekuj që kanë kaluar që nga periudha e teksteve më të vjetra shqipe, gjuha ka pësuar ndryshime, nganjëherë largvajtëse, aq sa të ketë vështirësi në të kuptuarit e këtyre teksteve nga përdoruesit e sotëm. Një arsye për këtë është edhe mungesa e lëvrimit intensiv të gjuhës shqipe me shkrim gjatë këtyre shekujve, mungesa e arsimit në shkallë të gjerë, si dhe mosbotimi i fjalorëve dhe gramatikave kodifikuese, që, edhe pse nuk kanë qenë krejt të pakëta, kanë mbetur në dorëshkrim, disa prej

tyre edhe kanë humbur. Prandaj hulumtimi i gjuhës së teksteve të vjetra si përfaqësuese të një faze më të vjetër të shqipes të fiksuar në shkrim është një pikënisje e domosdoshme qoftë për të rindërtuar fazat më të hershme, të padokumentuara të shqipes, qoftë për të kuptuar dukuri e tipare në dukje “të çuditshme” apo “të parregullta” të gjendjes së sotme. Në këtë kumtesë duam të sjellim disa shembuj të këtyre “anomalive” në sistemin gramatikor të shqipes së sotme që duhen shpjeguar me sistemin e shqipes së vjetër.

1. Gjinia asnjane.

Siç është e njohur gjinia asnjane ka qenë një tipar gramatikor i shqipes së vjetër, që përfshinte edhe emrat e parmë (njësi primare të leksikut), të ashtuquajturit asnjane të vjetër, krahas emrave prejfoljorë e prejmbiemërorë asnjane, që janë kategori ende të gjalla sot në gjuhë. Në periudhën e teksteve të vjetra disa prej këtyre emrave asnjane ekzistojnë ende, por dalin me gjini të ndryshme, herë si asnjane, herë si mashkullorë e herë si femërorë. Disa emra që te Buzuku dalin si asnjane, te Bogdani psh. kanë kaluar në gjininë mashkullore ose femërore. Kjo flet për dobësimin e ndjenjës së asnjanesit në këtë fazë të shqipes dhe shpërbërjen e saj graduale deri në zhdukje. Disa nga emrat asnjane të mirëfilltë janë emra lënde, si *ujë*, *brumë*, *drithë*, *dyllë*, *dhallë*, *mjalte* por edhe emra të tjerë që nuk tregojnë lëndë, si *krye*, *djalë*, *mish*, *grunë/grurë*, etj. Sot në gjuhën e përgjithshme këta emra kanë kaluar përgjithësisht në gjininë mashkullore, por në dialekte jetojnë ende trajta të gjinive të tjera. Psh në të folme të jugut gjendet trajta e femërores *mjalta* (khs. Çajupi: *ku është balta më e ëmbël se mjalta*), po ashtu te Dhanil Haxhiu Voskopojari në fillim të shek. XIX (1802) del trajta e femërores *balla*; në disa krahina haset trajta e mashkullores *dhalli*, ndërsa në Shqipëri të Mesme del edhe mbaresa *-t* e asnjanesit në trajtat e shquara të gjinisë mashkullore: *kryti*, *ujti*, *dhallti*. Në të folmet e jugut në brezin e vjetër dëgjohen ende trajta të asnjanesit si *ujët* (*Ujë e ftohtë* në Vlorë), *ballëtë* në ndonjë këngë të vjetër popullore të Gjirokastrës (*e ke ballëtë me lule moj Bardhule*), *mishtë* (edhe në eposin e Veriut: *mishtë e dorës si rremi i shemshirit*), ndërsa në gegërishten veriore dëgjohet ende trajta e asnjanesit *kryet*, në shprehjen *më dhemb kryet*. Nga pozitat e sotme shumica e folësve nuk e dinë se këtu bëhet fjalë për një asnjane dhe u duket si një anomali gramatikore ku emri paraqitet në numrin shumë kurs folja në njëjës. Në rasat e zhdrejta ky emër del në gjininë femërore: si *krejet*, *kresë*, si në *shprehjen i ra kresë*.

2.1. Paradigma e emrave mashkullorë më -ë dhe e femërorëve më bashkëtingëllore.

Në shqipen e vjetër ka pasur një paradigme të gjerë emrash mashkullorë që mbaronin me -ë në trajtën e pashquar njëjës, si *emënë, dimënë, hekurë, shekullë, kopështë* etj. Një listë të plotë të këtyre emrave e ka dhënë Kolec Topalli në Gramatikën e tij historike. Gjurmë të kësaj paradigme gjenden sot në emrat mashkullorë që mbarojnë me -ë, si *kalë, lumë, burrë, djalë, ujë, gjalpë, djathë* e të tjerë që u përmendën më lart, që në vështirësi të parë duket sikur përbëjnë një anomali në paradigmen e shqipes të emrave mashkullorë që zakonisht mbarojnë me bashkëtingëllore. Për këta emra është diskutuar mjaft në debatet për rishikimin e drejtshkrimit, duke kërkuar që të njësohen me emrat mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëllore, pra të shkruhen pa -ë-në fundore. Kjo zgjidhje do të fshinte çdo gjurmë historike të kësaj paradigme emrash mashkullorë në shqipen e sotme.

2.2. Po kështu ka pasur edhe një paradigme të emrave femërorë që mbaronin me bashkëtingëllore, si *qiell, -ja, end, -ja, mend, -ja, vullnet, -ja, shëndet, -ja, pushtet, -ja, ligj, -ja, kryq, -ja, Lesh, -Lezhja* me sonorizim të /sh/-së para spirantes -j e zgjatje të zanores së temës etj. nga të cilat sot kanë kaluar disa në gjininë mashkullore. Prandaj sot dëgjojmë ndonjëherë ose lexojmë në literaturën e paraluftës *ligja*, si në kartëmonedhat e vjetra që i kemi trashëguar edhe pas luftës: *ligja dënon ata që prodhojnë e shpërndajnë monedha të falsifikuara*. Ose në toponomastikë ka emërtime si *Krygja*. Emri i qytetit Lezhë siç e dimë ka qenë Lesh (nga Alessio) dhe kjo trajtë ka mbetur në fjalinë përmbyllëse të përrallave popullore: *Prralla në Lesh, shndetja prej nesh*.

3. Shumësi i emrave asnjans prejfoljorë

Në rrugën drejt shpërbërjes së gjinisë asnjans, emrat asnjans në numrin shumës, shumë kohë para fazës së dokumentuar të shqipes, kanë marrë mbaresa të gjinive të tjera, kryesisht të gjinisë femërore¹. Kjo ka ndodhur për arsye se në shumës nevoja për markimin e gjinisë zbehet dhe shtohet nevoja për markimin e numrit, ku mbaresa e femërores -a e luan fare mirë këtë rol. Përdorimi i formave të gjinisë femërore bie në sy veçanërisht në shumësin e emrave asnjans prejfoljorë (tipi *të qeshurat*). Madje ka shumë gjasë që njëjësi i gjinisë femërore të këtyre emrave të jetë krijuar duke u nisur nga shumësi. Në gjuhën e folur kjo dukuri e përdorimit të formave të femërores në njëjësin e emrave asnjans është vënë re së pari nga Weigandi për

¹ Sh. Demiraj, "Gjinia asnjans në gjuhën shqipe (punim historik dhe përshkrues)", në *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, USHT, Tiranë, 1972, f. 71-263; Po ai, "Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumës në gjuhën shqipe, vështuar edhe në përjasje me rumanishten", në *Çështje të sistemit emëror*, vep. cit., f. 64.

gegërishten jugore² ku emrat prejfoljorë asnjans në njëjës janë zëvendësuar me format përgjegjëse të gjinisë femërore, të tipit *e hangmja, e ikmja, e dridhmja, e hymja, e dalmja* etj. Në studimet sinkronike për shqipen e sotme, ndërkaq është arritur në përfundimin se shumësat e tipit *të qeshurat* duhen trajtuar vetëm si shumësa të emrave përkatës të gjinisë femërore, edhe për faktin se shumësat e këtij tipi kuptimisht afrojnë më tepër me emrat foljorë me paranyjëzim të gjinisë femërore, domethënë anojnë më shumë nga shprehja e rezultatit të veprimit.³ Ndërsa emrat e veprimit të tipit *të folurit* duhen trajtuar si emra që përdoren vetëm në numrin njëjës.⁴ Ky qëndrim është pasqyruar edhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe 1980, ku emrat asnjans të tipit *të folurit, të qeshurit* janë trajtuar si emra që përdoren vetëm në njëjës.

Në shqipen e vjetër gjendja është ndryshe: emrat prejfoljorë asnjans e formojnë shumësin me mbaresat e gjinisë femërore. Shumësat femërorë të tipit *të kallëzume,-t* i përkasin së njëjtës paradigme të lemës emërore asnjansë *të kallëzuem,-itë*. Edhe kuptimi leksikor i këtyre emrave asnjans e përlligj trajtimin në të njëjtën paradigme: në shqipen e vjetër emrat asnjans prejfoljorë mund të shënojnë edhe rezultat veprimi, ashtu si emrat përkatës prejfoljorë të gjinisë femërore, madje kanë edhe kuptim të një sendi konkret. Dhe pikërisht ky kuptim konkret ka favorizuar edhe krijimin e njëjësit të gjinisë femërore. Emri asnjans *të mbëluem,-itë* ka kuptimin konkret “mbulesë: it. *coprimento*”: II 39 4 pa zjarm, pa shtëpi, pa *të mbëluem*, e pa ndonji ngushëllim. Në shumës merr treguesit e gjinisë femërore: I 56 7 veçë ndëpër shumë duer *së mbëluemesh* rrethuem (nisi varietate sacrorum *velaminum* circumvelatum). Emri asnjans *të lypun/ë,-itë* ka kuptimin konkret “kërkesë: it. *domanda*”: I 110 2 Pëlqej Tinëzot këta *të lypunë*, e i kthej fjalë. Në shumës merr mbaresën e gjinisë femërore: I 89 15 të kthenje ke Faraoni me *të lypuna*~të vet (che tornasse da Faraone con la sua *dimanda*).⁵

Ndërkohë, vihet re se janë krijuar, në gegërishten e shek. XVII, njëjësat femërorë që tregojnë emra konkretë. Në tekstin e Bogdanit dalin disa raste të femërorëve njëjës, të formuar nga pjesoret më *-m*: II 75 14 as ndë çast mos e kallëzo, o përpall *të bamenë* (ò publicare il *fatto*); II

² G. Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1917, f. 136-137; A. Xhuvani, *Studime Gjuhësore*, Tiranë, 1956, f. 208; khs. Sh. Demiraj, “Gjinia asnjansë...”, në: *Çështje të sistemit emëror...*, vep. cit., f. 203.

³ L. Buxheli, “Emrat prejfoljorë të paranyjëzuar me kuptimin e veprimit në gjuhën e sotme letrare shqipe”, *Studime Filologjike*, 1983, nr. 2, f. 143-146.

⁴ Po aty, f. 145.

⁵ Shih më gjerësisht artikullin tim në *Kërkime Gjuhësore* II, akte të konferencës shkencore organizuar nga Instituti i Gjuhësisë, 4 korrik 2013, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2014, f. 169-173.

141 3 E u ndie një madh zâ, *e dridhme*, e silla punë aspak s i tmeroj; II 40 9 me një thembër bukë melakuqe e një *të pīme* ujë etj. Që te Frang Bardhi dëshmohej njëjësi i gjinisë femërore si emër konkret prejfoljor: *e pime* “potio, bevanda” 103 18.

4. Shumësi me -zë

Në një shqipe më të vjetër prapashtesa -z ka shërbyer si prapashtesë shumësi. Kjo nuk duhet ngatërruar me prapashtesën deminutive -zë⁶. Te autorët e vjetër dalin forma të tilla shumësi: Buzuku 11va *duorzit*, 13ra *duorzëtë*, 54ra *vashëzatë*, 41rb *të vogjëlizitë*, Budi SC 36, 171 *dielmzit*, 59 *vashazëtë*; Bogdani *djelzit*, *zojzit*, *vashaz*, *vashëzatë*, *petëkazitë*, *mjalcazitë*, *tryesazë* etj.. Te Matranga gjithashtu del shumësi me -z: *djäljazit* (li demonij) 18r. Këtë prapashtesë e ka vënë re së pari Jokli i cili e mendonte si prapashtesë me kuptim kolektiv.⁷ Në gjuhën e sotme kanë mbetur gjurmë të këtij shumësi në pak emra si: *vëllezër/vëllazën*, *njerëz*, *kallëz*, *varreza* etj. Në ndonjë të folme ruhet trajta e shumës me -z te emri varr: *varrezt e vjetër* (Seman).⁸ Në një dialekt konservativ si çamërishtja ruhen më tepër gjurmë të shumës me -z, psh. *vajzë* e bën shumësin rregullisht *vashëz*, si në shqipen e vjetër të Bogdanit, po kështu edhe *gërshëraz*. Të këtij lloj shumësi mund të quhen edhe formimet toponimike me -s që janë të zakonshme në Çamëri si: *Arast*, *Guvast*, *Goricast*, *Pusest*.⁹ Emrat femërorë të zvogëlimit më -ez: *pulez*, *arrez*, *balez*, *korez*, *botez* e bëjnë shumësin po kështu. (Haxhihasani 168). Shumësa me -z dalin edhe në shqipen e Greqisë (te Reinholdi): ajo hora e ndajturë *lumërez-lumërez* (Klosi 73), di *drurëz* (f. 62), *lulezëtë* (f. 58).

5. Rasa vendore

Në sistemin rasor shqipja e një faze të vjetër të caktuar ka pasur një rasë më shumë nga sistemi me 6 apo 5 rasa që kemi sot: të ashtuquajturën rasë vendore ose lokativ, ekzistenca e së cilës si rasë më vete ka pasur mendime të ndryshme. Së fundi Kolec Topalli në Gramatikën e tij

⁶ Shih për këtë Xhuvani-Çabej, “Prapashtesat e gjuhës shqipe”, në *Studime Gjuhësore* III, Prishtinë 1976, f. 296v.

⁷ N. Jokl, “Disa fjalë të shqipes si dëshmi të historisë së kulturës shqiptare”, SF, 1964, nr. 3, f. 3-14.

⁸ Jani Thomai, “E folmja e katundit Seman”, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, nr.3, Tiranë 1961, fq.178, 58.

⁹ Q. Haxhihasani, “Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë”, në: *Dialektologjia Shqiptare*, I, Tiranë, 1972, f. 168. Shih edhe A. Omari, “Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut”, në *Wir sind die Deinen, Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, Albanische Forschungen 29, Hgg. von Bardhyl Demiraj, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 372v.

historike e ka pranuar si rasë të veçantë në shqipen e vjetër, që plotëson të gjitha kushtet morfologjike, sintaksore e funksionale për të qenë e tillë. Emri në rasën vendore merr mbaresën -t dhe përdoret me parafjalët *ndë, ndënë, ndëpër, mbë, me, përmbi, për*. Kjo trajtë rasore përdorej rëndom në shqipen e vjetër, pasi e gjejmë te të gjithë shkrimtarët e vjetër të Veriut, si dhe te Matranga e te shkrimtarët më të vjetër arbëreshë nga Sicilia¹⁰. Më pas dëshmohet në tekstet toskërisht të shekullit XIX (Samiu, Naimi, Kristoforidhi, tekste folklorike nga Pedersen, Dozoni, Mitko etj.¹¹), ndërkohë që në geg. veriore ka humbur. Në gjendjen e sotme të gjuhës, gjurmë të saj gjenden në hapësirën midis Matit dhe Vjosës. Për shembull në të folmen e Tiranës dhe më në jug dëgjojmë shprehje si: *erdhi në drekët, në darkët*, në rrethinat e Lushnjes *në mëngjest, në malt* etj., por kemi ndeshur dëshmi edhe për Nikaj-Mertur: *-A kie pasë dâm në gjât ...? - Sha zotën, kam pasë dâm në gjât boll*.¹²

Në shqipen e sotme kjo rasë është zëvendësuar me kallëzoren e shquar kur kundrina ndiqet nga një përcaktor (*në bregun e detit, në malin e Dajtit, në Gjirin e Lalzit*). Në gjuhën e brezave më të vjetër në këto raste përdoret ende kallëzorja e pashquar: *në breg të detit, në mal të Dajtit, në Gji të Lalzit*. Kjo mund të duket si një “parregullsi” gramatikore, pasi emri kur ndiqet nga një përcaktor është kuptimisht i shquar, pra duhet të ishte i pajisur me nyje. Në të vërtetë këtu kemi një mbeturinë të rasës vendore, tek e cila ka rënë mbaresa -t në kushtet kur ndiqej nga një nyje me të njëjtën fonemë nistore.

6. Mbiemrat e nyjshëm të përdorur pa nyje

Siç na dëshmojnë studimet historiko-gjuhësore të shqipes¹³, paravendosja (prokliza) është një dukuri relativisht e vonë dhe ka lindur në proceset sintaksore nga prapavendosja (enkliza). Si një dukuri e paravendosjes, nyja e përparme është shfaqur më vonë se e prapmja në sistemin nominal të shqipes. Nyja e prapme i takon periudhës parahistorike të shqipes, ndërsa e përparmja është formuar në periudhën paraletrare dhe është zhvilluar shkallë-shkallë,

¹⁰ M. La Piana, “I dialetti siculo-albanesi”, në: *Albanesi in Sicilia*, a cura di M. Mandalà, AC Mirror, Palermo 2003, f. 79.

¹¹ A. Xhuvani, “Parafjalët”, në: *Vepra I*, IGJL, Tiranë, 1980, f. 277.

¹² D. Qokaj, “Qasje ndaj kompetencës sociolinguistike nikajmërturase”, në: *Kërkime Gjuhësore V*, QSA, IGJL, Tiranë, 2016, f. 325.

¹³ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, BUSHT SSHSH, nr. 3, 1963, f. 79-90. Sh. Demiraj, Gramatikë historike e shqipes, Tiranë 1986, passim.

nëpërmjet përsëritjes sintaktike të nyjës së prapme.¹⁴ Çabej sjell dëshmi të shumta të përdorimit të mangët të nyjës te mbiemri në dialektet arkaike të shqipes, në onomastikë e në tekstet e vjetra shqipe, të mbështetura edhe me shembuj nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, si mbiemri, përemri, numërori, ku historikisht nuk është përdorur nyja.¹⁵ Të gjitha këto argumente tregojnë se, në një fazë më të vjetër, të padokumentuar të shqipes, mbiemri nuk përdorej me nyjë dhe po ashtu pjesorja dhe, ashtu si dhe në gjuhë të tjera, edhe në shqipen kufijte e pjesores me mbiemrin dhe të mbiemrit me ndajfoljen, nuk kanë qenë të prera, as për nga forma as për nga funksioni.¹⁶

Këta kufij fluidë vihen re sidomos në rastet e përdorimit të mbiemrave në funksion predikativ. Funksioni predikativ është ai ku dallimi midis mbiemrit dhe ndajfoljes është edhe më i papërcaktuar, pasi siç dihet nga gramatikat,¹⁷ përcaktori kallëzuesor ka lidhje të dyanshme, nga një anë me emrin në rolin e kryefjalës/kundrinës dhe nga ana tjetër me foljen në rolin e kallëzuesit. Në shqipen e vjetër, të shekujve XVI-XVII, ndeshen raste të shumta kur mbiemrat, edhe në funksion atributiv,¹⁸ por sidomos në funksion predikativ, dalin pa nyjë të përparme dhe nga ana formale nuk dallohen nga ndajfolja ose nga pjesorja.¹⁹

Në literaturën tonë të specializuar këto lloj leksemash, që hasen edhe në shqipen e sotme dhe përbëjnë një problem ende të diskutueshëm për gramatikat shqipe, janë trajtuar si forma

¹⁴ E. Çabej, “Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike”, SF, nr. 4, 1970, f. 3-15; ribotuar në Studime Gjuhësore IV, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 345.

¹⁵ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, art. i cit., f. 80-89. Në mbështetje të këtij mendimi mund të sjellim dëshmi të tjera gjuhësore qoftë nga të folmet jugore, qoftë nga dialektet veriore të shqipes. Në fjalorin e Marko Boçarit (1809) hasen mbiemra pa nyjë si edhe gjinore pa nyjë të përparme, si: *unazë mirë, kafshë keqe, njeri mirë, dorëzë kordhësë, marr rrogë muajit* (6c) (shih. A. Klosi, “Hyrje: një thesar gjuhësor që fjeti 150 vjet”, në *Netët pellazgjike të Karl Reinholdit. Tekste të vjetra shqipe të Greqisë*, transkriptuar e shpjeguar nga Ardian Klosi, f.37).

¹⁶ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, BUSHT SSHSH, nr. 3, 1963, f. 82-83, 88-89.

¹⁷ M. Totoni, “Përcaktori kallëzuesor”, *Studime Filologjike*, nr. 3, 1976, f. 88-89. Sh. dhe kapitullin përkatës në *Gramatika e gjuhës shqipe II. Sintaksa*, ASHSH, Tiranë 2002.

¹⁸ Disa raste përdorimi mbiemrash pa nyjë në funksion atributiv janë, psh. te Buzuku: 25vb *kā* me ardhunë ëmbë darsmë të lavdit *madh* të jetësë glatë; 37ra e lavdi *madh* i Tinëzot leu përëmbi tÿ; 43vb përëmbi shkamt të lavdit *madh* tÿ; 44va E të panëtë e lavdit *madh* Zot ish porsi zjarm; te Bogdani: II 77 2 ku Çelidoni mbaroj jetënë vet me *madhe* shëjtëni. II 134 14 ndë mor tÿ Aronit, prift *madh*. I 128 5 jashtë Hyjit Zotit *madh*; I 139 1 u godit nji *madh* tremek; I 113 12 e kje nji *förtë* shkandullë; I 51 13 gjithë kafshëvet *gjallave*, I 58 11 kruetë ujit *gjallë*, II 16 15 kishësë *gjallë* së Hyjit.

¹⁹ Për më gjerësisht shih A. Omari, “Vështrim sinkronik i një dukurie diakronike: trajtimi i sotëm leksikogramatikor i të ashtuquajturve ‘mbiemra reliktorë’ të shqipes”, në: *Kërkime Gjuhësore* III, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2015, f. 227-327.

reliktove të mbiemrave sot të nyjshëm.²⁰ Studimet diakronike të shqipes kanë vënë re se nyja ka ardhur duke u shtrirë gjithmonë e më shumë në përdorim, dhe, sidomos te pjesorja, ky zhvillim vijon edhe sot,²¹ siç dëshmojnë studimet e shqipes së sotme.²² Mjafton të sjellim për krahasim gjendjen e përdorimit të autorët e vjetër me atë të shekullit XIX të Kristoforidhi për të njëjtin kontekst:

Buzuku: 13v88-89 *Bekuom* je ti endër grāt, e *bekuom* frujtitë e barkut tit;

Bogdani: II 15 11 *Bekuem* je ti përmbi gjithë grat, e *bekuem* është frujti i barkut tyt;

Kristoforidhi: *E bekuarë* je ti ndë mest të gravet, edhe *e-bekuarë* është pem' e barkut t'ënt (Ungjilli pas Llukajt, 1 43).

Shtimi i përdorimit të nyjës mund të vihet re edhe ndër autorët e vjetër, nga Buzuku te Bogdani. Autorët më të vjetër të shqipes, Buzuku e Budi përdorin më shumë trajta pa nyjë sesa Bogdani.

Në studimet e shqipes së sotme mbizotëron qasja sinkronike dhe mbi këtë bazë është kriteri morfologjik ai që vlen për dallimin mbiemër/ndajfolje apo pjesore/mbiemër prejpjesor, pasi ajo që i dallon qartë mbiemrat e nyjshëm në shqipe është pikërisht nyja e përparme, sot e përgjithësuar në gjuhë.²³ Mirëpo edhe në gjuhën e sotme ka gjurmë të leksemave me kuptim kategorial mbiemëror që përdoren pa nyjë e pa mbaresë në funksion predikativ, dhe që klasifikohen si ndajfolje thjesht për hir të kriterit morfologjik. Të krahasohen psh fjalitë *e kapën gjallë* dhe *e kapën të gjallë* ku fjala predikative nuk ka ndonjë ndryshim semantik dhe lidhjes sintaksore; në të dy rastet ajo ka semantikë mbiemërore dhe përcakton gjendjen si tipar cilësor të kundrinës së shprehur me trajtë të shkurtër përemërore. Por në shembullin e parë *gjallë* nga pikëpamja e sotme kategorizohet si ndajfolje për shkak të mungesës së nyjës. Natyra

²⁰ Ali Dhrimo, "Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare", *SF*, nr. 1, 1969, f. 58-66; ribotuar në: *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Infbotues, Tiranë, 2008, f. 41-50.

²¹ Po ai, po aty, f. 88.

²² "përdorimi i mbiemnit participor, që duket se asht i rrallë në gjuhën e të folmes, u bā i shpeshë në gjuhë të shkrimit (prej influencës, si duket, të gjuhëve neolatine) dhe u fut me të madhe në shkrimet e në veprat e kohëve të reja si një formë letrare", A. Xhuvani, "Pjesorja në shqipet", në *Studime Gjuhësore*, Tiranë, 1956, f. 206. Në të njëjtin përfundim ka arritur edhe F. Agalliu, i cili ka vënë re se në veprat e shkrimtarëve që qëndrojnë më afër gjuhës popullore, si Ali Asllani, Jakov Xoxa, Sotir Andoni ndërtimet me pjesore janë shumë më të dendura sesa në standardin e sotëm, ndërsa në letërsinë e viteve '60 vihet re shtrirja e përdorimit të mbiemrit foljor nga pjesorja, më tepër si një prirje e vetë gjuhës sesa si ndikim i gjuhëve të huaja, khs. F. Agalliu, "Pjesorja në gjuhën shqipe", f. 189.

²³ Shih p.sh. Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, USHT, Tiranë, 1967, f. 266.; E. Hysa, "Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe", *SF* 1970, nr. 3, f. 47-48.

kategoriale mbiemërore e këtyre leksemave pa nyjë e pa mbaresa del e qartë në disa ndërtime ku ato përdoren si përcaktor predikativ i një emri të prirë nga parafjala *me*, si gjymtyrë e dytë e një fjalie, të tipit: *Mbeti jetim me baba gjallë; dëgjonte me gojë hapët*.²⁴

Grupi i leksemave me përmbajtje semantike të ndërmjetme midis vetisë dhe gjendjes, në shqipen e vjetër ishte më i gjerë dhe përfshinte, përveç fjalëve *gjallë, shëndoshë, sëmune/sëmutë*, edhe të tjera që në përdorim predikativ dalin pa nyjë, si *verbëtë, shurdhëtë, dëlir, lir, fështir*. Në shqipen e sotme këto leksema bëjnë pjesë në kategori të ndryshme leksikogramatikore: *verbër e dëlirë* ekzistojnë vetëm si mbiemra të nyjshëm, pasi nuk përdoren më në funksion predikativ pa nyjë; përkundrazi, *shurdhër* përdoret në mënyrë të figurshme si gjymtyrë predikative në shprehje si *na la shurdhër, mbetëm shurdhër*, të cilat kategorizohen nëpër fjalorë si ndajfolje edhe pse nuk përcaktojnë veprimin e foljes. Leksema *vështirë* në përdorim predikativ pa nyjë trajtohet si ndajfolje: *Është vështirë. E patëm vështirë. Vështirë të kthehet sonte. Sëmure* gjithashtu merret si ndajfolje në përdorimet *jam sëmure, ra sëmure*. Kriteri i pastër morfologjik i mungesës së nyjës së mbiemrave në përdorim predikativ ka bërë që në gramatikat e gjuhës shqipe të pranohet edhe ndajfolja si mjet shprehjeje i kallëzuesit emëror me këpujën *jam*, gjë që nuk gjen përgjegjëse në gjuhët e tjera evropiane.

Mbiemrat që tregojnë ngjyra janë cilësorë të mirëfilltë dhe nuk kanë ndryshime semantike nëse përdoren me nyjë ose pa nyjë. Këta lloj mbiemrash kanë mbetur edhe sot në disa përdorime në trajtën e paepituar, zakonisht të përsëritur: *kuq kuq, verdha verdha, bardhë si bora, kuq si molla, skuadra kuq e zi* etj. Në shqipen e sotme kriteri formal i nyjës i ka detyruar hartuesit e fjalorit të klasifikojnë deri edhe mbiemrat e ngjyrave në kategorinë e ndajfoljes kur dalin pa nyjë. FGJSSH ka *bardhë* si ndajfolje (*u bë bardhë në fytyrë*), por jo *kuq*, ndërsa dy mbiemrat e bashkërenditur homogjenë *kuq e zi* i ka njëfjalëzuar në mbiemrin kompozitë të panyjshëm *kuqezi*.

Leksemat *lum e mjerë*, që në shqipen e vjetër janë gjymtyrë predikative (khs. p.sh. Bogdani II 72 3 tha Jezu Krishti Pjetrit, *lum je*) në shqipen e sotme, tashmë të ngurosur, trajtohen si pjesëza (FGJSSH) apo pasthirrma²⁵. Në këtë mënyrë shmanget një inkoherencë e mundshme për të klasifikuar si mbiemër një trajtë pa nyjë të një mbiemri të nyjshëm. Por ky klasifikim ka lënë mënjanë rastet si *lumja unë, mjera unë*, që pas gjase janë konsideruar jonormative.

²⁴ Shih A. Dhimo, *Për shqipen dhe shqiptarët*, vep. cit., f. 49.

²⁵ *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Tiranë, 1997, f. 173, 197.

7. Mënyra lidhore pa pjesëzën të.

Në shqipen e teksteve të vjetra krahas lidhore me pjesëzën të²⁶ vihet re përdorimi i lidhore pa pjesëzën të.

7.1. Por në përdorimin e foljeve me kuptimin modal të lidhore bie në sy më shumë përdorimi i trajtave të dëftores, sidomos në fjalitë kohore të prira nga lidhëzat *para se*. Këtë e ndeshim shumë shpesh te Buzuku e Bogdani, krahas trajtave me lidhore me pjesëzën të, ndërsa rregullisht te Budi. Buzuku 12va: parë se *ish* shekulli *zanë*; 13ra: qi parë se *vjen ëndukunë* anshtë përvëluotë; 49va: përse aj të të bekonjë parë se *vdes*; 50ra: e u angra ën gjithësej parë se ti *vinjë*? 54va: e ti qi di gjithë kafshë parë se *banetë*; 59vb: parë se Abraami *ish*, u jeshë.

Budi DC 126 14: parë se *vien* mortja e të *gjën*; 198 19-20: parë se na *jemi shkuom* // ndëpër shekullit përdām; RR 22 29: Prifti aty parë se *ze fll* me e pagëzuom; 40 9: ende parë se *janë dām* n kishet; SC 131 10: A mos kishnje thanë meshë natënë, parë se *del* drita? Budi i përdor të gjitha rastet e foljeve me lidhëzat *parë se* në trajtën e dëftores.

Bogdani: I 2 7 e parë se *mbytej* shekulli me ujë, I 20 4 Parë se qiellja, dheu, deti e zjarmi /*Ishte*, kje zjarmi, dheu, qiellja e deti; I 97 1 Përpara se *vinte* Krishti. I 90 20 Parë se *goditej* ajo punë, Mojzesi bani me dijtunë rejnë “Prima che ciò avvenisse [...]”; I 34 8 parë se *kje çelë* Parrisi me mundi të Jezu Krishtit “prima che [...] fosse aperto il Paradiso”; I 104 2 Mu ende thonë se Davidi parë se *mirrte* gjumi thoj atë salm 107 “Anzi dicono, che David prima che s’addormentasse dicca quel Salmo 107”; I 122 16 se parë se xhudhijtë kurraj ndë mend *u bijte*, aj erdh “che prima, che li Giudei mai s’imaginassero, egli venne”; I 161 1 gjashtë vjet parë se *len*; I 164 1 e kje parë se *rrënohej* Troja; II 1 2 Prashtu njimend është parë se *kje krijuem* shekulli “che avanti fosse creato il Mondo”; II 2 2 posikur me thanë bukurë herijet parë se *zihet*; II 20 7 e lumeja Virgjinë jo veçë kje Virgjinë parë se *lente*; II 23 21 Mesia është lem ndë Betlemt parë se *çprishej* Kisha, II 86 6 Mamë, parë se të tjerë *zanë* me folë për ndere, ecë ke Mjeshtri ynë ‘Madre, prima che li altri preoccupino in dimandare honori [...]’, II 93 3 ndë kje kurraj nder, të sillënë parë se *rrijnë* mbë tryesë është mirë me lëvduem, I 31 52 e parë se *lente* Muhameti, II kallëzori M Mria kje vajzë parë se *leu*, e mbasi *leu*.

7.2. Po ashtu dëftorja përdoret në vend të lidhore me foljen modale *mund*:

²⁶ Shih S. Mansaku, Ndërtimet me foljet modale *mund* dhe *duhet* te Gjon Buzuku, SF 1979/3, 141v.; Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, (bot. 2), ASHSH, Tiranë 2015, f. 304-306.

Bogdani: II 67 14 Si *munë dole* Misirit? II 67 14 Si *munë u kthyenë* ndë natyrë~të gjakut ujënatë? II 67 14 Si *munë u kthye* t'idhunitë ujit me dru ndë të ambla? II 67 14 Si *munë rrodhnë* prej guri kroenatë me ujë? (Por: II 67 14 Si mujti *me mbetunë* Jordani?). Edhe në gjuhën e sotme në dialekte dëgjohet ky ndërtim: *Me pyesin a mund erdhe a je lodhur*.

Por **me foljen jam** nuk mund të përdoret dëftorja: II 67 14 ty o xhudhi është dhanë me më pëvetunë atë si *munë jetë* të vepëruemitë e këti S. Sakramend, II 67 15 e si *munë jetë* qi na n teje të dahemi?

Kjo dukuri duhet të jetë ndikim i gjuhës së folur te autorët e vjetër, gjuha e të cilëve qëndron më pranë gjuhës së popullit.

7.3. Por Çabej ka vënë re dhe mungesën e përdorimit të pjesëzës *të* me lidhoren në faza më të vjetra të gjuhës. Ai mendon se “*të*-ja e lidhore nuk është origjinale, por më e vonë, si një lloj hiperkarakterizimi gjuhësor, sipas kuptimit të E. Schwyzerit. Në monumentet e vjetra mungon te lidhorja, sidomos te lidhorja jussive (urdhërore): Buzuku: *ndiglonjë* “audiat”, *aj lanë vetëvetëhenë e marë kryqnë e tī e muo ndjekë* “abneget semet ipsum, et tollem crucem suam, et sequatur me” (XL/2a, LXXXIII=CLI b), Bogdani *Ma përpara se daheshinë* “Prima però che si dividessero” (I 51 15), *Venë roe gjithë kush* “Consideri ogn’uno” (I 113 13). Në dialekte, tosk. jug. *le vijë*, në një këngë pop. *vijë e më vrasë mua*, khs. edhe futurin *do të vete e do vete*. Pjesëza në këto lloj fjalish do të ketë hyrë në ballë për të theksuar më fort shtysën e urdhërit. Një nga pikënisjet e ngulitjes së saj unë e gjej te fjalia kushtore pa tjetër lidhëz, të cilën e studioi Lambertzi (IF 34, 157v.): *Moj thëllëza ndë kafaz, Të vij brenda a më qas?* Në të tilla fjali, të cilat, sikundër ka treguar ky dijetar, gjejnë analogjinë e tyre të plotë në fjalitë kushtore të rumanishtes ndërtuar me *sa* e me lidhore, kjo pjesëz do të jetë e lashtë, sepse ajo pas mendimit tim krahasohet, mbase edhe etimologjikisht, me *tai* “sikur të” të lituanishtes. Përhapjes më tej të *t*-së në shqipen i dha shkas tendenca për të dalluar sa më shumë lidhoren nga dëftorja, me të cilën dihet se koïncidon nga pikëpamja formale, me përjashtim të v. II e III të njëjësit.”²⁷

7.4. Nga ana tjetër te autorët e vjetër të Veriut vihen re edhe raste të përdorimit të mënyrës lidhore me trajtat e dëftores. Ky nuk është një tipar i vjetër por është veçori dialektore. Te Buzuku nuk vihen re kësi përdorimesh, te Budi sporadikisht: SC 252 16-17 mb arrësye të ndōnjī, qi *të shkon* përmjedis anëmiqet vet; 229 30 ndierë *të gjën* kohonë me të këputunë qafënë, ndërsa te Bogdani rastet shtohen: A ta *pushton* si e nisi (= që ta pushtojë) (Vjersha e

²⁷ E. Çabej, “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, *Buletin i USHT, SSHSH*, nr. 3, 1963, f. 75-76.

Bogdanit kushtuar Zmajeviqit); ka me lēm aj qi *të pushton* Izrael (II 28 6); bukurë *të kumbon e të kallëzon* arbënisht (Të primitë përpara letërarit); urdhënoj qi *të del* Parrisit (I 49 9), qi të disinë përpara se *të hën* festa e Pashkësë (II 123 14); e tue mos i pasunë shkuem fjala, përsëri ju lut a të i *ep* testir *të kthen* mbë shekullit (II 82 34); i sillu urdhënoj, qi atyne të trajtonte një lter, e *të ban* sakrifiçia Tinëzot (I 112 7). Krishti i urdhënoj *të mos ban* tjetër (II kallëzori P); a *të dërgon* Lazërinë (II 82 34); sikur *të provon* petëkatë (I 95 40); Eva nukë kje bām prej kreje, *të mos zotënon* nierinë (I 46 23); Aty Davidi ju avit Saulit, ashtu qi *të mos e ndien* (I 101 17); E lypa sish nierinë qi *të thurën* një gardh ndër mue e ndër ata, e *të më kundërshton* për dhët, të mos e çartinj (I 83 14); urdhënoj qi *të del* Parrisit (I 49 9).

Kjo shpjegohet me ndikimin e së folmes verilindore të vendlindjes së tij ku hasen këto përdorime. Në të folmet e gegërishtes verilindore këtë veçori e kanë të folmet e Kosovës, por jo ato të Tropojës²⁸.

Lëkundjet midis trajtave të vendlindjes me formën e dëftores për lidhoren dhe trajtave me lidhoren e mbarë gjuhës flasin për prirjen e autorit drejt një gjuhe më të përgjithshme: e gjindja tue prem gamba ullijsh, shtrojnë udhësë, e disa shtrojnë petëkatë tyne qi *të shkon* përmbi to (II 87 11), **krahas**: Atë, ndë mundetë kurraj le *të shkonjë* meje ky kelshëjt o mund (I 58 14), Ndë mundetë kurraj, le *të më shkonjë* ky kelshëjt (II 98 2); t'sillt Krishti i tha, se parë se *të këndon* dy herë gjeli (II 95 8), **por**: se parë se *të këndonjë* gjeli dy herë, aj kishte për t i ram mboh tri herë (II 104 15), ndjerë kur një Virgjinë tue mbetunë virgjinë *të len* një djalë (II 23 23); **por**: e parë se *të lente* Muhameti (I 31 52); ashtu qi zoti i shtëpisë *t i ban* me ma nder të tyne me ndenjunë nalt (II 80 29), krahas *të mos i banjë* me ma mbarre të tyne me ndenjunë ma ungjëtë (II 80 29).

Referenca:

Agalliu, Fatmir & al. (1997). *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Buxheli, Ludmila (1983). Emrat prejfoljorë të paranyjzuar me kuptimin e veprimit në gjuhën e sotme letrare shqipe. *Studime Filologjike*, nr. 2, f. 143-156.

²⁸ Shih Xh. Gosturani, “E pakryera në të folmet e gegërishtes verilindore”, SF 85/3, f. 107-127.

- Çabej, Eqrem (1963). Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe. *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*, nr. 3, f. 79-90.
- Çabej, Eqrem (1970). Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike. *Studime Filologjike*, nr. 4, f. 3-15.
- Demiraj, Shaban (1967). *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës.
- Demiraj, Shaban (1972). *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës.
- Demiraj, Shaban (1986) (2015²). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Dhirmo, Ali (1969). Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare. *Studime Filologjike*, nr. 1, f. 58-66. Ribotuar në: *Për shqipen dhe shqiptarët I*. Tiranë: Infbotues 2008, f. 41-50.
- Gosturani, Xheladin (1985). E pakryera në të folmet e gegërishtes verilindore. *Studime Filologjike*, nr.3, f. 107-127.
- Haxhihasani, Qemal (1972). Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë. Në: *Dialektologjia Shqiptare*, I. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 118-191.
- Jani Thomai (1961). E folmja e katundit Seman. *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr.3, Tiranë.
- Jokl, Norbert (1964). Disa fjalë të shqipes si dëshmi të historisë së kulturës shqiptare. *Studime Filologjike*, nr. 3, f. 3-14.
- Klosi, Ardian (2005). Hyrje: një thesar gjuhësor që fjeti 150 vjet. Në *Netët pellazgjike të Karl Reinholdit. Tekste të vjetra shqipe të Greqisë*, transkriptuar e shpjeguar nga Ardian Klosi, Tiranë: K&B.
- La Piana, Marco (2003). I dialetti siculo-albanesi. Në *Albanesi in Sicilia*, a cura di M. Mandalà, Palermo: AC Mirror.
- Mansaku, Seit (1979). Ndërtimet me foljet modale *mund* dhe *duhet* te Gjon Buzuku, *Studime Filologjike* nr.3, f. 135-158.

- Omari, Anila (2010). Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut. Në *Wir sind die Deinen, Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, Albanische Forschungen 29, Hgg. von Bardhyl Demiraj. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, f. 356-374.
- Omari, Anila (2014). Shumësi i emrave asnjnës prejfoljorë në shqipen e shek. XVII. Në *Kërkime Gjuhësore II*, akte të konferencës shkencore organizuar nga Instituti i Gjuhësisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, f. 169-173.
- Omari, Anila (2015). Vështrim sinkronik i një dukurie diakronike: trajtimi i sotëm leksikogramatikor i të ashtuquajturve ‘mbiemra reliktorë’ të shqipes. Në *Kërkime Gjuhësore III*, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 227-327
- Qokaj, Dedë (2016). Qasje ndaj kompetencës sociolinguistike nikajmërturase. Në *Kërkime Gjuhësore V*, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Totoni, Menella (1976). Përcaktori kallëzuesor. *Studime Filologjike*, nr. 3, f. 87-112.
- Weigand, Gustav (1917). *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig.
- Xhuvani, Aleksandër (1956). Pjesorja në shqipet. Në *Studime Gjuhësore*, Tiranë.
- Xhuvani-Çabej (1976). Prapashtesat e gjuhës shqipe. Në *Studime Gjuhësore III*, Prishtinë: Rilindja.

KDU: 821.18.09(05)

003.035:272-282(05)

MENSUR VOKRRI

E ASHTUQUAJTURA VENDORE NË MESHARIN E BUZUKUT

Abstrakt

Me këtë punim synojmë ta trajtojmë rasën e ashtuquajtur vendore në librin e parë të shqipes së shkruar të njohur deri më sot, në Mesharin e Gjon Buzukut. Pra, tema e këtij punimi është përdorimi i së ashtuquajturës vendore në sistemin emëror të shqipes së vjetër që është dëshmuar së pari më 1555. Qëllimi i këtij punimi është ta paraqesë përdorimin e së ashtuquajturës vendore në gjithë sistemin emëror të shqipes së Mesharit të Buzukut dhe të shihet se si realizohet rasta përkatëse. Do të jepet realizimi i kësaj rase në të gjitha pjesët emërore (te emri, mbiemri, përemri, numërori) në korpusin e hulumtimit të këtij punimi. Do të paraqitet aspekti formal dhe ai kuptimor e funksional i së ashtuquajturës vendore duke e dhënë mbaresën rasore dhe elementin tjetër kategorial analitik (parafjalë) që i shoqëron pjesët emërore për realizimin e rasës përkatëse. Sfondi kërkimor për këtë punim është vepra e Mesharit të Buzukut, duke u bazuar në veprën studimore të E. Çabejtë në dy pjesë *Meshari i Gjon Buzukut* (1555) *Botim kritik Pjesa e parë Hyrje dhe transliterim* dhe *Pjesa e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik* (1968). Ky punim do të realizohet duke përdorur metodën e analizës së të dhënave, metodën sasiore (kuantitative) dhe metodën cilësore (kualitative) për të dhënat e nxjerra, metodën e interpretimit të gjetjeve gjuhësore, si dhe në disa raste edhe metodën e krahasimit të të dhënave përkatëse. Rezultatet e pritura për këtë punim do të jenë: paraqitja e saktë formale e së ashtuquajturës vendore në tekstin e Mesharit të Buzukut, duke e dhënë mbaresën karakteristike rasore dhe variantin e kësaj mbarese, elementin analitik që e shoqëron çdo pjesë emërore (emrin, mbiemrin, përemërin, numërorin), si dhe funksionin që e përmbushin pjesët përkatëse të sistemit emëror të shqipes së Buzukut.

Fjalët çelës: rasë, e ashtuquajtur vendore, shqipe e vjetër, përdorim, mbaresë rasore, parafjalë, sistem emëror (emër, mbiemër, përemër, numëror), Meshari i Buzukut

Abstract

This work aims to address the so-called locative case in the first known book of written Albanian so far, which is Gjon Buzuku's Meshari.

Thus, the topic of this work is the use of the so-called locative case in the nominative system of old Albanian that was firstly proven in 1555. This work intends to introduce the use of the locative case in the entire nominative system of Buzuku's Meshari and to view how this respective case is implemented. The implementation of this case will be given in all nominative parts (into noun, adjective, pronoun, and numeral) on the whole corpus of the research of this work. The formal as well as the semantic and functional aspect of the locative case will be presented by providing the case ending and the other categorical and analytical element (the preposition) which accompanies nominative parts in order to implement this corresponding case. The research background for this work is Buzuku's Meshari, on the basis of the research book of E. Cabej in two parts: the first part *Gjon Buzuku's Meshari (1555) Critical edition Introduction and transliteration* and the second part *Facsimile and phonetic transcription* (1968). This work will be realized using the method of record analysis, the quantitative method and the qualitative method for the issued records, the method of interpretation of linguistic findings, and in some instances the method of comparison of the corresponding records as well. The expected results for this work will be: the accurate formal representation of the so-called locative case in Meshari's text, the providing of the characteristic case ending and the version of this ending, the providing of the analytical element that accompanies every nominative part (the noun, adjective, pronoun, and numeral), as well as the function that respective parts of the nominative system of Buzuku's Albanian fulfill.

Key words: case, the so called locative, old Albanian, usage, case ending, preposition, nominative system (noun, adjective, pronoun, numeral), Buzuku's Meshari

1. Hyrje

Gjuhës shqipe në gjendjen e saj të sotme i janë njohur pesë rasa. Ky përcaktim është bërë nga studiues të ndryshëm të kësaj gjuhe, qoftë nga gjuhëtarë shqiptarë, qoftë nga albanologë të huaj. Megjithatë, përcaktimi i lartpërmendur është bërë kryesisht nga studiuesit vendës.

Manuali kryesor i shqipes së sotme standarde, Gramatika e gjuhës shqipe 1, i hartuar nga një grup autorësh, i ka përcaktuar pesë rasa të veçanta për shqipen e sotme. Emri në gjuhën e sotme shqipe ka pesë rasa: *emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren*. (F. Agalliu, E. Angoni, Sh. Demiraj, A. Dhimo, E. Hysa, E. Lafi, E. Likaj 2002, 105). Sipas Gramatikës së gjuhës shqipe 1 (2002), si rezultat i kategorisë së shquarësisë dhe pashquarësisë që formohet sintetikisht, përmes ndajshitesash përgjithësisht të ndryshme për secilën trajtë, dallohet lakimi i shquar dhe i pashquar, prandaj edhe secila rasë realizohet në trajtën e shquar dhe të pashquar.

Më tej, kjo gramatikë i jep edhe kriteret për përcaktimin e numrit të rasave në shqipen e sotme e që janë dy, të dyja trajtat e lakimit, i shquari dhe i pashquari dhe të dy numrat, njëjësi dhe shumësi. Gjithashtu, përveç kriterëve, gramatika e dhënë i arsyeton edhe kriteret duke i ilustruar me shembuj konkretë rasat e caktuara dhe duke i krahasuar e kundërvënë njëra me tjetrën.

Derisa në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 përcaktohen të pesë rasat e sipërpërmendura për shqipen e sotme, në të thuhet se në disa gramatika të gjuhës shqipe është pranuar si rasë e veçantë edhe thirrëja, si kuptimisht, si formalisht, por, prapëseprapë, sipas kësaj gramatike, kjo rasë nuk përlligjet, për shkak se këta tregues edhe mund të mungojnë dhe kjo trajtë rasore del njësoj sikurse emërorja e pashquar. Ndërkaq, lidhur me vendoren, në këtë gramatikë thuhet se në gjuhën e sotme letrare nuk ka një formë të veçantë as për vendoren, duke e sqaruar këtë përcaktim në fusnotën përkatëse, të cilën po e japim këtu: Forma me mbaresën *-t* (në *malt*, në *gropët*), që përdoret vetëm me parafrjalë dhe shërben zakonisht si rrethanor vendi, nuk munda të përgjithësohet në gjuhën letrare dhe mbeti si formë dialektore. Në këtë ka ndikuar edhe fakti se kuptimet e vendores jepen me anën e kallëzores me parafrjalë dhe të rrjedhës: *në mal*, *në fushë*, *malit*, *fushës* (F. Agalliu, E. Angoni, Sh. Demiraj, A. Dhrimo, E. Hysa, E. Lafa, E. Likaj 2002, 107).

Për dallim prej shqipes së sotme, në shqipen e hershme të shekullit XVI, duke nisur që me autorin e parë të saj, Gjon Buzukun, dhe, më pas, me pasrendësit e tij deri në fundshekullin XVII, rasa e ashtuquajtur vendore ka qenë e rregullt në përdorimin gjuhësor të veprave të tyre. Në këtë punim do të trajtohet e ashtuquajtura vendore vetëm në kuadër të veprës së Mesharit (1555) të Gj. Buzukut.

1.1. Rishikimi i literaturës

Të gjithë studiuesit e shqipes, e sidomos ata që janë marrë me studimin gramatikor (morfosintaksor) të teksteve të vjetra, pajtohen se në gjendjen e hershme të dëshmuar me shkrim të kësaj gjuhe paraqitet edhe një rasë tjetër (e ndryshme, së paku formlisht) krahas pesë rasave që i ka pasur kjo gjuhë dhe vijon t'i ketë edhe shqipja e sotme. Flitet këtu për të ashtuquajturën rasë vendore, e cila është emërtuar kështu që në fillimet e studimeve gramatikore për shqipen nga studiues të ndryshëm, duke u bazuar në gjuhën indoevropiane dhe në rasën përkatëse të saj, lokativin. Pastaj, më vonë, shumica e studiuesve jo vetëm që nuk pajtohen, por edhe e kritikojnë emërtimin dhe konceptimin e tillë, mbështetur mbi kriteret kryesore për përcaktimin e një rase të veçantë dhe të ndryshme kundruall të tjerave, përkatësisht përcaktimit të rasës vendore, e cila njëherësh është edhe objekt shqyrtimi i këtij punimi.

Në historinë e gramatologjisë shqiptare, Konstandin Kristoforidhi (Gramatiqi tis alvaniqis glossis, 1882) është i pari konceptues vërtë i pasaktë, por prapëseprapë jo i pameritshëm i egzistencës së një rase vendore (topiqi ptosis) në gjuhën shqipe. (Riza 1965, 133). Këtë cilësim të konceptimit të vendores nga Kristoforidhi Riza (1965) e quan të pasaktë, sepse e kështuquajtura rasë vendore, larg së qeni rasë pikërisht vendore, as që është rasë fare dhe njëkohësisht e quan jo të pameritshëm, në një anë sepse konstatimi prej Kristoforidhit i ekzistencës në gjuhën shqipe të një tipi trajtash – të panjështa me ato të çdo rase tjetër ishte krejt me vend; e në anën tjetër sepse sferën e ekzistencës së këtyre trajtave Kristoforidhi e përcaktoi në një mënyrë përsosurisht të përpiktë; - çka kurrsesi nuk mund të thuhet për mbasardhësit e tij.

Pas Kristoforidhit, rasën e ashtuquajtur *vendore* e jep edhe Sami Frashëri (1886) në gramatikën e tij *Shkronjëtores e gjuhës shqip*, mirëpo nuk e quan *vendore* sikurse pararendësi i tij, por e quan *pritëtores*. Ky emërtim, siç dihet, nuk është trashëguar më pas nga gramatikanët pasardhës, kështu që nuk është futur në traditën gramatikore të shqipes. Për dallim prej këtij termi që nuk është treguar i përshtatshëm për përdorimin gramatikor në gjuhën tonë, gjithashtu e dimë se shumë emërtime të tjera shqipe (*zanore, bashkëtingëllore nyjë ... etj.*), të farëkuara nga Samiu neolog, kanë hyrë në përdorimin e përgjithshëm gjuhësor të shqipes letrare (standarde). Duke e përshkruar *emrin* në *Shkronjëtores* e tij, Samiu sheh, siç thotë vetë, *tri 'gjëra'* (ne do të thoshim *tri kategori gramatikore* – M. V.) në këtë pjesë ligjërata: *gjininë, numrin dhe rrënjën*. Siç vërehet nga kategoria e fundit, ky gjuhëtar nuk e përdor as termin e përgjithshëm *rasë*, porse për të e përdor emërtimin *rrënjë*. Sa i përket kësaj kategorie, vetëm do të themi se me termin *rrënjë*, siç njihet sot në gramatologji, kuptojmë trajtën bazë të një fjale, përkatësisht të një emri që e bart kuptimin themelor leksikor, kur t'i hiqen të gjitha elementet trajtëformuese (mbaresa, prapashtesa shumësi) për fjalët e thjeshta dhe elementet fjalëformuese (parashtesa, prapashtesa, ndërshtesa, nyja) për fjalët jo të thjeshta. Ndërkaq, termi *rasë* nënkupton format e ndryshme të emrit me të cilat shprehen lidhjet e tij me fjalët e tjera në fjali. Sigurisht, këto forma të ndryshme të emrit kushtëzohen nga funksioni gramatikor (sintaksor) i gjymtyrëve që përfaqësojnë brenda fjalisë. Pra, kemi të bëjmë me një koncept që shpreh një relacion midis dy objektsh dhe në këtë kuadër shihet edhe paskatësia dhe paqëndrueshmëria e termit *rrënjë* e Samiut për konceptin *rasë*.

Fillimisht, qysh Pedersenin më 1894 (2003), duke i trajtuar parafjalët e shqipes, tregon se shumica e tyre e kanë veçorinë që fjala e sunduar është pa nyjë. Sipas tij, kjo veçori paraqitet qartësisht te parafjala **ndë: ndë shtëpi**, dhe këtu hyjnë gjithashtu edhe parafjalët **ndë, ndër**,

mbë, për, më, ndënë, ndëpër. Më pas, ai i parashtron edhe dy-tri parafjalë që bëjnë përjashtim nga kjo rregull, si parafjalët me përdorim si ndajfolje lidhore si **nga/ngaha, tekë/tek/, ke/tu/te.** Kjo përdorje fjalësh lidhore në vend pra-fjalësh është vetëm një pasojë e veçantë e prirjes për të shfaqur idenë e shqimit dhe pas parafjalësh, një prirje që ishte në kundërshtim me trajtat e trashëguara. Kjo prirje nuk mund të kënaqej duke vënë kallëzoren e shquar në vend të së pashquarës (***ndë dorënë** në vend të **ndë dorë; përkundrazi ndë të shtatëtën patasi**; vetëm në disa nga dialektet ajo mundi të kënaqej duke shtuar nyjën (**ndë dorët**) në një mënyrë thjesht mekanike, e së këtijmi lindi një rasë e re, e cila quhet me emrin fort të palumtur “vendore” (më drejt “kallëzore parafjalore”). (Pedersen 2003, 22) Pra, pasi e vëren lindjen e kësaj rase të re, Pedersen (2003) e shfaq aq shumë pakënaqësinë e tij karshi termit *vendore* sa që emërtimin e kësaj rase si të tillë e quan me epitelin, *fort të palumtur*, në shkallën *sipërore*. (shkalla *sipërore* e mbiemrit: *theximi ynë*).

Duke e përshkruar gjuhën e Gj. Buzukut në veprën e tij Meshari (1555), E. Çabej (1988), në pjesën e studimit të tij për format te autori i parë i shqipes, thekson se lakimi i shqipes ka pësuar ndryshime të mëdha sidomos në sistem të rasave, me ç’rast, ndër të tjera, e cek humbjen e instrumentalit, të vërejtur së pari nga Pedersen, derisa në anën tjetër shprehet se ka pasur formime të reja me mbaresa të reja, ndër to të ashtuquajturën vendore (lokativ) më -t njëjës, e cila, po sipas Pedersenit, është sajuar nga kallëzorja e gjindorja duke iu ngjitur mekanikisht nyja -t. Edhe Çabej rasës përkatëse i referohet me termin e ashtuquajtura vendore ose lokativ (si term ndërkombëtar i trashëguar prej rasës përkatëse të indoevropianishtes – nënvizimi ynë) duke treguar për pakënaqësinë dhe pasaktësinë e këtij termi për rasën përkatëse. Ndërsa, sa i përket mospajtimit me të drejtë të Rizës me Çabejnë për atribuimin e pasaktë që i bën ky autor tezës së Pedersenit për sajimin e së ashtuquajturës vendore nga kallëzorja e gjindorja (jo nga të dyja, por vetëm nga kallëzorja – theksimi ynë) dhe për kritikën me vend duke u mbështetur në faktet e argumentet përkatëse, mund të shihet më gjerësisht vepra e Rizës *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* (1965).

Edhe W. Cimochofski (2004) në studimin e tij *Gjuha shqipe* tregon se në grammatikat e vjetra gjendet e ashtuquajtura “vendore” që përdoret pas parafjalëve, por në këtë rast thjesht bëhet fjalë për trajtën e pashquar të kallëzores me nyjën -t(ë), por, e cila, sipas tij, nuk përdoret në gjuhën e sotme letrare.

Ndërkaq, S. Riza (1965), duke e trajtuar sistemin rasor të shqipes në aspektin historik, ia njeh shqipes së teksteve të vjetra (që nga Buzuku, Matrënga Budi, Bardhi e deri te Bogdani) pesë

rasa për lakimin e pashquar: *emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren* dhe *rrjedhoren*; dhe shtatë rasa për lakimin e shquar: *emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren, thirroren, të kështuquajturën vendore* dhe *rrjedhoren*. Siç shihet edhe nga klasifikimi i mësipërm, por duke u mbështetur edhe në gjithë trajtimin e Rizës për rasat dhe sistemin rasor të shqipes së hershme përgjithësisht, paraqitet emërtimi prej tij si *e kështuquajtura* vendore. Nga ky epitete i emëruar (e kështuquajtura: theksimi ynë), del se as Riza nuk pajtohet me emërtimin e tillë, madje ai nuk pajtohet as me kallëzoren parafjalore të Pedersenit. Si rezultat i kësaj pakënaqësie me termin «kallëzore parafjalore», Rizës i është dukur i papërvetësueshëm ky term i Pedersenit, prandaj Riza edhe i jep propozimet e tij për rasën në shqyrtim, një herë si *rasë parafjalore* në dy punime të mëparshme mbi *Nyjat* (1958) dhe mbi *Pronorët* (1959), pastaj në punimin *Emrat në shqipe: Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit* (1965) e jep emërtimin si *trajtë sekundare e kallëzores së shquar* ose si *trajtë parafjalore e kallëzores së shquar* në shtojcën e të njëjtit punim. Prandaj, emërtimi përfundimtar i Rizës mbetet ky i fundit, duke qenë se në fillim termi kallëzore parafjalore i Pedersenit, siç shprehet edhe vetë Riza, “na u pat dukur i papërvetësueshëm, të cilin na atëherë edhe u lejuam ta zëvendësojmë me termin vehtjak «rasë parafjalore»”, por që i njëjti autor, siç e thotë edhe vetë, “ndërkohësisht jemi bërë të ndërgjegjshëm se nga katër objeksionet që vetë ngritëm pak më parë kundër tezës së ekzistencës së një rase vendore në historinë e dokumentuar të gjuhës shqipe, dy objeksionet e parë vlejnë barabar edhe kundër ekzistencës së një rase parafjalore në këtë mes” (Riza 1965, 45).

Ndërsa, Bokshi (2005) në trajtimin që i bën fleksionit të sotëm nominal të shqipes dhe rindërtimit të zhvillimit të tij nëpër kohë, në kuadër të sistemit rasor të kësaj gjuhe, i përcakton pesë rasat (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore), të cilat i njeh edhe shqipja e dokumentuar së pari me shkrim me autorët e vjetër (Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi dhe Bogdani) dhe gjithashtu edhe shqipja e ditëve të sotme. Megjithatë, në kuadër të sistemit emëror të shqipes si në aspektin sinkronik ashtu edhe në atë diakronik, Bokshi (2005), duke e përshkruar nënsistemin rasor brenda sistemit emëror, i shqyrton gjerësisht sintagmat nominale SN dhe sintagmat prepozicionale SP dhe specifikisht edhe *nyjën shquese* dhe parafjalët *ën, ndë, në*, të cilat ai i quan lokative. Shikuar nga ky këndvështrim, mund të pohojmë se Bokshi i njeh edhe përdorimet e rasës së ashtuquajtur vendore në kuadër të sintagmave parafjalore me parafjalët përkatëse, edhe pse këto përdorime, ai, sikurse edhe autorë të tjerë, i fut në kuadër të rasës kallëzore, për shkak të reksionit rasor të këtyre parafjalëve që shkojnë me rasën përkatëse. Siç shihet, Bokshi nuk e dallon trajtën përkatëse me ndonjë term tjetër të veçantë, por vetëm e kuadron brenda kallëzores.

Ndërkaq, Sh. Demiarj (1986), duke e trajtuar sistemin rasor të shqipes së dokumentuar, e jep si risi të lakimit të shquar edhe formën rasore të tipit (në) *mal-t*, (në) *shpirt-i-t*, (në) *bark-u-t* etj. Më pas, ai i jep mendimet e disa gramatikanëve (Meyer, Skok, Bariç) se kjo formë me nyjën -*t* është rasë më vete dhe pikërisht rasë vendore (lokativ) dhe, gjithashtu, mendimin e Pedersenit e të Rizës se kjo formë rasore është trajtë dytësore e kallëzores të përdorur me parafjalë. Pasi i jep këto dy lloje të trajtimeve nga gjuhëtarët, Demiraj (1986) mendon se pranimi i kësaj forme si vendore është i diskutueshëm, prandaj për t'u sqaruar bindshëm, sipas tij, kjo çështje duhet parë njëherësh nga të gjitha aspektet, formale, kuptimore dhe funksionale. Pas trajtimit të këtyre kriterëve dhe plotësimit ose mosplotësimit të tyre nga forma përkatëse, Demiraj saktëson se kjo formë rasore duhet të trajtohet si një variant sintaksorisht i kushtëzuar i kallëzores së shquar.

Afërsisht njësoj sikurse Riza e Demiraj, edhe K. Topalli (2009) formën rasore në shqyrtim e trajton si trajtë të kallëzores, mirëpo përcaktimi i tij shkon edhe më tej dhe del i njëjtë sikurse ai i Pedersenit (mbështetur te ai dhe pajtuar me të), i cili këtë formë rasore e përcakton si kallëzore parafjalore. Edhe Topalli, ngjashëm me Rizën e Demirajn, përcaktimin për termin kallëzore parafjalore të dhënë fillimisht nga Pedersenit, e arsyeton duke e provuar formën e dhënë në të gjitha aspektet (formal, kuptimor, funksional) përmes shembujve përkatës nga autorët e vjetër dhe duke i parë si të papërshtatshëm termit e tjerë si *vendore*, *rasë parafjalore* dhe *trajtë sekondare e kallëzores së shquar* (dy emërtimet e fundit sipas Rizës), për të cilat gjithashtu sjell arsyet me shembujt konkretë.

Duke u mbështetur në të gjitha pikëpamjet dhe teoritë e gjuhëtarëve për koceptin/konceptimin dhe termin/emërtimin *vendore* që i shtruan edhe në këtë pjesë punimi dhe, gjithashtu, duke u bazuar në faktet dhe argumentet gjuhësore të të gjitha rasteve të përdorura me këtë formë rasore (vendore) në Mesharin e Buzukut, sipas analizës dhe interpretimit tonë, mendojmë se konceptimin dhe emërtimin më të saktë e ka dhënë S. Riza (1965) si *trajtë sekondare e kallëzores së shquar* ose si *trajtë parafjalore e kallëzores së shquar*. Te ky ose më saktë këto emërtime të Rizës për të ashtuquajturën vendore vërehet se në të dyjat mungon nga një element përbërës, te i pari parafjala (element i detyrueshëm), derisa te i dyti e kemi elementin parafjalor, por mungon elementi *sekondare* për t'u mos u ngatërruar me kallëzoren primare. Prandaj, po ta synojmë emërtimin edhe më të saktë e më të plotë në një të vetëm, emërtimit ose emërtimeve të Rizës do t'ia, përkatësisht, do t'ua shtonim edhe elementin/et e munguar/a. Pra, në qoftë se e përqafojmë emërtimin e parë, do ta kemi termin *trajtë sekondare e kallëzores së shquar parafjalore* ose nëse e zgjedhim emërtimin tjetër, do ta kemi termin *trajtë parafjalore e*

kallëzores sekondare të shquar. Ndërkaq, sa për termin kallëzore parafjalore të Pedersenit dhe Topallit, kujtojmë se edhe ky emërtim në esencë është i drejtë, por nuk e përfaqëson saktësinë e plotë të konceptit dhe të termit e ashtuquajtur vendore, duke qenë se në shqipen e hershme të shek. XVI, përveç kallëzores së vjetër (të trashëguar) joparafjalore me mbaresën e trashëguar rasore *-në* (më vonë të renë *-in/-un*), ekziston edhe e njëjta kallëzore e vjetër (e trashëguar) me të njëjtën mbaresë, e përdorur, gjithashtu, me parafjalë.

1.2. Pyetjet e hulumtimit

- A ka rasë vendore në gjuhën e Mesharirt të Gjon Buzukut?
- A përbën rasë më vete vendorja në përdorimin e saj në sistemin emëror të shqipes së Buzukut?
- Si realizohet forma rasore e vendores në Mesharin e Buzukut?
- Cila është mbaresa rasore e vendores në tekstin e Buzukut dhe a vlen për të dy trajtat e lakimit të shqipes së këtij autori?
- A është i kushtëzuar përdorimi me parafjalë i vendores të Buzuku, nëse po, me cilat parafjalë realizohet rasa përkatëse?
- Përdorimi i vendores realizohet vetëm në numrin njëjës, vetëm në numrin shumës, apo në të dy numrat?
- Cili është funksioni që përmbush vendorja e përdorur në kuadër të sistemit rasor të shqipes së Buzukut?

2. Metodologjia

Ky punim do të realizohet duke përdorur metodën e analizës së të dhënave, metodën sasiore (kuantitative) dhe metodën cilësore (kualitative) për të dhënat e nxjerra nga korpusi i hulumtimit, metodën e interpretimit të gjetjeve gjuhësore, si dhe në disa raste edhe metodën e krahasimit të të dhënave përkatëse.

Gjetjet dhe rezultatet që do të dalin nga ky hulumtim në Mesharin e Buzukut do të mbështeten në analizën dhe interpretimin gjuhësor të të dhënave të mbledhura për rasën e ashtuquajtur *vendore* dhe përdorimin e saj të plotë në librin e parë të shkruar shqip.

2.1. Mbledhja e të dhënave dhe analiza

Të dhënat për rasën e ashtuquajtur vendore i kemi nxjerrë nga teksti i Mesharit të Buzukut, përgatitur nga E. Çabej dhe që bazohet pikërisht në botimin e veprës në dy pjesë me titull: *Meshari i Gjon Buzukut (1555) Botim kritik Pjesa e parë Hyrje dhe transliterim dhe Pjesa e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik* (1968), i cili, njëherësh, është edhe korpusi i hulumtimit për këtë punim.

Edhe analiza e interpretimit të të dhënave bashkë me gjetjet dhe rezultatet e këtij hulumtimi mbështeten drejtpërdrejt në shembujt e nxjerrë nga i gjithë teksti i Mesharit të Buzukut në veprën e lartpërmendur të Çabejtë.

3. Rezultatet dhe diskutimet

3.1. Forma e rasës së ashtuquajtur vendore të emrave në Mesharin e Buzukut

3.1.1. Mbaresa e së ashtuquajturës vendore të emrave të shquar dhe përdorimi i kushtëzuar i një parafjale

Rasa e ashtuquajtur vendore e emrave në kategorinë gramatikore të trajtës së shquar, qoftë për numrin njëjës, qoftë për shumësin, në Mesharin e Buzukut formohet nga mbaresa rasore **-t** dhe nga përdorimi i kushtëzuar (i rregullt) i një *parafjale*, kryesisht me kuptim vendor, por, në disa raste, edhe nga përdorimi i ndonjë parafjale me kuptim jovendor (kuptim shoqërimi, qëllimi etj.). Disa shembuj të përgjithshëm ilustrimi për këtë formë rasore mund t'i sjellim në vijim: ***mbë malt, përmbi shtëpit, ndë dorët, ndër grat, me Atët, për meritat*** etj. Kjo formë rasore në lakimin e shquar ose në trajtën e shquar të emrave për shqipen e dokumentuar është pohuar e dëshmuar nga shumica e studiuesve që janë marrë me sistemin rasor të shqipes, derisa ka dhe disa studiues që ekzistencën e kësaj forme rasore e shtrinë edhe në lakimin e pashquar ose në trajtën e pashquar të të njëjtëve emra.

Ndërsa Kristoforidhi me plot të drejtë konstatoi se trajtat e «vendores» ekzistojnë për të vetmit emra të shquar; përkundrazi egzistencën e këtyre trajtave S. Frashëri, A. Xanoni, A. Xhuvani dhe K. Cipo pa asnjë bazë objektive e shtrinë edhe mbi emrat e pashquar (madje këte egzistencë S. Frashëri e tejshtriu deri mbi përemrat jo-cilësorë) (Riza 1965, 134)

Demiraj (1986) formën rasore të tipit (në) mal-t, (në) shpirt-i-t, (në) bark-u-t etj., me nyjën e prapme /-t/ e quan risi në paradigmën e lakimit të shquar të shqipes së dokumentuar. Sipas tij, kjo formë rasore ndeshet më fort në numrin njëjës, përdoret vetëm pas disa parafjalësh dhe e cila shfaqet në veprat e autorëve të vjetër shqiptarë dhe në shumë të folme të shqipes.

Edhe Topalli (2009) pohon se forma rasore e dhënë gjendet në shqipen e dokumentuar dhe në të folme të ndryshme dialektore, e cila karakterizohet nga një mbaresë e veçantë në trajtë të shquar dhe nga shoqërimi i detyrueshëm me një parafjalë.

Se forma rasore e së ashtuquajturës vendore ka karakter obligativ të përdormit me parafjalë përpara një emri e ka dëshmuar e specifikuar qysh më parë edhe S. Riza (1965), madje duke i dhënë të gjitha parafjalët që ndërtohen me këtë formë rasore dhe duke i cilësuar si parafjalë që ndërtohen vetëm me një rasë, pra me kallëzoren, si për shqipen e dokemunetuar te autorët e vjetër të shqipes, si për shqipen letrare të ditëve tona.

Mosshfaqjen e vendores pa parafjalë te Buzuku e thotë edhe K. Ashta (2000), duke treguar se një rasë e këtillë, si të thuash, vendore, del me mbaresën *-t*, por duke i prirë fjalës gjithmonë një parafjalë. Aty pastaj ky autor sjell disa shembuj nga Buzuku.

3.2. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore me parafjalët që ndërtohen me rasën kallëzore

Të gjitha parafjalët që ndërtohen me kallëzoren në tekstin e Mesharit të Buzukut janë këto në vijim: *mbë/mbë/mb*, *mbi/përmbi*, *me*, *ndë/nde/nd*, *ndënë/ndenë*; *përndënë/përndenë*, *ndër/ndërpër*, *pa*, *për/pr*, *mbas*, *më*, *ndaj*, *sipër(ë)*. Këto katër të fundit janë parafjalë që janë përdorur shumë pak herë me kallëzoren dhe si të tilla janë përdorime me reksion rasor të dyshimtë, pra me përdorim jo të duhur rasor në disa prej tyre. Për to do të diskutohet më poshtë në këtë punim, në vendin përkatës.

3.2.1. Përdorimi parafjalor i së ashtuquajturës vendore të shquar me parafjalët me kuptim vendor

Parafjalët me kuptim vendor të përdorura në Mesharin e Buzukut janë: *mbë/mbë/mb*, *mbi/përmbi*, *ndë/nde/nd*, *ndenë/ndënë/përndënë/përndënë*, *ndër/ndërpër*.

3.2.2. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës të emrave me parafjalën mbë/mbë/mb

E ashtuquajtura vendore e trajtës së shquar njëjës të emrave te Buzuku del e përdorur më së shpeshti me parafjalën *mbë*, ndërsa është gjetur vetëm një rast me variantin fonetik të reduktuar të saj *mb*. Duke u mbështetur në analizën dhe në mbledhjen e të dhënave në gjithë tekstin e Mesharit të Buzukut, kjo rasë përdoret në gjithsej 305 raste. Përdoret vendorja e shquar njëjës me variantin themelor parafjalor *mbë* e shoqëruar në të gjitha rastet me emra vijues që nisin me bashkëtingëllore cilado qoftë ajo, si dhe me disa zanore (a, e, o). Nga

vjelja e të gjitha rasteve në Mesharin e Buzukut për vendoren e shquar njëjës të emrave të shoqëruar me këtë parafjalë po sjellim këtu vetëm disa shembuj me variantin themelor *mbë* dhe rastin e vetëm me variantin e reduktuar *mb*.

Ngrita sytë e mī mbë malt, mbë qish anë muo të më vinjë ndima. (Meshari, 19/a); *Vollëndetja jote kloftë, porsi mbë qiellt ashtu edhe mbë dhët* (Meshari, 53/a);

E ashtuquajtura vendore e shquar njëjës me variantin parafjalor të reduktuar *mb* na paraqitet vetëm një herë në Mesharin e Buzukut me emrin *udhë* që nis me zanore, rast të cilin e shpërfaq shembulli vijues:

Ngreu, ecë prej mjesëditet mb udhët qi del prej qytetjet së Jeruzalemit ndë qytet të Gaxësë ... (Meshari, 247/a);

3.2.2.1. Përdorimi i vendores së shquar shumës të emrave me parafjalën mbë/mbe/mb

Edhe e ashtuquajtura vendore e shquar shumës e emrave në Mesharin e Buzukut na paraqitet e përdorur në disa raste, por krahasuar me vendoren e shquar të njëjësit numri i përdorimeve është dukshëm më i vogël. Duke u nisur nga një përdorim relativisht i lartë i vendores së shquar njëjës, disa gjuhëtarë kanë bërë përcaktime e përfundime të gabuara, duke dhënë vetëm numrin njëjës të së ashtuquajturës vendore të shquar në sistemin rasor të shqipes së Buzukut (dhe të autorëve të tjerë të vjetër) dhe duke u shprehur se e njëjta rasë nuk ekziston për shumësin. Për këtë na njofton Riza (1965, 2002), duke spikatur ndër ta tre nga albanistët më të autoritetshëm, G. Majer, H. Pedersen dhe E. Çabej. Përcaktimin e Çabejtë dhe dy albanistëve të huaj i diskuton dhe i hedh poshtë qysh herët S. Riza (1965, 2002), i cili jo vetëm me shembujt argumentues të tij e provon se e kështuquajtura vendore realizohet edhe për shumësin, por se edhe nga të gjithë shembujt (85) në njëjës të Çabejtë, këtij të fundit, sipas Rizës dhe sipas nesh, i shpëton edhe (vetëm) një rast shumësi (edhe ai i bashkërenditur në fjali me dy shembuj njëjës). Përcaktimin dhe shembujt e Çabejtë i kemi verifikuar edhe ne gjatë hulumtimit për këtë punim, vetëm se këtu do ta shtonim edhe një studiues të autorëve të vjetër, K. Ashtën (2000), i cili, në kaudër të Fjalorit historik të gjuhës shqipe I, krahas vlerës së madhe leksikore duke e dhënë gjithë fjalorin e gjuhës së Buzukut, te të dhënat gjuhësore morfologjike, vendoren te autori i parë i shqipes e jep vetëm për numrin njëjës, duke i sjellë për të 5-6 shembuj.

Nga hulumtimi dhe analiza e Mesharit të Buzukut i kemi gjetur 77 raste të përdorimit të vendores së shquar në numrin shumëshoqëruar me parafjalën *mbë/mbë/mb*, nga të cilat 66 raste me parafjalën *mbë*, 8 raste me variantin *mbë* dhe 3 raste me variantin parafjalor *mb*. Për ta dëshmuar përdorimin e parafjalës themelore *mbë* bashkë me variantet *mbë/mb* nga të gjitha statistikat e dhëna më lart, këtu po sjellim vetëm disa shembuj ilustrues të të tria varianteve, sigurisht me numër më të madh të rasteve nga varianti kryesor *mbë*.

..., aj qi beson **mbë shtrigët**, ... (Meshari, 61/a); *o aj të prunjë kryetë e tī porsi kau mbë zgjedhët*, ... (Meshari, 117/a); ... , *u tue mbajtunë një klisë, mbë të dy anët* më duhë me sherbyem. (Meshari, Pasthënia, 387)

Siç shihet edhe nga shembujt e dhënë më lart, qoftë për numrin njëjës qoftë për shumësin, e ashtuquajtura vendore e shquar me mbaresën *-t* ndërtohet nga Buzuku në shumicën dërrmuese të rasteve me parafjalën *mbë* në variantin e saj të plotë, e cila njëherësh përbën edhe rregull, derisa e njëjta formë rasore paraqitet me variantin e saj fonetik të reduktuar në zanoren e fundit vetëm në pak raste dhe sa herë që fjala pasuese nis me zanoren *u*, me përjashtim të një rasti.

Sa u përket kuptimit dhe funksionit të vendores së shquar të emrave njëjës e shumë të prirë nga parafjala themelore me kuptim vendor *mbë* bashkë me variantin e saj *mb*, mund të themi se emrat e prirë nga parafjala përkatëse shprehin rrethanën e vendit të kryerjes së veprimit të foljes-kallëzues dhe objektin e zhdrejtë me të cilin lidhet ky veprim. Pra, emrat në të ashtuquajturën vendore të shquar njëjës e shumë me mbaresën *-t* karakteristike për këtë rasë dhe të prirë nga parafjala *mbë* e luajnë rolin ose e kryejnë funksionin e rethanorit të vendit sa herë që emrat përkatës sipas kuptimit të tyre leksikor shënojnë vend (dhe, mal, vis, qiell etj.). Përndryshe, sa herë që emrat në të njëjtën formë rasore nuk shënojnë vend për nga kuptimi i tyre leksikor (emën, oratë, ordhën, bir etj.), atëherë, në shumicën e rasteve, emrat përkatës e luajnë rolin e objektit të zhdrejtë mbi të cilin bie veprimi nga folja-kallëzues, pra e kryejnë funksionin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë. Është vërejtur se emrat prejpjesorë të prirë qoftë me parafjalën themelore *mbë* qoftë me variantin e saj *mbë* në të gjitha rastet shënojnë objektin e zhdrejtë me të cilin lidhet veprimi i foljes-kallëzues, pra e luajnë rolin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë. Nga i gjithë korpusi i hulumtimit vetëm në një rast e ashtuquajtura vendore e shquar me parafjalën *mbë* nuk e kryen asnjërin nga këto dy funksione, as të rethanorit të vendit, as të kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë, por e luan rolin e rethanorit të kohës. Është fjala për rastin me emrin *ditë* prirë nga parafjala *mbë* (*mbë ditët të festësë*), i cili, siç mund të shihet në shembullin përkatës të grupi i emrave të parmë ose të thjeshtë, nuk shënon

vend ose objekt të zhdrejtë, por shënon rrethanën e kohës kur kryhet veprimi nga folja-kallëzues. Për funksionin e kësaj forme rasore të shquar njëjës e shumës të emrave prirë nga parafjala me kuptim vendor *mbë* nuk po sjellim shembuj, duke qenë se shembujt konkretë që i kemi dhënë për ta dëshmuar formën rasore përkatëse vlejnë edhe për funksionin. Prandaj, që mos të përsëritemi me shembuj të njëjtë dhe të zëmë hapësirë të panevojshme, jemi mjaftuar vetëm me dhënien e disa emrave përfaqësues në kllapa më sipër, pasi funksioni i tyre mund të shihet më gjerësisht në kuadër të fjalive në shembujt përkatës të dhënë për të gjitha llojet e emrave. Njësoj do të veprohet për të ashtuquajturën vendore njëjës e shumës të emrave të prirë edhe me parafjalët e tjera në këtë punim.

3.2.3. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës të emrave me parafjalën *mbi/përmbi*

Kjo formë rasore e shquar njëjës (edhe shumës) e emrave të Buzuku paraqitet në të gjitha rastet me variantin parafjalor *përmbi* dhe në asnjë rast nuk del me variantin *mbi*, për dallim nga Matrënga e Bardhi të cilët e përdorin edhe këtë të fundit. Vetëm në një rast të pashquar nga forma, por të shquar nga kuptimi, siç e quan edhe Riza (1965; 2002), të Buzuku del varianti *mbi*, i cili do të shihet në vendin përkatës. Këtë pohim e mbështesim në korpusin e nxjerrë për të ashtuquajturën vendore të shquar nga i gjithë teksti i Mesharit. Me parafjalën *përmbi* Buzuku e përdor këtë formë rasore të shquar në 188 raste, nga të cilat 124 në njëjës dhe 64 në shumës. Në këtë pjesë, nga të gjitha rastet e përdorimit e trajtës së shquar njëjës, po i japim vetëm disa shembuj ilustrues të emrave të ndryshëm që janë më me interes për gjuhën e Buzukut.

Zotynë anshtë të përuomitë tat, përmbi dorët të djathë tande. (Meshari, 19/a); , *E paqi kâ me klenë përmbi Israelt.* (Meshari, 21/a); ,... e *përmbi qiellt anshtë të madhtë e tî.* (Meshari, 25/b);... , e *aty Zotynë pat mishërier n mundimit qi lëshou përmbi popullit të tî.* (Meshari, 385/a)

Edhe me parafjalën *përmbi* e ashtuquajtura vendore e shquar njëjës paraqitet e ndërtuar me mbaresën -t të kësaj rase, me përjashtim të një rasti në të cilin mbaresa del -të. Pra, të gjitha rastet në këtë rasë në trajtën e shquar në njëjës me parafjalën *përmbi* të Buzuku dalin me mbaresën -t (në një rast edhe -të: *përmbi të nthehtë*), madje të shumica e tyre kjo mbaresë vjen pandërmjetshëm pas temës së parme të emrit përkatës në çfarëdolloj zanoreje ose bashkëtingëlloreje. Në disa raste është hetuar që mbaresa -t e së ashtuquajturës vendore nuk i ngjitet drejtpërdrejt temës së emrit, pasi ndërmjet temës përkatëse dhe kësaj mbarese hyn

tingulli anaptitik (lehtëshqiptues) *i* e në ndonjë rast edhe ai *u*¹ (variant i kushtëzuar i zanores *i*, *theksimi ynë*) për të lehtëshqiptuar grupet bashkëtingëllore që do të krijoreshin pa anaptiksin përkatës dhe do të ishin të vështira për shqiptim. Të gjitha këto raste janë dëshmuar përmes shembujve të nxjerrë nga korpusi i hulumtimit dhe të cilët i kemi dhënë më sipër. Kushtet e përgjithshme dhe të plota fonetike të ndërhyrjes ose mosndërhyrjes së zanoreve anaptitike te emrat nëpër rase të ndryshme i ka dhënë Riza (1965) në studimin e tij *Emrat në shqipe: Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit* (Punim historik me dy shtojca kritike).

Nga të gjitha përdorimet e së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës me parafjalën *përmbi* më së shumti është përdorur emri *dhe*, në të shumtën e rasteve, në formë të përsëritur.

3.2.3.1. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar shumës të emrave me parafjalën *mbi/përmbi*

Edhe e ashtuquajtura vendore e shquar shumës e emrave sikurse e njëjësit te Buzuku paraqitet vetëm me parafjalën *përmbi*, pra nuk del me variantin e parme *mbi*. Në raportin përpjesëtimor ndërmjet kësaj rase të shquar shumës me atë njëjës vërehen raste më të shumta të njëjësit, por janë gjetur edhe disa raste shumësi. Pra, nga 188 raste gjithsej për trajtën e shquar, 124 janë në njëjës dhe 64 në shumës. Nga këto raste shumësi, këtu po japim vetëm disa shembuj më përfaqësues, duke iu shmangur përsëritjeve.

Bekuom je ti qi ecën përmbi pendët të errëvët e përmbi valët të detit ; (Meshari, 95/a); *E pjesë rā përmbi gurët*, ... (Meshari, 109/b); (Meshari, 247/a); *E u bā një nmnner e madhe përmbi gjithë fqinjët të tī*, ... (Meshari, 329/b);

Edhe nga këto përdorime të shumësit në një rast është vërejtur se emri në këtë rasë prirë nga parafjala *përmbi* merr mbaresën *-të*, siç është rasti te emri prejmbiemëror *të dërejtëtë* si fjalë-formë daktilike, siç e quan Topalli (2009) e që zakonisht në këso lloj temash emërore paraqitet kjo lloj mbarese dhe jo mbaresë *-t* që është karakteristike për këtë rasë.

¹ Anaptiksi *u* përdoret nga Buzuku si tingull lehtëshqiptues ndërmjet temave të emrave që përfundojnë me bashkëtingëlloret grykore (prapagjuhore) *k*, *g* dhe mbaresës *-t* të së ashtuquajturës vendore, sikurse që ndodh edhe në shqipen e sotme, sidomos në shqipen standarde. Zanoren anaptitike *u* e kemi quajtur varinat të kushtëzuar të zanores *i*, për shkak të karakterit fonetik (prapagjuhor) të bashkëtingëlloreve përkatëse që ndodhen përpara saj dhe që, pikërisht për arsye të shqiptimit të *k*-së e *g*-së me pjesën e prapme të gjuhës, zanorja anaptitike *i* shndërrohet në *u*, pasi kjo e fundit është zanore e radhës së prapme dhe u përshtatet bashkëtingëlloreve përkatëse sipas kriterit fonetik horizontal të gjuhës (radha e prapme e gjuhës) për shqiptimin e tingujve. Në të gjitha rastet e tjera përdoret anaptiksi *i*.

Nga përdorimi i plotë i së ashtuquajturës vendore të shquar shumës me parafjalën *përmbi* më së shumti është përdorur emri *kafshë*.

3.2.4. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar të emrave njëjës me parafjalën *ndë*

Nga të gjitha përdorimet e së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës e shumës me parafjalë të ndryshme (me kuptim vendor dhe jovendor), përdorimin më të madh në tekstin e Mesharit të Buzukut e përbën forma përkatëse rasore e shquar njëjës dhe shumës e emrave të prirë me parafjalën *ndë* dhe me dy variantet e tjera të saj *nde* e *nd*. Në gjithë tekstin e Mesharit Buzuku e ka përdorur formën rasore përkatëse të shquar njëjës e shumës në 610 raste, nga të cilat 400 herë atë në njëjës dhe 210 herë atë në shumës. Këtë përdorim të madh të së ashtuquajturës vendore me parafjalën *ndë* e ka bërë të mundur kryesisht kuptimi vendor i saj dhe përfaqësimi më i shpeshtë i rrethanës vendore (rrethanorit të vendit) me këtë lloj parafjale+emër me kuptim vendi. Përdorimin e tillë me këtë parafjalë e arsyeton edhe fakti se parafjala *ndë* në shqipen e Buzukut është parafjala *në* e shqipes së sotme, e shndërruar në këtë formë përmes reduktimit dhe rënies së bashkëtingëllores *d* në mes dhe, siç mund të shihet edhe në gjendjen e sotme të shqipes, kjo parafjalë e ka përdorimin më të madh për ta shënuar në mënyrën më të thjeshtë rrethanorin e vendit, pra me formulën *në + emër me kuptim vendi*. Edhe në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 (2002), duke u trajtuar rasat veç e veç, thuhet se për vendoren nuk ka një formë të veçantë dhe për këtë rasë pikërisht jepet sqarimi në fusnotën përkatëse duke iu referuar dy shembujve në kllapa të prirë nga parafjala *në*. Për ta dëshmuar këtë që po themi e shohim të udhës që ta japim të plotë këtë fusnotë si në vijim: Forma me mbaresën *-t* (*në malt, në gropët*), që përdoret vetëm me parafjalë dhe shëben zakonisht si rrethanor vendi, nuk munda të përgjithësohet në gjuhën letrare dhe mbeti si formë dialektore. Në këtë ka ndikuar edhe fakti se kuptimet e vendores jepen me anën e kallëzores me parafjalë dhe të rrjedhores: *në mal, në fushë, malit, fushës*. (Sh. Demiraj et al., 107) Pra, në këtë fusnotë theksohet se kjo formë rasore shërbën zakonisht si rrethanor vendi dhe ne do të shtonim se shprehja zakonisht është e saktë, por për një saktësi të plotë themi se forma e dhënë rasore edhe te Buzuku edhe në shqipen e mëvonshme deri në ditët tona, përveç si rrethanor vendi shërben edhe si rrethanor kohe me emra që kuptimisht shënojnë kohë (sado që në këtë funksion paraqitet më rrallë te Buzuku – *theksimi ynë*), madje, edhe si kundrinor me parafjalë në rastet e emrave që kuptimisht shënojnë jo vend, por frymorë, objekte etj. (me ç’rast në këtë funksion kjo formë rasore shfaqet shpesh te Buzuku – *theskismi ynë*)

Në këtë pjesë po merremi vetëm me të ashtuquajturën vendore të shquar njëjës, për të cilën po paraqesim një numër shembujsh sa më përfaqësues, nga numri i madh i gjithë përdorimit të saj.

*O Zot, këqyrë **ndë ndimët** teme.* (Meshari, 15/a); *Porsi kle **nde e zanët** nfill,* ... (Meshari, 15/a); *përse të madhtë e tī të qëndronjë **ndë dhët** tanë.* (Meshari, 15/b); (Meshari, 367/a); *Eja e fabriko lterë Tinëzot **ndë fushët** të Areumnësë Jebuzevet.* (Meshari, 385/a);

Duke u mbështetur në të gjitha rastet e së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës të emrave të nxjerra nga Meshari i Buzukut e të pasqyruara përmes shembujve përkatës, shihet se emri në këtë rasë prihet rregullisht nga parafjala themelore *ndë* me kuptim vendor sa herë që shoqërohet me emra që nisin me çfarëdolloj bashkëtingëlloreje dhe në shumë raste edhe me emra që nisin me zanore, duke veçuar disa raste që bëjnë përjashtim.

Edhe mbaresa *-t* e kësaj forme rasore i ngjitet drejtpërdrejt temës së emrit me çfarëdolloj foneme fundore, përveç bashkëtingëlloreve prapagjuhore (grykore) dhe bashkëtingëllores lëngëzore anësore *ll*, ndërmjet së cilave dhe temave përkatëse të emrave mashkullorë hyn tingulli anaptitik *u*, përkatësisht *i*, për shmangie të krijimit të grupeve bashkëtingëllore të vështira për t'u shqiptuar. Grupi i parë i emrave në këtë rasë përbën njëherësh edhe numrin më të madh të përdorimeve, siç mund të shihen në pjesën e shembujve më lart, ndërsa grupi i dytë i emrave në rasën përkatëse është më i vogël dhe përbën përjashtim nga rregulla e përgjithshme. Për këtë grup po i sjellim rastet e gjetura përmes shembujve vijues:

***Ndë Damaskut** qi ish vum përmbi gjint të regjit Aretë,* ... (Meshari, 109/a-b); *Aj qi shtie dorënë **ndë mashtrëkut** tem,* ... (Meshari, 205/a); *e kÿ anshtë mbukuruom **ndë petëkut** të tī e shtrënguom nde e shumë të mujtunit tī.* (Meshari, 215/a);

Nga të gjitha trajtat e shquara njëjës të emrave në këtë rasë, të nxjerra nga Meshari i Buzukut, shumica janë përdorur me parafjalën themelore *ndë*, një pjesë me variantin parafjalor *nde* dhe vetëm 3 raste përdorimi me variantin e reduktuar *nd* të kësaj parafjale vendore. Është përdorur rregullisht varianti themelor *ndë* me emrat që nisin me bashkëtingëllore, derisa varianti *nde*, siç do të shihet më poshtë, është përdorur me emra të nyjshëm asnjnës prejpjesorë të formuar nga emërzimi, te të cilët, nyja, në të shumtën e rasteve, është *të* (*ndë të zanët*) dhe në disa raste është *e* (*nde e zanët*). Duke qenë se me parafjalën *ndë* i kemi shumicën e përdorimeve të vendores së shquar njëjës të cilat i kemi dhënë më lart dhe, gjithashtu, duke qenë se me variantin *nde* janë gjetur vetëm raste të emrave asnjnës prejpjesorë shumë, këtu

po i sjellim tri rastet e vetme së emrave njëjës (me zanoret nistore *u* dhe *a*: përkatësisht emrat *udhë*, *ujë*, *asht* – nënvizimi *ynë*) me variantin *nd* të parafjalës përkatëse.

e të këndonjënë nd udhët të Tinëzot, ... (Meshari, 57/b); *e stripi në qerjet aj e Felipi nd ujët, ...* (Meshari, 247/b); *E pa ndej tash dorënë tande e nÿvra nd ashtët e ndë misht të tÿ, ...* (Meshari, 387/a);

Siç shihet nga të tre shembujt e dhënë më lart, varianti parafjalor *nd* është përdorur në të gjitha rastet me emra (të parmë) që nisin me zanore. Nga këto përdorime fitohet përshtypja se varianti parafjalor *nd* përdoret rregullisht me emra që nisin me zanore, por nuk mund të ngrihet rregull e të përgjithësohet për të gjitha rastet me emra me zanore nistore. Për ta argumentuar këtë po i sjellim në vijim rastet e të njëjtës formë rasore të shquar njëjës të emrave që nisin me zanore e, megjithatë, prihen nga parafjala themelore *ndë*.

Ndë emënit të Tinëzot anshtë ndima jonë, ... (Meshari, 21/a); *Gjithë popullinë e kërshenë ndë Arbanit ata në mortajet largo, tÿ të lusmë, Zot.* (Meshari, 51/b); *aj qi nukë hÿn për deret ndë obort të dhendet, ...* (Meshari, 267/b);

Një përdorim të së ashtuquajturës vendore me mbaresën *-t* prirë nga parafjala vendore *ndë* e kemi gjetur në Mesharin e Buzukut edhe te klasa e përemrave, rasë me të cilën shumica e llojeve të përemrave nuk karakterizohen me mbaresën e tillë të kësaj forme rasore, e sidomos vetorët, siç thekson edhe Riza (1965, 2002). Nga hulumtimi i korpusit për të ashtuquajturën vendore na ka rezultuar një rast i përdorimit mbaresor të saj me përemrin e pacaktuar *tjetër* (forma e të cilit e lejon mbaresën – theksimi *ynë*), të cilin po e japim përmes shembullit përkatës:

... , përse na të jemi dej njani ndë tjetërit. (Meshari, 307/b);

Për arsien pse përgjithësisht përemrat nuk mund të marrin mbaresën *-t* të formës ë diskutuar rasore dhe cilat lloje kryesisht nuk e marrin dhe cili lloj bën përjashtim mund të shihet vepra e Rizës *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* (1965).

3.2.5. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të emrave njëjës me parafjalën *ndënë/përndënë; ndenë/përndenë*

Me parafjalën vendore *ndënë/përndënë* dhe me variantet e tjera të së njëjtës parafjalë e ashtuquajtura vendore e shquar e emrave përdoret në pak raste, në gjithsej 23 sosh. Nga ky numër i përdorimeve, shumica e përdorimeve dalin në njëjës dhe vetëm pak të tjera në shumës.

Kambëtë tonë fort të qëndruome ishnë përndenë portegut tand, ... (Meshari, 19/a);
(Meshari, 71/a); (Meshari, 83/a); (Meshari, 107/a); *Zot, u nukë jam i denjë ti me hīm*
përndenë strehët të shtëpisë sime ; (Meshari, 115/b); *E aj qi pat një (denar), vote e shtiu*
përndenë dhët. (Meshari, 375/a);

3.2.6. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të emrave të shquar njëjës me parafjalën *ndër/ndërpër*

Në këtë pjesë po i paraqesim rastet e së ashtuquajturës vendore të trajtës së shquar të emrave me parafjalën *ndër* dhe *ndërpër* për numrin njëjës, ndonëse kjo parafjalë vendore, për nga kuptimi që ka, përdoret kryesisht për shumësin. Edhe te Buzuku forma rasore përkatëse me parafjalën e dhënë në shumicën e përdorimeve del e realizuar me emra në shumës, sikurse që ndodh edhe në shqipen e sotme, mirëpo po i japim këtu rastet që janë gjetur për njëjësin, madje edhe këtu në dy rastet e para kemi të bëjmë me emra njëjës nga forma, por shumës nga kuptimi, të cilët hyjnë në kuadër të emrave përmbledhës (*shekull* me kuptimin e sotëm bota dhe *dhë* në kuptimin tokë – *theksimi ynë*):

njerëzitë kanë me ʘ thām për ʘmert e për të pritunitë qi kā me ardhunë ndërpër gjithë shekullit ; (Meshari, 85/a); ... , *e vete ndërpër dhët me lypunë të pushuom,* ... (Meshari, 127/b);

Nga shembujt e dhënë shihet se Buzuku e përdor të ashtuquajturën vendore të shquar njëjës me të dy parafjalët, pra me *ndër* dhe *ndërpër*, me përdorim më të madh me parafjalën jo të thjeshtë *ndërpër* jo vetëm nga shembujt e sjellë këtu, por edhe nga përdorimet e kësaj rase me emrat e njëjtë prirë po kështu nga parafjala e njëjtë. Po kështu, në të gjitha rastet kjo formë rasore përdoret me emrat e thjeshtë, siç mund të shihen më sipër.

Për këtë parafjalë me kuptim vendor, Riza (1965) e jep parafjalën e thjeshtë *ndër* të përdorur me shembuj nga Mtarënga, Buzuku, Budi e Bardhi, por megjithatë, në shënimin përkatës në fund, thotë se edhe parafjala e përbërë, siç e quan ai, *ndë-për* shkon me rasën në shqyrtim (pra me të ashtuquajturën vendore – nënvizimi ynë) duke dhënë shembuj nga Bardhi e Bogdani, por jo edhe nga Buzuku. Ndërkaq, siç e pamë më lart, ne e kemi gjetur të njëjtën parafjalë jo të thjeshtë me përdorim të shpeshtë te Buzuku, madje jo në formën *ndërpër* sikurse te autorët e tjerë të vjetër, siç e dëshmon Riza, por në formën *ndërpër*, pra edhe me një *r* ndërmjet, rrjedhimisht kjo formë i bie e ndërtuar sipas formulës *ndër+për*.

3.2.6.1. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të emrave të shquar shumës me parafjalën *ndër/ndërpër*

Rastet e kësaj forme rasore te trajtës së shquar me parafjalën *ndër/ndërpër* po i dallojmë më poshtë:

Ti je e bekuome ndër gjithë grāt. (Meshari, 13/a); ... , *e i Biri i njerit të jetë dhanë ndër duort të t përkatënuomet.* (Meshari, 207/a); ... , *e u me besë të të banj ndër popujt me ngjallë dhenë,* ... (Meshari, 185/a); *Nd atë mot ish ndër farizejt një njeri qi grëshitë Nikodemo, i pari i Xhudhivet.* (Meshari, 325/b); *Nd atë mot u bā një fjalë ndër dishipujtë,* ... (Meshari, 335/b);

Për numrin shumës të së ashtuquajturës vendore të shquar të emrave mbizotërues është përdorimi përpara emrave përkatës i parafjalës *ndër* në raport me parafjalën *ndërpër*. Nga të gjitha rastet e shumës që janë dhënë më sipër, vetëm tri sosh janë përdorur të prira nga parafjala *ndërpër*, ndërsa të tjerat me parafjalën *ndër*.

Nga e gjithë vjelja e rasteve për formën e dhënë rasore të shquar shumës në korpusin e hulumtimit vërehet përdorimi i shpeshtë i emrit *grua* në formën e shumës *grā* bashkë me mbaresën *-t* në trajtën *grāt*, i cili njëherësh edhe mbizotëron krahasuar me emrat e tjerë. Vetëm vlen të ceket se përdorimi i madh i këtij emri në trajtën e shquar të shumës me parafjalën *ndër* ndodh për shkak të përsëritjes së frazës së njëjtë fetare në tekstin e Mesharit të Buzukut *Ti je e bekuome ndër (gjithë) grāt*.

3.2.7. Përdorimi parafjalor i së ashtuquajturës vendore të shquar të emrave me parafjalët me kuptim jovendor

Edhe parafjalët me kuptim jovendor, sikurse ato me kuptim vendor që janë dhënë më lart në këtë punim, janë parafjalë që ndërtohen me rasën kallëzore të emrave, marrë parasysht formën dhe kuptimin e emrave përkatës prirë nga parafjalët përkatëse. Parafjalët me kuptim jovendor të së ashtuquajturës vendore të shquar të emrave që dalin te Buzuku dhe, gjithashtu, edhe në shqipen e sotme, janë: *me, pa, për*.

3.2.8. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës të emrave me parafjalën me

Kjo formë rasore e shquar njëjës e emrave me parafjalën *me* paraqitet me një përdorim relativ në Mesharin e Buzukut. Nga e gjithë vjelja e korpusit të hulumtimit dhe analiza, kemi gjetur 155 raste përdorimi të trajtës së shquar, nga të cilat 90 raste në njëjës dhe 65 në shumës.

Këtu më poshtë po japim disa raste më përfaqësuese me emra të ndryshëm për trajtën e shquar në numrin njëjës me parafjalën *me*:

Lavdi tÿ kloftë, qi je lëm në Virgjënet, me na qitunë jashtë ferënë, e jet përherë me Atët bekuom e me Shpirtinë shenjtë, për jetë të jetësë. Amen. (Meshari, 13/a); ... , kur buri **me gruot** të vet flenë, ... (Meshari, 63/b); *Ti të duosh Tëtzot Zotnë tand me gjithë zemërë tande, e me gjithë shpirtit tand,* ... (Meshari, 69/b);

Nga të gjitha statistikatat e nxjerra prej korpusit të hulumtimit më së shumti është përdorur emri mashkullor i përveçëm *Atë*, madje pothuajse në formë të përsëritur brenda një fraze të njëjtë.

3.2.8.1. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar shumës të emrave me parafjalën *me*

Trajta e shquar shumës me parafjalën *me* është përdorur në Mesharin e Buzukut në 65 raste, në më pak përdorime të së njëjtës formë rasore krahasuar me numrin njëjës me 90 raste përdorimi. Në këtë pjesë po e japim trajtën e shquar shumës të kësaj forme rasore me parafjalën *me* përmes disa përdorimeve me emra të ndryshëm, si të atyre të gjinisë mashkullore e femërore, si të atyre konkretë e abstraktë.

E aj erdh me bām mishërierë me përint tanë, ... (Meshari, 13/a); **Me kapistrët e me frët** shtrëngo fëlqinjëtë e tyne, ... (Meshari, 43/a); ... , e **me veshët** ndiglo të lutunitë tem; (Meshari, 47/b)

3.2.9. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar të emrave njëjës me parafjalën *pa*

Për trajtën e shquar njëjës e shumës prirë nga parafjala me kuptim jovendor *pa* nuk kemi gjetur asnjë rast në Mesharin e Buzukut. Përdorime të kësaj forme rasore njëjës e shumës kemi hasur vetëm për trajtën e pashquar, pra pa mbaresën përkatëse. Lidhur jo vetëm me këtë parafjalë, por me të gjitha parafjalët e dhëna, të shtojmë këtu pohimin e saktë e të drejtë të Rizës (1965), i cili e nënvizonte këtë fakt: “Tani, dihet mirëfilli se të gjitha këto parafjalë, *si në shqipen e sotme letrare ashtu edhe në shqipen e teksteve të vjetër*, ndërtohen pikërisht me rasën kallëzore të lakimit të pashquar”. (Riza 1965, 47)

3.2.10. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës të emrave me parafjalën *për/pr*

Emrat në trajtën e shquar me parafjalën *për* dhe variantin parafjalor të reduktuar *pr* janë përdorur relativisht përmes një numri përdorimesh, gjithsej në 243 raste, nga të cilat më shumë në numrin njëjës dhe më pak në shumësin përkatës. Këtu po i japim rastet e shquara njëjës prirë

nga parafjala *për/pr* për emrat e thjeshtë të gjinisë mashkullore e femërore, duke i ndarë në dy grupe rastet përkatëse. Njëri grup përfshin emrat që e marrin mbaresën *-t* drejtpërdrejt në temën e tyre dhe grupi tjetër përfshin emrat që të njëjtën mbaresë *-t* nuk e marrin drejtpërdrejt në temën e tyre, pra ndërmjet temës së emrit dhe mbaresës përkatëse hyn tingulli anaptitik *-i-*. Për grupin e parë të emrave, të cilëve mbaresa *-t* u prapangjitet drejtpërdrejt temave emërore përkatëse, po i japim rastet përdorimore nëpërmjet shembujve vijues nga korpusi i hulumimit:

*Porsi pat thashunë **për gojët** të shenjtet qi në së zanët nfill janë, ... (Meshari, 13/a) ... , **për ndimët** e për të lutunit ajo në në së këqiashit sonësh të na ngrenë. (Meshari, 21/b); ... , e vote **për shtekt** të tī. (Meshari, 375/a);*

*3.2.10.1. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar shumës të emrave me parafjalën *për/pr**

Edhe për numrin shumës po i japim pak shembuj.

*Për të mī vēllazënë e **për fqinjët** të mī, flasë paqnë për tȳ. E **për shtëpit** të Tinëzot, ... (Meshari, 19/a); ... , ti të dalsh e ti të dahesh në kēsi sherbëtorit sē Tinëzot, **për fuqīt** të Krishtit Zotit tinë. (Meshari, 73/b)*

3.2.11. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar të emrave me parafjalë të tjera me kuptim vendor e jovendor

Përveç përdorimit të detyrueshëm të rasës së ashtuquajtur vendore me parafjalët me kuptim vendor dhe me parafjalët me kuptim jovendor të dhëna më sipër, të cilat qenë përcaktuar në mënyrë të plotë më parë nga Riza (1965) për pesë autorët e vjetër të shqipes dhe pastaj qenë përmendur edhe nga autorë të tjerë, nga hulumtimi i veprës së Mesharit dhe nxjerrja e të dhënave konkrete për këtë rasë, na ka rezultuar se forma rasore përkatëse në trajtën e shquar, edhe pse në shumë pak raste, është përdorur edhe me katër parafjalë të tjera, tri nga të cilat me kuptim vendor dhe një tjetër me kuptim jovendor.

*3.2.11.1. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës e shumës të emrave me parafjalën me kuptim jovendor *mbas**

Me parafjalën me kuptim jovendor *mbas* formën e dhënë rasore të trajtës së shquar e kemi gjetur të përdorur nga Buzuku në Mesharin e tij vetëm në tri (3) raste përdorimi, dy nga të cilat në numrin njëjës dhe një në shumësin përkatës. Rastet e përdorimit të trajtës së shquar njëjës po i sjellim përmes dy shembujve ilustrues të mëposhtëm:

E dërgoi pëllumnë mbas korbt, me pām pam a t ishnë nllēm ujēnatē pērmbi dhēt. (Meshari, 231/b); *Nd at mot, tue rrjedhunë mbas Jezut shumë turmë, ...* (281/b); *E vote Jozefi mbas vëllazēnīt e i gjet m Dotaim.* (Meshari, 145/a)

3.2.11.2. *Përdorimi i së ashtuquajturës vendore me mbaresë-nyjën -t te përemri i pacaktuar tjetër + emër prirë nga parafjala me kuptim vendor më*

Përgjatë hulumtimit të Mesharit për të ashtuquajturën vendore të shquar njëjës dhe shumës e kemi hasur edhe një përdorim më të pazakonshëm, pra jo të parafjalës *më* të shoqëruar me një emër me mbaresën karakteristike -t siç është e zakonshme, por në një formulë tjetër sintagme, në të cilën prin përemri si gjymtyrë emërore i markuar nga mbaresa -t dhe emri që i vjen pas pa këtë mbaresë. Vlen të ceket se parafjala *më* në këtë rast është me kuptim vendor dhe është e barasvlefshme me parafjalën e sotme *në* ose *mbi*, siç mund të përcaktohet nga analiza kuptimore e funksionale e fjalisë së dhënë. Rasti për të cilin po flasim dëshmohet përmes këtij shembulli:

E grishnë shokëtë qi ishnjinë më tjetërët barkëzë, me ndimuom. (Meshari, 281/b)

3.2.11.3. *Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar shumës të emrave me parafjalën me kuptim vendor ndaj*

Edhe me parafjalën me kuptim vendor *ndaj* trajta e shquar shumës është përdorur rrallë nga Buzuku, pra vetëm dy (2) herë në veprën e Mesharit, çka tregon për drejtim rasor jo të duhur. Edhe te këto raste përkatësinë e së ashtuquajturës vendore e jep mbaresa -t, por jo edhe parafjala përkatëse, megjithëqë parafjala ka kuptim vendor, porse në këto raste është shoqëruar me emra që nuk tregojnë vend. Rastet e gjetura në korpusin e hulumtimit po i japim më poshtë përmes shembujve përkatës:

E kish një të motërë qi grëshitë Mëri Madalena, qi por rij ndaj kambët të Jezut, tue ndigluom fjalët e tī. (Meshari, 339/b); *e atë të madhështonjë ndaj fqinjët ;* (Meshari, 357/b)

Te këta shembuj do të pritej të përdorej mbaresë-nyja -vet që e ka zëvendësuar pastaj me kohë mbaresë-nyjën -shit buzukiane e kjo vërehet në disa raste sporadike edhe te Buzuku nën ndikimin e analogjisë, siç e pohojnë edhe Riza (1965), Bokshi (2005), Demiraj (1986), Topalli (2009) e të tjerë. Gjithashtu, për këto raste vlen të ceket se edhe për nga ana kuptimore nuk është përdorur me vend parafjala *ndaj*. Për rastin e parë, fjalisë buzukiane të shembullit të parë do t'i shkonte kuptimisht parafjala *afër* e jo *ndaj*, edhe pse formalisht të dyja parafjalët kanë të njëjtin reksion rasor. Ndërsa, për rastin e dytë, është më e vështirë të përcaktohet

parafjala e duhur, për shkak të paqartësisë kuptimore e funksionale, apo, mbase, edhe të mbetet parafjala e dhënë, porse mbasea të dilte jo -t e vendores, por e rrjedhoes përkatëse, meqë parafjala që i prin është e reksionit përkatës rasor.

Pasi i jep të gjitha parafjalët me të cilat ndërtohet e ashtuquajtura vendore ose më saktë trajta sekondare e kallëzores së shquar parafjalore, në tekstet e vjetra, Riza i jep edhe edhe parafjalët që ndërtohen me kallëzoren primare e jo atë sekondare, siç janë: *përteh*, *jashtë*, *ndaj*, *te*, për të cilat sjell edhe shembuj. Për parafjalët *përteh* dhe *jashtë* sjell nga një shembull nga Buzuku (*përteh Jordanësh*, *jashtë qytetnë* – sa për ilustrim); për *ndaj* nga një shembull nga Budi e Bardhi dhe për parafjalën *te* nga një shembull nga Bardhi e Bogdani, të cilët shembuj mund të shihen në veprën e përmendur të Rizës. Këtu me interes është se Riza e heton dhe e thekson përdorimin dysor të emrave me parafjalën e njëjtë nga të njëjtët autorë të teksteve të vjetra, duke i apostrofuar Buzukun e Bardhin, të parin për përdorimin e parafjalës *përteh* edhe me emrin në formën *Jordanit*, të dytin për përdorimin e parafjalës *ndaj* edhe me të ashtuquajturën vendore ose me trajtën sekondare të kallëzores së shquar parafjalore. Arsyeja pse e cekëm këtë çështje është se, megjithëse Riza (1965) i ka dhënë në mënyrë bukur të plotë rastet e përdorimit të rasave përkatëse shoqëruar me parafjalët përkatëse për të pesë autorët e teksteve të vjetra e sidomos për Buzukun, parafjalën *ndaj* me emrin *klishë* e regjistron për Bardhin, por nuk e shënon për Buzukun, sikur që e kemi gjetur në rastin përkatës në Mesahrin e tij. Për këtë nuk mund t'i vihet faj, sepse vepra e tij, duke qenë studim bukur i plotë e i përgjithshëm për sistemin rasor të teksteve të vjetra të pesë autorëve më të vjetër të shqipes, nuk ka si të jetë shterruese në të gjitha rastet, siç e ka thënë në ndonjë vend edhe vetë autori, pa u bërë vjelje e plotë e rasteve dhe përpunim statistikor i tyre. Mbase, për këtë arsyë edhe i ka ikur rasti i kallëzores sekondare me parafjalën *ndaj* te Buzuku, por e cekëm, ngaqë një rast të tillë e ka hasur te Bardhi.

3.2.11.4. Përdorimi i së ashtuquajturës vendore të shquar njëjës të emrave me parafjalën me kuptim vendor sipërë

Me parafjalën *sipërë* me kuptim vendor e ashtuquajtura vendore e shquar është përdorur vetëm një (1) herë në Mesharin e Buzikut, e cila, sikurse në rastin e parafjalës *mbas*, e shoqëron emrin e njëjtë *Jezu*. Rastin e vetëm të nxjerrë nga korpusi i hulumtimit po e sjellim përmes shembullit përkatës:

Ashtu atëherë vunë duortë sipërë Jezut, e zunë. (Meshari, 207/a)

Përfundime

Lidhur me të ashtuquajturën rasë vendore në Mesharin e Buzukut mund të nxirren disa përfundime:

Për shqipen e Mesharit të Buzukut të shekullit XVI e ashtuquajtura vendore është shenjë identifikuese dhe njëherësh veçori dalluese;

Trajtat e emrave me *-t* janë të ndryshme nga të gjitha rasat ekzistuese, prandaj në shqipen e dëshmuar së pari me shkrim përbëjnë vendore, të njohura me ndonjë term a emërtim tjetër për saktësi më të madhe, por që thelbi dhe forma karakteristike gërshetohen në këtë pikë;

Kjo formë rasore më *-t* i plotëson të gjitha kriteret për t'u konsideruar trajtë rase më vete, pra e plotëson kriterin formal (morfologjik) që është edhe ai kryesor, pastaj kriterin kuptimor dhe atë sintaksor (funksional);

Duke u mbështetur në të gjitha pikëpamjet dhe teoritë e gjuhëtarëve për koceptin/konceptimin dhe termin/emërtimin *vendore*, gjithashtu duke u bazuar në faktet dhe argumentet gjuhësore të të gjitha rasteve të përdorura me këtë formë rasore (vendore) në Mesharin e Buzukut, sipas analizës dhe interpretimit tonë, konceptimin dhe emërtimin më të saktë e ka dhënë S. Riza (1965) si *trajtë sekundare e kallëzores së shquar* ose si *trajtë parafjalore e kallëzores së shquar*. Te ky ose më saktë këto emërtime të Rizës për të ashtuquajturën vendore vërehet se në të dyjat mungon nga një element përbërës, te i pari parafjala (element i detyrueshëm), derisa te i dyti e kemi elementin parafjalor, por mungon elementi *sekondare* për t'u mos ngatërruar me kallëzoren primare. Prandaj, po ta synojmë emërtimin edhe më të saktë e më të plotë në një të vetëm, emërtimit ose emërtimeve të Rizës do t'ia, përkatësisht, do t'ua shtonim edhe elementin/et e munguar/a. Pra, në qoftë se e përqafojmë emërtimin e parë, do ta kemi termin *trajtë sekundare e kallëzores së shquar parafjalore* ose nëse e zgjedhim emërtimin tjetër, do ta kemi termin *trajtë parafjalore e kallëzores sekondare të shquar*. Ndërkaq, sa për termin kallëzore parafjalore të Pedersenit dhe Topallit, kujtojmë se edhe ky emërtim në esencë është i drejtë, por nuk e përfaqëson saktësinë e plotë të konceptit dhe të termit e ashtuquajtur vendore, duke qenë se në shqipen e hershme të shek. XVI, përveç kallëzores së vjetër (të trashëguar) joparafjalore me mbaresën e trashëguar rasore *-në* (më vonë të renë *-in/-un*), ekziston edhe e njëjta kallëzore e vjetër (e trashëguar) me të njëjtën mbaresë, e përdorur, gjithashtu, me parafjalë;

E ashtuquajtura vendore e ka të detyrueshëm përdorimin e një parafjale përpara emrit me mbaresë-nyjën *-t*, qoftë parafjalë me kuptim vendor, qoftë edhe parafjalë me kuptim jovendor.

Parafjalët që ndërtohen me kallëzoren dhe që bashkë me mbaresë-nyjën -t përbëjnë të ashtuquajturat vendore janë tetë (8): *mbë/mbe/mb, mbi/përmbi, me, ndë/nde/nd, ndënë/ndenë; përndënë/përndenë, ndër/ndërpër, pa, për/pr*, të cilat i jep në mënyrë të plotë edhe Riza, mirëpo, përveç këtyre parafjalëve, ne, përgjatë hulumtimit dhe vjeljes së të gjitha rasteve për këtë formë rasore, i kemi gjetur edhe katër (4) parafjalë të tjera që i shoqërojnë emrat në këtë rasë, siç janë parafjalët: *mbas, më, ndaj, sipër(ë)*, të cilat i kemi trajtuar brenda këtij punimi.

Shumica e përdorimeve të emrave me këtë mbaresë-nyjë -t dhe me parafjalë me kuptim vendor e jo vendor përmbushin funksionin e rethanorit të vendit në rastet kur emrat shënojnë kuptimisht vend dhe luajnë rolin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë në rastet kur emrat shënojnë kuptimisht jo vend, por frymorë, objekte etj.

Bibliografia

Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1. Vëllimi I. Morfologjia*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.

Bokshi, B. (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta LXII. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 26. Prishtinë.

Cimochowski, W. (2004). *Për gjuhën shqipe*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta LI. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 23. Prishtinë.

Çabej, E. (1988). *Studime gjuhësore VI* (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij). Rilindja. Prishtinë.

Demiraj, Sh. (1986). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha” – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. “8 Nëntori”. Tiranë.

Dodi, A. (1970). *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*. Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Prishtinë.

Frashëri, S. (1886). *Shkronjëto e gjuhës shqip*. Bukuresht.

Pedersen, H. (2003). *Studime për gjuhën shqipe*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta XLVIII. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 20. Prishtinë.

Riza, S. (1965). *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* (Punim historik me dy shtojca kritike). Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë.

Topalli, K. (2009). *Sistemi rasor i emrave të shqipes*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Plejad. Tiranë.

Korpusi i hulumtimit

Meshari i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej. *Pjesa e parë: Hyrje dhe transliterim.* Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë. 1968.

Meshari i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej. *Pjesa e dytë: Faksimile dhe transkribim fonetik.* Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë. 1968.

KDU: 811.18'36 (05)

Edmond CANE

NJË NDIKIM I PANJOHUR NË MARKIMIN E SHUMËSIT TË EMRAVE NË SHQIP

Abstrakt

Argumenti në këtë artikull cek një tipar të panjohur në shqip, përcaktorët numërorë, dhe në vijim ndjek rrjedhat e këtij ndikimi, më konkretisht në paradigmen e shumësit të emrave. Përcaktorët numërorë kërkojnë vëmendje në dy drejtime: së pari nevojitet një vlerësim tipologjik si dhe një analizë strukturore në lidhje me përcaktorët numërorë dhe sidomos implikimet e tyre, dhe nga ana tjetër, nuk është vlerësuar shkalla dhe dimensionet e turbulencave në sistemin e markimit të shumësit. Të dyja këto fenomene janë tepër të veçanta dhe nuk hasen në gjuhët indoeuropiane.

Fjalët çelës: formantet e shumësit; përcaktorët numërorë; qasjet bazuar në përdorim; tipologji; ambivalence morfologjike

1. Hyrje

Një profil i kategorisë së shumësit në shqip është ndërtuar tashmë, falë hulumtimeve të rëndësishme nga gjuhëtarë vendas dhe të huaj (duke filluar nga Kristoforidhi, Meyer, Pedersen, deri te Hamp, Çabej, Demiraj, Bokshi etj.). Në rrafshin struktural, ka një përshkrim të gjerë të tipareve dhe karakteristikave në shqip, produktivitetit të tyre, ku bie në sy që shqipja ka një gamë të gjerë mjetesh gramatikore për të realizuar kategorinë e shumësit. Në planin historik janë përvijuar hipotezat kryesore të evoluimit të formave të shumësit, ndonëse kjo është një sferë që aktualisht kërkon dhe tërheq vëmendje më të specializuar të studiuesve në gjuhësinë historike, veçanërisht asaj indo-europiane, në funksion të një tabloje më të plotë të brazdave në të cilat janë zhvilluar format gramatikore në fjalë. Në rrafshin tipologjik, karakteristikat e markimit të shumësit në shqip kanë nevojë të trajtohen në plane kompatibël dhe të krahasueshme me gjuhët e tjera europiane.

Një aspekt jo shumë i ndriçuar është shkalla e madhe e larmisë së formantëve të shumësit si dhe detaje të tjera që lidhen me shkallën e dallimit kategorial. Kjo është një specifikë e rëndësishme e strukturës së shqipes. Turbulenca dhe ambivalenca si në kategorinë e numrit, dhe në kategorinë e gjinisë ka nevojë të vlerësohet, dhe për këtë duhet kapërcyer orientimi i

ngushtë strukturor. Këto karakteristika paraqesin dy pyetje të rëndësishme: i) origjina dhe ecuria e tyre përgjatë evolucionit gjuhësor, faktorët që kanë sjellë cilat efekte, dhe ii) domethënia tipologjike, strukturore dhe konjitive e kësaj situate në shqip.

1.1 Metodologjia, të dhënat

Qasjet strukturore shpesh mjaftohen me përshkrimin e ndër-lidhjeve në strukturë dhe nënstrukturat, përcaktimin e lidhjeve hierarkike për të përmbushur tablon e konstituimit. Qasjet gjenerativiste ndërmarrin edhe sfidën, që përveç përshkrimit strukturor dhe analitik, të ofrojnë edhe alternativat e gjenerimit, por kjo e fundit bazohet kryekëput përgjatë linjës strukturore, bazuar në dhe në funksion të logjikës strukturore. Qasjet konstruktiviste dhe konjitiviste nga ana tjetër, ofrojnë një model bazuar në përdorimin (Goldberg 2006, Croft 2001, Langacker 1987, Bybee 2010, etj.) duke argumentuar dhe duke sjellë të dhëna të shumta që strukturat gjuhësore ngrihen prej, dhe zhvillohen në rrjedhat e përdorimit. Janë disa rryma në teoritë gjuhësore, që pavarësisht diferencave, kanë këtë orientim të përbashkët dhe referohen dhe vetë-referohen si qasjet me bazë përdorimin. Një tjetër koncept qendror është konstrukti - një çiftëzim koherent, i qëndrueshëm i formës me përmbajtjen përgjatë gjithë gjuhës. Këto qasje do të shërbejnë jo thjesht për kontur teorik, por do të orientojnë drejt një modeli të argumentuar të kursit të evolucionit dhe statusquosë aktuale të sistemit të markimit të shumësit.

2. Korniza tipologjike ku gjendet shqipja

Numri është një tipar me projektion morfologjik mbi emrin – referuar përmbajtjes, emri formatohet në njëjës dhe shumës. Ka edhe një projektion morfo-sintaksor mbi foljen, vetëm në lidhje me argumentin kryefjalë (domethënë, dallimi i kryefjalës emërore në njëjës apo shumës projektohet respektivisht te folja njëjës/shumës). Projektioni morfologjik në paradigmën emërore është i larmishëm, shenjë kjo e një zhvillimi real, intensiv, të gjatë. Projektioni i numrit mbi paradigmën foljore, në të kundërt, është më i thjeshtë dhe uniform, që e lidh me një ndikim apo burim më të reduktuar, ose që ndoshta u ka rezistuar ndikimeve të tjera përgjatë kontakteve historike të shqipes. Një veçori tipologjike e shqipes mund të hipotizohet se në paradigmën foljore ka pasur një hapësirë konjitive zhvillimi dhe ndikimi më të ndjeshme përgjatë vetës dhe kohës foljore dhe më të reduktuar në markimin e dallimit të numrit (njëjës/shumës). Ndoshta kjo ka një sinjifikancë jo të konsiderueshme duke pasur parasysh që vërehet edhe në gjuhët e

tjera indo-europiane. Por, pjesa tjetër që del në pah është larmia dhe mungesa e një formati uniform në projeksionin e markimit të shumësit në paradigmen emërore, e cila dallon dukshëm nga gjuhët e tjera europiane, përfshi edhe gjuhët më të afërta në arealin ku është shqipja. Ka një numër të madh devijimesh, që në kombinimin e tyre sasi-orCILësor, vështirë të gjenden në ndonjë gjuhë tjetër europiane ose edhe në një orbitë më të gjerë tipologjike rreth shqipes.

Pavarësisht devijimeve të shumta dhe të rëndësishme, shqipja megjithatë arrin të ruajë një tipar thelbësor – markimi i shumësit mbetet një tipar morfologjik i detyrueshëm, në asnjë rast i neglizhuar apo i neglizhueshëm. Pra nga njëra anë ka turbulencë të rëndësishme, nga ana tjetër, këto turbulencë balancohen nga një kontekst që ka në thelb këto tipare

- i) markimi i detyrueshëm i shumësit;
- ii) formati unik i këtij markimi nëpërmjet mbaresave në fund të temës;
- i) markimi i shumësit i pararend markimit rasor. Duke pasur parasysh kohën e hershme të formatimit të tiparit rasor, mund të kemi një orientim kohor (më të hershëm) për markimin e shumësit.

Megjithatë, ndryshe nga qasja me bazë strukturore, qasja konjitive nuk i merr paradigmat e numrit, rasave apo gjinisë në sens absolut. Nga një qasje konjitive, nuk do të përjashtohet edhe një ndikim më i vonë në paradigmen e numrit, më saktë në markimin e shumësit, që do të ruante megjithatë pozicionin e fiksuar më herët (përpara markimit rasor), për shkak se një slot i tillë ishte tashmë fiksuar, dhe, folësit kanë qenë të orientuar të bënin projektimin e një formanti tjetër të shumësit pikërisht në këtë pozicion (pas temës, para formantit rasor), pasi formanti i shumësit ka si informacion përmbajtësor, si pjesë të konstruktit të vetë edhe pozicionin relativ. Në kontekstin e gjuhëve indo-europiane, konstruktet morfologjike emërore, foljore, etj., përfshi edhe markimet e shumësit, kanë qenë të mirë-rrënjosura dhe përgjithësisht rezistente. Kjo shpjegon faktin që në një konstrukt të tillë të konsoliduar si markimi i shumësit, edhe pjesa e informacionit për slot-in, pozicionin relativ të formantit kundrejt temës dhe formantit të rasës, ka qenë e rrënjosur. Për shqipen, markimi i shumësit ka qenë në ndërlidhje me temën dhe me rasën si shtresë e mëpasshme, por jo me gjininë, e cila ka një situatë komplekse.

Paradigma e markimit të shumësit është më e hershme se ajo e strukturës së argumentit (rasave). Format e rasave në shumës shumë të qarta dhe të pavarura nga format respektive në njëjës – që thekson prevalencën dhe hershmërinë e markimit të shumësit

3. Fenomeni i përcaktorëve numërorë – edhe në shqip

Përcaktorët numërorë janë studiuar si fenomene gramatikore për një kohë të gjatë, por, pas studimit të njohur të Greenberg (1972) nga një qasje dhe relevance tipologjike, kanë marrë një vëmendje në rritje. Përcaktorët numërorë (PN) janë elemente që ndërhyjnë mes numërorëve dhe emrave që numërohen, pasi kjo skemë ndjehet nga folësit si një ndërmjetës i nevojshëm.

numëror	PN	emri i numëruar
3	<i>kokrra</i>	<i>mollë</i>
10	<i>rrënjë</i>	<i>ulli/ullinnj</i>
6	<i>barrë</i>	<i>dru</i>
2	<i>kotruve</i>	<i>ujë</i>
200	<i>kokë</i>	<i>bagëti</i>

Janë një sërë studimesh që kanë hulumtuar gjuhët ku është i përhapur ky tipar gramatikor, karakteristikat kryesore, shkallët e shtrirjes apo intensitetit dhe specifikat sipas gjuhëve apo grup-gjuhëve të caktuara¹.

Në kërkimet e para, u konfirmua që përcaktorët numërorë hasen kryesisht në gjuhët aziatike, në gjuhët e Paqësorit, në pak gjuhë të Afrikës si dhe në disa gjuhë të Amerikës Latine. Ndërsa, në gjuhët indo-europiane, u konfirmua (Lehman 2000, Cinque 2006, Cinque & Crapova 2007, Gil 2013, Tang & Her 2019) që nuk haset ky tipar. Nuk duhet ngatërruar koncepti i përcaktorëve numërorë me përcaktorët sasiore të tipit: një palë, 2 kg djathë, 3 metra litar, shumë/pak libra etj.

Megjithatë, një hulumtim më i kujdesshëm në shqip (Cane E., Yue, H. 2020) nxjerr në pah që shqipja ka një sistem të mirëzhvilluar të PN. Përcaktorët numërorë, ndryshe nga përcaktorët sasiore, nuk shërbejnë vetëm për të krijuar një masë apo një etalon numërimi, por me këtë gjasë, bëjnë (ndoshta instinktivisht) edhe një klasifikim të emrave objekt numërimi. PN shfaqen me si më poshtë:

- Sipas kategorizimit: emra njerëzish, frymorësh, jo frymorësh: janë 5 frymë në shtëpi, 10 kokë bagëti, 3 kokrra vezë.
- Bëjnë klasifikim sipas formës: 3 kokrra mollë, 5 rreshta pemësh, 7 pashë nën dhe.

¹ Greenberg 1975, 1977; 1990; Adam & Conklin 1973, Craig 1986, Dixon 1986, Croft 1994, Nichols 1992, Bisang 1996, Aikhenvald 2000, Gil 2008; 2013; Seifart 2010; Grinevald 2000, 2015, Sanchez & Slobin (2013); Her, One-Son; Yi Byeong-Uk 2011

- Bënë klasifikim sipas formës së përdorimit: 2 barrë dru, një kupë tamël, një bardhak ujë, një dorë miell, 2 kova ujë, 3 duaj gruri, 2 qese misër.
- Shpesh përdoren me numëror të ulët (1 ose 2) që në fakt shërben më tepër për të paraqitur një masë referimi apo etaloni: ka një barrë mend, që ka dy fije mend, kokërr gomari, një çikë shpirt, një bythë vend.
- Që përdoret si masë edhe për të bërë të matshme lëndë pothuajse të pamatshme ose edhe koncepte abstrakte: një shkullm ere, një fije respekt, 2 lek punë, një vorbull ere, një vorbull shqetësimi.
- etj.

Sa më sipër janë karakteristika tipike në gjuhët që kanë PN dhe nuk hasen në gjuhët indoeuropiane. Në gjuhët që janë tipologjikisht të prirura për PN, shkalla e detyrimit varion. Vetëm në pak gjuhë PN mund të jenë të detyrueshme për të ndërmjetësuar mes numërorit dhe emrit të numëruar, por në shumicën e tyre ka një fleksibilitet; është një zakon, një shprehje që gjendet rëndom, por nuk përjashtohet edhe përdorimi i numërorit direkt tek emri. Shqipja duket se bën pjesë te grupi i dytë.

3.1 Sistemi i markimit të shumësit përkundër tiparit të përcaktorëve numërorë

Markimi i shumësit në mënyrë të detyrueshme, i zhvilluar si një paradigmë e plotë, bile edhe e ndërthurur me tipare gramatikore kompatibël (gjini, rasë), është një karakteristikë tipologjike e gjuhëve indo-europiane. Studimet mbi PN (Tang & Her 2019:302) provojnë se këto dy tipare nuk janë kompatibël. Ka një dallim të qartë mes gjuhëve që kanë vetëm njërin tipar dhe vetëm tiparin tjetër. Përjashtimet që janë në mes janë tepër të pakta na njëra anë, por edhe tepër të dobëta, çka shkon në fakt për të konfirmuar fuqishëm këtë fenomen gramatikor.

Kjo ide u formulua si teza GSSG (*Greenberg-Sanches-Slobin Generalization*) që u referohet 3 autorëve të saj: Greenberg, Sanches, Slobin (shih Greenberg 1990: 177) që: *gjuhët që kanë tiparin e PN shihet që nuk kanë markimin morfologjik të shumësit, dhe anasjelltas, atje ku haset markimi morfologjik i shumësit, mungon PN.*

Bazuar në analizën e 400 gjuhëve, autorët konstatuan se përjashtim nga teza bëjnë gjuhët e mëposhtme (Tang & Her 2019:319)

Table 4: Languages with both classifiers and plural markers in the 400 languages.

Continent	Language	Genus
Asia	Armenian	Armenian
	Turkish	Turkic
	Persian	Iranian
Europe	Hungarian	Ugric

Gjuhët indoeuropiane si armenishtja dhe disa variante të persishtes kanë gjurmë të dobëta të PN për shkak se gjenden në arealin ku ky tipar është i pranishëm. Ndërsa turqishtja, nuk është gjuhë indo-europiane; ka elementë të dobët të PN dhe po kështu, markimi i shumësit me mjete morfologjike nuk është në atë tip dhe nivel si te gjuhët indoeuropiane. Të gjitha të dhënat paraqesin në forma të shumëfishta që gjuhët indoeuropiane nuk e kanë këtë tipar ndërkohë që kanë një sistem shumë të zhvilluar të markimit të shumësit.

Në kuadrin konjitiv kjo shpjegohet me faktin që në gjuhët e orientuara nga PN, ligjërimi i përditshëm krijoi masën e madhe të instancave të frazave me bazë treshe: [Numëror-Përcaktor Numëror – Emër], e cila u shtresëzua në memorien e folësve në mënyrë të shumëfishtë. Këtë frazë që fikson në kujtesë përcaktorët numërore por edhe kontekstin morfosintaksor të tyre, duhet ta konsiderojmë në statusin e konstruktit (Goldberg 2006: 5). Një konstrukt shërben si bërthamë që thith drejt vetes dhe i ruan ato, trajtat kryesore që ndodhin me një frekuencë të përsëritur mjaftueshëm. i tillë është edhe tipari morfonologjik i mungesës së markimit shumë tek emri i numëruar që është hallkë në këtë konstrukt. Në këtë mënyrë, prania e një konstrukt i tillë “rekomandon”, imponon, përhap formatin e emrit në përmbajtje kuptimore shumë por në format morfonologjik njëjës:

2 kokrra mollë

3 rrënjë ulli

100 kokë dhi

3 barrë dru

pavarësisht se ky format nuk është formësuar si absolut në shqip, për shkak të ndikimeve të ndërsjella.

4. Turbulenca në kategorinë e markimit të shumësit

4.1 *Shumësi i singularizuar*

Ka qenë ndër aspektet intriguese të shqipes dhe ka ngjallur qysh herët interesin e studiuesve, përfshi edhe albanologëve të huaj. Një studim disi më i plotë, që faktikisht ka reflektuar edhe gjetjet dhe punimet më të hershme, është monografia e Çabejit (2008). Ajo që të bien në sy për shqipen është gjerësia e fenomenit. Rastet janë të shumta si në diversitet, gamën e grupeve të emrave, por edhe në numrin e konsiderueshëm në këto sfera. Çabej përfshin rastet ku ambivalenca është e dukshme, rastet ku format fillestare të njëjësit kanë gjurmë por nuk janë më në përdorimin aktual, si dhe raste të hulumtuar në bazë të analizës dhe të dhënave gjuhësore historike dhe krahasuese. Fenomeni ndodh në emra që referojnë vende, bimësi, kafshë, pjesë trupi të njeriut, produkte e ushqime, orendi shtëpiake, sende dhe mjete pune, armë, sëmundje, etj. E çuditshme është që prek edhe sferën e emrave huazuar nga turqishtja në mënyrë të parregullt, d.m.th., në disa emra forma e njëjësit është konform formës në gjuhën e burimit, dhe në raste pothuajse pa ndonjë shtysë për diferencim, këta emra të huazuar kanë marrë një formante shtesë “-e”, qartësisht formante tipike e shumësit, dhe kjo formë është “ngjirë” si formë njëjësi, ndërkohë që ruan të njëjtën formë edhe për shumësin

Krahaso (Çabej 2008)

Kazan-kazane; borxh-borxhe

Sepete-sepete, tumane-tumane; beze-beze

Në vijim të rasteve atipike është edhe formanti i shumësit në turqisht *-llar*, që, në kontekstin e emrave të përveçëm, singularizohet pa asnjë problem nga folësit shqiptarë

Mujollari, Bejollari, Muçollari

Rastet me një dukje të qartë shumësi (në fakt, singularizuar): *qerre (karro), koqe (kokërr)* nuk do ishte vështirë të unifikoreshin në çfarëdo situatë normale nga komuniteti shqipfolës, por kjo dëshmon mungesën e perceptimit strukturor të folësve në lidhje me dallimin kategorial njëjës/shumës.

Një numër rastesh e kanë të vështirë vëzhgimin kategorial, pasi forma fillestare e njëjësit ka humbur (Çabej 2008)

Dalm-delme; gath-gjethe, kac-kec

Ambivalenca arrin përmasa edhe më atipike kur ka ndryshim pozicionesh të njëjësit me shumësin (Çabej 2008)

Thes-thasë; rreth-rrathë; vit-vjet (këtë vit – shumë vjet gëzuar)

Shqipja ka edhe raste të mbishtresave të shumësit, formantë shumësi të dubluar

zot-zotër por edhe zotërinj

mbret-mbretër; at-etër; princ-princër; frat-fretër; dreq-dreqër....

por

prift-priftërinj; gisht-gishtërinj

Fenomene të tilla gramatikore kalojnë nëpërmjet rianalizës, shkaktuar ose nga një konfuzion për shkak të prurjeve të reja dhe zhvillimeve në linja të ndryshme paralele që arrijnë një stad kundërvënie, ose, (në rastin e shumësit të shqipes), nga një konfuzion gramatikor dhe konjitiv, që nuk do ishte i pranueshëm dhe i shpjegueshëm në asnjë kontekst normal. Sigurisht, sot nuk ka më koncepte naive në gjuhësi se konfuzioni lidhet me komunitet gjuhëfolës. Gjuhëtarët në këto raste hulumtojnë praninë apo mungesën e faktorëve të caktuar dhe studiojnë ndërveprimin e tipareve të pranishme në ligjërimin gjuhësor, dhe paralelisht, në zhvillimin e strukturave gjuhësore bazuar në atë çka ndodh në ligjërim.

4.2 *Ambivalenca gjinore – në sferën e shumësit*

Fenomeni i ambivalencës gjinore është konstatuar në shqip, por nuk ka pasur shumë studime për shkallën e shtrirjes, hulumtim quantitativ strukturor. Një numër i konsiderueshëm i emrave mashkullorë “konvertohen” ose “sillen” në trajta femërore në shumës. Nivelet e këtij konvertimi variojnë nga një turbulencë e lehtë deri në konvertim absolut, domethënë, që për këtë kategori emrash mashkullorë, vetëm asocimet (përcaktorë mbiemërorë e përemërorë) në femërore janë të pranueshëm, ndërsa asocimet mashkullore kalojnë në nivele papranueshmërie absolute – që është faktikisht në kufijtë e gramatikalitetit (Cane, E. Yue, H. 2021). Të dhënat në studimin në fjalë u morën në mënyrë të dyfishtë: edhe nga korpuset e shqipes, dhe më pas, në një anketim me afro 90 folës së gjuhës. Të dhënat nga korpusi dhanë panoramën më poshtë.

Tabela 1: Frekuenca e emrave në shumës – Korpusi Kombëtar i Shqipes

Formantët e shumës	Fem frymorë	Fem jofrymorë	Mashk frymorë	Mashk jofrymorë	total	përqindja
-e	2665	161773	238	132089	296765	64.8%
-ë/-a/-ra	5713	0	87115	46121	138949	30.3%
-j/-nj	0	211	4786	5534	10531	2.3%
-qe/-gje	223	6960	3	4720	11906	2.6%

Të dhënat më sipër janë vetëm për rastet e përdorimit të emrave në shumës (*tokens*). Bie në sy që grupi më i madh janë emrat që në shumës marrin formantin -e. Tabela jep të dhënat për çdo grup, sipas formanteve të shumës, për *tokens* frymorë dhe jofrymorë si në gjininë femërore dhe mashkullore. Tabela nuk përfshin të dhënat për emrat me formant zero. Korpusi nuk e mundësonte në mënyrë të saktë. Në një përlllogaritje të përafërt, ky grup ishte rreth 20 për qind dhe ishin kryesisht emra të gjinisë femërore. Fokusi i studimit ishte tendenca e emrave mashkullore për konvertim në gjininë femërore në shumës, dhe kjo u studiua përgjatë linjave (tipareve) semantike dhe fonologjike, për të hulumtuar faktorët që inkurajojnë apo dekurajojnë këtë konvertim si dhe shkallën e këtij konvertimi. Tabela më poshtë jep të dhënat.

Tabela 1: Frekuenca e emrave në shumës dhe shkalla e konvertimit – Korpusi Kombëtar i Shqipes

Formantët e shumës	Përqindja në totalin e emrave	Mashk. %	Mashk. % jofrymorë	Shkalla e ruajtjes së gjinisë mashk.	Rezultante mashk. brenda nëngrupit	Rezultante mashk. brenda emrave total
-e	64.8%	44.6%	44.9%	2.4%	1.1%	0.7%
-ë/-a/-ra	30.3%	95.9%	100.0%	61.4%	61.4%	18.6%
-j/-nj	2.3%	98.0%	96.3%	93.1%	89.7%	2.1%
-qe/-gje	2.6%	39.7%	40.4%	10.5%	4.2%	0.1%
Rezultante në mashk.		61.2%	62.7%			21.5%

Grupi më i madh i emrave, që në këtë nënkorporus përmban 64.8 për qind, ka afërsisht gjysmën (44.6 për qind) emra mashkullore, të cilët e ruajnë “mashkulloritetin” në shumës në

masën 2.4 për qind. Prandaj, brenda këtij grupi vetëm 1.1 për qind e këtij grupi rezultojnë mashkullorë në shumës, dhe në total ky grup kontribuon vetëm 0.7 “mashkulloritet” në totalin e emrave. Grupet e tjera kanë shkallë ruajtje të gjinisë mashkullore më të madhe – për shembull, grupi me formant shumësi -j/-nj e ruan në masën 93.1 për qind, por, duke qenë grup me peshë të vogël, në total, ky grup sjell vetëm 2.1 për qind “mashkulloritet”. Në përfundim shihet se në shumës, vetëm 21.5 për qind e emrave rezultojnë mashkullorë, ndërkohë që në njëjës, ka një raport të balancuar. Konfirmohet nga të gjitha anët që ka një shkallë të madhe konvertimi, dhe kjo përthyerje strukturore është e paimagjinueshme në ndonjë gjuhë tjetër indoeuropiane.

Përthyerja nuk duket se ka ndodhur te pjesa thelbësore kategoriale e gjinisë. Emrat frymorë nuk paraqesin asnjë përthyerje. Pra turbulenca nuk është tek pjesa përmbajtësore e gjinisë. Gjithashtu, nëse do të ishte e lidhur me gjininë, kjo do të reflektonte përgjatë gjithë kategorisë – por shihet vetëm kur këta emra kalojnë në sferën e shumës. Të dhënat e studimit në fjalë konkludojnë që konvertimi në gjininë femërore nuk lidhet me tiparet semantike përmbajtësore të emrave mashkullore, edhe për rastet e emrave jofrymorë, ku kategorizimi gjinor nuk lidhet me seksin. Megjithatë, tiparet semantike të emrave jofrymorë mbeten jorelevantë në këtë konvertim. Faktori që bën diferencimin dhe tregon koherencë në këtë shkallë konvertimi në gjininë mashkullore është formanti i shumës – pra pjesa morfonologjike e konstruktit, pjesa e formës në çiftëzimin e konstruktit (formë/përmbajtje).

Nga të dhënat duket qartë edhe tendenca e zhvillimit kategorial për këtë grup të madh emrash

- formantët më të hershëm, janë më të ngarkuar morfonologjikisht, por ndërkohë kanë mbetur më të paktë në numër. Emrat me këta formantë janë më rezilientë kundrejt konvertimit gjinor
- emrat që në shumës markohen me formantin -e, kanë më pak histori, sidomos me emrat mashkullorë. Megjithatë, kjo bëhet tendenca e emrave të rinj që kategorizohen në gjini: emra jo-frymorë dhe sidomos një numër i madh emrash abstraktë.
- Edhe këto të dhëna tregojnë qartë dominimin e emrave me një formant shumësi më të dobët, që është faktori kryesor që lidhet me fenomenin e konvertimit gjinor.

Duke marrë në konsideratë që vetëm në shqip ndodh një turbulencë e tillë me ambivalencën gjinore, ky faktor vetvetiu veçohet dhe vihet në lidhje me specifikën tjetër të pranisë së përcaktorëve numërorë. Këto fakte empirike, krejt specifike për shqipen në arealin e gjerë indoeuropian i lidhin së bashku këto fenomene, minimalisht si faktorë që ndikojnë reciprokisht

njëri tjetrin, dhe maksimalisht që shkaktojnë mungesën e njëri tjetrit. Vërtetimi i kësaj lidhje është bërë në mënyrë të pavarur nga autorët që kanë provuar dhe argumentuar tezën GSSG, që në shqip konstatohet në një mënyrë origjinale.

4.3 Shpjegimi i fenomenit GSSG në shqip

Ajo që vërehet në shqip, është prania e një trysnie që ka shkaktuar turbulencë dhe konfuzion në markimin e shumësit. Konfuzion që vjen thjesht nga zgjerimi i një skeme në kurriz të një skeme tjetër, duke e lënë të pazhvilluar – konkretisht, lëvrimi, përdorimi i përcaktorëve numërore, ka pasur efektin e pritshëm, të zbehjes, të nulizimit të dallimit kategorial njëjës/shumës. Në këtë mjegullim si në perceptimin strukturor edhe në atë konjitiv, ato forma të shumësit që ishin krijuar dhe konsoliduar në shqip, vijuan të përdoren, dhe paralelisht me to edhe format respektive të njëjësit, ndërkohë që ishte dëmtuar lidhja simbolike me nevojën konjitive për të dalluar konceptualisht njëjës/shumës, pikërisht siç konfirmojnë autorët e shumtë. Tek frazat me përcaktorë numërorë, ngarkesa konceptuale bartet nga numri dhe përcaktorët numërorë, dhe pjesa emërore mbetet e panevojë për të marrë projeksionin e dallimit kategorial njëjës-shumës. Format egzistuese njëjës dhe shumës, të përdorura në mënyrë jo të diskriminuar për pjesën përmbajtësore njëjës/shumës, krijuan lidhje të çrregullta – siç shihet tashmë që format shumës janë përdorur dhe kanë ngrirë më tej në një lidhje simbolike me konceptin e njëjësit, bile në disa raste, duke konkurruar dhe zhdukur formën respektive të njëjësi (singularizimi i shumësit)t. Kjo zbehje vëmendje ka qenë kaq e madhe, dhe për një kohë kaq të konsiderueshme, sa që ka sjellë zbehjen e formave dalluese të markimit shumës. Domethënë, ulja e vëmendjes konjitive të pjesa e përmbajtjes në konstrukt, solli gradualisht edhe uljen e vëmendjes dhe të ngarkesës edhe të pjesa e formës.

5. Përmbledhje e vëzhgimeve nga ky parashtrim dhe nga kqyrja e të dhënave

5.1 Datimi.

Tipari morfologjik i përcaktorëve numërorë (*Numeral Classifiers*) duket se është tepër i hershëm. Sipas autorëve kryesorë, rrjedha e PN mendohet të jetë rreth 1500 vjet më parë, por rasti i pranisë së tyre në gjuhën shqipe e konteston këtë hipotezë. Nuk ka asnjë kontakt të

qenësishëm mes shqipes dhe gjuhëve që kanë këtë tipar gramatikor. Nga gjuhët që janë më të afërta:

Turqishtja, e cila vetë është jo ndër gjuhët aktive të këtij grupi, dhe ndodhet në ndërmes, duke pasur një prani të zbehtë të PN dhe një organizim jo të konsoliduar të markimit të shumësit. Nga ana tjetër, turqishtja nuk ka mundur të transferojë ndikim te shqipja as me sistemet e saj të konsoliduara. Prandaj kjo alternativë përjashtohet.

Armenishtja, disa gjuhë të nënndarjes së gjuhëve iraniane. Sipas të dhënave, tipari i PN në këto gjuhë është i zbehtë, kryesisht nëpërmjet kontaktit me gjuhët aziatike me të cilat ato kanë qenë në kontakt në arealin e tyre. Për shqipen përjashtohet edhe ky rast.

Në asnjë hapësirë tjetër në harkun e evolucionit të shqipes në 1500 vitet e fundit, nuk gjendet një ndikim që të ketë qenë bartës i ndikimit të fuqishëm të PN, çka na drejton te fakti që PN në shqip janë formësuar para harkut të 1500 viteve. Duke pasur parasysh se duke filluar nga shekulli II p.e.s., shqipja hyn nën ndikimin e gjatë dhe më të fuqishëm të argumentuar deri tani, nën gjuhën latine, e shtyn origjinën e ndikimit të PN para periudhës latine. As gjuha latine dhe asnjë prej gjuhëve që kanë vijuar pas saj, nuk kanë ndonjë shenjë të PN.

Presioni në të cilin ka qenë sistemi i PN për t'u shuar gjatë kursit të gjatë historik:

- Latinishtja njihet për reputacionin e saj si vrasëse gjuhësh. Përveç leksikonit, ka pasur një numër sferash gramatikore të ndikuara fuqishëm nga presioni latin. Megjithatë, nuk ndodhi shuarje e tiparit të PN. Kjo nënkupton që, para kontaktit me latinishten, shqipja ka pasur një sistem tepër të konsoliduar të PN.
- Tipari morfo-sintaksor i PN i rivalizua njëkohësisht si i) nga sistemi përcaktorëve sasiore universalë dhe nga skema e qasjes së drejtpërdrejtë të numrave tek elementët emërorë (pra *3 mollë*, në vend të *3 kokrra mollë*), edhe ii) (indirekt) nga sistemi i markimit të shumësit. Ky presion ka qenë edhe i pavarur nga presioni tjetër i madh nga latinishtja.

Të dhënat gjuhësore tregojnë që sistemi PN vijoi të lëvrohej, dhe të zhvillohej në përdorim (frekuencë) të gjerë dhe në diversitet përmes periudhës së kontaktit latin (Cane E., Yue, H. 2020). Arsyeja e rezistencës lidhet me vijimin e skemave dhe instancave të PN në përdorim, prej këtej në memorien gjuhësore të folësve, por edhe në nivel skematik, domethënë, folësit kishin ndërtuar skemat e abstraguara përmbi numrin e konsiderueshëm të rasteve PN. Pavarësisht presionit të njohur të latinishtes, shqipja duket se ka pasur si reziliencë nga njëra anë përkundër latinishtes (Ostler 2021: 76), por edhe një farë izolim mbrojtës, një farë vetë-

mjaftueshmërie që e ka mbrojtur këtë përdorim të shqipes në një komunitet pak të trazuar nga ndikimet latine. Përcaktorët numërorë kanë vijuar praninë e tyre si në përdorim por edhe në nivelin skematik-konjitiv deri në përdorimin e sotëm (Cane E. & Hu Y. 2020).

5.2 *Konsiderata përmbledhëse*

Prania e përcaktorëve numërorë duket se ka shkaktuar turbulencë strukturore: singularizim të shumësit, tendencë bjerrëse të markimit në shumës dhe të peshës morfonolgjike të këtyre formantëve, si dhe tronditje të sistemeve të tjera brenda rrafshit të shumësit – ambivalenca gjinore vetëm në shumës. Më shumë se gjysma e emrave kanë një markim të shumësit me formantët e dobësuar: -e/-ë ose zero, ndërkohë që si origjina indoeuropiane edhe ajo e hershme proto-shqiptare ka formante me informacion të dallueshëm (-ër; -j/nj; -ra, -a, k>q; g/gj), bile në rastin e formantit -inj/-enj etj., formanti rëndohet duke marrë mbi vete deri theksin e fjalës.

Sigurisht, rrafshi i formës është transferuar edhe te rrafshi i përmbajtjes kategoriale, që nënkupton një turbulencë konjitive (perceptimi konjitiv-gjuhësor i folësve për dallimin njëjës/shumës) në thellësi dhe në gjerësi.

Megjithatë, ky fenomen, nuk e ka nulizuar apo zhbërë sistemin e markimit të shumësit. Rezistenca e markimit të shumësit lidhet së pari me origjinën më të hershme indoeuropiane, siç shihet nga formantet e vjetra. Ndërkohë, efekt në mbështetje të markimit të shumësit ka pasur edhe kontakti dhe ndikimi i gjatë latin, i cili ka vijuar edhe përtej mbulimit nga perandoria bizantine nëpërmjet sferave relevante, sidomos, ligjërimi në sferën fetare. Në këtë kah kanë qenë edhe ndikimet në kuadër të Sprachbundt, pasi gjuhët në kontakt kanë pasur sistem të mirëkonfiguruar të markimit të shumësit.

Rezultantja e këtij konkurrimi duket se është një rënie e ndikimit të PN për shkak se baza më e madhe mbi të cilin mbështetet sistemi i PN ka dalë pothuajse jashtë përdorimit, ose është shmangur nga mjete të tjera. Por, edhe markimi i shumësit, pavarësisht se tani nuk është nën presionin e fortë si më përpara, ka pësuar ndryshime strukturore dhe skematiko-konjitive të cilat janë ireversibël. Markimi i shumësit ka tendencë në rënie së bashku me konstruktet e markimit të shumësit të cilat kanë formën me një peshë informacioni shumë më të lehtë.

Projeksioni i dallimit njëjës/shumës te mbiemrat është gjithashtu në të njëjtën linjë. Në një periudhë më të hershme mbiemrat kanë pasur një markim qartësisht të dallueshëm, me informacion fonologjik të konsiderueshëm; krahasoni:

i ri – të rinj (ndryshon nyja e përparme & ka formantin – nj të shtuar

I madh – të mëdhenj – përveç sa më sipër, ka edhe ndryshimin e rëndësishëm të theksit, që e ka marrë mbi vete formanti i shumësit

Sidoqoftë, ky markim i hershëm, u pasua më vonë me një peshë fonologjike shumë më të lehtë, deri të pakonsiderueshme

I kuq/të kuq

I shkurtër/të shkurtër

Qendër historike/qendra historike

Nga ana tjetër, projeksioni i markimit njëjës/shumës mbi foljen, jo vetëm që nuk ka pasur oshilacione, turbulencia apo ambivalencia të tilla, por ruan një fizionomi shumë të qartë të formave njëjës dhe shumës përgjatë paradigmes së vetës dhe të kohëve të shumta. Ky kontrast përsëri veçon efektin e dallueshëm të PN mbi emrat dhe në vijim mbi mbiemrat. Nëse do të ishte një zbehje e përgjithshme, do të ishte shtrirë në koncept, në strukturë dhe në nivel skematik edhe te projeksioni njëjës/shumës mbi foljen.

Siç u shtjellua më sipër, shqipja ka edhe zbehje e gjinisë, por

- Zbehja e gjinisë ndodh vetëm në sferën e shumësit
- Studimi dhe të dhënat provojnë që kjo lidhet me formantet e shumësit që i kemi përmendur më sipër, veçanërisht grupi tepër i madh i emrave që marrin formantin -e të shumësit
- Ndërsa turbulencia te numri është e pranishme në gjithë paradigmen, paradigma e gjinisë shfaq një pjesë të qartë në rrafshin e njëjësit, tepër e rregullt, pa konfuzione, me uniformitet të lartë dhe dallueshmëri mashkullore/femërore.

Pra problemi duket se shkaktohet tek dhe për shkak të shumësit.

Perspektiva e zhvillimit. Trajtimi në këtë studim, bazuar në qasjet që shikojnë strukturimin të bazuar mbi përdorimin (ligjërimin faktik), sugjeron se, shqipja nuk parashikon të ketë efekte të mëtijshme presioni mbi sistemin e markimit të shumësit. Ndikimi i deritanishëm duket jo-reversibël, por megjithatë, ligjërimi bart një sistem të plotë, të pasur markimi, bile edhe “të

rënduar” pasi, përveç emrit, bartës të konstrukteve kategoriale të shumësit janë edhe mbiemrat, përemrat. Ndërkaq, sistemi i PN, duket se ka një rënie për shkak se është humbur baza kryesore konceptuale dhe pragmatike e situatave që kryenin matjen nëpërmjet këtij sistemi arkaik. Nga ana tjetër, sistemi duket se ka lënë gjurmët e veta në ligjërim por edhe në skemat në mendjet e folësve (*cognitive patterns*) që kanë bazë PN. Shanset janë që kjo vazhdë të mbijetojë, por në mënyrë modeste.

Referencat

- Aikhenvald, A. Y. 2000. Classifiers. A typology of noun categorization devices. Oxford: Oxford University Press.
- Bisang, W. 1999. Classifiers in East and Southeast Asian languages. Counting and beyond. Numeral types and changes worldwide, ed. by Jadranka Gvozdanović, 113–85. Berlin and New York: Mouton de Gruyter, Trends in Linguistics. Studies and Monographs 118.
- Bybee, J. (2010). Language, usage and cognition. Cambridge University Press.
- Cane, E., & Yue, H. (2020). A typological account of Albanian Numeral classifiers. *Institute for Linguistic Studies of the Russian Academy of Sciences (Saint Petersburg, Russia)*.
- Cane, E., & Yue, H. 2021, “Constructional change along the evolving gender schema - split gender paradigm nouns”; 11th International Conference on Construction Grammar (ICCG11), University of Antwerp, 16-18 August 2021, Antwerp, Belgium (<https://www.uantwerpen.be/en/conferences/construction-grammars/>)
- Cinque, G. (2006). Are all languages' numeral classifier languages'?. *Rivista di Grammatica Generativa*, vol. 31 (2006), p. 119-122.
- Cinque, G., & Krapova, I. (2007). A note on Bulgarian numeral classifiers. In Alboiu, G., Avram, AA, Avram, L., Isac, D.(eds.) *Pitar Moș: A Building With a View. Papers in Honour of Alexandra Cornilescu*. Bucharest: Editura Universității din București, 2007, pp. 45-51.. Bucharest: Editura Universității din București.
- Croft, W. (1994) Semantic universals in classifier systems, *Word*, 45:2,145-171,

- Croft, W. (2001). *Radical construction grammar: Syntactic theory in typological perspective*. Oxford University Press on Demand.
- Çabej, E, (2008) *Vepra të Zgjedhura*, Prishtinë, ASHAK
- Demiraj, S., (2015). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
- Diessel, H., & Hilpert, M. (2016). Frequency effects in grammar. In Oxford research encyclopedia of linguistics. Georgakopoulos, T., et al. "Universal and macro-areal patterns in the lexicon." *Linguistic Typology* (2021).
- Gil, David. 2013. Numeral classifiers. In Matthew S. Dryer & Martin Haspelmath (eds.), *The world atlas of language structures online*. <http://wals.info>
- Goldberg, A. E. (2006). *Constructions at work: The nature of generalization in language*. Oxford University Press.
- Greenberg, J. (1972) Numeral Classifiers and Substantival Number: Problems in the Genesis of a Linguistic Type. *Working papers on Language universals*, No. 9..1-40,
- Greenberg, Joseph H. 1990. Numeral classifiers and substantival number. In Keith Denning & Suzanne Kemmer (eds.), *On language: Selected writings of Joseph H. Greenberg*, 166–193. Stanford: Stanford University Press.
- Langacker, R. W. *Foundations of cognitive grammar: Theoretical prerequisites*. Vol. 1. Stanford university press, 1987.
- Lehmann, C. 2000, "On the German numeral classifier system." Schaner-Wolles, Chris & Rennison, John & Neubarth, Friedrich (eds.), *Naturally! Linguistic studies in honour of Wolfgang Ulrich Dressler, presented on the occasion of his 60th birthday*. Torino: Rosenberg & Sellier; 249-253.
- Nichols, J.. 1992. *Linguistic diversity in space and time*. Chicago: University of Chicago Press.
- Ostler, N. (2021). Albanian: Language Survival against the Odds, in *Proceedings of FEL XXV*, 16-19 December 2021, Tirana, pp. 65-72
- Pierrehumbert, J. "Lenition and contrast." *Frequency and the emergence of linguistic structure* 45 (2001): 137.

- Sanches, M. & Slobin L. 1973. Numeral classifiers and plural marking: An implicational universal. *Working Papers in Language Universals* 11. 1–22.
- Seifart, F. (2010). Nominal classification. *Language and linguistics compass*, 4(8), 719-736.
- Tang, M., & Her, O. S. (2019). Insights on the Greenberg-Sanches-Slobin generalization: Quantitative typological data on classifiers and plural markers. *Folia linguistica*, 53(2), 297-331.

KDU: 811.18:811.124(05)

(908) (05)

Evalda PACI

**DËSHMI DHE GJURMË TË LATINITETIT NË STUDIMET SHQIPTARE
(VËSHTRIM HISTORIKO-KRAHASUES)**

Abstrakt

Vëmendja ndaj studimeve që kanë pasur objekt studimi elementet latine në gjuhën shqipe ka qenë përherë e dukshme, aq më tepër në rasë të ngërthimit të të njëjtit argument në probleme të historisë së gjuhës shqipe dhe të kontakteve më të hershme me gjuhë e kultura të tjera. Gjithashtu, çështje të studimit të aspekteve të shfaqjes së latinitetit dhe ndikimit në vise jashtë Romës janë bërë pjesë e një tradite të gjatë studimore që ka grishur së pari studiues të fushave specialistike si historia e gjuhës shqipe, historia e teksteve të vjetra shqipe, letërsia e vjetër shqipe, epigrafia latine dhe shfaqje të saj në trevat tona. Në këtë punim tonin kemi cekur disa linja studimore, duke marrë parasysh dhe kontribute paraardhëse, që mbajnë autorësinë e E.Çabejt, Sh.Demirajt, R.Ismajlit, M.Camajit, E.Deniaux etj. Si një argument që bëhet shtysë dhe për studime të natyrës ndërdisiplinore dhe të gjurmimeve mbi antropologjinë e antikitetit, jo pak studiues të huaj i janë qasur këtij të fundit, duke ofruar hulumtime dhe trajtesa të posaçme në lidhje me të. Është me interes të vihet në dukje larmia e disiplinave që mund të përafrojnë qasjet e tyre në lidhje me anjë argument të tillë, sa specifik në thelbin e vet, aq dhe me prirje për të nxitur gjurmime të mëtejme ndërdisiplinore.

Fjalët çelës: latinitet, elemente latine, histori e gjuhës, studime mbi romanitetin.

Hyrje

Studimet në fushë të gjuhësisë së krahasuar dhe asaj historike kanë pasur për një kohë të gjatë në vëmendje çështje të argumentimit të origjinës dhe karakterit i.e. të sanskritishtes, greqishtes së vjetër, gjuhës latine, por dhe të gjuhëve të tjera që të njohura më pak se këto të sipërcituarat, apo dhe të dokumentuara më pak në pikëpamje dëshmish shkrimore, mbeten përherë në objekt të një saktësimi tipologjik të domosdoshëm.

Ndërkohë që trajtohet dhe historiku i gjuhës latine në manuale studimore mbi periodizimin e kësaj të fundit në kuptimin e dokumentimit shkrimor të besueshëm, si dhe të vendit ku duhet të jenë konsoliduar bërthamat e para të një qytetërimi të ardhshëm përherë e më të afërmuar, nuk mbeten jashtë vëmendjes as popullsia e kultura që kishin të bënin me një historik të tillë në pikëpamje kontaktesh, ndikimesh apo shkëmbimesh më se të kuptueshme në kohë më të hershme.¹

Një çështje e tillë përfshin në mënyrë të pashmangshme konsiderimin e kulturave të arealeve të afërta me Gadishullin Italik, por dhe rëndësinë e njohjes së tyre nëpërmjet dëshmish e dokumentimesh shkrimore.

Në këtë vështrim, ndërsa dhe prurjet e ndërsjella mes gjuhëve e kulturave ndihmojnë të kuptohet më qartë rruga e alfabetizimit dhe e integritit të elementeve të tjera të qytetërimit, dhe çështjet e studimit të depërtimit të elementeve të gjuhëve si greqishtja e vjetër dhe latinishtja në gjuhët e Ballkanit marrin një domethënie më specifike.²

Kultura të tilla, të konsideruara faktorë me rëndësi në zhvillimin e traditës së njohjes së letërsisë dhe shkrimit si praktikë që përfshinte jo pak fusha të mendimit e të dijes njerëzore, janë të pranishme në shumë aspekte dhe në të tilla gjurmime, me një prirje të qartë ndaj historisë së lashtësisë dhe hulumtimit të të dhënave që kjo e fundit ofron në ngjarje, rrethana, dëshmi e dokumente.

Japin një ndihmesë të qartë në këtë drejtim gjetjet dhe interpretimet mbi burimet epigrafike nga të dyja kulturat, ndërkohë që dhe përditësimet në vijim të korpuseve gjegjëse të mbishkrimeve si dhe të suplementeve që i shoqërojnë ato, vijnë të ofrojnë të dhëna mbi praninë e elementeve qenësore të tyre të reflektuara në onomastikë, antroponimi, tipologji teksti në monumente etj.

¹ Devoto G., (1940). *Le origini indoeuropee del latino*, në *Storia della lingua di Roma*, Cappelli editore, Bologna, f.1: La documentazione veramente organica del latino non va oltre il III secolo a.C. Essa è di parecchio più recente di quella delle lingue indoiraniche, dell'ittita, del greco. Ma è notevolmente più antica di quella delle altre lingue indoeuropee, e specialmente delle lingue baltiche, delle quali non conosciamo nessun documento prima del secolo XVI della nostra era.

² Gianotti G., Pennacini A., *Società e comunicazione letteraria di Roma antica, I*, Loescher editore, Torino, 1986, f.22: Nella cultura europea e mediterranea i segni rappresentano singoli usi, la cui combinazione, nel momento della lettura, porta all'articolazione delle parole. L'alfabeto è un elemento della cultura materiale che fa passare l'opera dall'incertezza e variabilità della tradizione orale alla stabilità e certezza della trasmissione scritta. I Romani conobbero presto l'alfabeto, probabilmente per l'intermediazione degli Etruschi, i quali l'avevano certamente ricevuto da colonie della grecità tirrenica nel corso di ripetuti contatti commerciali e bellici.

1. Vështrim i përgjithshëm mbi elementet latine në gjuhën shqipe

Elementet latine në gjuhën shqipe vijojnë të përbëjnë një argument me interes për studimet në fushë të gjuhësisë historike dhe asaj romane, ndërkohë që një traditë e pasur gjurmimesh dhe hulumtimesh në autorë dhe tekste ka bërë të mundur që dhe arritjet shkencore në pikëpamje të evidentimit kronologjik e depërtimit të tyre në gjuhën tonë të konsiderohen të kënaqshme dhe serioze.

Që në dokumentimet shkrimore më të hershme që njihen deri më sot për shqipen është e mundur të gjurmohen tekste që përmbajnë elemente të një origjine të qartë latine dhe ajo çka është pikërisht qenësore, të mund të ndiqet një lidhje e qartë me latinitetin e krishterë dhe prurjet përkatëse në veprat e asaj periudhe që emërtohet zakonisht si letërsi e vjetër shqipe.³

Ndihmojnë në pikëpamje të evidentimit të këtyre fakteve dhe leksikone e fjalorë të përmasave të konsiderueshme që përfaqësojnë dhe sot e kësaj dite monumente të kulturës klasike dhe të antikitetit duke përfshirë greqishten e vjetër dhe latinishten, bashkë me dallimet që me vetë diakroninë e natyrshme që karakterizoi zhvillime të pashmangshme në gjuhë e kulturë, u krijuan në rrjedhë të shekujve.

Albanologët që u morën gjerësisht me historinë e gjuhës shqipe dhe me shtresëzimet leksikore që bënë të mundur të dalloheshin dhe elemente me origjinë jovendëse, bënë pjesë të trajtesave të tyre dhe elementin latin të shqipes dhe karakteristikat themelore të një trashëgimie të pasur që orienton si ndaj prurjeve nga një periudhë më e hershme e që lidhet me periudhën klasike të evolucionit të gjuhës latine, ashtu dhe me zëra që transmetojnë një proces më të ndryshëm që ka të bëjë me depërtimin e krishtëritimit në viset tona.⁴

Evidentimi i zërave të veçantë që i përkasin një leksikoni të qëmtuar gjerësisht në traditën e studimeve në fushë të indoevropianistikës, gjuhësisë historike dhe asaj të krahasuar ka bërë të mundur të mund të shtrohen trajtesa mbi përkatësinë semantike të këtyre elementeve, por dhe mbi kronologjizimin e mundshëm të tyre, falë proceseve fonologjike që shpien dhe në periudhën më të afërt në të cilat fjalë të veçanta mund të kenë hyrë në gjuhën shqipe.

³ Paci E., *Çështje të gjurmimit të elementeve latine dhe latino-romane në veprat e letërsisë së vjetër shqipe*, në *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017, f.85-98.

⁴ Të tilla ndikime dhe zhvillime pasqyrohen ndjeshëm në gjuhë e në kulturë e në njëfarë mase reflektohen dhe në pasurimin e dialekteve të një gjuhe me elemente kulturore e antropologjike.

Elementet latine të shqipes ofrojnë mundësi për trajtesa dhe të natyrës ndërdisiplinore, duke qenë se mjaft prej tyre u përkasin fushave semantike specifike në disa aspekte. Përkatësia e elementit latin të shqipes dhe qëmtimi i një kronologjizimi që hipotetizohet duke pasur parasysh periudha më të hershme të padokumentuara plotësisht rimerret vazhdimisht në punimet e karakterit historik mbi gjuhësinë ballkanike dhe atë të vendeve në të cilat ndikimi latin ka qenë mjaft i pranishëm.⁵

Një dukuri e rrahur gjerësisht dhe që duhet marrë në konsideratë patjetër si një faktor historik mjaft përcaktues mbetet romanizimi i viseve të Ballkanit, i trajtuar në punime dhe studime mbi historinë e Romës dhe çështjet e ekspansionit të një fuqie në rritje që karakterizohet nga profile të veçanta në shekuj të caktuar të historisë së lashtësisë në Evropë e më tej.⁶

Vise të veçanta, por dhe emra lumenjsh e portesh që më vonë do të njihen me emra thellësisht shqiptarë janë pikërisht më të ndërmendurat në veprat e Cezarit, politikanit dhe shtetarit romak që do të shënonte historinë e Romës dhe atë të civilizimit përkatës për shumë shekuj në vijim, ndërkohë që me ardhjen e Oktavianit (Augustit) në fuqi do të vijojë në linja të tjera edhe ekspansioni në drejtim të viseve ballkanike, me ndikime të pashmangshme në gjuhën e kulturën e popujve të përfshirë.⁷

Çdo kontribut studimor mbi elementet latine të shqipes ka ofruar dhe këndvështrime origjinale mbi gjurmimin e tij në dëshmi kryesisht shkrimore, por ka pasuruar ndjeshëm dhe një panoramë studimesh mbi leksikun e shqipes dhe linjat themelore të shtresëzimit të tij.

Modifikimet që kanë pësuar të tilla elemente janë hulumtuar imtësisht dhe në studime mbi fonologjinë e morfologjinë historike të shqipes, duke qenë se bëhet fjalë për procese që ngërthehen natyrshëm mes tyre e që përfshijnë si elemente të një leksiku vendës, ashtu dhe

⁵ Ndërkohë mbetet i pashmangshëm dhe trajtimi me gjasë antropologjik i rrethanave të kontakteve dhe shkëmbimeve mes romakëve dhe stërgjyshërve të shqiptarëve, një fakt ky i domosdoshëm për t'u konsideruar nëse ndërmerret dhe një vështrim hyrës që shpjegon dhe kushtet në të cilat u mundësuan të tilla ndikime. Shih ndër të tjera Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 109 v. Shih gjithashtu dhe Paci E., *Për një vështrim antropologjik dhe gjuhësor të nocioneve themelore të botës romake dhe latine në programet universitare shqiptare*, në Buletin i Universitetit të Shkodrës, SSHSH, n.69, 2019, f.7-22.

⁶ Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.110-111.

⁷ Caesar I., *De bello civili, Liber tertius, V*, Grandi tascabili economici Neëton, Roma, 2007, f.472: Frumenti vim maximam ex Thessalia Asia Aegypto Creta Cyrenis reliquisque regionibus comparaverat. Hiemare Dyrracchii Apolloniae omnibusque oppidis maritimis constituerat, ut mare transire Caesarem prohiberet, eiusque rei causa omni ora maritima classem disposuerat. Praeerat Aegyptiis navibus Pompeius filius, Asiaticis D.Laelius et C.Triarius, Syriacis C.Cassius, Rhodiis C.Marcellus cum C.Coponio, Liburnicae atque Achaice classi Scribonius Libo et M.Octavius. Toti tamen officio maritimo M.Bibulus praepositus cuncta administrabat; ad hunc summa imperii respiciebat.

elemente që janë huazuar në një periudhë të caktuar të evolucionit të shqipes. Nëpërmjet këtyre elementeve nganjëherë është e mundur dhe të kryhen deduktime mbi çështje thellësisht historike të fonologjisë apo ortoepisë së shqipes, duke qenë se pikërisht në lidhje me to mund të disponohen burime të shkruara të dokumentuara hershëm me shkrim.⁸

1.1. Elementet me origjinë latine në disa fjalorë të shqipes

Mund të gjurmohen elemente të cilësuar me origjinë latine në *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* (1891), hartuar nga Gustav Meyer, një vepër që rezulton mjaft e cituar në trajtesat e mëvona mbi etimologjinë e fjalës shqipe, në veçanti në gjurmimet e thelluara të kësaj natyre të Eqrem Çabejt.⁹

Referimi i Meyerit ndaj punimesh e studimesh mirëfilli shkencore mbi gjuhët e vjetra të Evropës, por në veçanti ndaj manualeve që evidentojnë një pasuri leksikore të plotë e mjaft të rrahur mbi greqishten dhe latinishten vihet re qartë në proces të konsultimit të veprës së tij mbi etimologjinë e shqipes.¹⁰

Vijnë natyrshëm në vëmendje të këtij studiuesi elemente leksikore nga gjuhët romane që më tej orientojnë dhe ndaj fazash më të hershme evolutive që shpeshherë dhe rindërtohen pikërisht mbi bazë të të dhënave që gjurmohen nga trajta që për arsye modifikimesh fonetike e morfologjike dallohen që kanë një vijimësi prej gjuhës latine. Terminologjia e përdorur në

⁸ Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.112-115. Paraqiten me vend dhe modifikime që lidhen me shtresëzime që nuk janë paraqitur në të njëjtat hollësi në çdo kohë. Shih ndër të tjera, Demiraj Sh., *po aty, botim i cituar*, f.112: Evolucion i au:a, që ka prekur shtresën më të vjetër të elementit latin, si p.sh., aurum>ār, gaudium>gas, laurus>lar etj. Kurse në shtresën më të vonë ky diftong nuk është thjeshtuar në a, si p.sh., causa>kafshë, laud->lavd etj.

⁹ Shih ndër të tjera në përbërje të këtij fjalori dhe lemat *kafshë* (Botime Çabej, Tiranë, 2007, *përkthim i A.Omarit*, f.218), dhe *qiell, po aty, botim i cituar*, f.418. Mjaft me interes në këtë drejtim mbetet dhe trajtimi i zërit *regj*(2), *po aty, botim i cituar*, f.426. Nuk do të mungojnë në këtë fjalor të G.Meyer as zëra që lidhen me botën e krishterë e me një shtrirje të njohur dhe në viset arbëreshe, siç është rasti i përveçimit *Rshajë* (*po aty, botim i cituar*, f.433), një emërtim për Pentekostet, që ndeshet në variante të caktuara në disa të folme të shqipes. Rimarrja e gjurmimeve të G.Meyerit në studimet etimologjike të E.Çabejt, por dhe vështrimi kritik në raste të caktuara bashkë me qasjet ndaj studiuesish që kanë bërë objekt vështrimi mjaft prej elementeve latine në shqipe përbën një linjë të rëndësishme në shtrijen metodologjike të këtyre vëzhgimeve. Janë të shumtë studiuesit që i qasen një argumenti të tillë, qoftë dhe duke dalluar në pikëpamje historike procese të ndryshme kryesisht fonetike në gjirin e këtyre elementeve, qoftë dhe duke nënvizuar veçantinë që këto të fundit paraqesin në krahasim me gjuhët romane, të formuara secila në kontekste sa specifike, aq dhe të ndryshme prej njëra-tjetrës.

¹⁰ Dallimet kronologjike që bëhen herë pas here ndërkohë që trajtohen fjalë të caktuara që janë pjesë dhe e leksikut të gjuhës shqipe e që kanë të bëjnë me faza historike evolutive të këtyre gjuhëve, janë një tjetër linjë metodologjike dhe orientuese ndaj njohurive të tij dhe kategorizimit të një sërë kontributesh që pikërisht në kohën kur u përpilua ky fjalor përfaqësonin burime referenciale me vlerë të madhe.

lidhje me emërtime të veçanta dëshmon sërish që autori konsideronte në çdo aspekt dhe paraqitjen sa më korrekte të përveçimeve të përzgjedhura, pa lënë jashtë vëmendjes dhe lidhjen me gjuhë të tjera apo dhe reflektimin përkatës të pranisë së fjalëve të caktuara në këto të fundit.

Të tilla kontribute që shohin dritën e botimit dhe pas realizimit të jo pak veprave dhe doracakëve në gjuhën shqipe janë një tjetër perspektivë e reflektimit të leksikut të shqipes dhe e përbërësve të tij nga fusha të veçanta të dijes e të kulturës jetësore.

Referime të qarta ndaj pranisë së elementit latin në shqipe do të mund të gjurmohen në përbërje të Fjalorthit të Ri të përpiluar prej D.Nikoll Gazullit, kontributi i të cilit do të pasurojë ndjeshëm dhe kuadrin kompleks të evidentimit të këtij elementi në të folme të caktuara dhe në kulturën e gjuhës shqipe.¹¹

1.2. Elementet latine të shqipes në studimet e Eqrem Çabejt

Vështrimet e Eqrem Çabejt mbi elementet latine të shqipes përbëjnë në të vërtetë një model të trajtesës shkencore dhe ndërdisiplinore, me një vëmendje të qartë jo vetëm ndaj evidentimit të një pranie të tillë në leksikun e shqipes, por dhe ndaj sqarimit të ndikimeve të qarta që dëshmojnë përmes emërtimeve që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me latinitetin dhe botën romake të antikitetit të hershëm. Panteoni romak është pasqyruar dhe në emrat e ditëve të javës e një fakt i tillë reflektohet dhe në emërtimet gjegjëse në gjuhën shqipe, me gjithë proceset fonetike e historike që kanë bërë të mundur që të paktën në pikëpamje tipologjike këto të fundit të paraqiten nën të njëjtin model formimi.

Duke iu referuar pikërisht emërtimeve të ditëve të javës dhe veçorive sintagmatike që karakterizojnë çdonjërin prej tyre mbetet e qartë një lidhje e hershme mes botëkuptimeve të popujve të viseve të Ballkanit dhe atyre të Gadishullit Italik, çështje kjo që mund të rimerret dhe në ditët e sotme në një vështrim të ri dhe mirëfilli ndërdisiplinor.

Të tilla përveçime dhe pse përbëjnë elemente të veçuara në pikëpamje leksikore mund të shpien në deduktime mbi ndërlidhje të hershme mes popujve dhe çështje të toposeve në besimin e tyre

¹¹ Është fjala për të quajturin *Fjalorth i Ri* të pajisur me fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë, të botuar në serinë e quajtur *Visaret e Kombit (Vëllimi XI)*, botuar në vitin 1941 prej Ministrisë së Arsimit të asaj kohe. Referimi i shpeshtë ndaj këtij vëllimi leksikografik ndeshet në skadat me shënime që Eqrem Çabej (1908-1980) ka përpiluar ndër vite në mbështetje të vëllimeve të studimeve etimologjike të realizuara prej tij. Elementi latin evidentohet qartë dhe në qasje me zëra të ngjashëm dhe në gjuhë të tjera në këtë botim të Gazullit, ndërkohë që gjejmë me vend të vëmë në dukje dhe referimin e vazhdueshëm ndaj kësaj veprë leksikografike në studime të mëvona të përqendruara mbi leksikun e shqipes dhe shtresëzimin e tij.

në kohë më të lashta. Ka një sërë veprash e tekstesh që bëjnë të mundur të gjurmohen elementet latine në gjuhën shqipe dhe pikërisht letërsia e shkruar përbën një burim kompleks në pikëpamje të mundësisë për vjelje shembujsh e përdorimesh në këtë fushë.

Studimet etimologjike të përpiluara prej Eqrem Çabejt mbeten gjithashtu një pikë referimi e qëndrueshme në pikëpamje të trajtimit konsequent të huazimeve latine në gjuhën shqipe, duke qenë etimologjia një lamiye mjaft e përshtatshme për të tilla gjurmime. Të tilla elemente, që bëjnë të mundur dhe reflektime mbi praninë e zërave që në ndonjë rast nuk dëshmohen në gjuhët romane, vetëm se rinëvizojnë rëndësinë e studimit të tyre në pikëpamje etimologjike dhe të vetë historisë së fjalës, përfshirë dhe kontekste të natyrës antropologjike, mjaft me interes për studimet shqiptare.

Zërat që duket se janë përzgjedhur në përbërje të vëllimeve me studime mbi etimologjinë e gjuhës shqipe u përkasin fushave të veçanta studimore, edhe në kuptimin e përkatësisë në regjistra gjuhësorë që evokojnë qytetërimin romak.

Trajtesat që shtjellohen në lidhje me të tilla elemente leksikore cekin dhe proceset fonetike që mendohet se kanë shoqëruar depërtimin e tyre në leksikun e shqipes, bashkë me qasje ndaj gjuhësh të tjera, ndër të cilat dhe rumanishtja.

Në të vërtetë, janë pikërisht elementet latine të shqipes që bëjnë të mundur ndërthurjen e qëmtimeve si mbi gjuhë të caktuara romane a neolatine, ashtu dhe mbi rumanishten, një tjetër gjuhë me lidhje të qartë birnie nga latinishtja popullore, por e lindur në një substrat specifik.¹²

Emra të shumtë, folje, por dhe mbiemra pasurojnë ndjeshëm panoramën e këtyre elementeve, prania e të cilëve dëshmon mbi të gjitha dhe kontaktet e hershme të paraardhësve tanë me popullsi e kultura që shtriheshin dhe tej Adriatikut. Emrat e përveçëm të vënë në dukje në studime të viteve '50-'60 në revistat shkencore që reflektojnë arritjet dhe interpretimet mbi mbishkrimet latine të gjetura e të domosdoshme për t'u botuar janë një tjetër dëshmi e faktit të

¹² Shih gjithashtu Paci E., *Çështje të gjurmimit të elementeve latine dhe latino-romane në veprat e letërsisë së vjetër shqipe*, në *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017, f.85-86: Një prire të veçantë në traditën e studimeve kryesisht albanologjike përfaqëson dhe gjurmimi i elementeve latine në proces të hulumtimit të marrëdhënieve të shqipes me gjuhë të tjera, në veçanti me ato të arealeve fqinje. Marrëdhëniet mes shqipes e rumanishtes janë gjurmuar me synimin që të zbulohen elemente që ndihmojnë në ndriçimin e rrethanave të lëvizjeve migratore, stabilizimit të mundshëm dhe gjenezës së popullsisë përkatëse.

kolonizimit e romanizimit të territoreve të Shqipërisë së sotme në vitet e fundit të republikës romake.¹³

Vetë kuptimet konkrete me të cilat njihen dhe në gjuhën latine të tilla elemente, bëjnë të mundur të rindërtohet dhe historia e fjalës, bashkë me ndryshime të mundshme jo vetëm fonetike që rinënvizojnë veçantinë me të cilat paraqiten si përveçime që i përkasin leksikut të shqipes.

Trajtimi i zërave të veçantë në studimet etimologjike të E.Çabejt dallohet dhe nga rimarrja e një tradite të hershme, por të qëndrueshme që bën të mundur të njihen gjurmues që kanë qenë konsequentë si në orientimin ndaj studimeve albanologjike, ashtu dhe ndaj vetë elementeve latine në gjuhën shqipe, bashkë me një fakt të rëndësishëm që ka të bëjë me përfshirjen e argumenteve të tilla në periodikët, por dhe punimet studimore më të mira të kohërave e një gjë e tillë konfirmohet nga një sërë evidentimesh që aktualisht na lejojnë përmes konsultimesh më të lehtësuara të të dhënave mbi arritjet shkencore në fusha të tilla.

Trajtimi dhe konsiderimi i elementeve latine në shqipe përbën një argument mjaft të trajtuar në revistat shkencore institucionale të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, ndërkohë që vetë zëra a lema të fjalorit të gjuhës shqipe përbëjnë për studiuesit e gjuhësisë historike e të krahasuar faktorë me rëndësi për të shtruar a rindërtuar qasje mes trajtash që në shumicën e rasteve sillen të supozuara për arsye të mungesës së dokumentimit shkrimor në faza më të hershme të evolucionit të gjuhëve të caktuara.¹⁴

Pikërisht dhe përfshirja e trajtimit të shumicës së këtyre elementeve në punime studimore kushtuar etimologjisë së fjalës shqipe bën të mundur që të konsiderohen dhe vepra e tekste në të cilat këto të fundit gjenden, mund të vilen e më tej dhe të citohen për arsye studimi.

Tipologjia e klasës së cilës këto elemente mund t'i përkasin gjen pasqyrim mirëfilli në studimet etimologjike të sipërcituara, të cilat dhe janë botuar në vëllime të sistemuara e të kujdesuara

¹³ Shih gjithashtu dhe Anamali S., Ceka H., Deniaux É., *Introduction*, në *Corpus des inscriptions latines d'Albanie*, Collection de l'École française de Rome, 2009, f.5-6: La période de la colonisation romaine est la dernière grande phase d'apport de population sur le territoire de l'Albanie antique. L'époque de la dictature de César et celle du triumvirat furent des moments privilégiés de la réalisation de vastes projets de fondations coloniales. La localisation des projets césariens réalisés permet de montrer la cohérence de ceux-ci qui visaient à contrôler aussi les axes de communication. Dyrrachium, Byllis, Buthrotum sont les colonies fondées sur le territoire de l'Albanie d'aujourd'hui qui fut inclus, sous Trajan, dans la province d'Épire nouvellement créée.

¹⁴ Vetë Eqrem Çabej në trajtesa dhe ligjërata mbi gjuhësinë i.e. vë krahas njëra-tjetrës trajta fjalësh që ndërkohë që i përgjigjen një fushe të caktuar semantike, bëjnë të mundur të shkohet qoftë dhe në mënyrë hipotetike ndaj gjendjesh më të hershme për studimet e gjuhësisë historike, në të cilat është fare e qartë që dhe shqipja përbën një komponente me rëndësi të veçantë bashkë me latinishten dhe greqishten e vjetër. Shih ndër të tjera dhe kapitullin me titull *Fonetika* në Çabej E., *Hyrje në indoeuropianistikë*, Botime Çabej, Tiranë, 2008, f.119 v.

mirë prej vitesh, duke qenë tashmë pjesë e një trashëgimie gjuhësore, letrare dhe filologjike unike për studimet shqiptare.

Në hulumtimet e Eqrem Çabejt duhen veçuar dhe ato konsiderata që kanë të bëjnë me proceset konkrete në të cilat duhet të jenë përfshirë elementet latine të shqipes dhe më në veçanti, kategori fjalësh që përafrohen mes tyre në pikëpamje të tipologjisë morfologjike.

Të tilla dukuri, të lidhura me procese themelore për nga rëndësia e studimit në disiplina si p.sh., morfonologjia përfshijnë klasa të tëra fjalësh që paraqiten me një origjinë të qartë latine, por ndër të tjera bëhen pjesë prej vetë studiuesit tonë në trajtesa mbi linja të veçanta studimore në gjuhësinë shqipe, siç është dhe rasti i shumësit të singularizuar.¹⁵

1.3. Tekstet e vjetra shqipe dhe fjalorët etimologjikë të gjuhëve klasike si burime për evidentimin e elementeve latine

Elementi latin dhe më tej dhe nënshtresime që kanë të bëjnë me periudha të mëvona të shndërrimit gradual dhe evolutiv të latinishtes në gjuhë-bija që emërtohen njëzëri si neolatine apo dhe romane janë të gjurmueshme më së pari në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, të iniciuara nën objektivin e shërbesave konkrete në praktikën e liturgjisë, por njëkohësisht dhe reflektuese të një kulture kishtarë që kishte origjinën në botën romake. Janë pikërisht të tilla vepra që të hulumtuara dhe në pikëpamje të leksikut të tyre dhe regjistrave e nënsistemeve që përfshihen në to, përbëjnë dhe burimet parësore në të cilat mund të gjurmohet prania e elementeve latine, greke, por dhe neolatine e kësisoj të arsyetohet dhe shkalla e ndikimit në ligjërimin biblik të një terminologjie të konsoliduar dhe që mbart qartësisht gjurmë të një trashëgimie të hershme kryesisht latine.¹⁶

¹⁵ Çabej E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, në *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008, f.269 v. Përveç emrave që përafrohen nga tipologjia eptimore dhe fakti që gjurmohen në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, në shkrimet e Çabejt radhiten dhe raste përveçimesh që kanë të bëjnë me emra vendesh, me emërtime festash fetare që në ndonjë rast përbëjnë dhe përshtatje apo kalkime në gjuhën shqipe, gjithnjë mbas një modeli latin origjinar. Këto të fundit, të trajtuara dhe nga disa gjuhëtarë të tjerë që janë marrë me evidentimin e elementit latin në shqipe, përbëjnë raste të përveçme ndërtimesh, shpesh dhe me tipare që lidhen me aglutininimin e trajtave të caktuara. Sa u përket klasave më të veçanta emërore, proceset në të cilat duhet të jenë përfshirë, bashkë me tipare morfologjike që i dallojnë këto të fundit veçanërisht në shqipen e vjetër, pikërisht në studimet e Çabejt rezultojnë të trajtuara në pikëpamje të veçorive tipike që lidhen me gjininë dhe eptimin e tyre siç paraqitet në tekste të letërsisë së vjetër shqipe. Përfshirja e elementit latin të shqipes në procese të rëndësishme fonologjike bën të mundur të interpretohet dhe lashtësia e depërtimit të tij në gjuhën tonë, gjithnjë në vështrim referues ndaj proceseve të zgjerimit të Perandorisë Romake në shekuj.

¹⁶ Përfshihen në këtë këndvështrim një sërë leksemash dhe zërash që lidhen me objekte të kultit dhe detaje që përfshihen në to; emërtesa dhe përveçime që kanë të bëjnë me praktikën e liturgjisë dhe atë të nderimit të figurave

Pikërisht në dëshmitë shkrimore më të hershme të gjuhës shqipe e veçanërisht në vepra që paraqiten më të plota në pikëpamje përmbajtësore, është e mundur të gjurmohen të tilla elemente, herë të patrajtuara mjaftueshëm në pikëpamje të përpunimit fonetik e përmbajtësor ndërsa përdoren në tekste specifike në gjuhën shqipe të kohës, herë të modifikuara në atë shkallë që bëjnë të supozohet për një ngulitje të hershme të tyre në leksikun e gjuhës sonë.

Leksikonet e shqipes, korpuset gjuhësore që në dekadat e fundit po përvijohen e pasurohen ndjeshëm, arrijnë të jenë dhe një gurrë e çmuar e evidentimit të një trashëgimie leksikore e semantike që ndër të tjera ofron dhe linja të gjurmimit të ndikimeve që ndaj shqipes kanë qenë të pashmangshme dhe që gjejnë shpjegim në faktorë dhe rrethana historike që përfshinë jo vetëm viset tona të mëhershme, por krejt Ballkanin e krahinat e tij.

Elementet latine të shqipes shërbejnë dhe si raste qasjesh mes trajtash të ngjashme me gjuhë neolatine të lindura në substrate të ndryshme nga ato të gjuhëve të tjera të konsideruara si bija të latinishtes popullore.

Në këtë mënyrë dhe krahasimet përvijojnë një linjë më vete studimore që përafron mes tyre studimet ballkanike me ato romane dhe albanologjike.

Të tilla çështje që shkojnë përtej krahasimeve të thjeshta mes fjalësh të veçuara e që ndihmojnë dhe në parashtrime mbi ndikime të ndërsjella mes popujsh e kulturash, pasqyrohen ndjeshëm në manualët dhe traktatet më të mira të gjuhësisë historike dhe asaj të krahasuar, ndër të cilat do të veçonim dhe fjalorë madhorë etimologjikë mbi gjuhën greke dhe atë latine, sigurisht dhe me dallime të qarta kronologjike që bëjnë të mundur të dallohen dhe periudhat e zhvillimit të secilës prej këtyre gjuhëve.

Realizimi dhe dalja në dritë të shtypit e këtyre vëllimeve lehtësoi ndjeshëm punën kërkimore të indoevropianistëve dhe studiuesve të gjuhësisë së krahasuar, ndërkohë që vetë konsultimi i tyre dëshmon praninë e elementeve të caktuara të leksikut të shqipes që dhe me interpretimet përkatëse mbi prejardhjen e hershme i.e. mund të konsiderohet një faktor ndihmës për studimet në fushë të indoevropianistikës dhe të gjuhësisë ballkanike.

Nëse do të merrnim në shqyrtim pikërisht elementet latine që analizohen në studimet etimologjike të Eqrem Çabejt, do të duhej të vinim në dukje dhe përzgjedhjen në pikëpamje të

themelore të kësaj të fundit; emra shenjtorësh dhe shenjtoresh që paraqiten të modifikuara fonetikisht në zona të caktuara të praktikimit të besimit të krishterë në viset tona.

rëndësisë që ato paraqesin për qytetërimin përkatës dhe vendin që zënë në leksikonet e periudhave të caktuara të zhvillimit të gjuhës latine dhe më tej në fjalësin e veprave të autorëve latinë më të rëndësishëm të letërsisë romake. Njohës i mirë i teksteve të vjetra shqipe dhe parashtrues i një metodologjie të përcaktuar në transkribimin dhe interpretimin e tyre, Eqrem Çabej kontribuon dhe në pikëpamje të njohjes së elementeve më specifike, pikërisht atyre përveçimeve që kanë të bëjnë me latinitetin e krishterë, jo vetëm atë romak e të periudhës klasike.¹⁷

Një lidhje e natyrshme mes gjuhës dhe civilizimit, por dhe një vëmendje e përqendruar mbi përveçime që hedhin dritë mbi kontakte të hershme e mbi faza të domosdoshme për t'u sqaruar mbi ndërlidhjet gjuhësore në viset ballkanike, por dhe me ato tej Adriatikut do të mund të gjurmohet në trajtesat që përmbahen në këto studime etimologjike, ndërkohë që dhe gjuhëtarë të huaj dhe gjurmues të një konteksti jo vetëm gjuhësor, por dhe etnologjik e antropologjik renditen si kontribues dhe evidentues në një panoramë të tillë studimesh dhe hulumtimesh.

Një arsenal mjaft i shtrirë në elemente leksikore, por dhe në fusha semantike me rëndësi për botën ballkanike e atë shqiptare gjen reflektim në të tilla studime, bashkë me vërejtjet mbi burime që bëjnë të mundur të kuptohen më mirë kontaktet e ndikimet e ndërsjella mes gjuhëve në një areal të gjerë gjeokulturor.

Romanizimi i Ballkanit përfshiu vise që duhet të kenë pasur dhe më parë ndërlidhje gjuhësore e kulturore mes tyre, por ndërkohë dhe dëshmimi i elementeve të përbashkëta ose i veçantive që konkretizohen në proces të këtij ndikimi të madh mbi gjuhën dhe kulturat përkatëse shpie në rikonsiderimin e ndërveprimeve apo ndikimeve që vetëkuptohen në të tilla rrethana.

Punime studimore mbi gjuhën shqipe dhe historinë e saj konsiderojnë ndër të tjera karakterin indoevropian të saj dhe tiparet në të cilat ky fakt bëhet konkret dhe i prekshëm.¹⁸

Do të jenë pikërisht këto tipare dhe elemente konstitutive të vetë gjuhës shqipe që të rishqyrta në të njëjtat nënsisteme të gjuhës latine apo dhe asaj greke do të bëjnë të mundur

¹⁷ Studimi i elementeve latine në veprat e letërsisë së vjetër shqipe sigurisht nuk mund të shihet i ndarë nga vëzhgimi dhe evidentimi i një sërë ndërtimesh me përkatësi liturgjike që dëshmojnë jo vetëm ndikime që në krye të herës të një kulture specialistike kishtare, por dhe dëshmi trajtash të modifikuara falë kalimit të kohës.

¹⁸ Shih në veçanti kreun me titull *Shqipja gjuhë i.e.*, në Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.25-32. Edhe në interpretimin e tipareve themelore që dëshmojnë karakterin i.e. të gjuhës shqipe qasja ndaj elementeve greke dhe latine rikonfirmon përkatësinë gjenetike të kësaj gjuhe në familjen gjuhësore i.e.

të konstatohen afri të qarta, por dhe ndryshueshmëri të shfaqjes së dukurive të caktuara që prekin mbi të gjitha sistemin gramatikor të këtyre gjuhëve të vjetra të Evropës.¹⁹

Shkalla e ndikimit të gjuhës latine në nënsisteme të caktuara të shqipes provon më së miri që kjo e fundit ka ruajtur një integritet të qartë dhe që ka qenë leksiku i saj që ka prurje të shumta që janë dëshmi e një ndërveprimi të mundshëm në faza të hershme historike. E dëshmojnë gjerësisht një fakt të tillë jo vetëm variantet doktrinare të shekujve që pasojnë botimin e *Mesharit* (1555), por dhe realizime të mëvona që të përpiluara në të njëjtën linjë paracaktimi, ruajnë në përbërje të vet një tërësi formash e ndërtimesh që evidentojnë dhe një vijimësi të qartë me veprat e mëparshme, të ngjashme në pikëpamje tematike.

Romanizimi i Ballkanit me fazat përkatëse kronologjike dhe viset që u përfshinë më tepër prej tij përbën një faktor për t'u konsideruar në trajtesat që kanë objekt elementet latine në gjuhën shqipe dhe sferat semantike që i rrokin këto të fundit.

Një prirje e tillë ndiqet qartë në studimet e Shaban Demirajt, ndërkohë që dhe klasifikimi i zërave leksikorë që përndahen në disa lamiye të jetës kulturore dhe shpirtërore bën të mundur që të kihen të qarta dhe kategoritë leksiko-gramatikore që përfaqësojnë elemente të një origjine latine.²⁰

Në trajtesat e Shaban Demirajt do të evidentohen emra farefisnie apo emra që shënojnë pjesë të trupit; emërtime të përgjithshme që lidhen me terma të latinishtes klasike, por dhe kafshë, shpend, elemente të ndërtimit të shtëpisë, pemë dhe materiale lëndore.²¹

¹⁹ Do të përbënin në këtë pikëpamje aspekte qenësore krahasimi tipare që kanë të bëjnë me sistemin rasor në të dyja gjuhët, por që në shqipe gjurmohet më gjerësisht në dokumente shkrimore të shekujve të parë të konfirmimit të saj me shkrim; gjithashtu sistemi tri gjinësh që gjithashtu në vepra të letërsisë së vjetër shqipe vjen në një gjendje më arkaike e sigurisht më të ndryshme se në ditët e sotme. Për më tepër, mund të ndërmendim dhe foljet supletive që gjurmohen si në greqishten e vjetër, ashtu dhe në gjuhën latine. Karakteri i.e. i gjuhës shqipe përkon në këto aspekte më së miri me tipare të ngjashme në gjuhën latine dhe në atë greke. Sa i përket greqishtes së vjetër dhe çështjes së alternimit të rrënjëve foljore, shih në veçanti dhe Devoto G., *Le origini indoeuropee del latino*, në *Storia della lingua di Roma*, Cappelli editore, Bologna, 1940, f.3. Mbetet po aq me interes trajtimi i origjinës i.e. të gjuhës latine dhe peripecive që i shpjen paraardhësit e bërthamës së Latiumit të gjejnë rrënjë dhe stabilizim në Gadishullin Italik, në qendër të tij. Shih sërish Devoto G., *Storia della lingua di Roma, botim i cituar*, Bologna, 1940, f.1-36.

²⁰ Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.111.

²¹ Shih në veçanti *Elementet latine* në kreun me titull *Elementet e huaja që shqipja i ka trashëguar nga nëna e saj*, në Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.114: Fjalë prej burimi latin ndeshen, ku më shumë e ku më pak, në sfera të ndryshme të fjalorit të shqipes, përfshirë këtu edhe sfera të tilla të rëndësishme, siç janë: emrat e farefisit, të kafshëve, të shtëpisë, të bujqësisë e të zejtarisë, të kohës, të jetës shpirtërore etj.

Ndër mbiemrat që renditen si shembuj në një rubrikë të përveçme kushtuar këtyre elementeve në trajtimet e Sh.Demirajt, bie në sy fakti që këta të fundit janë të nyjshëm, d.m.th., elemente të një klase të formësuar brenda shqipes dhe falë ndryshimesh të natyrshme në proceset evolutive të saj, por me tipare të rrënjës që dëshmojnë qartë lidhjen me latinishten: i ashpër, i drejtë, i gjelbër, i pëgërë, i qetë, i shëndoshë, i shkretë, i shtrenjtë, i shurdhër, i varfër, i verbër, i verdhë etj.²²

Një pjesë e foljeve që veçohen si shembuj prej këtij studiuesi i përkasin një sfare me interes studimore, pikërisht asaj të liturgjisë. P.sh., *bekoj, gjykoj, lëvdoj, pagëzoj, shëmbëllez, shërbej, shpërej* etj., të kujtojnë jo vetëm tekstet koncize të liturgjisë, por dhe përdorime tipike nga pjesët biblike që me Pesëqindën e më tej do të ndeshen në autorët kryesorë të letërsisë kishtarë në gjuhën shqipe. Hulumtime më të thelluara do të bëjnë të mundur të vihen re dhe kontekste të tjera të përdorimit të elementeve të tilla, që për nga vjetërsia e depërtimit në gjuhën shqipe dhe sigurisht dhe periudhat jo të njëjta kur mund të ketë ndodhur një dukuri e tillë, përbëjnë me siguri argumente studimi mjaft me interes për historianët e gjuhës shqipe.

Është me vend që në kuadër të kësaj trajtese të mund të rikujtojmë interesin e qartë që studiues të gjuhëve romane, por dhe atyre ballkanike treguan ndaj elementesh të veçanta leksikore të gjuhës shqipe, duke mbërritur të rindërtojnë skema krahasimesh që dëshmojnë dhe afri të mundshme mes gjuhëve të një areali kompleks dhe që u përfshi në gjithfarë ndryshimesh në shumë aspekte.²³

2. Përfundime

Rëndësia e studimit të elementeve latine në gjuhën shqipe nënvizohet me të drejtë në ato lamije gjurmimesh që lidhen drejtpërdrejt me historinë e gjuhës shqipe, me dialektologjinë dhe leksikologjinë historike të saj, me historinë e shkrimit dhe të dëshmive më të rëndësishme të letrarësisë në këtë gjuhë, por dhe interpretime tekstesh të mëhershme në të cilat ndërlidhjet me botën tej Adriatikut shpien në kërkime perspektivash përherë më me interes për periudha të hershme të zhvillimit të qytetërimit tonë. Ndër të tjera, studimet mbi epigrafinë romane dhe që

²² Shih sërish *Elementet latine* në Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.115.

²³ Afritë mes shqipes dhe rumanishtes bënë të mundur të rimerreshin në konsideratë dhe të tilla elemente, qoftë dhe për të qartësuar shkallën e ndikimit të latinishtes në njërën apo tjetrën gjuhë, apo dhe për të provuar kontakte më të hershme mes gjuhëve të sipërcituara, me shumë gjasë të ndodhura para se të merrte udhë vetë romanizimi i viseve në fjalë.

gjejnë terren të përshtatshëm hulumtimi dhe në viset shqiptare plotësojnë më së miri një panoramë të tillë, domosdoshmërisht e përfshirë dhe nga vështirimet shkencore historiografike dhe etnokulturore.

Mbas tyre qëndron solide një traditë e mëvetësishme gjurmimesh që më së fundi na ofrohet dhe në kuadër të rindërtimit të korpuseve të mbishkrimeve që marrin në konsideratë jo pak kontribute të realizuara mbi një tematikë të tillë e që i shërbejnë dhe studimit në një perspektivë më konkrete të pranisë së elementeve latine në botën shqiptare, madje, të asaj më të hershme.

Praktikës së leximit dhe interpretimit të këtyre dëshmive shkrimore i ndihmon më së miri njohja e një regjistri specifik që ka të bëjë me antroponimet dhe elemente të veçanta që në mbarë botën romake paraqiten si tipike dhe përfaqësuese. Prania e tyre dhe në qendra të rëndësishme urbane që ruajnë gjurmë të antikitetit greko-romak e që mund të evidentohen në viset tona dhe në ditët e sotme falë ruajtjes dhe klasifikimit të posaçëm kronologjik dhe tipologjik, përbën një tjetër mundësi dokumentimi të lidhjeve më të hershme mes popullsive në kohë të lashta.²⁴

Në të vërtetë, reflektime të një kulture epigrafike latine e romake në këto vise nuk janë të pakëta në pikëpamje numerike, e aq më tepër sa u përket periudhave në të cilat romaniteti e latiniteti ishin një prirje kulturore më se solide në tipare dhe shfaqje.²⁵

Duke dashur të qëndrojmë në kufijtë e një analize që mëton dhe të sintetizojë arritjet më të mira në këtë linjë studimore, që siç u tha më sipër, orienton ndaj studimesh ndërdisiplinore, por dhe mjaft specifike brenda disiplinave historike dhe qasjeve kryesisht diakronike, do të rinëvizonim faktin që dhe gjuha shqipe ruajti më së miri përgjatë historisë së saj shumëshekullore strukturat themelore të nënsistemeve të saj, duke reflektuar njëkohësisht dhe ndikime të pritshme për periudha që u përballën me lulëzimin dhe fuqizimin e dy gjuhëve të konsideruara klasike për qytetërimin dhe evropianitetin: greqishtes së lashtë dhe gjuhës latine.

Ndikimi i pashmangshëm nga dy gjuhë të rëndësishme që njohin një evolucion të gjatë në kohë, por dhe një dokumentim më të hershëm shkrimor e një pasuri të konsiderueshme në materiale

²⁴ Bruhl A., *Inscriptions de Durazzo et de Tirana, në Albania, Cahiers d'archéologie, d'histoire et d'art en Albanie et dans les Balkans*, n.5, Année MCMXXXV, f.91-97.

²⁵ Anamali S., Ceka H., Deniaux É., *Introduction*, në *Corpus des inscriptions latines d'Albanie*, Collection de l'École française de Rome, 2009, f.1-23. Në këtë hyrje gjithashtu bëhet e qartë jo vetëm domosdoshmëria e disponimit të një *corpusi* më vete në lidhje me mbishkrimet latine të viseve shqiptare, por dhe rrethanat që bëjnë të mundur realizimin gradual të këtij të fundit, paraprirë nga botime të shumta tematike që konkretizohen në artikuj përshkrues e analitikë mbi tekstet e këtyre mbishkrimeve.

epigrafike e më tej në vëllime të një letërsie të shkruar disashekullore, reflekton dhe jetëgjatësinë e mjaft ndërtimeve që mbijetuan pikërisht në gjuhën shqipe dhe elementet leksikore tipike të saj.²⁶

BIBLIOGRAFI

Ceka H. & Anamali S., (1961). *Mbishkrime latine të pabotueme të Shqipnisë*, në *Buletin Shkencor i Universitetit të Tiranës*, (1).

Anamali S., & Ceka H., Deniaux É., (2009). *Corpus des inscriptions latines d'Albanie*, Collection de l'École française de Rome.

Ashta K., (1966). *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, në *Studime filologjike*, (4).

Ashta K., (1982). *Leksiku i plotë i veprës "Kuvendi i Arbënit"*, në *Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës*, (1).

Ashta K., (1996). *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Shkodër.

Ashta K., (2000). *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Shkodër.

Ashta K., (2002). *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Camaj-Pipa.

Bogdani P., (2005.) *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*. Botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë.

Bonnet G., (1999). *Les mots latins de l'albanais*, L'Harmattan, Paris.

Bruhl A., *Inscriptions de Durazzo et de Tirana, në Albania, Cahiers d'archéologie, d'histoire et d'art en Albanie et dans les Balkans*, Année MCMXXXV (5).

Camaj M., (1960). *Il «Messale» di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë.

Cordignano F. S. J., (1934). *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese (Il nuovo Jungg); parte albanese-italiana*, Ulrico Hoepli, Milano.

²⁶ Në të vërtetë, pikërisht dhe përndarja gjeografike e etnokulturore e ndikimeve të tilla dëshmon konglomerimin kulturor që në antikitet përfaqëson një dukuri më vete në shumë pikëpamje.

Çabej E., (1974). *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, në *Studime filologjike*, (2).

Çabej E., (1976). *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, Tiranë.

Çabej E., (2002). *Studime etimologjike në fushë të shqipes VI*, Tiranë.

Çabej E., (2008). *Hyrje në indoeuropianistikë*, Botime Çabej, Tiranë.

Çabej E., (2012). *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Botime Çabej, Tiranë.

Demiraj Sh., (1988). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.

Demiraj Sh., (2013). *Elementet e huaja që shqipja i ka trashëguar nga “nëna” e saj, në Gjuha shqipe dhe historia e saj, (botim i dytë i ripunuar)*, Botime Onufri, Tiranë.

Demiraj B., (2008). *Dictionarium latino-epiroticum(Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër.

Devoto G., (1940). *Storia della lingua di Roma*, Licinio Cappelli editore, Bologna.

Geci, P., (1965). *Frang Bardhi dhe fjalori i tij latin-shqip*, në *Studime filologjike*, (2).

Mansaku S., (1982). *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, në *Studime filologjike*, (3).

Meillet A., (2003). *Lineamenti di storia della lingua greca*, Einaudi editore, Torino.

Mihaescu H., (1966). *Les éléments latins de la langue albanaise*, në *Revue des études sud-est européennes*, IV, 1-2, Bucarest.

Mohrmann Ch., (1965). *Études sur le latin des chrétiens, Tome III, Latin chrétien et liturgique*, Edizioni di storia e letteratura, Roma.

Ölberg H., (1982). *Kontributi i gjuhësisë për çështjen e atdheut ballkanik të shqiptarëve*, në *Studime filologjike* (3).

Omari A., (2016). *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*, Botimet Albanologjike, Tiranë.

Paci E., (2011). *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë.

Paci E., (2017). *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe (studime letrare dhe filologjike)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Paci E., (2019). *Për një vështrim antropologjik dhe gjuhësor të nocioneve themelore të botës romake dhe latine në programet universitare shqiptare*, në *Buletin i Universitetit të Shkodrës*, SSHSH (69).

Paci E., (2019). *Rreth disa veçorive leksikore e frazeologjike në vepra të letërsisë së vjetër shqipe (vështrim analitik dhe retrospektiv)*, në *Studime filologjike*, (1-2).

Paci E., (2020). *Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe*, Botime Françeskane, Shkodër.

Palmer L.R. (2002). *La lingua latina*, Einaudi editore, Torino.

Schlösser R., (2005). *Le lingue romanze*, Il Mulino, Bologna.

Szemerényi O., (1985). *Introduzione alla linguistica indoeuropea*, Edizioni Unicopli, Milano.

Väänänen V., (1971). *Introduzione al latino volgare*, Pàtron, Bologna.

Väänänen V., (1981). *Introduction au latin vulgaire*, Librairie Klincksieck, Paris.

Vineis E., (2005). *Il latino*, Il Mulino, Bologna.

KDU: 821.18.09(05)

811.18 '36(05)

Shpëtim ELEZI

**ARKAIZMA NË SISTEMIN EMËROR TË SHQIPES LETRARE TË
SHEKUJVE XVI-XVIII**

Abstrakt

Punimi trajton tiparet konservatore në sistemin emëror të shqipe letrare të shekujve XVI-XVIII, të pasqyruara në veprat e autorëve të vjetër gegë (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani) dhe toskë (Matrënga). Disa nga këto tipare arkaike, të trashëguara nga faza më të hershme të zhvillimit të shqipes, dalin të ruajtura ende mjaft mirë në këtë fazë të shkrimit shqip, kur, nga ana tjetër, nisin e shfaqen edhe inovacione. Punimi ka për synim përshkrimin e elementeve konservatore tek autorët e vjetër dhe krahasimin e tyre nga njëri autor tek tjetri për të parë kështu shkallën e përdorimit dhe vitalitetin e këtyre arkaizmave në këtë fazë të zhvillimit të shqipes. Në lidhje me vitalitetin e tyre, tipare të caktuara do të vështrohen edhe përmes metodës statistikore për të përcaktuar kështu dendurinë e përdorimit të tyre në këtë fazë të zhvillimit të shqipes. Së fundmi, punimi synon që këto elemente konservatore t'i paraqesë në mënyrë sintetizuese, ashtu siç dëshmojnë në shqipen letrare të shekujve XVI-XVIII dhe, kështu, të pasqyrohet më qartë gjendja e përdorimit të tyre në fazën e hershme të shqipes së shkruar. Në shqipen e shek. 16-18 disa prej tipareve konservatore janë sistemore, kurse disa dalin të ruajtura pjesërisht.

Fjalët çelës: shqipe e teksteve të vjetra XVI-XVII, Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi, Bogdani, sistem emëror, arkaizëm

Abstract

Literary Albanian of the 16th-18th centuries is characterised by conservative features reflected in the works of all Gheg authors (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani) and Tosk authors (Matrënga). These archaic features, inherited from earlier stages of the language development, emerge as quite well-preserved in this stage of Albanian writing, when, on the other hand, innovations that would later increase had started to make their appearance. This paper deals precisely with conservative features of the nominal system of Albanian in the 16th-18th

centuries, represented by these five authors of Albanian writing. The descriptive comparative method highlights the use of these elements in Albanian of the time, whereas the statistical method determines the frequency of their use, which demonstrates the vitality of these archaisms at this stage of development of the Albanian language. In the documented Albanian of the 16th-18th century, some of these conservative features are systemic as they appear regularly, such as, for example, the ending of the definite plural ablative *-shit*, the form of prepositional accusative (like *krypa nd'*) *ujët*, the ending of the genitive and dative without the anti-hiatus *-v-* in plural stems which end in consonants *pleqet* (com. *pleqvet*), and in this last example, the preservation of the definite plural article *-t* (com. *pleqve*), etc. But, there are also archaic features that emerge as partially preserved at this stage of development, such as, for example, the neuter gender (*ballët*), biflection in the noun phrase (*bjeshkëshit së naltash*) etc., that show that their reduction process must have started a long time before the writing stage of Albanian. These archaic features, proven to be completely or partially preserved in literary Albanian in the 16th-18th centuries, get gradually reduced in Albanian of the later centuries, furthermore many of them have now completely disappeared and their traces are found only in some distal or conservative speeches or within idiomatic expressions.

1. Hyrje

Shqipja letrare e shekujve 16-18 karakterizohet nga disa tipare të vjetra që dëshmohen në shqipen e autorëve të vjetër gegë: Buzuku (1555), Budi (1618, 1621), Bardhi (1635) e Bogdani (1685) dhe toskë: Matrënga (1592). Duke qenë se në gjendjen e sotme të shqipes tiparet gramatikore që do të vështrohen në këtë punim nuk kanë përdorim në gjuhën e folur dhe të shkruar, ose përdoren pjesërisht dhe më shumë në formë reliktesh, atëherë nga ky këndvështrim ato marrin statusin e arkaizmave. Këto tipare konservatore, që janë të trashëguara nga faza paraletrare të gjuhës, dalin të ruajtura ende mjaft mirë në këtë fazë të shkrimit shqip, kur, nga ana tjetër, kishte nisur procesi i shfaqjes së inovacioneve, të cilat më pas do të intensifikohen. Por, duke mbetur brenda objektit të hulumtimit, punimi trajton në mënyrë të veçantë arkaizmat në sistemin emëror të shqipes letrare të shekujve 16-18, ashtu siç dalin në veprat e të gjithë autorëve të vjetër të shkrimit shqip. Përmes metodës përshkruese dhe krahasuese vihet në dukje gjendja e përdorimit të këtyre elementeve në shqipen e kohës, kurse përmes metodës statistikore përcaktohet denduria e përdorimit të tyre, e cila na dëshmon lidhur me vitalitetin e këtyre arkaizmave në këtë fazë të zhvillimit të shqipes. Disa prej këtyre tipareve konservatore

në shqipen e dokumentuar të shek. 16-18 janë sistemore, meqë si të tilla dëshmohen rregullisht tek këta autorë, siç janë, p.sh., mbaresa e rrjedhore së shquar shumës *-shit*, forma e vendores (si krypa nd') *ujët*, mbaresa e gjinore dhe e dhanore pa antihiatizuesen *-v-* në temat e shumësit që mbarojnë me bashkëtingëllore *pleq-e-t* (khs. *pleq-ve-t*) dhe, në këtë shembull të fundit, edhe ruajtja e nyjës së shumësit të shquar *-t* (khs. *pleqve*) etj. Por ka edhe tipare arkaike që dalin pjesërisht të ruajtura deri në këtë fazë zhvillimi, siç është, p.sh., gjinia asnjanëse (*ballët*), biflektivizmi në sintagmën emërore (*bjeshkëshit së naltash*) etj., gjë që tregon se procesi i reduktimit të tyre do të ketë nisur qysh përpara fazës shkrimore të shqipes. Këto tipare arkaike, të dëshmua si plotësisht ose pjesërisht të ruajtura në shqipen letrare të shekujve 16-18, në shqipen e shekujve të mëvonshëm vijnë duke u reduktuar gjithnjë e më shumë, madje shumë sosh tashmë janë shuar fare dhe gjurmë të tyre gjejmë vetëm në ndonjë të folme skajore a konservatore ose edhe brenda shprehjeve idiomatike.

2. Arkaizmat në sistemin emëror të shqipes së vjetër

2.1. Gjinia asnjanëse

Gjinia asnjanëse e emrave të parmë të jofrymorëve që tregojnë lëndë të panumërueshme dhe pjesët e trupit të njeriut, në shqipen letrare të shekujve 16-18 paraqitet si element gramatikor pjesërisht i ruajtur, pasi ka edhe lëkundje të asnjanësisë së tyre duke u përdorur edhe si mashkullorë e femërorë. Por, në krahasim me gjendjen e sotme, emrat asnjanës më shqipen e vjetër janë dukshëm më të shumtë dhe më të qëndrueshëm, gjë që tregon se ndjenja gjuhësore e asnjanësit në shekujt 16-18 ka qenë ndjeshëm më e gjallë sesa sot. Ky vitalitet i asnjanësisë vihet re jo vetëm sa u përket asnjanësve të parmë, por edhe asnjanësve jo të parmë prejmbiemërorë e prejppjesorë. Si asnjanës të parmë përdoren disa emra konkretë, që emërtojnë pjesë të trupit (*ballë, bark, gji, krye, sy*) e lëndë (*brumë, drithë, dyllë, voj, ujë*) dhe disa të tjerë që nuk tregojnë lëndë (*djalë, emënë, faj, shekull, shtrat*), numri më i madh i të cilëve në shqipen e sotme dalin në gjininë mashkullore. Lidhur me përcaktimin e numrit dhe me gjallërinë e asnjanësve në shqipen e vjetër, studiuesit (Riza 2002; Çabej 1988; Demiraj 1988, 2002; Topalli 2011; Ashta 1998; Omari 2007; Mulaku 2012 etj.), që e kanë trajtuar këtë temë, jo gjithherë kanë qenë të një mendjeje, sidomos në ato raste kur nuk janë dëshmuar trajtëforma në emëroren e kallëzoren e shquar, ku identifikohet më qartë gjinia asnjanëse.

Nga të gjithë autorët e vjetër, te Buzuku (1555) gjinia asnjanëse del më e gjallë. Tek ai hasen gjithsej 37 asnjanës: *anë-të* (sot *enë-të*, në ndonjë dialekt *an-i*), *bark-të* (ose *barkë-të*), *djalë-të* (edhe si mashkullor *djal-i*), *drithë-të*, *dru-të* (edhe si mashk.), *emën-i-të*, *faj-të*, *frujt-i-*

të (edhe si mashk. *frujt-i*), *grunë-të*, *gji-të*, *gjq-i-të* (edhe si mashk. *gjq-i*), *klomësht-i-të* (= qumështi), *krye-të* (në rasat e zhdrejta të njëjësit edhe *kre-së*), *miell-të*, *mish-të*, *muoj-të*, *penk-të*, *petëk-u-të*, *prehën-i-të*, *sy-të*, *shekull-të* (më fort si mashk. *shekull-i*), *shenj-të* (edhe si mashk. *shenj-i*), *shtrat-të*, *ujë-të*, *varg-të*, *voj-të* (edhe si mashk. *voj-i*), *veshë-të*, *vjetë-të*, *vor-të*. (Demiraj 2002: 110; 1988: 198). Si asnjans të Buzuku duhen interpretuar edhe *ashtë*, *kruo*, *mjaltë*, *rush-të*, *unguent*, *të tym* e ndofta edhe *dhé* dhe *mill* (Demiraj 1988: 198). Çabej (1955, cituar sipas 1988: 57-63), përcakton më parë pothuajse të gjithë këta të Demirajt, përveç këtyre: *grunëtë*, *klomështitë*, *penktë*, *krou*, *mjaltë*, *rushtë*, *të tym*, ndërsa ka përcaktuar edhe 4 asnjans të tjerë, të cilët Demiraj më pas nuk i trajton si të tillë, si: *tamblëthit*, *plehë*, *kopështë*, *rrjetë*.

Shembuj: *djalëtë* tem anshtë *ata* qi ashtë gjall (171). *frujton klomështë e mjaltë* (133). Aj *kā* me ngranë *tëlyenë e mjaltë* (41), E *miellhtë* n gavixhit nukë mëngoi (139), lyej *kryetë tat* (113), Lëvdajnë *emënitë tat* (139). e ajo u përdaj *vojhtë* (155), aj qi shtypën *rushtë* me atë qi mbiell (299), *ata* kujtonin se aj flit për *gjumët* (183), na u bām pors *plehëtë* (351), ju ... mos shkulinjtë edhe *drithëtë* (105), E dëshir kish *barkëtë* e tī me e nginjunë (149), *ujëtë* ish bām venë (101), E ju kthye *mishtë* e tī posi *mishtë* e një djali d vogëlë, e kle shëndoshunë (153), u duo tuk të jetë *fajtë* (387) (shih Mulaku 2012: 185).

Te Matrënga (1592) ndeshen më pak emra të gjinisë asnjansë, gjithsej 3 sish, si: *emër-i-të* (por edhe *emër-i*), *krie-të* (p.sh. *krietë e asaj ishtë*) dhe, ndofta, edhe *ballë* (?) (shih Demiraj 1988: 198; Ashta 1998: 68).

Budi (1618-1621) përdor 18 emra asnjans: *anë-të* (por edhe *an i madh*), *ballë-të*, *bark-të*, *dam-të* (por edhe *dam-i*), *drithë-të*, *dyllë-të*, *emën-i-të*, *faj-të*, *grunë-të*, *frë-të*, *gjq-i-të* (por edhe *gjq-i*), *krye-të* (në rasat e zhdrejta *kre-së*), *mish-të*, *mjaltë-të*, *plehë-të*, *ujë-të*, *vjetë-të* e ndofta edhe *qumështë* [...me *qumështitë* tyne...]. (Demiraj 1988: 198). E. Çabej (1955, cituar sipas 1988: 57-63) përcakton si asnjans edhe këta emra te Budi: *vesh*, *gji*. Ndërsa R. Mulaku (2012: 185) përcakton edhe *gjumë-të* (DC 206) dhe *lesh-të* (DC 274).

Shembuj: ... *ndë gjumëtë* (SC 401), *grunëtë* (DC 206), *ujëtë e dëtit* (SC 54), *Mjaltë* e bletësë (DC 274), nd arbënë shtiu *leshtë* (DC 274), ashtë *fajtë* tem (SC 108), me i paguom gjithë *damtë* (SC 65), me vdierrë *mishtë* (SC 68), *Plehëtë* (SC 47), kūr mblidhet... *dyllëtë e majltëtë*, kur vritenë bletët (SC 92), *grunëtë* (DC 206), me *qumështit* e tyne ushqenenë, e me *lesht* e tyne vishenë (SC 335) etj. (shih Mulaku 2012: 185).


Bardhi (1635) përdor 13 asnjanes: *ballë-të, bark-të, emër-i-të, fre-të, grunë-të, gjyq-i-të, krye-të* (në rasën gjinore e *kre-së*), *mjaltë-të, ujë-të*. Si asnjanes duhen interpretuar tek ai edhe *djathë, dyllë* e ndofta edhe *miell* (Demiraj 1988: 198). Mulaku (2012: 185) përcakton edhe: *plehëtë* (126).

Shembuj: *Kryet e gjatorëve* (1), *Majën plehëtë dhënë* (126), *Me rudhunë ballëtë* (137), *Mjaltëtë shumë herë ban me lëpym gishtatë* (213), *Me lëshuem ujëtë* (132) etj. (shih Mulaku 2012: 185).

Nga 53 emra potencialisht asnjanes që janë analizuar nga Elezi (2018: 49-73), del se Bogdani përdor 17 emra me veçori të gjinisë asnjanesë. Por, duke u bazuar në të dhënat e dendurisë së përdorimit në emëroren e në kallëzoren e shquar dhe sipas përcaktorëve të gjinisë asnjanesë që marrin këta emra, mbi ç'kritere edhe bëhet përcaktimi i këtyre emrave në gjini, del se si asnjanes te Bogdani mund të kundrohen 14 të tillë, 9 prej të cilëve, siç i ka përcaktuar edhe Omari (2007: 267), dëshmohen në thelb vetëm si asnjanes, ose me ndonjë hasje në gjininë mashkullore, si: *anë-të, ballë-të, emën/ë-itë, grunë-të, krue-të, krye-të, kumët/ë-itë, ujë-të, vë-të*, gjë që përcakton edhe lemën e tyre si asnjanesë dhe për 5 emrat e tjerë, si: *bark-të, faj-të, gjyq-i-të, hekur-i-të, mish-të*, duke qenë se dalin në pak raste si asnjanes dhe më shumë si mashkullorë: *bark-u, faj-i, gjyq-i, hekur-i, mish-i*, lema e tyre në konkordancë përcaktohet si mashkullorë. Më tej, 2 emrat e tjerë: *gjī-të, mend-të* edhe ashtu të cilësuar me rezervë si asnjanes, pasi nuk dëshmohen qartë si asnjanes dhe kanë denduri më të madhe përdorimi si mashkullor: *gjī-u* dhe si femëror: *mend-ja*, prandaj dhe lemat e tyre përcaktohen si mashkullorë për të parin dhe si femërore për të dytin. Edhe emri *qiell*, edhe pse del në 4 raste si asnjanes *qiell-të*, kundrohet si femëror *qiell-ja*, për shkak të dendurisë shumë më të madhe të përdorimit të tij në këtë gjini. Ndërsa 5 asnjanesit e vjetër si: *brumë, drithë, dyllë, kjumështë, mjaltë*, që janë me kuptim kolektiv, që emërtojnë lëndë dhe që dalin me temë në-ë të patheksuar, meqë nuk dëshmohen si asnjanes në asnjë rast të emërores e të kallëzores së shquar njëjës e as me ndonjë përcaktor, por, në fakt, as si mashkullorë, siç mendon edhe Omari (2007: 268), mund të rindërtohen si asnjanes me shenjën përkatëse të asteriskut në bazë të dokumentimit të gjerë që kanë përgjithësisht tek autorët e vjetër dhe gjithandej në mbarë shqipen e sotme. Duhet thënë se asnjanesit e tjerë të Buzukut, te Bogdani tashmë dalin të integruar plotësisht ose në gjininë mashkullore, ose në gjininë femërore. Kështu, dëshmohen si mashkullorë 26 sish, si: *asht/ë-i* (por femëror në shumës), *burr/ë-i, dam-i, djal/ë-i, dhé-u, frujt-i, gjī-u, kopësht/ë-i, miell-i, mill-i, muej-i, *peng-u, petëk-u, pleh/ë-u, prehën/ë-i, *rrjet/ë-i, sy-u, shekull/ë-i, shenj-i, shtrat-i, tambl/ë-i, *tim-i, vesh-i, vjet-i, voj-i, vorr-i*. Kanë kaluar në gjininë femërore 3 sish: *drū-ja,*

mend-ja, qiell-ja dhe 5 asnjanes të Buzukut nuk dalin fare te Bogdani, si: *djathë, frë, rush, unguent, varg*.

Shembuj: *anë-të* (1 rast): merr *anëtë* për gjithë qish ka mbrenda (I, 21); *ballë-të* (1 rast): Mbëlonte pakëzë *ballëtë* (II, 7); *emën/ë-itë* (58 raste): Qish kërkon *emënitë* tem (I, 121); *grunë-të* (3 herë): të bahetë *grunëtë* qëruem e të dëlirë prej lamet (II, 65); *krue-të* (3 herë): Hyji naltë i qiellët është *kruet* e kahë bunon e rrjedh të gjallëtë (I, 27); *krye-të* (49 herë): posi *kryet* e vet (I, 24); *kumët/ë-itë* (1 herë): i sillti shatërë shpū *kumëtitë* Davidit të mortës Saulit, tue kujtuem se kish me i bam të falë (I, 102); *ujë-të* (28 herë): *Ujëte* prej së nxitit së diellit holluem bâhetë shī (I, 36); *vā-të* (2 herë): përse Jakobi shkoj *vātë* Jabotit (I, 80); *bark-të* (1 rast): qi këtu të mbushinjë *barktë* e mbë qiellt mendtë (I, 43); *faj-të* (5 herë): për të kjam e anëkuem *fajt* e tyne (I, 49); *gjq-i-të* (1 herë): O Hyj *gjqitë* tat epja Regjit e të dërejtënë tande t’birt Regjit (I, 108); *hekur-i-të* (1 herë): e jo veçë bani gatī landënë, qi është drutë, gurëtë, *hekuritë*, rgjandnë e ārrë (I, 104); *mish-të* (17 herë): Aj qi të hae *mishtë* tem e të pie gjaknë tem ka jetën’e amëshueshime (I, 42) (shih për më shumë Elezi 2018: 49-73).



Siç shihet edhe nga *grafiku 1*, gjithnjë duke pasur parasysh edhe volumin e veprave të autorëve të vjetër, emrat asnjanes nga Buzuku te Bogdani kanë shkuar duke u reduktuar. Për më tepër, edhe ata që dalin si asnjanes, nuk kanë përdorim gjithaq të qëndrueshëm, sepse i njëjti

autor të njëjtin emër e trajton herë si asnjans e herë si mashkullor dhe ndonjë prej tyre herë si asnjans e herë si femëror. Për këtë ambiguitet të këtyre emrave flet edhe Riza, i cili, duke trajtuar këtë problematikë tek autorët e teksteve të vjetra, thotë se “procesi i mënjanimit të asnjansvet të paprejdardhur në të mirë të mashkullorëvet përkatës kishte nisur të zhvillohej qysh në kohën e autorëvet të vjetër, e rrjedhimisht për faktin se qysh atëherë ndjenja gjuhësore për gjininë asnjansë të emrave të paprejdardhur kishte zënë të bëhej e lëkundshme; ndërkaq,... i njëjti autor të njëjtin emër e trajton herë si asnjans herë si mashkullor“ (Riza 2002: 116). Për këtë dëshmon edhe humbja e gjallërisë së asnjansve prejmbiemërorë e prejfoljorë të paranyjëzuar, proces që është thelluar nga Buzuku te Bogdani si rezultat i zëvendësimit të tyre me emra të formuar me prejardhje sintetike me anë të prapashtesave *-i*, *-(ë)ni/- (ë)ri*, *-(ë)si*, *-im* dhe *-je*.

2.2. Emra mashkullorë më -ë

Në shqipen e teksteve të vjetra është një tip i veçantë i emrave të gjinisë mashkullore, që në trajtën e pashquar të emërores e të kallëzores dalin rregullisht me *-ë* të patheksuar fundore, si: *popullë, tamblë, hekurë, mjeshtërë, vjehërrë, gjarpënë* etj. Këta emra në trajtën e shquar e bjerrin *ë*-në fundore, kur marrin njëjën *-i*, si: *populli, tambli, hekuri, mjeshtri, vjehërri, gjarpëni* etj. Ngjashëm me këta dalin edhe disa emra të gjinisë femërore, si: *niegullë, ufullë / uthullë, vetullë; bukëlë, gogëlë; egjërë, letërë, lundërë, thupërë, vepërë, zemërë; andërrë; dhelpënë, femënë* etj., të cilën e bjerrin kur marrin njëjën *-a*, si: *niegulla, bukëla, letëra, andërëra, femëna* etj. Numrin më të madh të tyre e përbëjnë emrat e gjinisë mashkullore, kurse ata të gjinisë femërore janë më pak. Siç mund të vihet re nga këta shembuj, në aspektin fonetik veçori e këtyre emrave është se *ë*-ja fundore paraqitet kur para saj këta emra kanë sonantet *ll, l, r, rr, n*.

Tipi	Mashkullorë
-llë (16 emra)	<i>akullë, apostullë, avullë, diellë, dishipullë, engjëllë, grumbullë, idhullë, kungullë, kushullë “konsull”, mashkullë, mërekullë / mrekkullë / mbrekullë, popullë, qefullë, shekullë, shkandullë</i>
-lë (1 emër)	<i>tamblë</i>

-rë (8 emra)	<i>agërë “gomar”, flamburë, hekurë, kandërë, lepurë, librë (edhe libër), mjeshtërë (edhe mjeshtër' dhe, më shpesh, mjeshtër), Pjetërë (më shpesh Pjetër)</i>
-rrë (2 emra)	<i>dhandërrë / dhandërë, vjehërrë</i>
-në (14 emra)	<i>arbënë / arbën', breshënë, dimënë, djemënë “djall”, drapënë, emënë, gjarpënë, këllogjënë, krahënë, pjepënë, pluhunë / pluhënë, prehënë, Shtjefënë, urdhënë</i>

Tabela 1. *Emrat mashkullorë më -ë në shqipen e vjetër.*

Siç shihet edhe nga *tabela 1*, në përgjithësi në tekstet e autorëve të vjetër janë evidentuar gjithsej 41 emra të tillë të gjinisë mashkullore.

Kjo veçori që karakterizon këtë tip emrash mashkullorë e femërorë vihet re se është një lloj prirjeje me karakter sistemor që shfaqet në tërë sistemin emëror, duke prekur kështu edhe klasat e tjera të fjalëve, në të cilat fjalët përkatëse me këto sonante dalin me -ë fundore. P.sh., kjo shfaqet edhe te mbiemrat e tipit: *i amblë, i bukurë, i egrë, i mitunë, i mjerë, i verbënë, i vjetërë, i vogëlë* etj., ose edhe kur këta mbiemra dalin në përdorim ndajfoljor: *amblë, bukurë* etj. dhe në përdorime si pjesëza: *mjerë*, si dhe në klasën e përemrave, siç është rasti me përemrin e pacaktuar *tjetërë*, si: me krijuem nukë do me thanë një kafsheje me bam një *tjetërë* (CP I, 19), megjithëse forma pa -ë te ky autor ka denduri dukshëm më të madhe, si: Se një *tjetër* dielli, / Po del neve prej Perasti (Të primitë XXIV).

Këtij tipi emrash të gjinisë mashkullore një trajtim të hollësishëm në shqipen në përgjithësi dhe në tekstet e vjetra në veçanti i ka bërë Topalli (2009: 106-124). Sipas tij, në shqipen e vjetër dokumentohen 36 emra të tillë, prej të cilëve në shqipen e sotme kanë ruajtur këtë veçori vetëm 7 syresh. Topalli i trajton këta emra duke i paraqitur sipas një rendi alfabetik me gjithë të dhënat për prejardhjen e tyre, mënyrën e formimit dhe dokumentimin e tyre në shkrimet e autorëve të vjetër (shih dhe Omari 2010: 235-240).

Duke lënë mënjatë ata që burimisht kanë qenë asnjatës, si: *djathë, brumë, ujë, ballë, mjaltë, dyllë, drithë* etj., sipas Topallit (2009: 106-110), numri i emrave mashkullorë me fundoren -ë në shqipen e sotme është mjaft i kufizuar, duke u ruajtur sot vetëm 7 të tillë, si: *atë, burrë, djalë, gjumë, lamë / lëmë, lumë, kalë*. Por, sipas tij, “në një periudhë më të hershme të gjuhës, që mund të rrokët edhe me anë të shkrimeve të vjetra, numri i tyre ka qenë shumë më i madh, pasi në këtë grup bënin pjesë edhe emra të tjerë me ritëm daktilik, që në shqipen e

sotme, me rënien e zanores fundore -ë, kanë përfunduar në emra me temë trokaike (Topalli 2009: 110).

Ky reduktim i formës së tyre vihet re qysh në shqipen e vjetër, sidomos te Bogdani, tek i cili vihen re edhe forma të reja pa fundoren -ë, që kanë dalë me lëvizjen e sonantes, siç është rasti me emrin *mjeshtëre* (1 rast): prashtu iknë, e lanë të zotnë e tyne e *mjeshtëre* (II, 100) dhe *mjeshtër'* (1 rast): Apostujitë tue pam Jezu Krishnë, të dashuninë *mjeshtër'* e tyne zanunë (II, 100), del fare pa -ë fundore (në 6 raste) *mjeshtër*, si: e për të parët plak rabi o *mjeshtër* xhudhi âshtë rabini Haj Gaon (I, 17). Kjo vërehet edhe tek emri *Pjetërë*, i cili del në 4 raste me format *Pjetërë* / *Pjetrë* dhe në 11 raste me formën *Pjetër*. Po ashtu e hasim edhe tek emri *diell*, i cili ndonëse nuk del në trajtë të pashquar të rasave emërore e kallëzore si emër mashkullor për trup qiellor, në 3 raste si emër në femërore për ditën e javës shfaqet pa -ë fundore *diell*: ani Krishti shëkroj ndë të parët të *diell* të kreshëmëvet (I, 61). Edhe tek emrat femërorë vihen re raste të përdorimit të tyre pa fundoren -ë, si: *mjekër* (2 raste), *mitër* etj. Edhe te përemri *tjetërë*, megjithatë, forma pa -ë e tij ka denduri dukshëm më të madhe, duke dalë në 117 raste: Se një *tjetër* dielli, / Po del neve prej Perasti (Të primitë XXIV). Ky është një tregues se lëkundja e përdorimit të kësaj rregulle shfaqet qysh te Bogdani dhe intensifikohet në fazat e mëvonshme për t'u rrudhur në gjendjen e sotme në një grup emrash prej 7 sish: *atë*, *burrë*, *djalë*, *gjumë*, *lamë* / *lëmë*, *lumë*, *kalë*.

2.3. Emra mashkullorë që sot përdoren si femërorë

Disa emra që në shqipen e sotme kanë veçori gramatikore të emrave femërorë, në tekstet e vjetra përdoren si emra të gjinisë mashkullore (khs. shq. e sotme: *dëshirë* – *dëshira*; shqipe e vjetër: *dëshir* – *dëshiri*). Këta emra në trajtën e pashquar të emërores njëjës dalin në temë me bashkëtingëllore, kurse në të shquarën marrin mbaresën -i (khs. *kshilli*, *shenji*). Emra të tillë të evidentuar përgjithësisht në tekstet e vjetra janë: *dëshir* – *dëshiri*, *kshill* – *kshilli*, *cmir* – *cmiri*, *sakrifç* – *sakrifçi*, *shenj* – *shenji*, *kështjell* – *kështjelli*, *balen* – *baleni*, *komet* – *kometi*, *Vener* – *Veneri* etj. P.sh.

Buzuku: Nd ato dit ish sëmune një qi e kluonjinë Laxaro n Betaniet në *kështjELIT* së Mërisë (181). E ajo vepëroi porsi ish *dëshiri* duoret saj (335).

Budi: Kujdesi e *dëshiri* i zemërësë sime (SC Parathënia).

Bogdani: Përditë rritetë *dëshiri* e nevoja e tyne (II, 30), Ndë mos u kthefshi kësi *dëshiri* me kjanë të parë (II, 74), Për t u përgjegjunë këtë *kshilli* tyne (II, 81), Së vërtetejet bîn *cmiri*, i *silli* zu vend ndë zemër (II, 63), âshtë *shenji* i *kthielltë* e i

motit mirë (I, 37), o vejinë prej *njij kështjeli*, qi thojnë Emaus (II, 133), e nukë ka tjetër yll mbī atë *të Venerit* (I, 25) etj.

2.4. Emra femërorë që sot përdoren si mashkullorë

Nga ana tjetër, disa emra që sot janë të gjinisë mashkullore, në shqipen e vjetër përdoren në gjininë femërore. Përgjithësisht në tekstet e vjetra dëshmohen diku 30 emra të tillë, si: *djep – djepja, end – endja, et – etja, grigj – grigjja, gjeth – gjethja, gjind – gjindja, kryq – kryqa / kryqja / krygjja, kurt – kurtja* “oborr”, *Lesh – Lezhja, ligj – ligja / ligjja / ligjeja, mend – mendja, mishërier – mishërirja, mner – mnerja, mort – mortja / mordja, ndër – nderja, paq – paqja, par – parja* “çift”, *prind – prindja, pushtet – pushtetja, pyll – pyllja, qerr – qerrja, qiell – qiellja, qytet / gjytet – qytetja / gjytetja, shëndet – shëndetja, Shkup – Shkupja, short – shortja / shordja* (por edhe *shorti*), *tmer – tmerja, turp – turpja, vërtet – vërtetja, vollundet / vollëndet – vollundetja / vollëndetja*.

Ky grup emrash me bashkëtingëllore tematike përbëjnë një tip të veçantë femërorësh në kuadër të paradigms së lakimit të tretë në shqipen letrare të shekujve 16-18. (Për veçoritë lakimore të tyre dhe gramatikore në përgjithësi, shih Riza 2002: 116-119; Topalli 2011: 318-352; Elezi 2012: 223-240; Elezi 2018). Këta emra që në të pashquarën mbarojnë në temë me bashkëtingëllore, në të shquarën marrin një shquese *-ja* ose, më rrallë, *-a*. Përgjithësisht, karakteri femëror i këtyre emrave vihet re nga nyja *-ja* që e marrin në të shquarën e emërores dhe nga mbaresa *-së* që e marrin në gjinore-dhanore-rrjedhoren e shquar, si dhe në të pashquarën nga mbresa rasore *-je* që e marrin në format e rasave të zhdrejta të gjinore, të dhanore e të rrjedhore njëjës. Por gjinia e tyre dallohet edhe nga përshtatja me përcaktorë të gjinisë femërore. Këtij tipi femërorësh i përkasin emra të trashëguar, huazime të vjetra dhe ndonjë emër i përveçëm topik, si *Lesh – Lezhja* dhe *Shkup – Shkupja*. Kjo paradigmë emrash femërorë, që dëshmohet e gjallë në shqipen e vjetër, në gjendjen e sotme përgjithësisht ka dalë nga përdorimi. Gjurmë të saj gjejmë te pak prej këtyre emrave që e ruajnë edhe sot gjininë femërore kryesisht në të folme të caktuara të gegërishtes veriore, si *nera, mortja* etj.

Buzuku: e *endja* e ranzësë tī kā me ʘ ritunë (15), aj kurajtë mos të ketë *et* (53), dhentë e *grigjsë* të përdahenë (84), me atë *gjind* e madhe (84), shenjtë e *Kryqsë* (23), djerie tek *kurtja* e t parit priftënet (84), Se në ish klenë dhanë *ligja* qi të mundë ngjallën, gjyqitë e *ligjsë* të klenëke të vërtetë (97), as *mordja* atë mā nukë kā me e zotënuom (283), fort i muor *mnerja* (211), e Zotynë i karitatit e i *paqsë* të jetë me jū (100), Zytynë ordhënoi me u bām *parja* e bekuome (26), e *pyllja* të

lëshonjë ente porsi drandofillja (32), E ordhënoi të qëndron *qerja...* e u afëruo *asaj qerr* (247), përmbij të ish *qytetja* e tyne (155), i erdhi *shordja* ndë priftënit (327), *të vërtytsë* (2/207), *vollundetja* (135) etj.

Matrënga: Lumtë ata që kanë ú e *et* (42v), Lumtë ata që psonjënë të përzëna për *ligjt* (42v), të tretënë ditë u anastis *mortjet* (16v), që prepsnjënë mbë *ndert* të tinëzot (31v) etj.

Budi: qi banetë të diellë e *endet* (RR 217), posikūr bariu *grigjnë* përpara veti me j ruojtunë (RR 331), posikūr bari e *gjethja* ndë pranëvëret (SC 392), sikundrëse gjithë popullit e *gjindsë* tjetërë (RR 330), mbasi të banjë të thellë reverencie *kryqsë* (RR 167), dom Simonë Ngjeqi prej *Leshe* (SC 6), mbajtunë *anso pushtetje* (SC 125), *Mortja* e të vjerrëtë e shpirtit (SC 79), lavdi e *nderja* (SC 377), *qellja* (DC 39), *Qytetja* gjithë rrëzuom (DC 267), *ajo shëndet* (DC 91), e shtata ashtë frika e *tmërja* (DC 377), aso *turpje*, e mbarreje (SC 17), *vullëndetja* e gruosë (SC 85) etj.

Bardhi: *djepja* (17), *E keqe mōrtja ashtë* (31), *Gjethja* e lārit (46), *gjytetja* (222), *mishërier* (180), *mner* (173), *m pyllje* (169), *mōrtja* (61), *ndërja* (31), Të jam falë *ndërsë* (222), *pushtetja* (103), *qiellja* (37), *Qytetja e rē* (197), *shëndetja* (140), *Shkupja* (198), *vertytja* (184) etj.

Bogdani: lëkura e *gjethja* t'atī lisi shëndoshkeshinë gjithë sëmunjënie (II, 31), Ujënat' e shuma *gjindja* shumë (I, 58), *t'asaj gjytet*, e *cila* kje emënuem Babilonia (I, 51), *gjytetja e vogëlë* (II, 21), ani *kryqa* duel *ngushëllore* (II, 142), nierëz aqa t'urtë sa me të hollët të *mendsë* vet (I, 5), *mortja eme* (II, 122), *Ndërë* (=ndërnë) *teme* nukë kam me ja dhanë kuj (I, 94), *Pushtetja e fortë* qi i kje dhanë prej Krishtit (II, 172), Parë se *qiellja*, dheu, deti e zjarmi (I, 20), krijoj Hyji *qiellnë* e dhenë (I, 16), Zotynë drita eme e *shëndetja eme* (I, 97), të bij *shortja* mbë tâ (II, 111), Depërto me gozhdë~të *tmersë sate* mishtë tem (II, 150), Zot ndë *vërtyt tande* ka me u gëzuem Regji (I, 105), me të *madhe vullëndet* të xhudhijet (II, 111), Ani prej Alesandrit VII bam argjupeshkëpi i *Shkupsë* (II, 178) etj.

K. i Arbënit: *ndereja* (32), mbë vend të pa droe të *pyllësë* (14), *pushtetja* me dhanë ndëjesëtë (20), *shëndetja* (10), afrohi ke na me *një vullundete* (12) etj.

2.5. Emra femërorë që në njëjësin e shquar të emërores e ruajnë fundoren -e

Në shqipen e dokumentuar emrat femërorë që dalin në temë me zanoren -e të patheksuar, si: *faqe, rreze, lule, megje, valle, shoqe, drandofille; dije; e lume, e keqe, shêjte* etj., në njëjësin e shquar të emërores e ruajnë fundoren e patheksuar *e* kur marrin mbaresën -ja, p.sh.: *faqeja, luleja, dijeja, droeja, deleja, drandofilleja, shërbetoreja, rajeja, shoqeja, e lumeja, e vërteteja, shêjteja* etj. Emri *hie* në trajtën e shquar krahas trajtës *hie-ja* del edhe me trajtën *hije-ja*. Në këto raste nyja -a është ndodhur në kushte të hiatit, për çka bashkëtingëllorja -j- ka luajtur rol antihiatizues. Sot këta emra e bjerrin fundoren -e të patheksuar në trajtën e shquar (*lulja, dija*).

2.6. Mbaresa e gjinore dhe e dhanore shumës

Në shqipen e vjetër, në paradigmen e numrit shumës, gjinorja dhe dhanorja e pashquar dalin me dy variante të mbaresës:

- alternantin primar **-e**, si rregull, e marrin emrat me temë në bashkëtingëllore: Gj. *t'qiell-e* dhe Dh. *bij-e* dhe
- alternantin sekondar **-ve** (v-ja është shtuar kundër hiatit), si rregull, e marrin ata emra që mbarojnë me zanore: Gj. *i krena-ve* dhe Dh. *ffalë-ve*.

Si rrjedhojë, edhe në gjinoren dhe dhanoren e shquar shumës mbaresa shfaqet me dy variante:

- variantin e vjetër **-et** e marrin, si rregull, emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore: Gj. *i engjij-et* dhe Dh. *zogj-et* dhe
- alternantin **-vet** e marrin rregullisht ata që mbarojnë me zanore: Gj. *e gjuhë-vet* dhe Dh. *kafshë-vet*.

Në rastin e paradigmës së shquar shumës vihet re edhe ruajtja e nyjës së shumësit të shquar **-t**, e cila në gjendjen e sotme ka përdorim reliktor. Khs.

	<u>sotme</u>	<u>shqipe e vjetër</u>	<u>shqipe e</u>
tipi I	zogj-e-t		zogj-v-e
.. ..		-	

Kështu, emrat në këtë aspekt ndahen në dy tipa:

Tipi I. Emrat në temë me bashkëtingëllore që marrin mbaresën **-e** në paradigmen e pashquar dhe **-et** në paradigmen e shquar. P.sh.

pashq. *anëmiq-e, atën-e, barij-e, bij-e, brij-e, desh-e, djelm-e, duer-e, dyer-e, gjykatës-e, jevrej-e, kofinj-e, kual-e, lot-e, miq-e, muej-e, njerëz-e, pleq-e, priftën-e, ujq-e, yj-e* etj.

shq. *anëmiq-et, atën-et, barij-et, bij-et, brij-et, desh-et, dishepuj-et, djelm-et, duer-et, dyer-et, gjykatës-et, jevrej-et, kacadrêj-et, kofinj-et, kual-et, lot-et, luanj-et, miq-et, muej-et, njerëz-et, pleq-et, priftën-et, qiell-et, ujq-et, yj-et* etj.

Tipi II. Emrat që dalin me zanore tematike dhe që marrin mbaresën rasore **-ve** në paradigmen e pashquar dhe **-vet** në paradigmen e shquar. P.sh.

pashq. *avulla-ve, bija-ve, bukë-ve, burgje-ve, çardaqe-ve, dimëni-ve, ërë-ve, femëna-ve, fëtigë-ve, fusha-ve, grā-ve kohë-ve, konopë-ve, krimba-ve, kroena-ve, leqe-ve, lëqenja-ve, lymëna-ve, mpkate-ve, patriarkë-ve, pësime-ve, qe-ve, rrenëca-ve, sy-ve, tregëti-ve, ujëna-ve, vëllazënë-ve, vise-ve* etj.

shq. *avulla-vet, bija-vet, bukë-vet, burgje-vet, çardaqe-vet, dimëni-vet, ërë-vet, eshtra-vet, femëna-vet, fëtigë-vet, fusha-vet, grā-vet, gjahtarë-vet, kohë-vet, konopë-vet, krimba-vet, kroena-vet, leqe-vet, lëqenja-vet, lymëna-vet, mpkate-vet, patriarkë-vet, pësime-vet, qe-vet, rrenëca-vet, sy-vet, tregëti-vet, ujëna-vet, vëllazënë-vet, vise-vet* etj.

Alternanti sekondar **-ve**, që, siç u tha më lart, është krijuar në kushte të caktuara fonetike, me kohën në ndërgjegjen gjuhësore të përdoruesve është interpretuar si formant i veçantë mbaresor bashkë me antihiatizuesen **-v-**, duke dalë kështu edhe në rastet kur temat e shumësit mbarojnë me bashkëtingëllore. Gjurmë të këtij përdorimi gjejmë qysh te Bogdani. P.sh.: qish janë këto plagë ndë mjedis të *duer-vet* tuave (II, 149), ta venë përmbi të dÿ pragjet e *dyer-vet* (I, 65) etj. (shih dhe Demiraj 2015; Elezi 2011: 147-165; Elezi 2018). Sipas Elezit, ky përdorim në tekstin e Bogdanit është një inovacion i gegërishtes së asaj periudhe (mesi i shek. XVII) dhe si shfaqje anticipuese do të intensifikohet në tekstet e mëvonshme pasbogdaniiane për të shkuar drejt zhdukjes së plotë të alternantit **-e** në dobi të alternantit **-ve** në shqipen e sotme (Elezi 2018: 134). Edhe sipas Demirajt, në gjendjen e sotme varianti i vjetër **-e** ka marrë një karakter arkaik dhe si i tillë ruhet vetëm në disa toponime (p.sh. *Shteku i dhenet*,

Rrasa e Çobanet etj. në Shqipërinë Veriore) dhe në disa të folme kryesisht të Shqipërisë Jugore (Demiraj 2015: 49-50).

2.7. Kallëzorja e painovuar me mbaresën e vjetër *-në*

Në shqipen e teksteve të vjetra, emrat mashkullorë e femërorë kallëzoren e shquar njëjës e formojnë përgjithësisht duke marrë drejtpërdrejt mbaresën e vjetër rasore *-në*, si emrat që tematikisht mbarojnë me zanore të theksuar a të patheksuar, ashtu edhe emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore. P.sh.: *amë-në, atë-në, drekë-në, Evë-në, gruo-në, gluhë-në, Kishë-në, landë-në, vajzë-në; kā-në, trā-në, vēllā-në, zā-në, dhē-në, frē-në, pē-në, Mesi-në, nierī-në, shī-në, urtī-në, drū-në* etj.; *Abel-në, dash-në, djep-në, gjeth-në, gjind-në, gjytet-në, kryj-në (<kryq-në), shoj-në (<shoq-në), lij-në (<ligj-në), rej-në (<regj-në), mal-në, mort-në, Pompej-në, pus-në, qiell-në, gjytet-në, rreth-në, shëndet-në shtat-në, trim-në, thes-në, vullëndet-në, të zot-në; ark-në (<harkun), breg-në, burg-në, gjak-në, fik-në, mik-në, shok-në, ulk-në* etj.

Përveçse në shqipen e teksteve të vjetra, mbaresa e vjetër *-në* ruhet edhe në të folmet skajore të shqipes, që dëshmojnë si më konservatore, siç janë të folmet arbëreshe të Greqisë e të Italisë dhe e folmja shqipe e Ukrainës, por edhe në të folmen e Çamërisë (shih Haxhihasani 1971: 169). Bie fjala, sipas Morozovës, në sistemin rasor të së folmes së Ukrainës ruhen disa trajta arkaike, siç është mbaresa e lashtë *-në* e rasës kallëzore: *djal-në, motër-në, vlla-në, narî-në* ‘njeriun’, *gru-në* ‘gruan’, *vajna-në* ‘luftën’, *shkoll-në* ‘shkollën’ etj. (Morozova 2011: 381-393).

Por, megjithëkëtë, duhet shtuar se qysh në këtë fazë të shqipes ka raste kur del edhe kallëzorja e inovuar me mbaresën *-inë* dhe *-unë* për emrat e gjinisë mashkullore: *shekullinë, emëninë; peshkunë, petëkun* etj. Siç vëren Riza (2002: 84), kjo ndodh përgjithësisht në situata fonetike të caktuara, e pikërisht:

a) kur emri mashkullor del me një grup konsonantik, si: Merreni *Shpirtinë* Shint (CP II, 136), *shpīrtin’* e hirit e të lutunavet..., përse përzienë me venë mirreje *helmthinë* (CP II, 117), me punuëm *vēshtin...* me nxjerr *frujtinë* (CP II, 88), ende krijoj Zotynë *Firmamentinë...*, për të bām *peshkunë* e zojtë (CP I, 24), Ezdra përtëriu *Biblīnë* (CP I, 181) etj., si dhe

b) kur emri mashkullor theksohet në rrokjen (tej)parafundore: *shekullinë* (CP I, 181), pā *engjëllinë* (CP I, 104), këtu panë *gjarpëninë* (CP II, 118), përpara tī bani profeta *petëkun* e vet dymbëdhjetë pjesësh (CP I, 113) etj.

Megjithëkëtë, në tekstet e vjetra mbaresa e vjetër *-në* del të jetë mbizotëruese karshi mbaresës së re *-inë*, përkatësisht *-unë*. Bazuar në pikëpamjen e Rizës (2002: 87, 133), ky

shndërrim sporadik i formantit të vjetër *-në* në formantin e ri *-inë* (*-unë*) përbën një fenomen thjesht fonetik të një natyre pikërisht anaptiktike.

2.8. Mbaresa e vjetër *-shit* e rrjedhore së shquar

Në shqipen e teksteve të vjetra rrjedhorja e shquar njëjës e shumës ka një ekzistencë aq të plotë dhe një funksionim aq të pakufizuar sa edhe ekzistenca e funksionimi i katër rasave të tjera më të përdorshme nga autorët e vjetër. Duke folur për përdorimin ose jo të rrjedhore në tekstet e vjetra, Riza për dallim nga disa studiues të tjerë të shqipes e pranon me të drejtë ekzistencën e rrjedhore si një rasë me përdorim të plotë nga çdo anë, e pikërisht si nga ana e aspektit të pashquar dhe të shquar, ashtu nga ana e numrit shumës dhe njëjës. (Riza 2002: 149).

Sa i përket rrjedhore së shquar shumës, veçori e saj është se ajo në shkrimet e hershme dëshmohet rregullisht me formantin e vjetër mbaresor *-shit*: se Dielli e hana o ndonjë *yjshit* së qiellit (SC 215), tue u rrëzuem *bjeshkëshit* së naltash (CP I, 5), aj qi nxjerr ërëtë *prej visareshit* së vet..., ngrihenë nalt avulli ujënash, bërrakash e *viseshit* së njomash (CP I, 37), mshikëza *zorreshit* së vet si e ban veti vorrë (CP I, 2), me reshunë zjarrë *n'qiellshit* (CP II, 75) etj.

Në të vërtetë, këto forma rasore të rrjedhore së shquar shumës janë të ndërtuara nga format rasore korresponduese të rrjedhore së pashquar, të cilave u është shtuar forma nyjore *-t* dhe tingulli anaptiktik *-i-*, që është futur për lehtësim shqiptimi midis mbaresës rasore *-sh* dhe formës nyjore *-t*. Kjo rrjedhore e numrit shumës me formantin *-shit* mungon plotësisht në shqipen e sotme, madje ajo ka afro dy shekuj që është zhdukur plotësisht në të mirë të dhanores përkatëse me mbaresën *-ve*. (Khs. *vise-shit* – *vise-ve*).

Sa i përket rrjedhore së shquar, një veçori arkaike haset edhe në paradigmën e njëjësit, ku rrjedhorja e shquar e emrave femërorë të lakimit të tretë, në vend se me mbaresën femërore *-së*. dëshmohet me formantin mbaresor mashkullor *-t* (khs. m. *biri-t*, *populli-t*, *barku-t*, *dheut*), i cili i ngjitet mekanikisht trajtës së pashquar të kësaj rase në numrin njëjës, si: *mortje-t*, *dore-t*, *Rome-t*, *frike-t*, *shtëpije-t*, *lumeje-t*, *vollëndetje-t* etj. Sipas Bokshit, pikërisht se në burim kjo nyjë e kishte efektin e shquarsisë, në format e rrjedhore: prej fejet, prej lisit, prej lisashit etj. është një nyjë e aglutinuar mekanikisht, d.m.th. pa efekt konkretizimi (Bokshi 2010: 134). Por kjo mbaresë e përdorur në tekstet e vjetra është mënjanuar në shqipen e sotme nga mbaresa *-së* (*shtëpisë*, *mërisë*) (për formantin *-t*, shih Demiraj 2015: 60-62).

2.9. Vendorja e shquar (ntreti si krypa) **nd' ujët**

Në shqipen e teksteve të vjetra vendorja dëshmohet si formë e veçantë rasore, e cila shënohet rregullisht nga mbaresa **-t** dhe paraprihet detyrimisht nga një parafjalë në gjithë paradigmen e saj, si, p. sh., nga parafjalët: **mbë**: *mbë barkët, mbë dhët, mbë kruot, mbë kryjt, mbë malt, mbë qiellt, mbë vort, mbë pëndesët*; **mbí**: *mbí qiellt, mbí ajrit*; **me**: *me dijet*; **ndë**: *ndë anët, ndë barkt, ndë fjalët, ndë gjumët, ndë hiet, ndë klishët, ndë mjedist, ndë punët, ndë shëjtet, ndë terrt, nd' ujët*; **ndënë**: *ndënë zât*; **ndër**: *ndër anëmiyt, ndër djelmt, ndër njanët, ndër mjedist*; **ndëpër**: *ndëpër Shkupt, ndëpër Kosovët*; **pa**: *pā peshkut, pa mpkatit*; **për**: *për barīt, për gojët, për jetët, për kujdest, për mjedist*; **përmbí**: *përmbí dhët*.

Këtë rasë e njeh vetëm paradigma e lakimit të shquar të emrave më shumë në numrin njëjës dhe më pak në numrin shumës, por jo edhe ajo e lakimit të pashquar dhe as paradigma e lakimit përemëror. Ekzistencën e vendores në shqipen e teksteve të vjetra e dëshmojnë këta tregues gramatikorë:

- prania e formës nyjore-mbaresore **-t** (jo **-të**) tek emrat pa dallim gjinie e numri, që është treguesi kryesor morfologjik i kësaj rase,
- prania e rregullt e parafjalëve *mbë, mbí, me, ndë, ndënë, ndëpër, ndër, pa, për* dhe
- prania e nyjës së përparme **të** (jo **e** e kallëzores së shquar) të mbiemrit apo emrit në gjinore pa dallim gjinie e numri.

Vendorja në shqipen e teksteve të vjetra ka përdorim të plotë e të pakufizuar, duke u dëshmuar dendur tek të gjithë autorët e kësaj periudhe. P.sh.:

Buzuku: E vote Jezu *mbë malt* të ulla jet (167), ajo duo j me votë *mbë vort* (183), E hipi *mbë barkët* (119), E qish ti të nli dh njësh këtu *mbë dhët*, të jetë nli dhunë edhe *mbë qiellt* (183), U në mos pasha *mbë duort* të tī vendnë e gozhdëvet (93); e gjetnë *ndë klishët* (99), ajo tue nfjetunë e mbyti *ndë gjumët* (171), u dogj *ndë gropët* (357), U vu *ndë vort* të tī (211), a mundë hinjë *ndë barkt* të samësë kah duol (327), a mundë hinjë *ndë barkt* të samësë kah duol (327); përse t i nvrit *ndër malt* (161); shpata të mos shkonjë *ndëpër dhët* (273); e përmbi *prakt* të derësë ((71) etj.

Matrënga: nani e *nd' orët* të mortsë sanë (21), *ndë ballët, ndë barkut, ndë krahët* të djathëtë (9); *me shpirtit* (26); *për mkatët të tire* (18) etj.

- Budi: ndjerë *mbë rryptë* (SC 394), Mpkati i tyne *mbë dhët* (DC 214), me u afruom *mbë zakont* (SC 169), ta pritë anëmiknë e vet *mbë derët* (SC 229), erdh *mbë shekullit* (SC 190), *Mbë qiellt* përpara muo (DC 214); *ndë gjaktë* (SC 62), *ndë zemëret* (SC 398), e si zogzitë *ndë pyllt* (DC 285), vete *ndë grykët* ukut (SC 390), me qitunë *ndë plehët* (SC 121), *ndë faqet* tue e pshtym (DC 239); ata aty *ndënë rrasët* dergjenë vdekunë (SC 262) etj.
- Bardhi: qi ashtë *mbë Qelltë* (218), *mbë gjuhët* t' arbëreshe (Parathënie), me thām *mbë diellët* (152); Peshku mā parë qelbetë *ndë kryet* (210), Kush dhiet *ndë Dët*, e gjān *ndë krypët* (211), vend i kthjellët *ndë rët* (165); *ndënë doret* të tinëzot (161) etj.
- Bogdani: po hipinj ke Ati em *mbë qiellt* (II, 133), hipi *mbë barkët* (II, 55), ka me u begenisunë ende *mbë qiellt...* ka me kjanë lidhunë ende *mbë qiellt* (II, 75), e shoqejat tue pām ndenjune *mbë derët* (II, 49), qi leu ndë grasht e dviq *mbë kryjt* (Të primitë XVII), vote *mbë malt* (II, 14); Ujënate gjithë qi *mbi qiellt* janë (I, 24), e disa *mbi ajrit* i kthej ndë zjarm (I, 24); giuha jonë qi *me dijet* dvuer edhe fjalëtë (Të primitë XVII); kur e pa *ndë shkretët* (I, 65), urdhënoj *ndë Esodit* përsipëri (I, 65), *ndë shëjtet* meshë (I, 65), *ndë terrt* e *ndë hiet* të mōrtsë rrëzue (I, 122), t'i vejnë *ndë Galilet* (II, 133), ntreti si krypa *nd'ujët...*, nuk' e kē ndjerë *nd anët* (Të primitë XVI), *ndë hambart* (II, 65); *ndënë zāt* të djallit (I, 3); *ndër mjedist* tyne (II, 33); *ndër anëmi* tanë ashtë ma i fështiri (II, 49), qi të xgidh *ndër gjithë djelmt* (I, 129); *ndëpër Shkupt* e *ndëpër Kosovët* (II, 12); *pā peshkut* qi i bijnë prej dēti (I, 112), *pa mpkatit* së lem (II, 2); e kanë me u zanë e me u vram, *për urdhënit'* Antikrishtit (II, 157); me një dritë të kuqe *për mjedist* (II, 161), Feja duhetë, e jo të ndërdu *për kujdest*, qi ka Zotynë mbi ne (II, kallëzori F); të lidhëni *përmbi dhët* (II, 75); (*ndë*) *Hast*, *ndë fjalët*, *ndë punët* të teologjisë, *ndëpër punët* të ushtërisë, *me dijet*, *mbë dyert* të huej, *për të lutunat* të fort ndriçimit (Të primitë XIV-XVIII) etj.

Mirëpo vendoren e shquar mund të zëvendësojë një rasë tjetër, e pikërisht rasa kallëzore, e cila, siç dihet, këtë rasë do ta mënjanojë gjithandej nga mbarë shqipja e sotme (Riza 2002: 56). Ndonëse sjell shembuj përveçse nga autorët e vjetër (Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi, Bogdani), edhe nga të folme dialektore e nga arbërishtja e Italisë, por edhe nga shqipja e shkruar e shek. XIX dhe XX (N. Frashëri, A. Xhuvani, T. Dizdari), që provojnë se kjo rasë është përdorur deri vonë, edhe Topalli thotë se në shqipen e sotme kjo formë ka ardhur duke u

zhdukur dhe mbijeton vetëm në të folme dialektore (Topalli 2009: 321; 2011: 398), më saktë në të folme të gegërishtes jugore dhe të toskërishtes veriore (Gjinari e Shkurtaj 2003: 216-217).

2.10. Biflektivizmi në sintagmën emërore: *bjeshkëshit së naltash*

Në tekstet e vjetra përshtatja e mbiemrit të nyjshëm me emrin për nga kategoria gramatikore e rasës shprehet jo vetëm përmes formave rasore të nyjës së mbiemrit, sikundër ndodh ekskluzivisht në shqipen e sotme, por, në numrin shumës, edhe në saje të mbaresave të njëjta rasore, duke dëshmuar kështu për dukurinë e biflektivizmit përmes shembujsh, si: *i silli tue u rrëzuem bjeshkëshit së naltash* (CP I, 5), *e silla është themeli i gjithë vepëravet mirave* (CP Të primitë XIV), *bishash së egrash* (CP II, 130), *viseshit së njomash* (CP I, 37), *të dëshirëvet këqiave* (CP I, 87), *prashtu si u shëndosh ende plagëshit së vet e lëngimeshit së fōrtash pat katërmbëdhjetë mijë dele* (CP I, 117) etj.

Në ndonjë rast kjo vihet re edhe te mbiemrat e panyjshëm: *të vashëzavet lodërtareve* (CP I, 157), *qi është profetixuem prej profetësh plejsh* (CP II, 153) etj.

Kjo dukuri e lakimit të emrit bashkë me mbiemrin, qoftë duke marrë mbaresa të njëjta rasore, si mbaresat *-ve* të gjinore-dhanores dhe mbaresa *-sh* e rrjedhores, apo edhe nëpërmjet trajtës nyjore mbiemërore *së* në rasën rrjedhore, ka karakterizuar mbarë shqipen e moçme, pasi gjurmë të saj gjenden që nga Buzuku e Matrënga e gjer te Bogdani, si dhe pas tij për njëfarë kohe.

Ndër autorë të vjetër të shqipes dukurinë e biflektivizmit e ka hetuar edhe Demiraj (1975; 1988; 2002), si te Buzuku: *për fryjtit të vepëravet mira-ve...; ... ruoj shpirtinë tem ën buzëzish së këqia-sh*, te Bardhi: *ende deleshit së njëfuna-sh ha turku*, si dhe te Bogdani: *ashtë e para e dritave nalta-ve*.

Ndërsa ndonjë studiues këtë dukuri e sheh si mundësi të ndikimit nga gjuhët e tjera e sidomos nga latinishtja, Demiraj e interpreton si ndikim i një faze më të vjetër të shqipes, kur edhe emri, edhe mbiemri merrnin mbaresa rasore. “Tek autorët e vjetër të Veriut, sidomos tek Buzuku, gjejmë ende disa gjurmë, me sa duket, të një faze më të vjetër, kur mbaresat rasore i merrte si emri ashtu edhe mbiemri që vinte pas tij. Këtu është fjala për disa raste, ku emrat e përdorur në rasat gjinore-dhanore e sidomos në të ashtuquajturën rrjedhore më *-sh* ndiqen nga mbiemra të nyjshëm, që përshtaten në rasë e shprehin jo vetëm me ndryshimet përkatëse në nyjën e tyre të përparme, por edhe me anë mbasesash rasore” (Demiraj 1975: 51).

Gjithashtu, kjo dukuri tek autorët e vjetër është trajtuar edhe nga Çabej (1988: 76), i cili vëren se lakimi i mbiemrit me emrin përkatës përbën një kongruencë karakteristike në gjuhën e Buzukut, që haset edhe te Bogdani, por më rrallë te Budi e Bardhi dhe fort rrallë në arbërishte. Por më parë këtë dukuri te Buzuku e Bogdani e ka hetuar J. Rrota (1942), ndërsa një shtjellim të hollësishëm mbi tezat kryesore rreth origjinës së kësaj dukurie në shqipen e vjetër e ka bërë S. Mansaku (2001: 15-37), si dhe E. Likaj (2003: 92), K. Topalli (2011) dhe E. Paci (2011), e cila biflektivizmin e ka trajtuar në gjuhën e Buzukut si një dukuri të veçantë të tij dhe të autorëve të tjerë të shqipes së vjetër që hetohet në strukturën e sintagmës emërore *emër + mbiemër*, në të cilën marrin tipare flektive edhe emri i përcaktuar, edhe mbiemri që e ndjek atë (Paci: 2011: 225). Sipas saj, rastet e biflektivizmit në veprën e Bogdanit janë më të shpeshta se në veprën e Buzukut (shih për më shumë gjithë rastet e Buzukut, Paci 2011: 145-155).

Biflektivizmi është dukuri që ka karakterizuar mbarë shqipen e teksteve të vjetra, por që shfaqet sidomos te Buzuku e Bogdani dhe, për më tepër, ka qenë dukuri sistemore, duke prekur tërë sistemin emëror, pasi gjurmë të tij hetohen edhe në sintagma emërore gjymtyra përcaktuese e të cilave shprehet me përemër, qoftë në rasat e zhdrejta të gjinore-dhanores në shumës me mbaresën *-ve*, qoftë në rasën rrjedhore në shumës me mbaresën *-sh*. P.sh.: me pasë shpëresë e të penduem *fajeshit së vetsh* (CP I, 53); nukë zunë asndonji *së tish* (CP II, 37), Zotyni *i prindet tëve* ka dërguem mue juve (CP I, 13), gjithëve ka me paguem, gjithë *anëmiqet tëve* (CP I, 122), urdhënoj për ty me të ruejtunë gjithë *udhëvet tuave* (CP I, 23), Ashti *eshtënash së mijash*, e mishi i mishit tim (CP I, 46), ky tash është *prej eshtënashit së miash* (CP I, 66) etj.

Megjithëkëtë, format e palakueshme të kësaj kategorie leksiko-gramatikore shfaqen më shpesh në tekstet e vjetra, sikurse janë po kështu më të shpeshta edhe trajtat rasore me një të thjeshtuar të mbiemrave: *kafshëvet të hyjënueshime* (CP I, 6), *mpkateve të ndëjyem* (CP II, 98). Këtë e vëren edhe Paci në gjuhën e Buzukut, kur thotë se faktet e tilla “që mbiemri merr thjesht fundore zanore, e jo fundoren *-sh* të rasës përkatëse... dëshmojnë për prirjen për thjeshtimin e treguesve formalë rasorë të këtyre formave mbiemërore që ndjekin një emër në rasën rrjedhore të numrit shumës (Paci 2011: 226).

3. Përfundime

Në sistemin emëror të shqipes letrare të shekujve 16-18 dëshmohen mjaft arkaizma. Disa prej këtyre tipareve konservatore janë sistemore dhe konsistente, meqë si të tilla dëshmohen rregullisht në shqipen e teksteve të vjetra, siç janë, p.sh.:

- mbaresa e vjetër e rrjedhore së shquar shumës **-shit** (*sÿshit, bjeshkëshit*);
- mbaresa e vjetër e rrjedhore së shquar njëjës **-t** e emrave femërorë të lakimit të tretë (*gojet, doret*);
- forma e vendores (si krypa *nd'*) *ujët*;
- emrat mashkullorë me **-ë** të patheksuar fundore (*popullë, hekurë, gjarpënë*);
- emrat femërorë me bashkëtingëllore fundore tematike (*djep-ja, nder-ja, shëndet-ja*);
- ruajtja e fundores **-e** në emëroren e shquar të emrave femërorë (*faqeja, dijeja*);
- mbaresa e gjinore dhe e dhanore pa antihiatizuesen **-v-** në temat e shumësit që mbarojnë me bashkëtingëllore *pleqet* (khs. *pleqvet*) dhe
- në këtë shembull të fundit edhe ruajtja e nyjës së shumësit të shquar **-t** (khs. *pleqve*) etj.

Por ka edhe tipare arkaike që dalin pjesërisht të ruajtura deri në këtë fazë zhvillimi, siç janë, p.sh.:

- gjinia asnjëse (*ballët, ujët*);
- mbaresa e vjetër **-në** e kallëzores së shquar krahas mbaresës së re **-inë**, përkatësisht **-unë**;
- biflektivizmi në sintagmën emërore (*bjeshkëshit së naltash*) etj.,

Kjo tregon se shqipja e teksteve të vjetra, në një anë, dëshmohet për një gjendje të vjetër të dukurive gramatikore të ruajtura mirë deri në këtë fazë dhe, në anën tjetër, karakterizohet nga një proces i reduktimit të vazhdueshëm të tyre, që do të ketë nisur disa kohë përpara fazës shkrimore të shqipes, meqë në shqipen e teksteve të vjetra dëshmohet përdorimi jo gjithaq konsistent i tyre.

Këto tipare arkaike, të dëshmuara si plotësisht ose si pjesërisht të ruajtura në shqipen letrare të shekujve 16-18, në shqipen e shekujve të mëvonshëm vijnë duke u reduktuar gjithnjë e më shumë, madje shumë sosh tashmë janë shuar fare dhe gjurmë të tyre gjejmë vetëm në ndonjë të folme skajore e konservatore dhe, për më tepër, më fort brenda shprehjeve idiomatike.

Referencat

- Ashta, K. (1996, 1998, 2000, 2002). Leksiku historik i gjuhës shqipe. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Bokshi, B. (2010). Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes. Prishtinë: ASHAK.
- Çabej, E. (1988). Studime gjuhësore VI. Prishtinë: Rilindja. Botimi i parë: Gjon Buzuku. Në: Buletin për Shkencat Shoqërore, nr. 1, 2, 3, 4, Tiranë, 1955.
- Demiraj, Sh. (1988). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: Rilindja.
- Demiraj, Sh. (2002). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.
- Demiraj, Sh. (2015). Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe. Tiranë: ASHSH. (Referuar edhe sipas botimit të parë: 1975).
- Elezi, Sh. (2011). Sistemi rasor i shqipes në Çetën e Bogdanit. Në: “Gjurmime albanologjike”, nr. 40, ff. 147-165, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Elezi, Sh. (2012). Sistemi eptimor i shqipes në Çetën e Bogdanit. Në: “Studime për nder të Rexhep Ismajlit”, ff. 223-240, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë: Koha.
- Elezi, Sh. (2018). Sistemi emëror i shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit. (Disertacion doktorate). Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike.
- Gjinari, J. – Shkurtaç, Gj. (2003). Dialektologjia. Tiranë: SHBLU.
- Haxhihasani, Q. (1971). Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë. Dialektologjia shqiptare, I. Tiranë: ASHSH, IGJL.
- Likaj, E. (2003). Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe. Tiranë: SHBLU.
- Mansaku, S. (2001). Disa veçori morfo-sintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe. Studime filologjike, nr. 1 – 2, ff. 15 – 37, Tiranë.
- Morozova, M. (2011). A ka arkaizma në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës? Një krahasim me dialektet dhe të folmet e dokumentuara në *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe* (ADGjSh). Seminari XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 30, ff. 381-393. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.

- Mulaku, R. (2012). Gjuha e shkrimeve të vjetra shqipe (shek. XV-XVIII). Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Omari, A. (2007). Lëkundje në gjininë e asnjansve të vjetër te Bogdani dhe probleme të lematizimit të konkordancës elektronike. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 26/1, ff. 259-268, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
- Omari, A. (2010). Kolec Topalli, Sistemi rasor i emrave të shqipes. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Buletin Shkencor, nr. 60, ff. 235-240, Shkodër.
- Paci, E. (2011). Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Riza, S. (2002). Vepra 3. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botimi i parë: Emrat në shqipe. Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit (Punim historik me dy shtojca kritike). Tiranë: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT, 1965.
- Rrota, J. (1942). Sintaksi i shqipes. Shkodër. Botimi i tretë: 2005, Shkodër: Botime françeskane.
- Topalli, K. (2009). Sistemi rasor i emrave të shqipes. Tiranë: Plejad.
- Topalli, K. (2011). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.

Korpusi

- Buzuku, Gj. (1555). “Meshari” i Gjon Buzukut (1555). I, II. Botim kritik nga E. Çabej. Tiranë: USHT, 1968 (Botimi i ri: 2013).
- Matrënga, L. (1592). E mbsuame e chræsteræ (dorëshkrimi I). Roma.
- Budi, P. (1618). Dottrina Christiana. Roma.
- Budi, P. (1621). Rituale Romanum. Roma.
- Budi, P. (1621). Speculum Confessionis. Roma.
- Bardhi, F. (1635). Dictionarium latino-epiroticum. Romae.
- Bogdani, P. (1685). Pjetër Bogdani, Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve). Botim kritik nga A. Omari, Tiranë: ASHSH, IGJL, 2005.

KDU: 811.18'282.3(82-92)(05)

Julie KOLGJINI

**REZISTENCA NDAJ NËNSHTRIMIT GJUHËSOR: MARGJINALIZIMI I NJË
VARIANTI TË SHQIPES**

Abstrakt

Repertorët gjuhësorë që përmbajnë variacione rajonale si dhe diaglosi, ndër të tjera, kanë marrë vëmendje të konsiderueshme vitet e fundit. Në këtë punim po e orientojmë fokusin tonë në një fushë relativisht më pak të studiuar, specifikisht në komunitetet e folësve të gjuhës shqipe ku përdorimi i konstrukteve të ndryshme të shtresuara shoqërore (më parë) të indeksuara, me shkallë të ndryshme të stigmës dhe prestigjit, po vazhdojnë të shfaqin mos-miratimin e normës së vendosur në shekullin e kaluar. Penetrimi i elementeve të tilla gjuhësore alternative në diskursin qendror shpesh invizibilizohen në forma të ndryshme. Kohët e fundit, megjithatë, për shkak të lëkundjes së atitudës ndaj ideologjisë gjuhësore hegjemonike, përveç faktorësh të tjerë, konfigurime diaglosike të zgjedhura, që përmbajnë këto forma (dikur) të përjashtuara, duket se mund të kenë fat në procesin e kualifikimit si divergjenca të mirëpritura nga standardi. Qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi i përdorimit të shqipes bashkëkohorë, ku shpërfaqen konstrukte heteroglosike. Rezultatet sugjerojnë që rezistenca periodike ndaj nënshtrimit gjuhësor asimetric është e evidente, në një farë mënyre, si remenishencë me disa variante të tjera të shqipes.

Fjalët çelës: shqipja, invisibilizimi, destandardizimi, diaglosia, variantet jo-standardë, variantet gjuhësore, nënshtrimi gjuhësor

Abstract

Linguistic repertoires containing regional variation and diaglossia, among other elements, have received considerable attention in recent years. Thus, in this paper we turn our focus to a relatively understudied realm, namely domains within Albanian speech communities where the employment of various (once) socially stratified constructions indexed with stigma exhibit non-adoption of the prescribed norm of the last century. The admittance of such alternative linguistic elements into mainstream discourse has often been met with obstruction and consequently suppression and invisibilization. Recently, however, influenced in part by oscillating easing of language attitudes with regard to hegemonic ideologies, select diaglossic

configurations containing proscribed forms may be in the process of qualifying as felicitous divergences from the standardized norm. The aim of this paper is to examine various modes of contemporary Albanian where heteroglossic constructions surface. The findings suggest that periodic resistance to asymmetrical linguistic bowing, somewhat reminiscent of other Albanian varieties, may be transpiring.

Keywords: Albanian, invisibilization, destandardization, diaglossia, non-standard varieties, language variation, linguistic bowing

1. Hyrje

Gjatë viteve të fundit përzierja e repertorëve gjuhësorë ka marrë vëmendje të konsiderueshme në qarqe të ndryshme akademike. Përzierje të tilla përfshijnë daljen në pah edhe të variacioneve rajonale si dhe veçorive të arealit me elemente të llojllojshme gjuhësore të shfaqura nga kontaktet dhe diaglossia, ku format dialektore ndërthuren me standardin (Auer, 2005; Cerruti & Regis, 2014; Rutten, 2016), që megjithatë herë pas here shkaktojnë turbulenca shqetësuese për ideologjitë gjuhësore hegjemonike (shih Milroy, 2001). Në këtë punim po e orientojmë fokusin tonë në një fushë relativisht më pak të studiuar, specifikisht në komunitetet e folësve të gjuhës shqipe ku përdorimi i konstrukteve të ndryshme të shtresuara shoqërore (dikur) të indeksuara, me shkallë të ndryshme të stigmës dhe prestigjit, po vazhdojnë të shfaqin mos-miratimin e normës së përcaktuar të shekullit të kaluar. Penetrimi i elementeve të tilla gjuhësore alternative në diskursin qendror shpesh hasë në pengesa që pasohen me shtypje dhe invizibilizim (shih Byron, 1976, 1978, 1985; Havinga & Langer, 2015; Vosters & Rutten, 2015; Havinga, 2018; Joseph, Rutten, & Vosters, 2020, f. 175; Elspaß, 2020; Hickey, 2020). Kohët e fundit, megjithatë, për shkak të lëkundjes së atitudes ndaj ideologjisë gjuhësore hegjemonike, midis variablave të tjerë, konfigurime diaglosike të zgjedhura, që përmbajnë forma të përjashtuara (më parë), duket se mund të kenë fat në procesin e kualifikimit si divergjenca të mirëpritura nga standardi përmes kodifikimit implicit (shih Hickey, 2020; Joseph, Rutten, & Vosters, 2020, f. 172) dhe rivlerësimit (Elspaß, 2020, f. 296) nga poshtë. Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë dinamikën e të folmeve dhe të shkruajturit të shqipes bashkëkohorë, duke përfshi edhe korpuset online (shih Schilling, 2016), ku shpërfaqen konstrukte heteroglosike (shih Deumert, 2010; Coupland & Kristiansen, 2011; Elspaß, 2020, f. 288-9), duke demonstruar

rezistencë periodike ndaj nënshtrimit gjuhësor asimetrik (Morales-Gálvez, 2017, f. 655) në një ekosistem të rrjedhshëm gjuhësor, si remenishencë e varianteve të tjera të shqipes, por me shkallë të ndryshme të mbështetjes institucionale.

1.1 Rishikimi i literaturës: Rishikimi i hegjemonisë gjuhësore

Vëmendje e konsiderueshme gjatë dekadave të fundit i është kushtuar shqyrtimit të ideologjive hegjemonike, përfshi këtu edhe peisazhin gjuhësor historik dhe bashkëkohor. Përpjekje të tilla u ushtruan për të kundërshtuar kulturat e ndryshme standarde shtypëse të gjuhës duke përfshi inxhinierimin e ngurtë si dhe fushatat e purizmit gjuhësor, të përhapura gjatë shekullit të kaluar (Milroy, 2001; Joseph, Rutten, & Vosters, 2020). Ndërsa varianti gjuhësor që devijonte nga norma e zyrtarizuar shpesh konsiderohej kërcënim për përparimin e shtetit-komb, një gjuhë standarde homogjene konsiderohej shoqëruese e modernizimit (Ricento, 2000, f. 198; Ruttens, 2016b, f. 45). Në kundërshtim me variabilitetin e alternativave jo standarde (Milroy, 2001, f. 531–2), gramatikat standarde përbëheshin nga njëtrajtshmëria fikse e pandryshueshme (Ricento, 2000, f. 201; Ruttens, 2016b, f. 41). Sidoqoftë, një ndryshim kritik i paradigmës, së fundmi nisi të jape frutat e veta. Politikat ortolinguistike nxorën në pah përhapjen e padrejtësive shoqërore. Margjinalizimi dhe shtresimi i folësve të varieteteve jo-dominuese, u bë objekt i diskutimeve edhe në sferat akademike (Ricento, 2000, f. 201–6; Milroy, 2001, f. 532, 540; Low & Sarkar, 2014, f. 104). Kornizimi i repertorëve gjuhësor dinamik dhe fleksibël, të konsideruara “pellgje burimesh gjuhësore” (Grace e cituar në Milroy, 2001, f. 540) të mangëta, tani po sfidohej nga një kundër-reagim (shih Deumert, 2010). Ky rishikim në hierarkitë e ideologjive dominuese gjuhësore nënkupton largimin nga forcat e centralizuara drejt atyre periferike (shih Low & Sarkar, 2014, f. 113).

Mosnënshtrimi ndaj imponimeve të politikave gjuhësore hegjemonike mund të vërehet në dinamikën e praktikave gjuhësore heteroglosike, duke shërbyer kështu si një kundër-reagim. Heteroglosia, e cila shpesh shtrihet përtej kod-ndërrimit, mund të përfshijë përzierjen e varianteve, regjistrave, kodeve, lekteve, gjuhëve dhe/ose shprehësive (shih Schilling, 2016, f. 44-50). Ndryshueshmëria dhe hibriditeti i gjuhës, përfshi edhe rrjedhshmërinë që i përket përbërësve kohor, hapësinor dhe diatopik (gjeografik), janë pjesë përbërëse e heteroglosisë Bakhtin-*esque* (Pietikäinen & Dufva, 2014, f. 64–7; Schilling, 2016, f. 49-50). Këndvështrimet e ndryshme janë në lojë konkurrese njëra me tjetrën, ku “‘çdo shprehje konkrete është një mikrokozmos i kësaj lufte midis forcave ‘centripetale’ dhe ‘centrifugale’ që unifikojnë dhe shtresojnë njëkohësisht gjuhën në të gjitha fazat e ekzistencës së saj historike’” (Nougueron-

Liu & Warrier, 2014, f. 182). Në këtë lojë janë zgjedhjet gjuhësore ndërmjet standardit të ngurtë hegjemonik, homogjen, dhe variantetve vernakulare jo standarde. Kjo dinamikë shtyj-tërhiq mund të përcaktojë gjithashtu shtresimin e folësve në varësi të formave gjuhësore që ata përdorin (Bell, 2011, f. 179). Ky tension midis politikave të gjuhës unitare centripetale dhe variabilitetit gjuhësor centrifugal, kufijve të paqartë dhe identitetit të folësve, ndër të tjera, është element parësor integruar në zhvillimin e gjuhëve të gjalla (shih Schilling, 2016, f. 49-50).

Diaglosia gjithashtu mund të jetë e rëndësishme për diskutimet që sillen rreth përzierjes së formave divergjente gjuhësore. Kur normat e përcaktuara janë tolerante, mund të kultivohen edhe repertorët diaglosikë, ku sistemet gjuhësore centripetale dhe centrifugale shpërfaqen në peisazhin e gjërë gjuhësor. Auer (2005, f. 22) shpjegon që repertori diaglosik karakterizohet nga variante të ndërmjetme midis standardit dhe dialekteve. Një peizazh i dhënë gjuhësor mund të prodhojë diaglosi¹, veçanërisht pasi të ketë zënë rrënjë një standard eksoglosik dhe më vonë endoglosik në përputhje me vernakularin. Diaglosia mund të thuhet se po shfaqet kur (nën)variantet jo standarde depertojnë në bazën e standardeve (shih Rutten, 2016a; Cerruti & Regis, 2014), duke frymuar kështu në “hapësirën midis...dialektit dhe standardit” (Auer, 2005, f. 22) që përfshin “forma të ndërmjetme as dialektore as standarde” (Rutten 2016a, f. 7–8)². Përmes ndërrimeve të tilla novatore në regjistër, variant dhe stil, përdoruesi është në gjendje të krijojë një identitet të vetjes që nuk është i prangosur në ndarjen standard/jo standard.

Destandardizimi, gjithashtu hapë rrugë për ndërtimet e tilla hibride gjuhësore. Davies (2012, f. 50-1) thekson: “Koncepti ‘destandardizim’...zakonisht i referohet dy proceseve të ndryshme: (i) ndryshueshmërisë më të madhe strukturore brenda variantit standard dhe (ii) dukshmërisë dhe pranueshmërisë në rritje të varianteve jo standarde në domenet e rezervuara më parë për standardin.” Destandardizimi lejon tipare të formave jo-standarde dhe rajonale (më parë) të stigmatizuara, të rishfaqen në hapësirat e okupuara nga standardi (shih Auer, 2005, f. 25; Rutten, 2016a, f. 8). Në lidhje me destandardizimin, Auer thekson se “elementët rajonalë po tolerohen gjithnjë e më shumë në standard (Auer 2005: 25)” (cit. në Rutten, 2016a, f. 8). Repertorët që shfaqin destandardizimin përfshijnë “centrifugalizimin [...]...ikjen nga standardi

¹ Rutten (2016a, p. 8) shkruan: “Auer (2005, 2011) presents a typological and historical analysis of the rise of diglossic repertoires in Europe. The typological development runs from a previous state of diglossia to diaglossia. The diglossic phase is first characterized by an exoglossic standard such as Latin, Church Slavonic or Arabic, and vernacular spoken varieties...Then there was a transition to a situation with an endoglossic standard, which is structurally related to the vernacular.”

² Rutten (2016a, p. 8) citon Auer-in: “Such intermediate forms enable language users ‘to act out, in the appropriate contexts, an identity which could not be symbolized through the base dialects (which may have rural, backwardish or non-educated connotations) nor through the national standard (which may smack formality and unnaturalness and/or be unable to express regional affiliation). (Auer 2005:23).”

në të gjitha drejtimet, si dhe çlirojnë gjuhën nga prangat e idesë së një standardi” (Bell, 2011, f. 179). Pozicioni i standardit centripetal i "gjuhës më të mirë" është lëshuar (shih gjithashtu Coupland & Kristiansen, 2011, f. 28). Marrja në pyetje në menyrë të qartë e variantit standard është thelbësore, veçanërisht kur shqyrtohet gjendja aktuale e gjuhës, sidomos dinamika e kombinimeve standard-dialekt ku shfaqet hibriditeti gjuhësor (shih Deumert 2010, f. 247).

Fshirja, apo invisibilizimi, i formave jo standarde si elemente përbërëse të standardit hegjemonik, gjithashtu gjen vend në studimet që përfshijnë konfigurimet gjuhësore hibride. Joseph, Rutten, & Vosters (2020, f. 175) theksojnë se “zhdukja graduale nga shkrimi i formave të përdorura rregullisht në gjuhën e folme, deri edhe në ditët e sotme, është quajtur invisibilizim (Langer dhe Havinga 2015).” Kur një ndërtim ose veçori e dhënë gjuhësore nuk përfshihet në normën e zyrtarizuar, pavarësisht praktikave të përdorimit, thuhet se është ‘de-selektuar’ ose i është nënshtruar ‘mos-përzgjedhjes’. Joseph et al. komentojnë: “Termi [invizibilizim] pasqyron pak a shumë heqjen me vetëdije të formave të caktuara nga tradita e shkrimit, duke e kufizuar përdorimin e tyre në regjistrat e të folmeve (jozyrtarë) (krh. koncepti i fshirjes, diskutuar nga Irvine dhe Gal 2000)” (f. 175)³. Kur një formë e caktuar de-selektohet nga norma (e shkruar) e kodifikuar, ajo zbret në opsionin e nivelit gojor si jo standarde, shpesh duke u stigmatizuar sepse nuk e ka *overt prestige*-in e standardit. Për rrjedhojë, struktura të tilla bëhen të padukshme në materialet e shkruara të kontrolluara nga gardianët standardistë, përfshi këtu dokumentet e (ri)prodhuara nga shkruarit, korrektorët dhe recensuesit (shih gjithashtu Havinga, 2018; Elspaß, 2020; Hickey, 2020, f. 222-3).

Gjithashtu, për të hetuar amalgama gjuhësore që përmbajnë forma jo standarde të stigmatizuara (me pare), është i rëndësishëm kodifikimi implicit. Siç thekson Hickey (2020, f. 222), nëse folësit, e një varianti jo vernacular, në veçanti “nuk e përceptojnë një strukturë apo veçori si vernakular, atëherë, mund ti rrëshqasin rrjetës dhe të përfshihen në...variantin e

³ Tsitsipis (2003, p. 247) përmend: “According to Gal and Irvine (1995: 974), erasure is a powerful ideological strategy in the process of which certain phenomena such as linguistic structures, cultural products, social groups, sociolinguistic varieties, etc. are rendered invisible... The processes that index this erasure are fragmentation, marginalization, sublimation, and repression.” Havinga (2018, p. 1, footnote 1) shkruan: “The term ‘invisibilisation’ is more forceful than ‘disappearance’ and implies a degree of deliberate agency, i.e. a particular variant or variety is no longer written down for a reason, not accidentally. Skutnabb-Kangas’s (2000) wider use of ‘invisibilisation’ corresponds with this understanding of the term. In her discussion of the suppression or marginalisation of minority languages, cultures, and peoples, she refers to cases where languages are not acknowledged, are not granted the label ‘languages’ or regarded as small parts of the majority language. Thus minority languages and cultures are stigmatised and made invisible by those in power (Skutnabb-Kangas 2000: 662).”

kodifikuar implicit.” Pra, me këtë lloj kodifikimi, forma të ndryshme devijuese, jo standarde mund të ndërveprojnë në standard. Përfshirja e ndërtimeve të tilla në normën e zyrtarizuar “mund të shfaqet... si preference për, ose tolerancë ndaj, strukturave apo shprehjeve të veçanta” (f. 223). Hickey shpjegon se “disa tipare të cilat paraprakisht të stigmatizuara duke qenë tipike për variantet vernakulare, mund të depërtojnë lart drejt variantit mbirajonal dhe të çlirohen prej stigmës gjatë procesit,” si p.sh adaptimi i tingullit [t] të anglishtes së Dublinit në anglishten irlandeze (f. 226). Kur struktura të tilla nuk kategorizohen në indekse të veçuara të repertorëve gjuhësorë si *katunarçe*, kodifikimi implicit, mund të ndodhë, krahas proceseve të tjera (f. 228-9).

1.2. Rasti i shqipes: Invisibilizimi dhe nënshtrimi gjuhësor

Duke pasë parasysh të kaluarën relativisht jo të largët të fshirjes së ndërtimeve gjuhësore (tashmë) jo standarde, disa përdorues të shqipes shmangin gjuhën standarde në ekosisteme të ndryshme gjuhësore nëpërmjet anashkalimit të normës së zyrtarizuar, duke përdorë praktika gjuhësore heteroglosike që shfaqin destandardizim, diaglosi dhe kodifikim implicit.

Invizibilizimi gjuhësor merr rëndësi kur merren parasysh variantet e shtypura, në rastin tone dialekti gegë. Një situatë e tillë mund të vërehet kur shqyrtohet vendim-marrja për kodifikimin e gjuhës, veçanërisht gjatë shekullit të kaluar (Ismajli, 2005). Në Shkodër, Tiranë dhe Prishtinë, si dhe në pjesët e tjera, para vitit 1967 varietetet geqe dhe toske shfaqeshin rregullisht në shtyp, ndonjëherë edhe në të njëjtin dokument, përfshi materialet e standardizimit të gjuhës, të tilla si *Rregulla mbi orthografin e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej komisis letrare* 1917 ku varianti gegë i Elbasanit u propozua të merrej si baza e një standardi të përbashkët, veçanërisht pasi ky nënvariant përmbante një përzierje harmonike të dy dialekteve (shih Ismajli, 2005, f. 225-232). Ky dokument i hapi rrugën botimeve të tjera, si *Ortografia e gjuhës shqipe*, në varietetin gegë shkruar nga studiues të gjuhës në Institutin e Shkencave në Tiranë në 1948, dhe më vonë në 1951, në toskërishte; të dy botimet shërbyen në bashkëjetesën e gegnishtes dhe toskërishtes në larminë e publikimeve. Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, vetëm pesë vjet më vonë në 1956, varieteti gegë, edhe pse me përdorim të gjërë në një mori zhanresh, përfshi abetaret e gjuhës, materialet letrare, fetare, shkencore dhe organet e shtypit të kohës, u zhvendos në fusnota në versionin e Tiranës *Ortografia e gjuhës shqipe* (Ismajli, 2005, f. 277-307), pavarësisht se ende shfaqet në shumë tekste shkollorë në Kosovë (p.sh. Vokshi, 1959) me përzgjedhje të teksteve letrare, si p.sh. nga Migjeni, midis një numri të kufizuar të materialeve të shkruara që shfaqeshin në gegnisht në të

dy anët e kufirit. Mandej, pak më shumë se një dekadë më vonë varianti gegë pothuajse u eliminua si kod legjitim gjuhësor në botimin e materialeve shkollore, shkencore dhe materialeve të tjera zyrtare, përmes ndalimit dhe fshirjes, në vitin 1967 nga një ekip i autoriteteve të gjuhësisë nën kujdesin e Universitetit të Tiranës (shih *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* në Ismajli, 2005, f. 357-520) si dhe në 1968 në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës nga një grup gjuhëtarësh të Institutit Albanologjik të Prishtinës (shih *Konkluzat e konsultës gjuhësore të Prishtinës* në Ismajli, 2005, f. 521). Gjuha e Njësuar Letrare (GjNjL) e vitit 1972 me bazë në dialektin toskë, erdhi në jetë si standardi hegjemonist i RPS-së të Shqipërisë dhe KSA-së të Kosovës (shih Ismajli, 2005, f. 523-630; Bajron, 1976, 1978, 1985). Pra, afërsisht në dy dekada, varianti gegë nga asocimi me gjuhën e kulturës, i'u nënshtrua invisibilizimit të konsiderueshëm gjuhësor. Vendimet politike, përfshi edhe planifikimin gjuhësor, të fundviteve 1960 dhe fillimviteve 1970 në Evropën Juglindore formuan shtratin ideologjik të standardizimit gjuhësor të Shqipërisë dhe Kosovës. Ndërsa dialekti toskë u ngrit në *overt prestige* duke u zgjedhur për standardin e ri, varianti gegë dhe folësit e tij u stigmatizuan (shih gjithashtu Bajron, 1976, 1978, 1985) dhe për pasojë u marginalizuan.

2. Metodologjia, subjektet dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave

Për të pasë një pasqyrë dinamike të ekosistemit bashkëkohor gjuhësor të shqipes, metodologjia dhe mbledhja e të dhënave të këtij studimi përfshin ndëgjimin e gjashtë videove të publikuara kohët e fundit në internet⁴, shënimet e mbajtura si dhe transkriptimin e pjesëve përkatëse. Nga 45 folës, e folmja e të cilëve u përdor për këtë studim, 25 janë gra dhe 20 janë burra (folës: n = 45; gra: n = 25, 56%; burra: n = 20, 44%); 12 nga gratë janë nga Kosova, 10 nga Shqipëria, 2 nga Maqedonia e Veriut dhe 1 nga Mali i Zi; 14 nga burrat janë nga Shqipëria dhe 6 janë nga Kosova. Në këto materiale, bashkëbiseduesit posedojnë repertor gjuhësor që

4

Listimi i videove: Ora 7: “Sekreti i Altin Prengës nga Mrizi i Zanave Agroturizëm për kuzhinën shqiptare” - 16.06.2021 (<https://www.youtube.com/watch?v=0BBTkLbTdol>); Rudina Xhunga: “Mrizi i Zanave” – 18.01.2020 (<https://www.youtube.com/watch?v=voHwABhLvzI>); Opinioni: “Çfarë do të thotë të jesh femër në trevat shqiptare?” – 12.06.2021 (<https://tvklan.al/opinion-live-12-korrik-2021/>); Opinioni: “Vendet më interesante të Tiranës” – 3.06.2021 (<https://www.youtube.com/watch?v=gPrEdkMv094>); Jeta në Kosovë: “Gratë në Qeversije” - 13.02.2020 (<https://www.youtube.com/watch?v=vHmU5g84sBs>); RUBIKON Klan Kosova: “Dita e Qeverisë Kurti II” - 22.03.2021 (<https://www.youtube.com/watch?v=2-vlO09pafE>).

përmbajnë toskërishten (T), gegnishten (G) dhe GjNjL-në. Edhe pse shfaqet larmi e një sërë praktikash të të folmeve, përdorimi i formave diaglosike të konstatuara në shkallë të ndryshme nga folësit, përbën interes të vecantë.⁵


Kjo pjesë përshkruan se si u krye studimi. Në të shpjegohet, në sa më shumë hollësi, çfarë ka ndodhur dhe si e keni kryer hulumtimin. Kjo pjesë është veçanërisht e rëndësishme në studimet eksperimentale që kërkojnë një përshkrim të ndërhyrjes. Shembujt e informacionit për t'u paraqitur në këtë pjesë përfshijnë një përshkrim të trajnimit të nevojshëm për zbatimin e një metode të re mësimore eksperimentale dhe llojet e udhëzimeve që duhet t'u jepen të anketuarve, të cilëve iu kërkuar të plotësonin një anketë. Kjo pjesë duhet të përmbajë, gjithashtu, një plan kohor realist për fazat e ndryshme të studimit.

3. Rezultatet

Në këto materiale spikasin veçanërisht elementë të ndryshëm morfologjikë që shfaqen në të folmen diaglosike, në veçanti pjesorja e shkurtë geqe (p.sh. *pasë*). Ajo u mat në lidhje me pjesëzën paraprirëse: i.) T/GjNjL **duke** (p.sh. *duke pasë*; krh. T/GjNjL *duke pasur*, G *tue pasë*); ii.) shënuesin gegë të infinitivit të shkurtë **me** (p.sh. G *me pasë*; krh. T/GjNjL *të kesh*); dhe iii.) **të tjera** (p.sh. T/GjNjL/G *për të, duhet, mos, pa*). Në lidhje me [Figurën 1](#), në të folmen e subjekteve, në total prej 1,020 rastesh për të tre kategoritë e lartpërmendura (gra: n = 456 ose 45%; burra: n = 564 ose 55%), 35 raste treguan se pjesorja geqe e parapirë nga pjesëza *duke*, u paraqit, me 37% (n = 13 herë) aplikuar nga gratë dhe 63% (n = 22) nga burrat. Në lidhje me pjesoren geqe të parapirë nga shenjuesi *me*, nga numëri total prej 423, 44% (n = 185) u shqiptua nga gratë dhe 56% (n = 238) nga burrat. Sa i përket rastit kur ndonjë artikull tjetër i paraprin pjesores geqe, numri i përgjithshëm i rasteve ishte 562, me 46% (n = 258) të shqiptuara nga gratë dhe 54% (n = 304) nga burrat. Këto të dhëna sugjerojnë se e folmja heteroglosike është e pranishme në përdorimin e gjuhës bashkëkohore, si nga gratë ashtu edhe nga burrat ku burrat udhëheqin lehtë në të tre kategoritë, pavarësisht se me pesë folës më pak në studim.


⁵ Shumë nga këta folës kanë jetuar në rajonet gegë; janë të trashëgimisë gegë; dhe/ose i janë ekspozuar kësaj shumëllojshmërie për një periudhë të konsiderueshme kohore në secilin prej këtyre rasteve, kontakti dialektor multimodal në sfera të ndryshme publike dhe private, p.sh. me miqtë dhe të njohurit, përfshi programet televizive, është me rëndësi për këtë investigim.

Figura 1: Frekuenca e rasteve dhe përqindja e pjesoreve geqe në të folmen e subjekteve sipas kategorisë me elementet paraardhës



Njësi të tjera leksikore geqe, ndër të tjera, me interes janë fjalët *nji* (krh. T/GjNjL *një*), dhe *shpi* (krh. T/GjNjL *shtëpi*), nga ku dolën në pah praktikatat gjuhësore të subjekteve në fjalë, prej 491 rastesh në total (gra: n= 138 ose 28%; burra: n=353, ose 72%, shih Figura 2). Fjala *nji*⁶ (krh. T/GjNjL *një*) u shqiptua gjithsej 345 herë, nga gratë 21% të rasteve (n = 73), dhe nga burrat 79% (n = 272). Njësia leksikore *shpi* (krh. T/GjNjL *shtëpi*) u shqiptua gjithsej 27 herë, në të gjitha rastet nga burrat. Pjesorja geqe *pasë* (krh. T/ GjNjL *pasur/patur*) u shqiptua gjithsej 87 herë, nga gratë që e përdorin atë në 55% të rasteve (n = 48), dhe burrat 45% (n = 39). Në lidhje me pjesoren geqe *ardhë* (krh. T/GjNjL *ardhur*), nga gjithsej 18 raste të shfaqura, gratë e shqiptuan atë 61% të rasteve (n = 11), dhe burrat 39% (n = 7). Pjesorja geqe *shku* (krh. T/GjNjL *shkuar*) u përdor 14 herë, 43% nga gratë (n = 6) dhe 57% (n = 8) nga burrat. Sipas të dhënave që përputhen me rezultatet e përgjithshme në [Figurën 1](#), burrat marrin epërsi në shqiptimin e formave divergjente që kontribuojnë në përdorime heteroglosike dhe diaglosike, në veçanti për *nji*, *shpi* dhe *shku*; sidoqoftë, gratë u vërejt se shqiptuan më shumë raste pjesoret geqe *pasë* dhe *ardhë*.


Figura 2: Frekuenca e rasteve dhe përqindja e njësive leksikore geqe në të folmen e subjekteve



Siç tregohet në [Figurën 3](#), sjellje të ngjashme gjuhësore në gjuhën shqipe mund të vërehen edhe në gjuhën e shkruar, përfshi korpusin online. Gjatë investigimeve ndërtimet jo-standarde dhe hibride në Korpusin Nacional të Gjuhës Shqipe (KNGjSh), herë pas here dalin në pah forma jo standarde. Numra të tillë sugjerojnë që standardi hegjemonik po përballlet në konkurrencë nga elementët diaglosik, siç del nga vëzhgimet në [Figurat 1 dhe 2](#).

Figura 3: Frekuencat e rasteve të zgjedhura leksikore (G/T/GjNjL) në KNGjSh

⁶ Përfshi të gjitha njësitë leksikore ku përdoret *nji*, p.sh. *nji shpi*, *njiqind*, *nji mijë*.



4. Diskutim

Nënshtimi gjuhësor nga folësit e varianteve divergjente dhe diaglosike, gjithashtu, duhet të trajtohet. Nënshtimi asimetrik gjuhësor, ose akomodimi, ndodhë kur “një pjesë e qytetarëve gjithmonë duhet të ndryshojë gjuhën e vet në mënyrë që të komunikojë me pjesën tjetër. Kjo do të thotë që këta qytetarë duhet të mësojnë gjuhën dominuese, por jo anasjelltas, duke i imponuar këtyre grupeve të gjitha kostot e bashkëjetesës sociale, por jo edhe të tjerëve ... para të cilëve janë të detyruar gjithmonë të ‘përuken gjuhësisht’” (shih Van Parijs, 2011, f. 54, 174 në Morales-Gálvez, 2017, f. 655). Kjo do të thotë, në rastet e nënshtimit apo përujes asimetrike, njëri segment i komunitetit të ndihet i pafuqishëm nga ana gjuhësore kur format devijuese i nënshtrohen fshirjes, ndërsa segmenti tjetër të ndihet i fuqizuar kur norma hegjemonike është dominante. Një përuje e tillë, megjithatë, mund të ishte reciproke, ku “[ç]do individ në territorin e përbashkët, pritët të ushtrojë aftësi në vernakularin gjuhësor, ti përulet gjuhës së folësve të vernakularit...” (Van Parijs në De Schutter & Robichaud, 2015, f. 102). Pra, padrejtësitë lindin kur akomodimi asimetrik është parazgjedhja automatike, ku imponon nënshtimin e njëanshëm gjuhësor (f. 100-1).

Rastet e përujes asimetrike janë të shumta në gjuhën shqipe. Në njërin nga videot e analizuar⁷, të paktën dy pjesëmarrës folën kryesisht në standard, duke mos përfillë gjuhësisht bashkëbiseduesit e varieteteve jo standarde dhe/ose diaglosike. Megjithatë, rastet e përshtatjeve reciproke gjuhësore ndaj varianteve divergjente në shqip, janë të pranishme, siç dëshmohet në ndërveprimet diaglosike në këto video si dhe në mjaft raste të gjetura në KNGjSh (shih [Figurat 1-3](#)). Një shembull u shfaq kur një folës i T/GjNjL shqiptoi të paktën pesë raste të këtyre formave, p.sh. *nji*, *e arnume* (krh. *e arnuar*), *gegnishte* (krh. *gegërishte*), *shqipnia* (krh. *shqipëria*), dhe *ardhë* (krh. *ardhur*), të gjitha të ndërthurura në peizazhin hegjemonik gjuhësor, duke ilustruar një trohë sado të paktë në horizont të drejtësisë gjuhësore kah një kodifikim implicit. Rastet e shumta të folësve gegë që përdorin forma devijuese që shfaqen në këto materiale, ilustrojnë rezistencën ndaj përujes prej normës hegjemoniste – pra edhe refuzimin e invisibilizimit.

⁷ Opinioni: “Çfarë do të thotë të jesh femër në trevat shqiptare?” – 12.06.2021 (<https://tvklan.al/opinion-live-12-korrik-2021/>)

5. Përfundimet dhe implikimet

Këto amalgama dinamike që përbëjnë objektin e fshirjeve të mundshme, nuk janë të vetme; ato mund të rrjeshtohen krahas varianteve të tjera të marginalizuara të shqipes që reflektojnë gjithashtu përballjen me forca hegjemoniste. Variante gjuhësore që gjithashtu kanë ndjerë deri në një shkallë invizibilizimin (shih Hamp në Tsitsipis, 1995, f. 544) përfshijnë ato të Arvanitëve në Greqi dhe Arbëreshëve në Itali (Tsitsipis & Elmendorf, 1983; Tsitsipis, 1995; 2003; Derhemi, 2006) por, pa anashkaluar edhe të folmet e Arbëreshëve të Zarës në Kroaci. Duke pasë parasysh strukturat e ndryshme institucionale dhe qeveritare, përfshi kornizat ligjore, komunitetet arbëreshe duket se kanë një pozitë më të favorshme se ato arvanitase, për të cilët bjerrja e gjuhës, fshirja dhe zhdukja në rritje mund të jenë në një fazë më të avancuar, veçanërisht kur merret parasysh mungesa e autonomisë gjuhësore për këta folës gjatë shekullit të kaluar (shih Hamp in Tsitsipis & Elmendorf, 1983, f. 289; shih gjithashtu Derhemi, 2006). Megjithëse repertorët diaglosikë të komuniteteve shqipfolëse në Kosovë dhe Shqipëri nuk po përjetojnë rrezikimin gjuhësor në masën e komuniteteve të lartpërmendura në Itali dhe Greqi, e gjetkë, forcat hegjemonike janë ende prevalente. Garantimi i hapjes së portës (Kraus & Kazlauskaitė-Gürbüz, 2014), mbështetja institucionale kundër-hegjemonike, financimi qeveritar, si dhe kuadri ligjor që avokon për diversitetin gjuhësor të këtyre varieteteve të marginalizuara, të përdorura në ligjërimin e përditshëm, mund të përforcojë rëndësinë e rinegociimit të fuqisë simbolike, mirëmbajtjen dhe transmetimin e këtyre praktikave gjuhësore (si dhe dialekteve) (shih Tsitsipis, 2003, f. 545). Njohja e vlefshmërisë dhe dobisë së variateteve të tilla gjuhësore dhe ndërtimeve diaglosike në zhvillimin e hapësirës së përbashkët (Morales-Gálvez, 2017, f. 657) nga autoritetet e ndryshme mund të nxisë rivlerësimin e përtërirë për këto amalgama divergjente.

Referencat

- Albanian National Corpus*. <http://webcorpora.net/AlbanianCorpus> (accessed 7 May 2021).
- Auer, P. (2005). Europe's sociolinguistic unity, or: A typology of European dialect/standard constellations. In N. Delbecque, J. van der Auwera, & D. Geeraerts (Eds.), *Trends in linguistics. Studies and monographs [TiLSM]: Perspectives on variation: Sociolinguistic, historical, comparative* (pp. 7–42). Berlin: De Gruyter Mouton.
- Bell, A. (2011). Leaving home: De-europeanisation in a post-colonial variety of broadcast news language. In T. Kristiansen & N. Coupland (Eds.), *Standard languages and language standards in a changing Europe* (pp. 177–198). Oslo: Novus Press.
- Byron, J. L. (1976). *Selection among alternatives in language standardization: The case of*

- Albanian*. The Hague: Mouton.
- Byron, J. L. (1978). Displacement of one standard dialect by another. *Current Anthropology*, 19(3), 613-614.
- Byron, J. (1985). An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia. *International Journal of the Sociology of Language*, 52(52), 59-92.
- Cerruti, M., & Regis, R. (2014). Standardization patterns and dialect/standard convergence: A northwestern Italian perspective. *Language in Society*, 43(1), 83–111.
- Coupland, N., & Kristiansen, T. (2011). SLICE: Critical perspectives on language (de)standardization. In T. Kristiansen & N. Coupland (Eds.), *Standard languages and language standards in a changing Europe* (pp. 11-35). Oslo: Novus Press.
- Davies, W. V. (2012). Myths we live and speak by: Ways of imagining and managing language and languages. In M. Hüning, U. Vogl, & O. Moliner (Ed.), *Standard languages and multilingualism in European history* (pp. 45–69). Amsterdam: John Benjamins Publishing Company.
- De Schutter, H. & Robichaud, D. (2015) Van Parijsian linguistic justice – context, analysis and critiques. *Critical Review of International Social and Political Philosophy*, 18(2), 87-112.
- Derhemi, E. (2006). Features of dysfunctional attrition in the Arbresh of Piana Degli Albanesi: Sociolinguistic studies on the Albanian language. *International Journal of the Sociology of Language*, (178), 31-53.
- Deumert, A. (2010). Imbodela zamakhumsha – reflections on standardization and destandardization. *Multilingua*, 29, 243–264.
- Elspaß, S. (2020). Alternative sources of data for alternative histories of standardisation. *Language Policy*, 19(2), 281-299. doi:10.1007/s10993-019-09528-x
- Havinga, A. D. (2018). *Invisibilising Austrian German: On the effect of linguistic prescriptions and educational reforms on writing practices in 18-century Austria*. Berlin: Walter de Gruyter.
- Havinga, A. D. & Langer, N. (Eds.). (2015). *Invisible Languages in the Nineteenth Century*. (Historical Sociolinguistics 2). Bern: Peter Lang.
- Hickey, R. (2020). Re-examining codification. *Language Policy*, 19(2), 215-234.
- Ismajli, R. (2005). *Drejtshkrimet e shqipes*. Botime të veçanta LXVIII Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Libri 29). Pristinë: Akademi e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- Joseph, J. E., Rutten, G., & Vosters, R. (2020). Dialect, language, nation: 50 years on. *Language Policy*, 19(2), 161-182. doi:10.1007/s10993-020-09549-x

- Kraus, P. A., & Kazlauskaite-Gürbüz, R. (2014). Addressing linguistic diversity in the European Union: Strategies and dilemmas. *Ethnicities*, 14(4), 517-538.
- Low, B., & Sarkar, M. (2014). Translanguaging in the multilingual Montreal hip-hop community: Everyday poetics as counter to the myths of the monolingual classroom. In A. Dordecht: Springer.
- Milroy, J. (2001). Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics*, 5(4), 530–555.
- Morales-Gálvez, S. (2017). Living together as equals. Linguistic justice and sharing the public sphere in multilingual settings. *Ethnicities*, 17(5), 646-666.
- Nougueron-Liu, S., & Warrier, D. S. (2014). Heteroglossic practices in the online publishing process: Complexities in digital and geographical borderlands. In A. Blackledge & A. Creese (Eds.), *Heteroglossia as practice and pedagogy* (pp. 179–197). Dordecht: Springer.
- Pietikäinen, S., & Dufva, H. (2014). Heteroglossia in action: Sámi children, textbooks and rap. In A. Blackledge & A. Creese (Eds.), *Heteroglossia as practice and pedagogy* (pp. 59–74). Dordecht: Springer.
- Ricento, T. (2000). Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics*, 4(2), 196–213.
- Rutten, G. (2016a). Historicizing diaglossia. *Journal of Sociolinguistics*, 20(1), 6–30.
- Rutten, G. (2016b). Standardization and the myth of neutrality in language history. *International Journal of the Sociology of Language*, 2016(242), 25-57.
- Schilling, C. (2016). *Heteroglossia online*. Bern, Switzerland: Peter Lang D. Retrieved from <http://ebookcentral.proquest.com/lib/rit/detail.action?docID=4740790>.
- Tsitsipis, L. D. (1995). The coding of linguistic ideology in Arvanítika (Albanian) language shift: Congruent and contradictory discourse. *Anthropological Linguistics* 37(4), 541-577.
- Tsitsipis, L. D. (2003). Implicit linguistic ideology and the erasure of Arvanitika (Greek–Albanian) discourse. *Journal of Pragmatics*, 35(4), 539-558.
- Tsitsipis, L. D., & Elmendorf, W. W. (1983). Language shift among the Albanian speakers of Greece. *Anthropological Linguistics*, 25(3), 288-308.
- Van Parijs, P. (2011). *Linguistic justice for Europe and for the World*, Oxford University Press, Incorporated, 2011. *ProQuest Ebook Central*.
- Vokshi, H. (1959). *Gramatika për klasën e VII e VIII të shkollave fillore*. Prishtinë: Rilindja.

KDU: 81'374.5:908

908.81'374.5(05)

Haki HYSENAJ

ZHDUKJA GRADUALE E VARIETETIT GJUHËSOR TË RUGOVËS

Abstrakt

Me këtë punim mëtojmë të bëjmë përshkrimin e varietetit gjuhësor të folur nga ish-banorët e Rugovës, të cilët kanë migruar në qytetin e Pejës me rrethinë. Rugova shtrihet në perëndim të këtij qyteti dhe deri në vitet e 90-ta ka qenë e banuar gjatë tërë vitit. Banorët e saj kanë folur gegërishten veriperëndimore. Migrimi masiv në qytetin e Pejës dhe në katundet përreth rugovasis i ka vënë përballë rrethanave të reja socio-ekonomike e gjuhësore. Të gjendur në një realitet të ri gjeografik e demografik dhe në kontakte të përhershme me folës të gegërishtes verilindore ish-banorët e këtij visi malor kanë ndryshuar kodin e tyre gjuhësor. Gati në të gjitha situatat folëse rugovasis përdorin gegërishten verilindore. Ndërrimi i kodit nativ me kodin e ri vendës është pasojë e rrethanave të reja socio-ekonomike dhe e kontaktit gjuhësor me varietetin e folur në Pejë me rrethinë.

Hulumtimi në terren tregon se vetëm një pjesë e gjeneratës së vjetër e përdor ende varietetin e vet gjuhësor, por jo si disa vite më parë. Tashmë edhe te ky brez dalin mjaft elemente të varietetit vendës, që është gegërishtja verilindore. Ndërsa dy brezat e tjerë nuk e përdorin më varietetin e prindërve të tyre (gegërishten veriperëndimore).

Megjithatë, ky hulumtim dëshmon se në gjuhën e folur të gjeneratës së mesme mund të evidentohet ndonjë nga ndryshoret karakteristike gjuhësore të së folmes së Rugovës dhe përgjithësisht gegërishtes veriperëndimore, ndërsa në gjuhën e folur të gjeneratës së re nuk ka më gjurmë të varietetit gjuhësor të gjyshërve të tyre. Hulumtimi ynë tregon se mosha e re nuk e ka mësuar ndonjëherë varietetin e origjinës. Madje, sot as prindërit nuk janë të motivuar të përdorimin e varietetit nativ me fëmijët e tyre dhe as nuk përpiqen t'ua mësojnë atë.

Punimi synon që të vërtetojë tezën nismëtare se ky varietet gjuhësor është në fazën e fundit të përdorimit të tij. Faktorët e këtij ndryshimi janë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Të dytët duket se kanë rol rëndësishëm.

Rezultatet e dala nga matjet e bëra në materialin e incizuar për këtë studim vërtetojnë këtë hipotezë.

Fjalë kyçe: e folmja e Rugovës, varieteti gjuhësor, kontakti gjuhësor, zhdukja graduale e varietetit, brezat folës.

Abstract

The purpose of this paper is to describe the linguistic variety spoken by former residents of Rugova, who have migrated to the city of Peja and the surrounding areas. Until recently, Rugova presented the geographical end of the Northwestern Gegë. The former inhabitants of this mountainous area, now found in new geographical and demographic circumstances and in constant contact with the speakers of the Northeastern Gegë, have already changed their language code, thus using the new variety, the Northeastern Gegë, in almost all speaking situations. This code change has come due to among other factors, primarily as a result of linguistic contact with the variety spoken in Peja and the surrounding area. Field research shows that only the older generation intentionally uses its linguistic variety *"to make sense of social encounters"*, while the other two generations, the middle and the young, almost completely eliminated their native variety. While some of the linguistic variables that characterize Rugova's variety can still be identified in the spoken language of the middle generation, the younger generation does not know how to speak this variety at all. This suggests that this variety is gradually disappearing.

The corpus of this research has been compiled on the basis of interviews, conversations and "retellings" by various speakers whose origin, or their parent's origin, is from Rugova.

Keywords: Rugova's variety, linguistic variety, linguistic contact, gradual disappearance of variety.

1. Hyrje

Ky punim duhet konsideruar si vazhdimësi e përshkrimit të nivelit të përdorimit të së folmes së Rugovës nga ish-banorët e saj, të cilët ka më shumë se dy dekada që kanë migruar në qytetin e Pejës dhe katundet përreth tij. Një punim të ngjashëm për këtë të folme e kemi prezantuar 6 vjet më parë, në Seminarin XXXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (Hysenaj, 2016: 183-195). Në atë punim patëm konstatuar se varieteti i gegërishtes veriperëndimore, që përfaqësonte varietetin folës të rugovasve, ishte zvetënuar

shumë dhe se ndodhej në fazën përfundimtare të përdorimit. Punimi i tanishëm shkon më tej dhe qëllim ka përshkrimin kualitativ e kuantitativ të dinamikës së ndryshimit të këtij varieteti gjatë kësaj periudhe kohore.

Ndryshimet gjuhësore janë afatgjate, megjithatë duke analizuar në hollësi situatën gjuhësore brenda dy-tre brezash, këto ndryshime mund të imagjinohen ose edhe të pranohen si “*të mundshme*”, sidomos kur konsiderohet aspekti fonetik i të foluri (Belluscio, 2016:404). Në rastin tonë del se ato kanë qenë të shpejta dhe kanë prekur të dy nivelet gjuhësore, nivelin kuantitativ dhe atë kualitativ, si në planin fonetik ashtu edhe morfologjik. Derisa pak vjet më parë varieteti gjuhësor i Rugovës ende përdorej me fanatizëm nga brezi i vjetër e ndonjëherë edhe nga brezi i mesëm, hulumtimi i tanishëm tregon se tashmë këtij varieteti ia ka zënë vendin varieteti verilindor i gegërishtes dhe në masë të kënaqshme edhe varieteti standard i shqipes. Ekspeditat në terren tregojnë se është një numër simbolik pleqsh që ende e përdorin varietetin e tyre gjuhësor në bisedat brenda llojit, ndërkohë që të njëjtit tashmë përdorin edhe ndryshore të varietetit verilindor. Ky fenomen ndodh në situatat e akomodimit të tyre gjuhësor.

Po ashtu hulumtimi në terren tregon se kemi të bëjmë me zvetënimin maksimal të përdorimit të këtij varieteti, si pasojë e humbjes së kompetencës gjuhësore në nivel komuniteti, proces ky që duket se nuk ka prekur të gjithë folësit në të njëjtën kohë dhe as në të njëjtën masë (Mufwene, 2004:204). Prandaj, zvetënimi kualitativ e kuantitativ, siç del nga të dy hulumtimet tona, ka qenë i shkallëshkallshëm, por i shpejt. Ka prekur gjithë sistemin, deri në ndërrimin e tërësishëm të tij. Rugovasit tashmë gjuhë të përdorimit të përditshëm kanë gegërishten verilindore të përzier me elemente lokale të se folmes së Pejës me rrethinë.

1.1. Rishikimi i literaturës

Për hartimin e këtij punimi është dashur të shfletohen botime që objekt trajtimi kanë pasur të folmen e Rugovës, ndërsa për të krijuar një sfond të teorik për lloje të këtilla studimesh kemi konsultuar literaturë shtesë në gjuhë të huaja. Këto burime lidhen me studimin e varieteteve gjuhësore, me gjuhët në kontakt, dinamikën e ndryshimeve gjuhësore, vdekjen dhe lindjen e gjuhëve.

Me studimin e të folmes së Rugovës janë marrë pak studiues. Përpyekjen e parë për të përshkruar këtë varietet gjuhësor e ka bërë Ahmet Kelmendi (1968) dhe më pas Menduh Begolli (1988). Këta dy autorë konstatojnë se ky varietet, ndonëse i shkëputur tërësisht nga areali i gjuhësor që i takonte dhe në kontakt me varietetin e gegërishtes verilindore, ruante

shumicën e tipareve që e karakterizonin gegërishten veriperëndimore. Konstatim të ngjashëm kishte dhënë edhe gjuhëtarja ruse Agnia Desnickaja (1972). Ajo kishte shkruar me tej, duke precizuar edhe arealin gjuhësor prej të cilit ishte “*shkëputur*” kjo e folme shekuj më parë. Desnickaja kishte precizuar se *e folmja e Rugovës së Pejës kryesisht e brezit të vjetër gjertani ruan karakteristikat themelore të të folmes së veriperëndimit, të malësorëve të Malësisë së Madhe (diftongu ua, kalimi i mb>p, nd>t, kalimi i kl>ki..edhe pse gjendet nën ndikimin e të folmes së popullsisë përreth të Kosovës dhe të Metohisë* (Desnickaja, 1972:111).

Në vitin 1996 kemi punimin e parë gjithëpërfshirës për këtë të folme, botuar në formë monografie nga Adem Hajdaraj (1966). Studimi i tij për këtë të folme është i kompletuar me të dhëna historike, demografike dhe gjuhësore. Në monografinë “*E folmja e Rugovës*” autori sjell shënime të bollshme edhe për shtegtimin dhe ngulitjen e banorëve me prejardhje kelmendase në 13 fshatra të Rugovës në kohë të ndryshme, duke filluar nga shekulli i XII. Njëjtë si Kelmendi e Begolli, edhe Hajdaraj ishte marrë me studimin e gjuhës së banorëve të Rugovës në kohën kur ata jetonin në vendlindjen e tyre.

Në vitet e 90-ta fillon migrimi i madh i banorëve rugovas, ndërsa pas luftës së vitit 1998/9 migrimi në qytetin e Pejës dhe në katundet përreth është masiv. Katundet e Rugovës së Pejës tash janë të banuara vetëm verës dhe më tepër shfrytëzohen për turizëm.

Në vitet e fundit banorët me prejardhje nga Rugova janë duke përjetuar edhe një migrim të tretë. Është gjenerata e mesme ajo që po migron drejt shteteve të Evropës në kërkim të një jete më të mirë.

Krahas ndryshimit të stilit të jetës ish-banorët rugovas në vendbanimet e reja kanë pësuar edhe transformim gjuhësor nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm gjuhësorë e jashtëgjuhësorë, prandaj edhe varieteti i tyre ka përjetuar transformim deri në ndërrim të plotë të tij. Sipas Mufwene, vitaliteti i gjuhëve (në këtë mes edhe i varieteteve) nuk mund të shkëputet nga interesat socio-ekonomike dhe aktivitetet e folësve të tyre (2004).

Studimet e Kelmendit, Begollit dhe Hajdarajt janë kryer në kohën kur folësit e këtij varieteti jetonin në vendbanimet e tyre të përhershme dhe përfaqësojnë gjendjen e atëhershme të vitalitetit e të përdorimit të këtij varieteti, ndërsa dy studimet tona mëtojnë të bëjnë

përshkrimin e dinamikës së ndryshimit gjuhësor që ka ndodhur në këtë varietetin gjuhësor të këtij etniteti të shpërndarë në shumë vendbanime të Komunës së Pejës.

Nga ana tjetër, për të bërë këtë hulumtim është dashur të konsultohen studime bashkëkohore që lidhen me këtë problematikë. Studimet e Crystal (2000), Labov (1987) Tagiamonte (2006), Coupland (2007), Thomson (2001), Stolz, Th. & Bakker, D. & Palomo, S. R (2008) dhe të autorëve të tjerë. Ndonëse shumica prej këtyre autorëve janë marrë më shumë me procesin e rrezikimit të gjuhëve dhe të vdekjes së tyre, megjithatë në shumë raste faktorët që ndikojnë në këto zhvillime janë të njëjtë edhe për ndryshimet dhe fatin e varieteteve gjuhësore të së njëjtës gjuhë.

Rasti i së folmes së Rugovës ka përligjur këtë bindje.

1.2. Pyetjet e hulumtimit

Në këtë studim përgjigje do të marrin këto pyetje:

- a) Cila është gjendja e përdorimit të varietetit të rugovishtes nga ish-banorët rugovas?
- b) A flitet rugovishtja e pastër nga brezi i fundit i përdoruesve të saj?
- c) Cilat tipare këtij varietetit mund i kenë bërë rezistencë varietetit vendës?
- d) A përdoret rugovishtja ende si varietet gjuhësor identitar nga brezi i mesëm?
- e) A insistojnë ende prindërit që t'ua mësojnë varietetin gjuhësor të të parëve të tyre?

2. Metoda

Për realizimin e këtij studimi kemi përdorur këto metoda: metodën e anketës, metodën e intervistës, metodën e analizës kualitative, metodën e analizës kuantitative, metodën statistikore, metodën krahasuese dhe metodën përshkruese

Të gjeturat dhe rezultatet janë produkte të korpusit të këtij punimi, si dhe të analizës e të interpretimit të gjendjes aktuale të varietetit gjuhësor veriperëndimor që flitej nga ish-banorët e Rugovës së Pejës.

2.1. Mostra / Pjesëmarrësit

Edhe për këtë punim është dashur të bëhet punë në terren. Paraprakisht kemi menduar që të shfrytëzonim të njëjtit informatorë që kishim shfrytëzuar për punimin e parë (Hysenaj, 2016:187) mirëpo, ndryshimet demografike të popullsisë kanë pamundësuar këtë gjë, prandaj, duke u bazuar në zgjedhjet e rastit, për këtë punim kemi shfrytëzuar 14 informatorë, banorë të qytetit të Pejës dhe të disa fshatrave përreth. Vetëm tre prej tyre kanë qenë pjesë e hulumtimit të mëparshëm. Shumica e informatorëve jetojnë në fshatra.

Përzgjedhja e informatorëve është bërë në përputhje edhe me faktorët jashtëgjuhësorë, siç janë mosha, gjinia, niveli i arsimimit dhe vendbanimi. Të gjithë këta faktorë kanë rol të rëndësishëm në ndryshimin gjuhësor të gjuhëve e të varieteteve gjuhësore. Të tillë dalin edhe në përshkrimin e këtij varieteti.

Duke konsideruar se në rastin tonë mosha del ndër faktorët kryesorë që reflekton qartë ndryshimin kualitativ e kuantitativ të këtij një varieteti gjuhësor ne kemi shfrytëzuar materialet e incizuara me 14 informatorë (subjekte folëse) moshash të ndryshme. Katër i takojnë brezit të vjetër, pesë brezit të mesëm dhe pesë brezit të ri.

Bazuar në kriterin e gjinisë nga brezi i vjetër dy informatore janë femra e dy meshkuj, ndërsa te brezi i mesëm dhe i ri raportet janë 2 femra dhe 3 meshkuj.

Katër informatorët e brezit të vjetër janë të lindur e të rritur në Rugovë. Kanë migruar në fushën e Pejës në moshë të thyer, ndërsa vetëm 2 nga 5 informatorët e brezit të mesëm kanë lindur në Rugovë. Rininë e kanë kaluar në vendlindje, ndërsa tashti jetojnë në Pejë. Tre të tjerët janë lindur gjithashtu në Rugovë, por si fëmijë bashkë me prindërit janë vendosur në vendbanimet e reja në komunën e Pejës, ku edhe janë shkolluar. Ndërsa, pesë informatorët e brezit të ri janë lindur dhe janë rritur në periferinë e qytetit të Pejës dhe në fshatrat përreth.

2.2. Instrumente(t)

Realizimi i këtij studimi ka kërkuar punë në terren. Është dashur që me informatorët e përzgjedhur të bëhen biseda dhe intervista. Këto aktivitete janë incizuar dhe më pas janë transkriptuar për nevoja studimi. Incizimet janë bërë me aparatën Samsung A7, të cilat pastaj janë transferuar në kompjuterin e tipit Acer. Materiali i incizuar shtrihet në 3 orë e 45 minuta. Për lehtësi interpretimi kemi provuar që edhe në këtë punim të kemi numër të njëjtë

informatorësh dhe kohëzgjatje të njëjtë incizimi (14 informatorë dhe 3.35 minuta incizim). Kjo përzgjedhje është treguar e qëlluar gjatë procesit të identifikimit dhe interpretimit të provave të këtij punimi.

Intervistat dhe bisedat janë shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave të synuara. Intervistat kanë qenë të parapërgatitura, ndërsa bisedat kanë qenë të karakterit spontan. Janë përdorur me informatorët e brezit të mesëm dhe të vjetër, ndërsa ritregimi i përrallave të ndryshme është realizuar me fëmijë. Besohet se të folurit e fëmijëve gjatë ritregimit të përrallave të mësuara në shtëpi ose edhe në shkollë shpërfaqin identitetin (vokacionin) e tyre gjuhësor.

2.3. Procedurat e mbledhjes së të dhënave

Mbledhja e materialit për këtë studim është bërë në mënyrë sporadike në muajin mars dhe prill të vitit 2021. Gjatë kësaj kohe kemi realizuar ekspedita njëditore në disa prej vendbanimeve të reja të ish-banorëve të Rugovës. Ekspeditat janë kryer në lagjet Kristal, Dardania I dhe II dhe në fshatrat: Bllagajë, Qyshk, Nabërxhan, Katund i Ri dhe Vitomiricë. Përzgjedhja e vendbanimeve është e bazuar në përqindjen e banorëve me prejardhje nga Rugova. Janë përzgjedhur vendbanimet me më shumë banorë me origjinë rugovase. Asnjë nga këto vendbanime nuk është i populluar vetëm me popullatë rugovase, që do të thotë se këto vendbanime nuk paraqesin kompaktësi të këtij komunitetit. Megjithatë, ka disa nga këto vendbanime në të cilat popullata rugovase është shumicë dhe në këto vendbanime vërehet një rezistencë më madhe gjuhësore e varietetit nativ.

Disa nga informatorët i kemi njohur edhe më parë (gjithsej 3), prandaj të folurit e tyre ka “*qenë i lirë*” (Belluscio, 2016: 404), gjë që preferohet në studimet e këtij lloji. Në anën tjetër, me disa informatorë e kemi pasur më të vështirë kontaktin, posaçërisht me brezin e fëmijëve. Në raste të kështilla kemi shfrytëzuar ndihmën e ish-studentes sonë, Arizona Lajçi, prindërit e së cilës kanë prejardhje nga Rugova. Arizona është profesoreshë e gjuhës shqipe.

Informatorët janë të koduar me shifrat: A1-A4 (brezi i vjetër), B1-B5 (brezi i mesëm) dhe C1-C5 (brezi i ri).

Intervistat janë hartuar ngjashëm me ato të punimit të përmendur, sepse kemi konsideruar se mbështetja në përvojat e Labov (1984), Váradi&Tomás (1998), Tagiamonte. Sali. A (2006) ka qenë e qëlluar që në punimin e parë (Hysenaj, 2016:187). Gjatë mbledhjes së materialit ndonjëherë kemi bërë reduktime pyetjesh, përshtatje dhe shtim të ndonjë pyetjeje të

re. tyre. Këto ndërhyrje janë bërë për shkak të ndryshimit të rrethanave socio-kulturore e gjuhësore të këtij komuniteti. Pyetjet shtesë lidhen me përjetimet e emocionale të informatorëve.

Bisedat spontane me disa nga informatorët janë realizuar për dy qëllime: i pari konsiston në synimin për identifikimin e ndryshoreve specifike të varietetit në zhdukje, që mund t'i kenë rezistuar kontaktit gjuhësor dhe rrethanave të reja në të cilat jetojnë ish-banorët e Rugovës, ndërsa qëllimi i dytë konsiston në përshkrimin e qëndrimit personal që mbajnë këta folës ndaj varietetit të tyre nativ.

Ekspeditat e planifikuara jo rrallë herë kanë qenë të vështirësuar të realizoheshin për shkak të pandemisë Covid 19. Varësisht nga shëndeti i disa prej informatorëve jo një herë është dashur të ndërrohen jo vetëm datat e planifikuara për ekspeditat njëditore, por edhe disa prej informatorëve me të cilët kishim vënë kontakt më parë. Kjo gjendje e ka vështirësuar paksa realizimin e projektit nismëtar të këtij punimi.

2.4. Analiza e të dhënave

Me qëllim të e përshkrimit të dinamikës së ndryshimit gjuhësor, zvetënimin dhe nivelin e përdorimit të këtij varieteti në rrethanat e reja socio-ekonomike dhe kulturore në të cilat ndodhen tash e tri dekada pjesëtarët e këtij komuniteti, këtë herë kemi përzgjedhur për hulumtim vetëm disa nga ndryshoret më karakteristike të kësaj të folmeje. Duke provuar të caktojmë edhe dendurinë e përdorimit të tyre, kemi insistuar që të identifikojmë tiparet themelore që u kanë bërë ballë ndryshimeve gjuhësore në kushtet e reja në të cilat është gjendur ky varietet gjuhësor.

Bazuar në studimet e mëparshme e folmja e Rugovës në kohën sa përdorej si kod i veçantë gjuhësor nga banorët e 13 fshatrave të Rugovës së Pejës, shquhej për shtatë tipare karakteristike të karakterit fonetik e më pak morfologjik (Hajdaraj, 1996:22).

Autorët që janë marrë me këtë të folme përmendin vetëm infinitivin e vjetër të tipit *me shkua* dhe pjesoren e formuar me togun zanor *-ua*, si dy veçori që këtë të folme e afronin shumë me idiomën e Malësisë së Madhe, veçanërisht me të folmen e Kelmendit dhe të Hotit (Hajdari, 1996:22), ndërsa tiparet e tjera janë trajtuar si të njëjta ose të përafërta me tiparet e të folmeve të tjera të gegërishtes veriperëndimore.

Në këtë punim ne kemi provuar të hetojmë praninë ose jo të grupeve të vjetra konsonantike *kj* dhe *gj*, praninë ose jo të togut vokalik *-ua* në pjesoret e disa foljeve dhe në

disa emra që përfundojnë në rrokje të hapur, si dhe praninë ose jo të infinitivit të vjetër të tipit *me punu*. Këto tri tipare dialektore janë nga më të veçantat e varietetit veriperëndimor që flitej në Rugovë të Pejës, prandaj edhe pritshmëria e daljes së tyre në ligjërimin e folur të pjesëtarëve të këtij komuniteti ishte reale. Siç do të shihet në pjesët në vazhdim, këto tipare dalin në të folurit “e pakontrolluar” ndonjëherë edhe të ndonjë pjesëtar i brezit të mesëm. Gjuha e brezit të vjetër reflekton më së miri rezistencën e këtyre tipareve ndaj gjegjëseve të tyre të varietetit verilindor me të cilin varieteti i tyre nativ është në kontakt për dy ose edhe tri dekada.

Tiparet e tjera, që karakterizojnë këtë varietet gjuhësor, takohen në raste shumë të rralla, prandaj si të tilla kemi konsideruar se nuk paraqesin interes përshkrimi. Në shumicën e rasteve ato janë zëvendësuar me gjegjëset e tyre të varietetit në kontakt, gegërishtes verilindore.

Pra, jashtë interesimit tonë kanë mbetur kësaj here tipari i hundorësisë, gjatësia e zanoreve, si dhe grupet konsonantike *mb, nd, ng* ...

3. Rezultate dhe diskutime

Rezultatet e këtij punimi bazohen në matjet që janë bërë në materialin e incizuar të korpusit të këtij punimi. Ky material është transkriptuar për nevoja interpretimi.

3.1. Brezi i vjetër dhe varieteti nativ

Këtu do të paraqesim ndryshimin gjuhësor që ka ndodhur në gjuhën e folur të brezit të vjetër të ish-banorëve të Rugovës së Pejës, të cilët tani jetojnë në mesin e verilindorëve të qytetit të Pejës dhe të disa katundeve përreth. Dy subjekte folëse janë të gjinisë femërore e dy të tjera të gjinisë mashkullore.

Material i incizuar në formë intervistash me këtë brez është shtrirë në kohëzgjatje prej 45 minutash. Intervistat kanë qenë të parapërgatitura, mirëpo ndonjëherë gjatë procesit të incizimit kemi hequr ose shtuar ndonjë pyetje për efekte të gjeturash sa më përfaqësuese. Këto të gjetura më pas janë shfrytëzuar si prova të mjaftueshme për të nxjerrë përfundime rreth ndryshimit gjuhësor të varietetit gjuhësor rugovas, 20-30 vjet pas migrimit të tyre në një areal tjetër gjuhësor.

3.2. Nga transkriptimi i katër intervistave të realizuara me brezin të vjetër, 2 prej të cilave me subjekte folëse femra të moshës (78-81 vjeç) dhe 2 të tjera me subjekte folëse meshkuj (75-80 vjeç) del se janë përdorur gjithsej 134 ndryshore dialektore, prej të cilave 61 të gegërishtes

veriperëndimore dhe 71 të gegërishtes verilindore. Shprehur në përqindje rezulton se aktualisht vetëm 45.52 për qind e ndryshoreve dialektore në gjuhën e folur nga ky brez janë të varietetit veriperëndimor, ndërkohë që 54.48 për qind janë të gegërishtes verilindore. Kjo jep për të kuptuar se tashmë edhe në gjuhën e brezit të vjetër dendësi më të madhe përdorimi kanë ndryshoret e varietetit vendës.

Vështruar në raport me gjininë del se gratë e moshuara përdorin më shpesh tipare të rugovishtes. Të përgjithësuara, shprehur në përqindje, raportet dalin 58% ndaj 42%. Kjo përqindje shpjegohet me lëvizjet më të pakta të pjesëtareve të gjinisë femërore.

Përshkrimi i frekuencën së përdorimit të tri ndryshoreve të përzgjedhura për interpretim, pavarësisht kriterit të gjinisë, pasqyron përdorimin më të shpeshtë të infinitivit të vjetër të tipit **me punua** (62.2%), pastaj të grupeve të vjetra konsonantike **kj** dhe **gj** (21.3%) dhe në fund të pjesores me **-ua** (16.3%).

Megjithatë, edhe në gjuhën e folur të këtij brezi, që përfaqëson gjeneratën e fundit të folësve të rugovishtes, përdorimi i këtyre tipareve nuk është gjithmonë konsekuent. Në vend të tyre, në situata të caktuara, dalin ndryshoret gjegjëse verilindore. Kjo ndodh në bisedat midis rugovasve dhe vendorëve. Matjet tregojnë se kjo dukuri është në rritje dhe rezulton si pasojë e kontaktit gjuhësor dhe e prirjes së këtij brezi për akomodim gjuhësor. Përqindjet e dhëna dëshmojnë për ndryshimin e shpejtë gjuhësor që është duke ndodhur edhe te brezi i fundit i folësve të varietetit gjuhësor të rugovishtes.

3.3. Varieteti gjuhësor i brezit të mesëm

Këtu do të përshkruhet gjuha e folur e brezit të mesëm. Dy nga informatorët e intervistuar për këtë qëllim janë të lindur e të rritur në Rugovë, prandaj në të folurën e tyre ndonjëherë dalin ndryshore të varietetit të origjinës, ndërsa gjuha e tre informatorëve të tjerë është gegërishte verilindore e përzier me elemente të varietetit lokal dhe të tjera të standardit të shqipes.

Dy e parë kanë jetuar në këtë në Rugovë deri në moshën 25-vjeçare. Gjatë kësaj kohe kanë kryer edhe fakultetin në Prishtinë. Në pyetjen nëse e përdorin ende në komunikimin e tyre të lirë varietetin e tyre nativ që të dy janë përgjigjur negativisht. Thonë se e flasin vetëm në situata kur duan që të folurit e tyre *t'u japë kuptim takimeve sociale brenda llojit* (Coupland, 2007:3-10). Shprehen se ndonjëherë provojnë të komunikojnë në rugovishte, porse pranojnë se përdorimi i këtij varieteti tashmë u sjellë telashe. Megjithatë, njëri prej tyre (B1) ka deklaruar

se e flet rugovishten, pavarësisht vështirësive nga ndikimi i varietetit vendës, sa herë që synon të dalë fitimtar në ndonjë debat të caktuar. “*Për me fitua betejën flasi rugovisht*”-shprehet B1.

Tre informatorët e tjerë, përfaqësues të këtij brezi, kanë lindur në periferinë e qytetit të Pejës. Prindërit e tyre kanë migruar në Pejë në fillim të viteve të 90-ta. Mësimet fillore dhe të mesme i kanë kryer në qytet, ndërsa kanë diplomuar në disa drejtime të ndryshme në universitetet e Pejës dhe të Gjakovës. Dy prej tyre janë femra.

Me këta informatorë/e kemi realizuar edhe anketa të ndryshme. Anketimi është bërë përmes “*ndërmjetësve*”. Ato janë bërë me qëllim të përshkrimit edhe të qëndrimit të këtij brezi ndaj ish-varietetit të origjinës. Incizimi i intervistave, anketave dhe bisedave të lira me këta informatorë shtrihet në 2.35 minuta kohëzgjatje.

Për hulumtim kemi përzgjedhur ndryshoret e njëjta me ato të brezit të vjetër, sepse kemi konsideruar se janë tipare tipike të varietetit që e kanë folur vetë (së paku 2 prej tyre) ose vetëm e kanë dëgjuar nga prindërit. Vlen për të theksuar se asnjëri nga dy grupet e këtij brezi nuk e përdor varietetin e origjinës. Të dy grupet, pavarësisht situatave folëse dhe pjesëmarrësve në to, tashmë e flasin gegërishten verilindore të përzier me tipare të varietetit lokal dhe tipare të tjera të gjuhës standarde. Të gjithë informatorët e kësaj moshe kanë të kryer shkollimin e lartë në drejtime të ndryshme, prandaj edhe ishte e pritshme që e folura e tyre të kishte prirjen e zëvendësimit më gjuhën standarde. Për këtë hulumtim nuk kemi mundur të gjejmë subjekte folëse të kësaj moshe të paarsimuar.

Duke qenë se interesimi ynë lidhej edhe me përshkrimin e nivelit të përdorimit kuantitativ e kualitativ të varietetit gjuhësor të origjinës edhe te ky brez jemi përqendruar në përshkrimin e tri ndryshoreve të përzgjedhura e të markuara si karakteristike për rugovishten.

Analiza e gjuhës së folur e dy informatorëve të parë (B1 dhe B2) tregon se rrallë herë përdorin ndryshoret e përmendura, që karakterizojnë varietetin e tyre nativ. Përdorimi i infinitivit i tipit **me punua** del më i shpeshtë krahasuar me dy ndryshoret e tjera. Nga 32 rastet e përdorimit të kësaj trajte foljore në variante të ndryshme, informatori me siglën B1 e përdor 11 herë (34.37 %), ndërsa B2 vetëm 9 herë (28.12 %). Rastet e tjera janë përdorime të ndryshores gjegjëse e varietetit verilindor të tipit **me punu/e**. Në gjuhën e folur të këtyre dy informatorëve këto dy variante nuk dalin raporte konkurruese mes veti. Dominojnë trajtat e varietetit vendës e ndonjëherë del edhe trajta e standardit. Infinitivi i standardit (*për të punuar*) te informatorit B1 del në 6 % të rasteve, kurse te informatori B2 del në 4 % të rasteve të rasteve të përdorimit të tij. Ky përshkrim pasqyron varietetin e përdorur në situata joformale.

Dy ndryshoret e tjera shpërfaqen shumë më pak në intervistat e bëra me këta dy informatorë. Grupet *kj* dhe *gj* dalin në përqindje të papërfillshme, ndërkohë që pjesorja me *ua* del vetëm në 3% të rasteve të përdorimit saj. Në të dy rastet e përshkruara dominojnë trajtat e gegërishtes verilindore.

Tre informatorët e tjerë, që përbëjnë grupin e parë të këtij brezi (mosha deri 30 vjet), dy prej të cilave i takojnë gjinisë femërore, e kanë zëvendësuar plotësisht varietetin e origjinës me varietetin vendës të përzier edhe me trajta të shumta të gjuhës standarde. Kjo situatë duket se është rrjedhojë e qëndrimit të tyre për të mos u dalluar gjuhësisht nga komuniteti i ri me të cilin jeton, si dhe nga ndikimi që ka bërë shkolla, mediet, rrethi shoqëror dhe zhvillimet industriale e teknologjike që kanë shoqëruar këtë brez (Munishi, 210: 2).

Kontakti i gjatë dhe ndjenja e të qenit të barabartë me popullatën vendëse edhe në planin gjuhësor te ky etnitet ka derivuar konvergjencën gjuhësore, me ç'rast me gjasë fillimisht ka ndodhur përafrimi e më pas edhe ndërrimi i tërësishëm i varietetit nativ, varësisht nga brezat që e folësve.

Në pyetjen se pse nuk e flasin varietetin e origjinës informatorët e këtij brezi janë përgjigjur se nuk e dinë mjaftueshëm ose hiç. Ky pohim na dërgon në konstatimin se tashmë ky grup i këtij brezi folësish nuk është më në situatë diglosie.

3.4. Varieteti gjuhësor i brezit të ri

Përshkrimi gjuhës të brezit të ri nuk ka qenë i vështirë. Transkriptimi dhe përshkrimi i materialeve të incizuara me 5 subjektet folëse të kësaj grupmoshe jep për të kuptuar se ky brez përfaqëson brezin e parë që nuk e di gjuhën e të parëve, rugovishten. Të gjithë e flasin gegërishten verilindore me prirje të përvetësimit gjithnjë e më të madh të gjuhës standarde. Siç do të shihet me poshtë, ata paraqesin brezin e parë që identifikon shuarjen e një varieteti të caktuar gjuhësor për një pjesë të etnitetit që gjuhësisht i takonte gegërishtes veriperëndimore.

3.5. Interpretimi i incizimeve të gjuhës së folur nga informatorët fëmijë (nxënës shkollash fillore) nuk ka pasur si të përqendrohet në përshkrimin e ndryshoreve të përzgjedhura për hulumtim, pasi që të gjithë nxënësit e incizuar kanë bërë ritregimet e kërkuara në gjuhën standarde, të përzier me pak elemente të gegërishtes verilindore. Materiali i incizuar është shtrirë në 65 minuta. Subjektet folëse kanë ritreguar përrallën “*Kësulëkuqja*” dhe “*Borëbardha dhe shtat xhuxhët*”, ndërkohë që për qëllime studimi janë shfrytëzuar edhe sekuenca të caktuara nga bisedat e lira me ta.

Incizimet kanë shpërfaqur përdorimin e gjithsej 60 ndryshoreve të varietetit të gegërishtes verilindore. Në 65% të rasteve kanë përdorur paskajoren e gegërishtes të tipit *me punu/e*, ndërsa në 35% të rasteve kanë përdorur trajtën standarde *për të punuar*.

Në asnjë rast nuk kanë dalë 3 ndryshoret karakteristike të rugovishtes, të trajtuara në këtë punim. Gjuha e këtyre fëmijëve përafrohet shumë me varietetin standard të shqipes, ani pse me një vokal dominues të varietetit vendës.

Kjo situatë reflekton të dhënë se brezi i ri nuk e di fare varietetin e origjinës. Këtë varietet nuk e ka mësuar as nga prindërit pasi edhe ata e kanë bjerrë atë dhe nuk shohin arsye që fëmijët e tyre ta zënë rugovishten. Prandaj, duket se tashmë është shkëputur hallka transmetuese e këtij varieteti prej një brezi në brezin tjetër. Dhe këtu fillon shuarja e këtij varieteti.

4. Përfundimet

Ndryshimi gjuhësor që ka ndodhur në varietetin e gegërishtes së folur nga ish-banorët e Rugovës së Pejës brenda një periudhe jo të gjatë kohore jep për të kuptuar se, përveç faktorëve gjuhësorë edhe faktorëve jashtëgjuhësorë, shpesh janë vendimtarë për transformime të këtij lloji. Këta faktorë, si në këtë rast, jo vetëm që ndikojnë në “*përzierjen*” varieteteve gjuhësore si rezultat edhe i kontaktit, por si të tillë ndikojnë edhe në bjerrjen, zvetënimin dhe ndërrimin e tërësishëm të një varieteti, duke e markuar atë si “**varietet në proces të zhdukjes graduale**” ose edhe si varietet “**të vdekur**” për një pjesë të një etniteti të caktuar. Ky ndryshim gjuhësor ka ndodhur edhe në varietetin gjuhësor të ish-banorëve të Rugovës, të cilët gjuhësisht i përkisnin gegërishtes veriperëndimore.

Migrimi masiv i rugovasve në rrafshin e Pejës dhe faktorët e përmendur kanë bërë që varieteti i tyre nativ, që ishte kontinum i gegërishtes veriperëndimore, të lihej anash nga folësit e saj e në vend të tij të përdorej varieteti vendës, d.m.th. gegërishtja verilindore, e cila me kohë është bërë varietet standard për të paktën dy brezat e ri të këtij komuniteti.

Vështruar në korrelacion me faktorët jashtëgjuhësorë, siç janë: mosha, gjinia, arsimimi dhe vendbanimi del se tani edhe brezi i vjetër ka nisur t’i përshtatet akomodimit gjuhësor në bisedat me brezin e vet vendës. Përqindjet e përmendura për tri ndryshoret e përcaktuara tregojnë se ka rënë frekuenca e përdorimit të tyre nën 50 për qind të rasteve të përdorimit të ndryshoreve dialektore në gjuhën e përditshmërisë, gjë që flet për përdorimin gjithnjë e më të tkurrur të këtij varieteti edhe nga ky brez. Nga ndryshoret e hulumtuara duket se vetëm infinitivi i vjetër

i tipit me punua duket se i ka bërë më shumë rezistencë kontaktit gjuhësor me varietetin vendës që është me prestigj në këtë areal gjuhësor.

Brezi i vjetër ende mbetet i fundit që përdor varietetin nativ, por me tendenca numerike të zvogëlimit gradual. Sipas Holms (2015:261) brezat që kultivojnë raporte të ngushta farefisnie ka të ngjarë të rezistojë më shumë në përdorimin e varietetit nativ. Kjo dukuri vazhdon së ekzistuari gjithnjë përderisa të ndodhë ndërrimi i brezave. Hulumtimi tregon se edhe ky brez ka “lëkundje” sistematike në përdorimin e varietetit nativ, si pasojë e kontaktit gjuhësor dhe e faktorëve të tjerë ekonomikë e socialë.

Brezi i mesëm e flet varietetin e gegërishtes verilindore që flitet në këtë areal gjuhësor. Disa nga pjesëtarët e këtij brezi e dinë varietetin e vendlindjes (B1 dhe B2), mirëpo tashmë nuk e përdorin. Në pyetjen se nëse e përdorin ndonjëherë varietetin e origjinës shprehen pozitivisht, duke theksuar se përdorimi i tij lidhet me situatat kur duan që t’u japin kuptim takimeve sociale. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe pjesëtarët e brezit të vjetër. Në këtë grup bëjnë pjesë subjektet folëse që kanë lindur në Rugovë, ndërkohë që në qytetin e Pejës me rrethinë kanë migruar pas luftës së fundit 1998/99. Janë të moshës 50/54 vjeçare, ndërsa subjektet e tjera folëse të këtij brezi, të lindur e të rritur në Pejë (mosha deri në 30 vjet) shprehen se pak ose fare nuk e dinë gjuhën e të parëve të tyre. Varieteti i tyre gjuhësor është gegërishtja verilindore me shumë elemente të gjuhës standarde.

Ndërkaq, gjenerata e re nuk e di fare këtë varietet. Kjo gjeneratë paraqet hallkën e parë të shkëputjes së transmetimit të këtij varieteti gjuhësor nga prindërit te fëmijët e tyre. E njëjta gjendje mund t’i përshkruhet edhe brezit të parë të gjeneratës së mesme, i cili nuk e di fare varietetin gjuhësor të prindërve pasi që nuk e ka mësuar në ambientet familjare. Mësimet e Labov-it saktësojnë se këto situata shënojnë zhdukjen e plotë të një gjuhë a të një varieteti të caktuar.

Migrimi i tashëm i të rinjve të këtij komuniteti drejt qendrave evropiane ka rralluar edhe më shumë kontaktin midis pjesëtarëve “*të të njëjtit lloj*”, prandaj është bërë më i zorshëm edhe komunikimi në varietetin e origjinës edhe për ata pak pjesëtarë të këtij komuniteti që e dinë pjesërisht këtë varietet.

Gjuhëtari Crystal (2000:11) e përshkruan një gjuhë të rrezikuar nëse flitet nga më pak se 100 persona. Pleqtë e intervistuar nuk kanë mundur të numërojnë më shumë se 50-57 persona të moshuar rugovas që jetojnë në periferi të Pejës dhe në katundet përreth, prandaj ky varietet

është duke shkruar drejt zhdukjes së plotë për pjesëtarët e këtij komuniteti. Me terminologjinë e përdorur nga Lyle Cambell dhe Martha C. Muntzel mund të përfundohet se varieteti i rugovishtes tashmë është në proces të “*vdekjes graduale*”.

Bjerrja graduale e varietetit të rugovishtes tashmë ka marrë dinamikë më të përshpejtuar. Ish-folësit e saj nuk e ndiejnë më të nevojshëm përdorimin e varietetit nativ, pasi që e kanë kuptuar se brezi i ri nuk është i interesuar të fitojnë kompetencë gjuhësore nga një varietet që i stigmatizon ata në mesin e shumicës.

Kjo situatë përshkruhet si asimilimin ndërbrezor gjuhësor, që nënkupton se edhe prindërit nuk insistojnë më që varietetin e tyre nativ ta bartin te fëmijët e tyre. Në anën tjetër numri i folësve aktivë të këtij varietetit është duke u zvogëluar në mënyrë dinamike, prandaj këmbimi i varietetit nativ me atë të vendbanimit të ri për ish-rugovasit është realitet i pakthyeshem.

Referencat

Hysenaj, H. (2016/a). *Varieteti në zhdukje, rasti i së folmes së Rugovës, (në SeminariXXXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare)*, Prishtinë

Belluscio, G. (2016/a). *Varietete/variante fonetike “tendenciale” në përdorimin e kontrolluar të shqipes standarde në një emision televiziv të sotëm, (në SeminariXXXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare)*, Prishtinë

Mufwene, S. (2004/a). *Language Birth and Deat, The Anual of Antropology*, <http://anthro.annualreviews.org>

Kelmendi, A. (1968) *Veçoritë e krijimtarisë popullore të Rugovës në pikëpamje fonologjike, (në Përparimi, 3/1968)*, Prishtinë

Begolli, M . (1988). *Të folmet e Rugovës me disa veçori të veta (në Përparimi, 5/1988)*. Prishtinë

Desnickaja, A. (1972/a). *Gjuha shqipe dhe dialektet e saja*, Prishtinë

Desnickaja, A. (1972/b)

Hajdaraj, A. (1966/a). *E folmja e Rugovë, Etruria*, Prishtinë

Mufwene. S. (2003/b)

Crystal. D. (2000/a), *Language death*, Cambridge University Press

Labov, W. (1984). *Field Methods of the projects on Linguistic Change and Variation*, (në: <http://www.ling.upenn.edu>)

Tagliamonte. S. (2006), *Analysing Sociolinguistic Variation*, Cambridge University Press, New York, (në: [http://www.cambridge.org/linguistics/...](http://www.cambridge.org/linguistics/))

Coupland, N. (2007/a), *Style, Language Variation and Identity*, Cambridge University Press.

Thomson, G. S. (2001). *Language contact*, Edinburgh University Press

Stolz, Th. & Bakker, D. & Palomo, S. R (2008), *Aspect of Language Contact*, Berlin. New York

Hysenaj, H. (2016/b)

Belluscio, G. (2016/b)

Belluscio, G. (2016/c)

Hysenaj, H. (2016/c).

Hajdaraj, A. (1996/b).

Coupland, N. (2007/a). *Style, Language Variation and Identity*, Cambridge University Press.

Hajdari, A (1996/c)

Coupland, N. (2007/b).

Munishi, Sh. (2010). *Gjuha standarde shqipe dhe konvergjenca e gjuhës së folur*,

Holms, J. (2015). *Hyrje në sociolinguistikë*, Pegi, Tiranë

Crystal, D. (2000/b)

TRYEZA E DOKTORANTËVE

KDU: 811.18'367 (05)

Lirodona MEHMETI

LIDHORJA NË RRAFSH HISTORIK

Abstrakt

Lidhorja, historikisht, paraqet një trajtë shumëdimensionale si për nga kuptimi, ashtu edhe për nga përdorimi i trajtave të saj. Shprehimisht, trajtat e lidhore paraqesin veprime që pritet të ndodhin, si të mundshme e të dëshirueshme, që janë të varura e të lidhura për një kusht (J.Rrota 1943, E.Çabej 1986, S.Riza 1997, K.Topalli 2010). Si rrjedhim i kësaj, S.Frashëri, lidhoren e ka quajtur mënyrë e varme, kurse S.Riza e emërton si nënrendore, që përbën një kalk nga greqishtja (*egklisis hypotaktike*), përkatësisht nga latinishtja (*modus subjunctivus*). Pra, format e lidhore paraqesin varësi dhe i referohen termit konjuktiv ose nënrendor.

Ndërkaq, sa i përket zanafillës së formave të lidhore, gjithsesi lidhorja ka zhvilluar format kohore nën ndikimin analogjik të mënyrës dëftore. Mirëpo, karakteristikë e ndërtimit të lidhore është pjesëza analitike të, që i dallon format e lidhore nga dëftorja: *të shkojmë-shkojmë, të shkonim-shkonim, të kemi shkuar-kemi shkuar, të kishim shkuar-kishim shkuar* (Sh.Demiraj 2015, K.Topalli 2010).

Ky punim është teorik, duke analizuar vështrimet teorike që janë bërë për historikun e lidhore. Ndërsa, sa i përket metodologjisë së këtij punimi, mbështetemi në metodën cilësore, metodën e analizës dhe të krahasimit.

Fjalët çelës: lidhorja, nënrendore, trajtat e lidhore, rrafsh historik, zanafilla e lidhore.

Abstract

The connective historically represents a multidimensional form both in terms of meaning and in terms of the use of its forms. Explicitly, connective forms represent actions that are expected to occur, as desirable as possible, that are dependent and related to a condition (J.Rrota 1943, E.Çabej 1986, S.Riza 1997, K.Topalli 2010). As a result, S.Frashëri has called the connective a dependent mode, while S.Riza names it as a subordinate, which constitutes a calc from the Greek (*hypotactic egklisis*), respectively from the Latin (*modus subjunctivus*). Thus, connective forms are dependent and refer to the connective or subordinate term.

Meanwhile, regarding the origin of the forms of the connective, however, the connective has developed time forms under the analogical influence of the indicative mode. However, a characteristic of the construction of the connective is the analytical part *of*, which distinguishes the forms of the connective from the indicative: *to go-go, to go-go, to have gone-we have gone, to have gone-we had gone* (Sh.Demiraj 2015, K.Topalli 2010).

This paper is theoretical-research, because in addition to the theoretical overview we have the research part, which consists of different texts as part of the research corpus. As for the methodology of this paper, we rely mainly on the empirical method and analysis.

Keywords: connective, subordinate, connective of forms, historical plane, connective of origin

1. Hyrje

Në këtë punim trajtojmë lidhoren (konjuktivin) në rrafsh historik, e cila paraqet një trajtë shumëdimensionale, si për nga kuptimi, ashtu edhe për nga përdorimi i trajtave të saj. Shprehimisht, trajtat e lidhores paraqesin veprime që pritet të ndodhin, si të mundshme e të dëshirueshme, që janë të varura e të lidhura për një kusht (J.Rrota 1943, E.Çabej 1986, S.Riza 1997, K.Topalli 2010). Si rrjedhim i kësaj, me anë të këtij punimi kemi për qëllim ta analizojmë lidhoren kronologjikisht, duke marrë për bazë vështirimet e gjuhëtarëve.

Sipas E.Çabejt (1986:109), mënyrat kryesore, në të cilat shfaqet folja në gjuhët, historikisht, të dokumentuara janë: *dëftorja (indikativi)*, *lidhorja (konjuktivi)*, *dëshirorja (opativi)* dhe *urdhërorja (imperativi)*. Ndërsa, S.Frashëri, lidhoren e ka quajtur mënyrë e varme, ndërkaq S.Riza e emërton si nënrendore, që përbën një kalk nga greqishtja (*egklisis hypotaktike*), përkatësisht nga latinishtja (*modus subjunctivus*). Pra, format e lidhores paraqesin varësi dhe i referohen termit *konjuktiv* ose në shqip termi *nënrendor*.

Ky punim është teorik, duke analizuar vështirimet teorike që janë bërë për historikun e lidhores. Ndërsa, sa i përket metodologjisë së këtij punimi, mbështetemi kryesisht në metodën cilësore, metodën e analizës dhe të krahasimit.

1.1. Rishikimi i literaturës

Sistemi foljor në gjuhët indoevropiane, me ç' rast bën pjesë edhe shqipja, paraqitet me pesë kategori kuptimore, formale apo trajtore, si: gjininë, numrin, vetën, kohën, mënyrën (E.Çabej, 1986:109). Nga këto kategori kuptimore dhe gramatikore, sipas S.Rizës (1997:127), më e ndërlikuara për ta përkufizuar gramatikusht del të jetë kategoria e mënyrës, pasi brenda saj nuk ka ndonjë lidhje përgjithësuese, domethënë pa u inkuadruar më parë brenda një përkufizimi të mënyrës foljore në përgjithësi, si dhe për shkak të abstrakticitetit të konceptit mënyrë.

J.Rrota (1943:46), pohon se mënyra lidhore nuk është e shkëputur më vete, por e varur ose e lidhur për ndonjë kusht. Sipas tij, pothuajse në shumicën e herave lidhja shpreh një mendim si dëshirë ose për një gjë që mund të jetë ose pritët të ndodhë. Si rrjedhim i kësaj, lidhja shpeshherë përfshin edhe të ardhmen e kushtoren për nga kuptimi që shprehin format e saj, për shembull: *të shkojmë, të lexoni, të mendojnë*.

Sipas E.Çabejt (1986:109), lidhja shpreh një veprim eventual, një veprim që pritët të ndodhë, mendohet ose dëshirohet të ndodhë. Gjithashtu, edhe W.Cimochowski (2004:228), vlerëson se lidhja në gjuhën shqipe shërben kryesisht për të shprehur mundësinë. Sipas tij, përdorimi i kësaj mënyre në fjali shpreh, pothuajse gjithmonë nocionin e mundësisë, ose një veprim që është paramenduar.

Kurse, S.Riza (1994:213) pohon se vlerat kryesore që i njihen mënyrës lidhore apo nënrendore përmbledhen në idenë e një veprimi të interpretuar ose të paraqitur subjektivisht nga folësi/ja sipas asaj që ky veprim përbën objektin, për shembull të një vendimi, këshillimi, parashikimi, urdhërimi, supozimi, kufizimi, përlejimi. Në anën tjetër, vargëzimi i shtatë funksioneve a vlerave të kësaj mënyre foljore, kurrsesi nuk përbën një përkufizimi të saj, sepse në bazën e cilësdo kategori kuptimore duhet vënë një koncept themelor. Për më tepër, shtatë funksionet a vlerat e lidhore shprehen jogramatikusht nga vetë ajo, por leksikalisht nga foljet në fjalitë kryesore. Vetëm në këtë kontekst mund të përlegjet përkufizimi i mënyrës në shqyrtim. Përkundrazi, me mënyrën lidhore (nënrendore) folësi/ja shpreh ekzistencën e një objekti të dhënë, përkatësisht ekzistencën e një fenomeni përkatës, kundrejt mënyrave të tjera, me anë të cilave shprehim kryesisht cilësime kufizuese, si: *habi, kusht, dëshirë, urdhër* (1994:213).

1.2. Pyetjet e hulumtimit

Lidhorma, historikisht, a paraqet trajtë mënyrore apo modalitet brenda sistemit foljor të shqipes?

2. Struktura e punimit

Sa i përket strukturës, ky punim ka tri pjesë kryesore; pjesa e parë ka hyrjen, duke përfshirë rishikimin e literaturës, pyetjet e hulumtimit, metodologjinë; pjesa e dytë përfshin zhvillimin e punimit, në të cilën kemi paraqitur vështrime për lidhoren dhe për zanafillën e saj nga gjuhëtarët e ndryshëm, si dhe pjesa e tretë përfshin përfundimet dhe referencat.

2.1. Nëndarja- pjesët e numëruara

1. Hyrje;

1.1. Rishikimi i literaturës;

1.2. Pyetjet e hulumtimit;

2. Struktura e punimit;

2.1. Nëndarja- pjesët e numëruara;

3. Metoda;

3.1. Mostra/Pjesëmarrësit;

3.2. Instrumentet;

3.3. Procedurat e mbledhjes së të dhënave;

4. Diskutime

4.1. Vështrime për lidhoren;

4.2. Zanafilla e lidhores;

5. Përfundimet;

6. Referencat

3. Metoda

Për realizimin e këtij punimi kemi përdorur metodën cilësore; të analizës dhe të krahasimit, me ç'rast kemi analizuar trajtat e lidhore në rrafsh historik, duke marrë për bazë studimet paraprake të gjuhëtarëve.

3.1. Mostra/Pjesëmarrësit

Artikujt që kemi marrë për shqyrtim për këtë punim janë kryesisht libra studimorë të fushës së gramatikës, si: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* e Shaban Demirajt, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike* nga Besim Bokshi, *Studime gjuhësore* nga Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore* nga Eqrem Çabej, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore* nga Selman Riza, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe* nga Kolec Topalli, *Sintaksa e gjuhës shqipe* nga Justin Rrota.

3.2. Instrumente(t)

Meqë ky punim është teorik, si instrumente për realizimin e punimit kemi marrë studimet gramatikore që kanë trajtuar lidhoren, përkatësisht format e saj.

3.3. Procedurat e mbledhjes së të dhënave

Vështtrimet teorike të gjuhëtarëve për lidhoren i kemi analizuar dhe krahasuar, duke i paraqitur e sintetizuar të gjeturat e tyre në pjesët e punimit tonë, pasi i tërë punimi është një përmbledhje teorike për lidhoren në rrafsh historik sipas këndvështrimeve të gjuhëtarëve, të cilët kanë bërë studime për të.

4. Diskutime

4.1. Vështirime për lidhoren

I.Ajeti (1978:11,16), paraqet një vështrim mbi përdorimin e lidhore apo koniunktivit në dy kryedialektet e shqipes- toskërishten dhe gegërishten, duke marrë shembujt nga veprat e shkrimtarëve të letërsisë së vjetër, publicistikës, emisionet e radios, teatrit dhe tekstet e nxënësve.

...Për këtë a ka mundësi me ba publikun për vehte dhe me e sjellë kush **të don** dhe kah **të don**, në vend që ta përdorte **kush të dojë** dhe **kah të dojë**... (Rilindja, 1951, nr.74, fq.3)

“...E ai që të **të mallkonjë** të jetë mallkuom... Ngrehu ati em, e na ngajetsë birit tit: për se **të më bekonjë** shpirti i yjt. (I.Rrota, monumenti më i vjetër i gjuhës shqipe: Gjon Buzuku, fq.18, Shkodër, 1938).

“...E mos **të vinjë** fështirë me uruom për muo...” (Pjetër Budi, Shkrimtarë shqiptarë, I, Tiranë, 1941)

“...Mbasi të lenjë njeri, hana, ka forcë e ruen ndjerë mbë katër vjet...” (P.Bogdani, Shkrimtarë shqiptarë, I, fq.56).

J.Gjinari (1989:69), në studimin për degëzimin historik të dialekteve të shqipes paraqet veçoritë e hershme që dallojnë dialektet, ndër të cilat përmend edhe lidhoren, e cila në dialektin e toskërishtes kryen funksionin e paskajores geqe, p.sh., *me punu - të punoj*, që konsiderohet njëra prej dallimeve relevante e absolute ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes. Lidhur me këtë, edhe R.Ismajli (2003:53), vlerëson se funksionet sintaksore të paskajores në toskërishten dhe në gjuhën standarde rimerr nga lidhorja, të cilën e ka edhe gegërishtja. Sipas tij, shqipja standarde ashtu si toskërishtja, për shkak se nuk e ka paskajoren e tipit *me punue*, i përdor format e lidhores ndjeshëm më dendur, ndërsa gegërishtja përmes përdorimeve shumë më të dendura të paskajores ka zhvilluar mundësitë e shprehjes sintaksore dhe stilistike në këtë drejtim.

Shembuj:

Duhet **me** punue, pra. Do gjetë ilaçi i kësaj sëmundjeje.

Punon **pa** ia ditë për nder. Mos u nis **pa** u pa **me** mue.

Pra, fjalëzat **pa** dhe **me** funksionojnë si opozita, mirëpo parafjala **me** u bë pjesë e paskajores.

S.Riza (1994, cit.sipas Ismajlit, 2003:54), paraqet dallimin e përdorimit të lidhores dhe paskajores midis toskërishtes dhe gegërishtes.

Dëshiroj që mbasi të kem mbushë moshën madhore **të lejohem me sprovue** forcat...

Ti **të punosh**: do të punosh dhe do me punue. E di se kam me shkue, por a **të shkoj** se?

4.2. Zanafilla e lidhore

Sipas Sh.Demirajt (1988:865), lidhorja është një nga mënyrat e trashëguara të gjuhës shqipe, e cila gjatë zhvillimit historik të kësaj gjuhe ka pësuar ndryshime largvajtëse si nga ana kuptimore dhe funksionale, ashtu edhe nga ana formale. Këto ndryshime janë përfutur qysh në periudhën parashkrimore të gjuhës shqipe, e kjo del e qartë po të krahasohet gjendja e sotme e kësaj gjuhe me atë të veprave të shkrimtarëve tanë më të vjetër dhe të të folmeve arbëreshe të Greqisë e të Italisë.

Te Buzuku: A mundë [= mund të] jetë se përherë ti të na mënihesh? O a mundë [= mund të] ndenjesh mëninë tande për fare të farësë sanë?... e përse mundë [=mund të] shofsh bijtë e bijet tuve... përse na për katetë tonë s`mundë [= mund të] të pëlqejmë. E pritnë një ditë të ngaeshime qi të muna [- të mund ta] vgjanjënë vetëmë. (f.15, 23, 165)

E këta aj e ban përse atë munda [= mund ta] nxir n`duorshit së tynesh... E lypnë si të muna [= të mund ta] zinjinë...; ...e ish aqë shtrembënë, sá má nuké mundë [= mund të] ndëreqë. (f. 145, 305)

Te Budi: ...a muna [= mund ta] dish ti...; se si e mbë qish arrësye mundë [= mund të] ndigjonetë këjo...; si mundë [= mund të] jëtë...; mun [= mund të] epetë...; ku munë [= mund të] gjindetë.....; ó ku të munë [= të mund të] gjindishnë sytë e korpit. (DC 6,7,8).

Te Bogdani: ...nukë mundetë me qëndruem... as nukë munë [= mund të] shelbenjë... Munë [= mund të] thoemi se ndër dhe të Arbënit... (Parathënia e veprës)

Format e mënyrës lidhore në shqipen e dokumentuar përdoren në fjali të pavarura kryesore, edhe të pashoqëruara me ndonjë folje modale, me të cilat në përgjithësi shprehin kuptimin e së ardhmes.¹ Mirëpo, format e lidhore, në rrafsh sintaksor i hasim edhe nëpër fjali të varura-nënrenditëse; qëllimore, kushtore, kryefjalore a kundrinore, që shpesh iu paraprin ndonjë lidhëz nënrenditëse. Shembuj:

Buzuku: E këta je tue bám, zotynë ka me shtuom ndër jú, se të korëtë taj të nglatetë djerie n së vjelash... E u ma duo të mbaronj vepërënë teme... E se për fat në keshë kund mbë ndonjë vend fëjyem, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë má i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë nde e mirë, (f.387). Duol i ati jashtë, e lutën të hín (f.149). Këtu itëni djerie u të kthenj

¹ Po aty, f. 872.

tek ju (f.127). E kur **të vinjë** ata qi anshtë má se të mirë, atëhere ata qish për pjesë anshtë, ká me ardhunë mé. (f.111).

Budi: Sá má **të fëdigësh**, aqë má mirë ke me i mbaruom gjithë kafshëtë...tue i lutunë qi për gjith arrësye **të shtampohetë**...; ...e rekumendonj e porësit ndë dorë të zotënisë sáj posi miqet t`dashunë për ndër, kafshënë ma të dashunënë, qi të keshë përmbí dhét, ashtu qi, ndónése me pak fëdigë mbasi **ta kini** bukurë ndëgjuom, t`ini të zotë jo veçese me e porësitunë e me rrekumenduom... (SC, Parathënia, f. 5,6,7).

Bardhi: Qish **të bajsh**, bane urtshim e shuko si ká me të dalë. Mbassi **të kiesh xanë**, ani mbso. Si **të ndërnjësh**, ashtu ké me qenë ndërunë. Të vobegunë ku **ta zanë** nata, aty ashtë pëlasi i tí. Kur të shofsh veshtë veti, atëhere kie me e páam. Me atë masë qi **të matëni**, me atë kini me qenë matunë. (f. 207, 208, 212, 217, 213, 126).

Sa i përket zanafillës së formave të lidhores, gjithsesi, lidhorja ka zhvilluar format kohore nën ndikimin analogjik të mënyrës dëftore. Mirëpo, karakteristikë e ndërtimit të lidhores është pjesëza analitike **të**, që i dallon format e lidhores nga dëftorja: *të shkojmë - shkojmë, të shkonim - shkonim, të kemi shkuar - kemi shkuar, të kishim shkuar - kishim shkuar* (Sh.Demiraj 2015, K.Topalli 2010).

Sipas K.Topallit (2010), zhvillimi historik i sistemit foljor gjatë evolucionit të tij është riorganizuar tërësisht; evolucion, i cili në të shumtën e rasteve është kryer që në periudhën parashkrimore dhe është kushtëzuar nga riorganizimi i kategorive gramatikore të sistemit foljor. Gjatë evolucionit të shqipes është përftuar edhe pajisja e lidhores me pjesëzën e paravendosur **të**, Sipas tij, pjesëza **të**, e cila është veçori për lidhoren dhe ka prejardhje lidhëzore.

Kurse, B.Bokshi (2010:65,66), vlerëson se pjesëza **të** e lidhores nuk ishte lidhëz që jepte kuptimin e qëllimit, siç është shprehur Sandfeldi. Me origjinën e saj përemërore, ajo ishte indiferente ndaj kuptimeve të trashëguara të lidhores së lashtë dhe u bë lidhëz e funksioneve të kufizuara të fjalive të varura të kësaj mënyre. Kështu, për shkak të neutralitetit të tillë, ajo u bë pjesë e pandashme e mënyrës lidhore, d.m.th., u përdor dhe kur lidhorja dilte në funksione të fjalisë së pavarur a kryesore. Format e futurit **do të punoj, kam të punoj** dhe format **duhet të punoj e mund të punoj** tregojnë se në këtë kohë lidhorja e kishte përftuar pjesëzën **të** në funksione të fjalisë së varur dhe dilte me të vetëm në këto funksione.

Ndërkaq, sipas Sh.Demirajt (1988:32), gjallërimi gjithnjë më i madh i fjalëzave shërbyese, disa prej të cilave në kushte të caktuara, sintaksore me kohë janë gramatikalizuar plotësisht, duke u shndërruar kështu në formante, gjë që ka bërë që struktura e gjuhëve indoevropiane të shndërrohet nga një tip sintetik, siç ka qenë në një periudhë parahistorike, në një tip analitik. Ky drejtim i përgjithshëm i evolucionit të strukturës gramatikore është mundësuar nga dy prirjet e kundërta, që kanë kushtëzuar dhe plotësuar njëra-tjetrën:

1. Prirja për të ruajtur ose për të forcuar aftësitë shprehëse të formave gramatikore të reja;
2. Prirja për të thjeshtuar eptimin (fleksionin).

Sipas Sh.Demirajt (2015:698), gjuha shqipe gjatë evolucionit të saj historik ka krijuar treguesit gramatikorë të posaçëm, të cilët në disa raste janë të dykuptimshëm, sepse krahas kuptimit modal shprehin edhe atë të kohës. Kështu, për shembull, treguesit gramatikorë të mënyrave dëshirore dhe habitore shprehin njëherazi edhe kuptime kohore. Mirëpo, te format e lidhore treguesi gramatikor i mënyrës lidhore **të** është i njëkuptimshëm. Gjatë këtij evolucionit të vazhdueshëm, jo vetëm formal, por edhe kuptimor, folja përveç formave të mënyrës dëftore që nga pikëpamja e modalitetit kishte edhe forma të mënyrës lidhore (*modus coniunctivus*), dëshirore (*modus optativus*) dhe urdhërore (*modus imperativus*).

Përveç këtyre, pranohet të ketë ekzistuar edhe mënyra lidhore (konjuktivi), që Brugmanni² e quan *konjuktivi i pamirëfilltë*. Format e lidhore (konjuktivit), historikisht, kanë qenë forma më të vjetra të dëftores, të cilat më vonë janë përzier nga ana e funksioneve edhe me urdhëroren. Gjithashtu, në traditën gramatikore të shqipes flitet edhe për një mënyrë lidhore-habitore (*të paskështa pasur*), e cila sipas B.Bokshit (2010:202), është formuar nga format e habitores të prira nga pjesëza **të** e lidhore. Sipas tij, format e lidhore-habitores janë krijuar, pasi ishin formuar format e habitores, meqë dalin edhe te Buzuku si kohë të formimit parasheh periudhën parabuzukjane.

Kjo formë e ashtuquajtur mënyrë nuk shpreh kuptimin e habitores, por është sinonimike me kuptimin kushtor të kohës më së të kryer të lidhore: **të lakështa - të kisha larë**. Prania e pjesëzës **të** të lidhore e ka bërë të trajtueshme formën e habitores si formë e lidhore, më saktësisht si formë e përmbysur të më se të kryerës.

² Dallon tri kuptime të lidhore: 1. kuptimin volitiv a voluntativ; 2. kuptimin deliberativ në pyetje, nëpërmjet të cilave pyetet ç' duhet bërë a ç' duhet të ndodhë; 3. kuptimin prospektiv nëpërmjet të cilit shprehet një parashikim.

5. Përfundimet

Gjatë këtij punimi qartazi kuptojmë se lidhorja pa rezervë është e pranuar si mënyrë në sistemin foljor të shqipes, krahas mënyrave të tjera. Mirëpo, historikisht, ajo paraqet një trajtë mënyrore shumëdimensionale, si për nga ndërtimi ashtu edhe për nga kuptimi e përdorimi.

Sa i përket ndërtimit të lidhore, ka përafëri me trajtat e dëftores, përveç pjesëzës *të*, me të cilën u kundërvihet mënyrave tjera. Mirëpo, lidhur me pjesëzën *të* ka hipoteza për përcaktimin e saj si pjesëz gramatikore, duke e kategorizuar herë si lidhëz, përemër, fjalëz, tregues gramatikor.

Historikisht, zanafilla e kuptimit të lidhore është e paqartë, pasi ka mendime se me anë të formave të lidhore shprehim vullnetin (*voluntativ*), të ardhmen (*deliberativ*) dhe parashikimin (*prospektiv*). Kuptimisht, lidhorja paraqet ndërthurje modalitetesh me trajtat e saj, të cilat kur shoqërohen me foljet modale shprehin mundësi, domosdoshmëri, obligim, lejim, kufizim, dëshirë, kusht. Siç shihet, ende është i paqartë kuptimi zanafillës i lidhore, sikurse burimi i saj në indoevropianishte.

Lidhorja përdoret dendur në gjuhën e folur e të shkruar, siç e pamë edhe nga pjesët e teksteve të shkrimtarëve të letërsisë së vjetër. Në rrafsh sintaksor përdoret, kryesisht, në fjalitë e pavarura- bashkërenditëse, por edhe në ato të varura- nënrenditëse gjen mjaft përdorim. Kurse, në rrafsh morfologjik, format e lidhore zëvendësojnë format e paskajores, veçanërisht në gjuhën standarde.

Pra, lidhorja, në vijë historike, del të jetë një nga mënyrat foljore me përdorim të gjerë; me shumë modalitete dhe forma analitike gramatikore, të cilat janë të hapura për studime të mëtejme gjuhësore.

Referencat

Ajeti, Idriz. (1978). *Studime gjuhësore*. Prishtinë: Rilindja.

Bokshi, Besim (2010). *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike*. Prishtinë: ASHAK.

Cimochowski, Wacław. (2004). *Për gjuhën shqipe*. Prishtinë: ASHAK.

Çabej, Eqrem. (1986). *Studime gjuhësore VII*. Prishtinë: Rilindja.

- Demiraj, Shaban. (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Rilindja.
- Demiraj, Shaban. (2015). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: ASHSH.
- Ismajli, Rexhep. (2003). *Standarde dhe identitete*. Pejë: Dukagjini.
- Gjinari, Jorgji. (1989). *Dialektet e gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- Riza, Selman. (1994). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Tiranë: ASHSH
- Riza, Selman. (1997). *Vepra 2. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë*. Prishtinë: ASHAK.
- Rrota, Justin. (1943). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Tiranë: Biblioteka Françeskane “Gjergj Fishta”.
- Topalli, Kolec. (2010). *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*. Tiranë: QSA/IGJL.

KDU: 811.18'37(496.5)(05)

Behar HOXHAI

**NDRYSHIMET SEMANTIKE TË PARAFJALËS *PËRMBI* TE BUZUKU
KRAHASUAR ME FJALORËT DHE GRAMATIKAT E AKADEMISË SË
SHKENCAVE TË SHQIPËRISË**

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është krahasimi i strukturës semantike të parafjalës së përngjitur *përmbi* të “Meshari” i Gjon Buzukut me botimet e Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, siç janë fjalorët dhe gramatikat e botuara, “Morfologjia” dhe “Sintaksa” ose edhe tek autorë të tjerë, siç është Mehmet Çeliku.

Sfondi kërkimor do të jetë “Meshari”, si libri më i vjetër shqip, prej të cilit janë nxjerrë shembujt e përdorimit të parafjalës *përmbi* nga Buzuku, si dhe kuptimet, shpjegimet dhe shembujt e marrë nga botimet e Akademisë etj.

Metodologjia e punimit do të jetë krahasimi i strukturave semantike të parafjalës *përmbi*, të pasqyruara në veprat që merren në shqyrtim, duke u mbështetur edhe në literaturë teorike, artikuj që janë botuar në lidhje me semantikën, leksikografinë, morfologjinë, sintaksën dhe fjalëformimin e parafjalës *përmbi* etj.

Nga punimi pritet të merren rezultate lidhur me ndryshimet apo lëvizjet semantike të mundshme të parafjalës *përmbi*, duke nisur nga Buzuku krahasuar me fjalorët shpjegues dhe gramatikat e shek. XX-XXI të Akademisë së Shkencave dhe të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

Fjalët çelës: parafjalë; ndryshim; strukturë semantike; krahasim; lëvizje semantike

Abstract

The purpose of this paper is to compare the semantic structure of the compound preposition *përmbi* of “Meshari” by Gjon Buzuku with the publications of the Academy of Sciences and the Institute of Linguistics and Literature, such as published dictionaries and grammars, “Morphology” and “Syntax” or to other authors, such as Mehmet Çeliku.

The research background will be “Meshari”, as the oldest Albanian book, from which are derived the examples of the use of the preposition *përmbi* by Buzuku, as well as the meanings, explanations and examples taken from the publications of the Academy, etc.

The methodology of the paper will be the comparison of the semantic structures of the preposition *përmbi*, reflected in the works under consideration, also relying on theoretical literature, articles that have been published regarding semantics, lexicography, morphology, syntax and word formation of the preposition *përmbi* etc.

The paper is expected to provide results related to possible changes or semantic movements of the compound preposition *përmbi*, starting from Buzuku compared to explanatory dictionaries and grammars of the 20th and 21st centuries of the Academy of Sciences and the Institute of Linguistics and Literature.

1. Hyrje

Në qendër të këtij punimi është krahasimi i strukturës semantike të parafrjalës së përngjitur *përmbi* të “Meshari” i Gjon Buzukut (Çabej, 1968) me botimet e Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, siç janë fjalorët (Fjalor i gjuhës shqipe, 1954), (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980) dhe gramatikat e botuara, “Morfologjia” (Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002) dhe “Sintaksa” (Gramatika e gjuhës shqipe II, 2002) ose edhe tek autorë të tjerë, siç është Mehmet Çeliku (Çeliku, 2019) apo Aleksandër Xhuvani (Xhuvani, 1980).

Qëllimi është që të vërejmë a ka ndryshime semantike të parafrjalës *përmbi*, duke krahasuar shembujt e përdorimit të saj në librin më të vjetër shqip, “Meshari” i Buzukut, me kuptimet e shpjegimet e dhëna në fjalorët dhe gramatikat e Akademisë apo me studimet e M. Çelikut dhe A. Xhuvanit. Si paraqitet struktura semantike e saj në këto dy rrafshë historike, shekulli XVI dhe shek. XX-XXI? A ka ngushtim apo zgjerim të kësaj strukture? Cili është kuptimi mbizotërues i kësaj parafrjale në këto dy rrafshë të krahasuara?

Për këtë punim janë marrë në shqyrtim kuptimet, shpjegimet dhe shembujt e përfshirë në dy fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe, *Fjalori i gjuhës shqipe* i vitit 1954 (FGJSH) dhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* i vitit 1980 (FGJSSH); studimet e A. Xhuvanit dhe të M. Çelikut, si dhe *Gramatika I* e Akademisë së Shkencave.

1.1. Parafjalët në gjuhën shqipe

Parafjalët në gjuhën shqipe janë studiuar nga një numër autorësh, në disa artikuj, kapituj, vepra apo punime të tjera shkencore. Kryesisht ato janë studiuar nga pikëpamja formale dhe sinkronike, duke mos i kushtuar vëmendje të madhe studimit të tyre në aspektin semantiko-leksikor dhe atë diakronik. Edhe në këtë aspekt të fundit i janë përafuar autorë kësaj klase fjalësh apo kategorie gramatikore, por nuk janë marrë me lëvizjet semantike të parafjalëve në gjuhën shqipe. Edhe përkufizimet në gramatikat e shqipes janë mjaftuar vetëm me anën formale, përveç fjalorëve, në të cilët janë vështuar nga ana kuptimore, semantike.

Parafjalët përbëjnë një klasë fjalësh shumë intriguese për nga veçoritë gjuhësore që paraqesin. Formalisht ato u përkasin fjalëve funksionale, por roli semantik i tyre në lidhjen e përbërësve të fjalisë është i pamohueshëm. Kjo i ka bërë studiuesit të hedhin hipoteza të ndryshme dhe të ngrenë teori të caktuara për statusin dhe vlerën e parafjalëve në gjuhë. Çështja bëhet edhe më tërheqëse kur merret parasysh diakronia e tyre, megjithëse semantika e kombinuar me sintaksën diakronike është një fushë e re studimi që por merr gjithnjë e më shumë vëmendje në gjuhësinë bashkëkohore.

Me studimin e parafjalëve të shqipes, duke u kushtuar atyre artikuj, kapituj apo punime të gjata, janë marrë Sami Frashëri (Frashëri, 1988), Anton Xanoni (Xanoni, 1909), Ilia Dilo Sheperi (Sheperi, 1927), Osman Myderrizi (Myderrizi, 1944), Justin Rrota (Rrota, 2005), Kostaq Cipo (Cipo, 1952), Eqrem Çabej (Çabej, 1968), Shaban Demiraj (Demiraj, 1970, 2002), Besim Bokshi (Bokshi, 2014), Aleksandër Xhuvani (Xhuvani, 1933, 1980), Miço Samara (Samara, 1999), Stefan Prifti (Prifti, 1971), Mahir Domi (Domi, 1954), Selman Riza (Riza, 1997), Spiro Floqi (Floqi, 1992), Mehmet Çeliku (Çeliku, 1972, 1975, 2019), Remzi Përnaska (Përnaska, 1996), Seit Mansaku (Mansaku, 2005), Enver Hysa (Hysa, 1972, 1986), Rami Memushaj (Memushaj, 2003), Thoma Dhima (Dhima, 2005), Ludmila Buxheli (Buxheli, 1977, 2007), Kolec Topalli (Topalli, K. 2011), Anila Omari (Omari, 2018), Tefë Topalli (Topalli, T. 2011), Anila Kananaj (Kananaj, 2015) etj. Duke qenë se parafjalët janë temë në kapërcyell të disa disiplinave, mund të pohohet pa dyshim se ka shumë studiues të shqipes që kanë shkelur në territorin e tyre, veçanërisht leksikologët e morfosintaksologët. Megjithatë, për qëllimet e këtij punimi, jemi përqendruar vetëm në disa vepra dhe autorë që kanë libra të veçantë për parafjalët.

1.2. Parafjala **përmbi** si fjalë e përngjitur

Jo më kot e morëm parafjalën përmbi si objekt të punimit, pasi ajo përdoret te Buzuku, ashtu si edhe në gramatikat, fjalorët dhe veprat e tjera të tjera të shek. XX-XXI si një fjalë e përngjitur, çka tregon për një vazhdimësi apo konsolidim të shkrimit të kësaj parafjale që në shekullin XVI. Siç edhe dihet, përngjitja është një mënyrë fjalëformimi, me anë të së cilës formohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, i një togu parafjalor ose i një grupi fjalësh në përgjithësi (Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, f. 75). Shumica e tyre kanë dalë nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi të qëndrueshëm ose i një togu parafjalor (Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, f. 75). Në të vërtetë, në rastin tonë, kemi dy parafjalë *për* dhe *mbi* që janë pjesë e parafjalës *përmbi*. Gjithsesi, kjo nuk na pengon të marrim parasysh atë që thuhet në këtë gramatikë, se në procesin e përdorimit të tyre të gjatë e të vazhdueshëm gjymtyrët (e togfjalëshit) ngjiten njëra me tjetrën, duke formuar një fjalë të vetme (Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, f. 75). Këtu e theksojmë dhe na intereson procesi i përdorimit, që është i gjatë dhe i vazhdueshëm. Konkretisht, për parafjalën *përmbi*, të cilën “Morfologjia” e klasifikon si parafjalë të përngjitur (Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, f. 75), por edhe pjesë të një grupi parafjalësh të përngjitura të formuara nga bashkimi i dy parafjalëve (Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, f. 383). Duke qenë se te “Meshari” shfaqet e përngjitur, parafjala përmbi merr një vlerë të veçantë, pasi na shtyn të mendojmë për një përdorim të gjatë të saj në këtë formë (të përngjitur) ndoshta edhe para Buzukut.

1.3. Parafjala **përmbi** si parafjalë e rasës kallëzore

Përmbi është parafjalë e rasës kallëzore, numri i të cilave është 15 (referuar *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* 1980) dhe ku bëjnë pjesë parafjalët:

deri, gjer, mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, nëpër, pa, për, përmbi, që, qysh.

Nga këto parafjalë, numrin më të madh të kuptimeve e ka parafjala *në*, me 24 të tilla, ndërsa parafjala përmbi paraqitet në këtë *Fjalor* (1980) me vetëm një kuptim. Më poshtë po japim parafjalët e kallëzores në një renditje sipas numrit të kuptimeve:

<i>në</i>	24 kuptime
<i>për</i>	21 kuptime
<i>me</i>	15 kuptime
<i>mbi</i>	9 kuptime

<i>nën</i>	8 kuptime
<i>më</i>	6 kuptime
<i>nëpër</i>	5 kuptime
<i>ndaj</i>	4 kuptime
<i>ndër</i>	4 kuptime
<i>pa</i>	4 kuptime
<i>deri</i>	3 kuptime
<i>gjer</i>	1 kuptim
<i>përmbi</i>	1 kuptim
<i>që</i>	1 kuptim
<i>qysh</i>	1 kuptim

2. Struktura semantike e parafjalës *përmbi* te “Meshari” dhe veprat e tjera

Në punim janë përdorur dhe gërshetuar disa metoda: siç është ajo krahasuese, përshkruese dhe analizuese. Konkretisht, janë krahasuar strukturat semantike të parafjalës *përmbi*, të pasqyruara në veprat e sipërcituara, duke u mbështetur edhe në literaturë teorike, artikuj që janë botuar në lidhje me semantikën, leksikografinë, morfologjinë, sintaksën dhe fjalëformimin e parafjalës *përmbi*. Pas përshkrimit të shembujve dhe shpjegimeve të kuptimeve të parafjalës *përmbi*, të vjelë nga veprat dhe autorët e përmendur, janë analizuar ata (shembujt dhe kuptimet), duke dalë në përfundimet përkatëse.

Kur flitet për semantikë diakronike, në mendje të vjen semantika historike. Në semantikën historike tradicionale (vitet 1830-1930), e njohur ndryshe edhe si semantika parastrukturaliste, vendin kryesor e zë etimologjia. Qasja etimologjike, që ka në qendër modelin komparativist të zhvilluar në shekullin XIX, mbështetet në krahasimin e formave të fjalëve përkatëse në gjuhë të ndryshme dhe jo në krahasimin e kuptimeve. Në punimin tonë nuk merremi me etimologjinë e parafjalës *përmbi*, por do të përshkruajmë dhe krahasojmë kuptimet e kësaj parafjale në një periudhë kohore relativisht të gjatë.

Si bazë për analizën e kuptimeve është marrë *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* i vitit 1980 (FGJSH), duke qenë se ofron pasqyrën më të mirë të shpjegimit të fjalëve krahasuar me fjalorët e tjerë. Nisur nga kjo, në fillim të analizës kemi dhënë kuptimin e parafjalës *përmbi* që jep ky

fjalor. Më tej jepen shembujt e vjelë nga “Meshari”, pastaj ata që jepen te *Fjalori i gjuhës shqipe* i vitit 1954 dhe te veprat e tjera që i kemi përmendur më sipër.

2.1. Analiza e kuptimeve të parafrjalës **përmbi**

Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të vitit 1980 kjo parafrjalë është dhënë me një kuptim, duke e shpjeguar me fjalët **sipër diçkaje, mbi dikë a mbi diçka**:

Përmbi tryezë. **Përmbi** dhe. **Përmbi** kokë. **Përmbi** ballë. U hodh **përmbi** top. **Përmbi** këtë çështje do të flasim nesër. (FGJSSH, 1980, f. 1448)

Te Buzuku gjejmë shembuj të tillë:

...përse u forcua mishërierja e tī **përmbi** ne (“Meshari”, 1968, f. 15, II)

...e ata që ishnë **përmbi** shtëpit të Davidit (“Meshari”, 1968, f. 19, I)

...e përse të mundë shofsh bijtë e bijet e tuve, e paqnë **përmbi** Israelt (“Meshari”, 1968, f. 23, I)

...amë e shullume **përmbi** djelmt e saj (“Meshari”, 1968, f. 25, II)

E këto oratë thuhën aqë **përmbi** djalë sã përmbi vajzë. (“Meshari”, 1968, f. 73, I)

...e aj të lypnjë me u madhështuom jo **përmbi** gjithë ata qi grëshitenë Zota (“Meshari”, 1968, f. 95, II)

E ndeni dorënë **përmbi** dishepujt të tī (“Meshari”, 1968, f. 129, I)

Gjaku i tī përmbi në e **përmbi** bijtë tanë (“Meshari”, 1968, f. 209, II)

E kur zunë me u shumnuom nierëzitë **përmbi** dhët (“Meshari”, 1968, f. 229, I)

Në *Fjalorin* e vitit 1954 kemi të paraqitura pesë kuptime të parafrjalës **përmbi**, (FGJSH, 1954, f. 401) pavarësisht se nuk janë dhënë në mënyrën e duhur së bashku me shpjegimin përkatës, por vetëm me shembuj e duke u mjaftuar vetëm me njëjtësimin apo shpjegimin me parafrjalë të tjera:

1. mbi, sipër: **përmbi** shtëpi; **përmbi** ujë; **përmbi** të tjerët;
2. **përmbi** këtë temë, rreth kësaj teme;
3. **përmbi** pesë vjet, lart nga pesë vjet;
4. prej: s’lyp kush gja **përmbi** të, prej tij;
5. **përmbi** këto, përveç këtyre.

Edhe A. Xhuvani ka dhënë 5 kuptime, por duke i paraqitur me shpjegime dhe shembuj:

Kuptimi i parë tek ai tregon **një të qenë në sipërfaqe ose më lart se dishka... me kuptim vendi të mirëfilltë:**

loste mbi dëborë si i dehur; i vuri dorën mbi supt; i pështetur mbi bishtin e sëpatës.
(Xhuvani, 1980, f. 291)

Po te kuptimi i parë, Xhuvani dallon edhe një **kuptim vendi të figurtë:**

ka njëmijë halle mbi kokë, të thyejmë zgjedhënë që po na rëndon mbi zverkut. (Xhuvani, 1980, f. 292)

Kuptimi i dytë tregon **idenë e një drejtimi me qëllim kundërshtimi:**

u sul përmbi ta. (Xhuvani, 1980, f. 292)

Kuptimi i tretë tregon **idenë e sipërisë, të epërsisë a të së tepërmes:**

ishin mbledhur për ta dëgjuar përmbi gjashtëqind veta. (Xhuvani, 1980, f. 292)

Kuptimi i katërt, sipas Xhuvanit, tregon **idenë e një kohe të caktuar:**

u ngjall mbi tri ditë, ashtu si ai tha gjindes. (Xhuvani, 1980, f. 293)

Kuptimi i pestë tregon **idenë e argumentit të gjësëdit, për të cilin flitet, shkruhet, botohet, çfaqet mendim a qëndrim, merret vendim:**

u bisedua mbi nevojën e një organizimi më të mirë të punës. (Xhuvani, 1980, f. 293)

Sipas M. Çelikut (i cili i referohet *Fjalorit* të vitit 1980), parafjala e përngjitur *përmbi* përdoret me kuptimin e parafjalës *mbi*, **sipër diçkaje, mbi dikë a mbi diçka:**

Një tufë e madhe laraskash u ngrit nga selvitë e Namazgjasë dhe mori lart, duke u rrotulluar përmbi sheshin e pazarit. Përse, duke kaluar përmbi dërrasën e ngushtë që është vendosur mbi themelin e hapur thellë, qëllon që të merren mendtë? Me vrap të shtinin të gjithë përmbi të. (Çeliku, 2019, f. 233-234)

Po sipas Çelikut, tregon edhe një **kuptim sipëror a të epërsisë përtej:**

Përmbi za që lëshon bylbyli, gjuha shqipe më shungullon. Malësorët e Tuzit janë ngritur gjithmonë përmbi dallimet krahinore dhe fetare për t'u bashkuar në emër të interesit të lartë kombëtar. (Çeliku, 2019, f. 234)

3. Përfundime

Pavarësisht se kjo parafralë është e përngjitur (pra, duhet të ishte përngjitur përgjatë përdorimit të pjesëve të saj përbërëse gjatë shekujve të fundit) vërehet se përdoret gjerësisht që nga Buzuku (por edhe nga Budi e Bogdani) e deri në ditët tona, me të njëjtën formë të pasqyruar në shkrim, të përngjitur, si një fjalë e vetme.

Kuptimi i vetëm i parafralës *përmbi* në *Fjalorin* e vitit 1980 shpjegohet me fjalët **sipër diçkaje, mbi dikë a mbi diçka**. Megjithatë, në *Fjalorin* e vitit 1954 gjejmë pesë kuptime të parafralës *përmbi*, pavarësisht se nuk janë dhënë në mënyrën e duhur së bashku me shpjegimin përkatës, por vetëm me shembuj. Nëse te *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* 1980 është paraqitur vetëm me 1 kuptim, te *Fjalori* i 1954-ës dhe te Xhuvani është dhënë me 5 kuptime. Pra, në këtë rast kemi zvogëlim të numrit të kuptimeve (duke marrë parasysh vitet kur janë botuar këto vepra). Kemi ngushtim dhe jo zgjerim të strukturës kuptimore të parafralës *përmbi*. Kjo është e kundërta me atë që vërehet te parafralë të tjera, bie fjala me strukturën semantike të parafralës nga te *Fjalori* i vitit 1954 krahasuar me *Fjalorin* e vitit 1980, ku kemi zgjerim të kësaj strukture. Sipas A. Xhuvanit, kemi 5 kuptime për parafralën *përmbi*, të cilat ai i paraqet me shpjegime dhe shembuj, ndryshe nga fjalorët e mësipërm. Ndërkaq, M. Çeliku jep dy kuptime për këtë parafralë, ndonëse njërin e ka marrë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* i vitit 1980.

Duke përfunduar, vërejmë se ka ndryshime semantike të parafralës *përmbi*, pas krahasimit dhe analizës së bërë kuptimeve nëpër veprat e marra në shqyrtim në këtë punim. Pavarësisht se *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* 1980 e paraqet me vetëm me një kuptim këtë parafralë, përsëri tri nuancat kuptimore përbërëse të këtij kuptimi na tregojnë se ka prirje për zgjerim. Kjo prirje përforcohet kur shqyrtojmë kuptimet dhe shpjegimet e dhëna qoftë edhe nga një autor, siç është A. Xhuvani. Pra, do të thoshim se struktura semantike e parafralës *përmbi* vjen drejt zgjerimit, duke nisur nga Buzuku e deri në shek. XX-XXI.

Bibliografi:

- Bokshi, B. (2014). Një sistemim i parafralëve të shqipes. Prishtinë: VARIA, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, botime të veçanta cxxxv seksioni gjuhësisë dhe i letërsisë i 50, f. 35-54.
- Buxheli, L. (1977). Togfjalëshat me parafralën për në gjuhën letrare shqipe, Studime filologjike, nr. 2, f. 29-51. Tiranë. (2007). Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme

shqipe. Tiranë: Neraida. (2011). Foljet njëvetore në gjuhën shqipe. Tiranë: Botimet Albanologjike.

Cipo, K. (1952). Sintaksa. Tiranë: Mihal Duri.

Çabej, E. (1968). “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), botim kritik, pjesa II – Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë: USHT, IHGJ.

Çeliku, M. (1972). Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe, Studime filologjike, 1, ff. 85-109. (1975). Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II. Tiranë.

Çeliku, M. (2019). Parafjalët e shqipes standarde (Trajtim leksiko-semantik e gramatikor), Tiranë: ILAR.

Demiraj, Sh. (1970). Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe. Prishtinë; (1975) Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe. Tiranë. (2002). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave.

Dom, M. (1954). Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë (Sintaksa), Tekst për shkollën shtatëvjeçare. Tiranë: Botim i Ministrisë s’Arsimit dhe Kulturës.

Dhima, Th. (2005). Gjuha shqipe, Sintaksa. Tiranë: SHBLU.

Fjalor i gjuhës shqipe (1954). Tiranë: Akademia e Shkencave.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980). Tiranë: Akademia e Shkencave.

Floqi, S. (1992). Togfjalëshat me parafjalën nga në shqipen e sotme letrare, Studime filologjike, N° 1-4, ff. 23-34.

Frashëri, S. (1988). Shkronjëto e gjuhës shqip, Bukuresht, 1886, në: Sami Frashëri Vepra 2. Tiranë: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë.

Gramatika e gjuhës shqipe, I, Morfologjia, (2002). Tiranë: Akademia e Shkencave.

Gramatika e gjuhës shqipe, II, Sintaksa, (2002). Tiranë: Akademia e Shkencave.

Hysa, E. (1972). Formimet me parashtesën për- në gjuhën shqipe, në Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II. Tiranë: ASHSH.

Hysa, E. (1986). Sindajshtesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Studime filologjike, 2.

- Kananaj, A. (2015). Funksionet e rrethanorit në gjuhën shqipe. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Mansaku, S. (2005). Disa veçori morfosintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe, në Buzuku dhe gjuha e tij. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Memushaj, R. (2003). Gjuhësia gjenerative. Tiranë.
- Myderrizi, O. (1944). Gramatika e re e shqipes: Për shkollat e mesme. Tiranë: “Gutenberg”.
- Omari, A. (2018). Veçori gjuhësore të përkthimit të Ungjillit sipas Mateut nga Vangjel Meksi, 1820, botuar në: Konferencë gjuhësore për nder të 80-vjetorit të lindjes së prof. dr. Xhevat Lloshit, Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare, Infbotues, Tiranë, f. 161-181.
- Përnaska, R. (1996). Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe. Prishtinë.
- Prifti, S. (1971). Sintaksa e Gjuhës Shqipe. Prishtinë.
- Riza, S. (1997). Selman Riza, Vepra 2. Prishtinë.
- Rrota, J. (2005). Sintaksi i shqipes (1942). Shkodër: Botime Françeskane.
- Samara, M. (1999). Parafjalët në shqipen e sotme (vështrim leksiko-semantik). Tiranë: Panteon.
- Sheperi, I. D. (1927) Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskënishtes, (Për shkollat e mesme). Vlorë: Shtypshkronja “Vlora”.
- Topalli, K. (2011). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Botimet Albanologjike.
- Topalli, T. (2011). Gramatikë e gjuhës shqipe, Sintaksa e Fjalisë, sprovë monografike. Shkodër: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve Albanologjike.
- Xanoni, A. (1909). Gramatika Shqyp, Shkodër: Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme.
- Xhuvani, A. (1933). Njohnit e Para të Syntaksës Shqipe, Pjesë Parë për Klasët e Nalta të Filllores, Shpallje e dytë e përmirësuese. Tiranë: Shtypshkronja “TEKNIKE”.
- Xhuvani, A. (1980). *Parafjalët*, në Xhuvani, A. Vepra I. Tiranë: Akademia e Shkencave.

KDU:811.18'282.3(496.5)(05)

Majlinda BUSHAJ

ELEMENTE TË SHQIPES SË VJETËR NË KRAHINËN E POSTRIBËS

Abstrakt

Krahina e Postribës shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës, në të ashtuquajturën zona e Mbishkodrës. Kjo krahinë bën pjesë në të folmen veriperendimore. Rëndësia e kësaj zone qëndron në disa aspekte. Së pari kjo lidhet me historinë, trashëgiminë dhe kulturën. Një ndikim të veçantë ka edhe pozicioni gjeografik, larmia e territorit, afërsia me qytetin e Shkodrës. Postriba ka pozitë gjeostrategjike shumë të rëndësishme. Kjo zonë lidh Shkodrën me zonën turistike të Thethit dhe komunat e Dukagjinit me zonën e Shllakut. Në Postribë ndodhet “Ura e Mesit”, një monument i rrallë me vlera kulturore dhe arkitektonike në Shqipëri.

Tema e këtij punimi përqendrohet në elementet e shqipes së vjetër të cilat janë të pranishme edhe sot në brezin e vjetër të banorëve të Postribës, duke u përpjekur të sjell në vëmendje dhe të analizoj veçoritë më tipike të saj si: përdorimi i gjinisë asnjëanëse, përdorimi i përemrave, rasat e emrave, trajta të ndryshme leksikore etj.

Sintaksa popullore përmban një pasuri të madhe ndërtimesh, nga më të larmishmet, me aftësi të veçanta e me vlera të shumta origjinale që nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Emrat mashkullorë që tregojnë prejardhjen e një banori paraprihen me nyjën -i te brezi i vjetër, ndërsa te brezi i mesëm del pa nyjë: *i boksor, i domnor, i kullagji, boksort, domnort, kullagjit* etj. Ka ndërtime e struktura të vjetra, që janë zhdukur nga shqipja e sotme, por kanë qenë të pranishme në shqipen e lashtë. Nga këto vëmë në dukje përdorimin e rrjedhore pa parafjalë etj. Si përfundim, mund të thuhet se në gjuhën e banorëve të Postribës ruhen mjaft tipare që janë zhdukur në shqipen e sotme. E folmja e Postribës ka rëndësi të veçantë për kërkimet në fushën e historisë së gjuhës shqipe.

Fjalë dhe shprehje kyçe: Sintaksa popullore, Postribë, rasa rrjedhore, leksik, elementet e shqipes së vjetër etj.

Abstract

Postriba is situated at north-east of Shkoder town, in the region so-called Mbishkodër area. This province is part of the northwestern speech. In Postriba is located “*Ura e Mesit*”, a rare monument of cultural and architectonic values in Albania. Under the foundations of this zone of name Postribë are found the ruins of an ancient town of name Drivast. The importance of this area is based in some aspects. First of all this is related to the history, heredity and culture. Postriba has a very important geostrategic positioning. This region is the connection between Shkoder and the touristic zone of Theth and Dukagjin with the Shllak region.

The topic of this paper focuses on the elements of Old Albanian which are present even today in the older generation of inhabitants of Postriba, trying to bring to attention and analyze its most typical features such as: the use of the neuter gender, the use of pronouns, different lexical forms etc. The popular syntax contains a great wealth of constructions, from the most diverse, with special abilities and with many original values that have not been used enough. The masculine nouns that indicate the origin of a resident are preceded by the -i in the older generation, while in the middle generation it appears without it: i boksor, i domnor, i kullagji, boksort, domnort, kullagjit etj. There are old constructions and structures, which have disappeared from today's Albanian, but were present in ancient Albanian. In conclusion, it can be said that in the language of the inhabitants of Postribas are preserved many features that have disappeared in today's Albanian. Postribas's speech is of special importance for research in the field of the history of the Albanian language.

Key words and expressions: Folk syntax, Postriba, derivation, lexicon, Old Albanian etc.

HYRJE

Krahina e Postribës shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës, në të ashtuquajturën zona e Mbishkodrës. Postriba kufizohet në veri me komunën Gruemirë dhe konkretisht me përroin e Vrakës, fshatrat Rrash e Vorfë, në lindje me fshatin Xhan të zonës së Dukagjinit dhe Dajc të bajrakut të Sumës, në jug me zonën e Temal Dushmanit, fshatin Vukaj, Ukbibaj të zonës së Shllakut dhe Bardhaj të komunës Rrethina, në Perendim kufizohet me Hotin e Ri, Grudë e Re, Guci e Re të komunës Rrethina. Banori vendas quhet Postribas/e. Sot në këtë zonë përfshihen 12 fshatra: Boks, Dragoç, Kullaj, Mes, Myselim, Drisht, Vilzë, Ura e Shtrenjtë, Prekal, Domen, Shakotë dhe Fshati i Ri. Kjo krahinë bën pjesë në të folmen veriperendimore.

Sipërfaqja e saj është 180 km². Rreth 20% e sipërfaqes së saj shtrihet në fushë. Pjesa tjetër është kodrinore dhe malore. Lartësia e saj më e vogël është në luginën e Shtodrit në 37 m mbi nivelin e detit. Lartësia e saj më e madhe është maja e Cukalit me 1722 m mbi nivelin e detit.

Rëndësia e kësaj zone qëndron në disa aspekte. Së pari kjo lidhet me historinë, trashëgiminë dhe kulturën. Një ndikim të veçantë ka edhe pozicioni gjeografik, larmia e territorit, afërsia me qytetin e Shkodrës. Postriba ka pozitë gjeostrategjike shumë të rëndësishme. Kjo zonë lidh Shkodrën me zonën turistike të Thethit dhe komunat e Dukagjinit me zonën e Shllakut. Në Postribë ndodhet “Ura e Mesit”, një monument i rrallë me vlera kulturore dhe arkitektonike në Shqipëri.

Postriba është një nga krahinat më të vjetra të Veriut. Fshatrat e saj po t’i ndjekim nëpër dokumente na dëshmojnë mjaft herët. Kryet e vendit për nga lashtësia e zë Drishti, kryeqendra e kësaj krahine që, siç shkruan prof. Çabej “Ky emër na shfaqet për herë të parë në shek. VIII të erës sonë, por burimet i ka në kohën më të vjetër”(Çabej 1977:15). Pastaj dalin me radhë edhe fshatra të tjera si: *Mesi*, *Domni* (Pulaka:174), *Myselimi* (më 1621) (*Relacion mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëllimi II, f. 258, 308, 384.) Ura e Shtrejtë (më 1685) (Pepa 2000:58) etj. Si krahinë ka mjaft gjëra karakteristike nga krahinat e tjera. Për këtë gjë H. Koplikaj shkruan: “*Banorët e kësaj krahine ...për kah doket, zakonet e më tepër kah veshja kanë ndryshim prej atyre të vendeve të tjera duket se këta banorë...trashëgojnë disa gjëra prej të parëve, qi banojshin këtu, ndoshta prej qytetarëve të Drishtit të dikurshëm.*”(H. Koplikaj, Cirka nr. 19, 11 prill 1937, f.74.)

Tema e këtij punimi përqendrohet në elementet e shqipes së vjetër të cilat janë të pranishme edhe sot në brezin e vjetër të banorëve të Postribës, duke u përpjekur të sjell në vëmendje dhe të analizoj veçoritë më tipike të saj si: përdorimi i gjinisë asnjëanëse, përdorimi i përemrave, rasat e emrave, trajta të ndryshme leksikore etj.

Metoda e punës: Në vjeljen e materialit dialektor kam zbatuar metodën e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, ndërsa në përpunimin e materialit metodën e përshkrimit të të folmes në brezin e vjetër, në zonat malore, metodën e analizës, sintezës dhe krahasimit. Punimi është hartuar mbi bazën e materialit të vjelë në disa fusha të ndryshme të veprimtarisë. Për shpjegimin e dukurive gjuhësore dhe afërsinë me gjuhën e autorëve të vjetër, kam shfrytëzuar artikujt e studiuesve të njohur të gjuhësisë sonë dhe literaturë teorike ndihmëse. Gjatë punës për mbledhjen e lëndës së parë gjuhësore kam ndjekur udhëzimet e përgjithshme të pranuar e të njohura për vjeljen e materialit dialektor me anë të vrojtimit të drejtpërdrejtë. Të anketuarit janë nga brezi i vjetër pak ose aspak të arsimuar, që rrallë kanë lëvizur nga fshati dhe, natyrisht,

duke mos pasur kontakte intensive me të folmet e tjera kanë ruajtur të folmen e tyre deri në gjendjen e sotme.

EMRAT E DYGGJINISHËM. Shumë emra në krahinën e Postribës na dalin të dyggjinishëm. Kjo shpjegohet sepse në emërtimet dykryemgjymtyrëshe gjymtyra e parë e një emërtimi dykryemgjymtyrësh drejton gjymtyrën e dytë si: **Shpellkorbja** (Kullaj), etj. Veçori tipike është problemi i gjinisë së emrave. Në zonën e Postribës problem i gjinisë së emrave është i ndërlikuar, mbasi ka mjaft luhatje dhe është e vështirë të përcaktohet prerazi gjinia e tyre. Janë në gjininë femërore këta emra ku në zonat e tjera ka lëkundje. **Fukaraja, mordja, interesa.** Ka edhe mjaft emra që dalin me mbaresën e femërores, kurse në të vërtetë emërtojnë frymorë mashkullorë. P.sh. **Hakija, Haxhija, Alija, Musaja, Avdija,** etj.

Disa të tjerë dalin përsëri dyggjinish (por asnjëanës-mashkullorë dhe asnjëanës - femërorë) *leshi-lesht, rrushi-rrusht, kryet-kreja, grosht-grosha* etj.

Përdorimi i emrave të gjinisë asnjëanëse. Gjinia asnjëanëse është gjinia e tretë e emrave. Kjo gjini ndeshet në brezin e vjetër. *Për kryet tem nuk po të rrej asgja. Për të rit që i kam gzue nuk po ta tham i fja:l për i tjetër. Qekja qi:k nuk ka gja t' shame, lum aj qi e fut n konak.*

RASA

- Parafjala **në**, ndërtohet zakonisht me të ashtëquajturën rasë vendore: *na gjen n'Kopshtiqe tuj punue; Po rrijm n'hije plepit me u freskue i fije* etj.
- Me të njëjtën trajtë dalin ndonjëherë edhe parafjalët me, për: **për kryet t' djalit ke me e marrë njëkët havli se e kam pa njet me ta dha:n** etj.
- Emrat që vijnë pas një emri tjetër të rasës vendore-kallëzore zakonisht dalin pa nyjë: *kullotshin dhit n'ograja t'Boksit; kështu edhe pa parafjalën në: me i ra shjelm barkut* etj.
- Me mjaft interes është **përdorimi i rasën kallëzore.** E formojnë rasën kallëzore duke i shtuar temës drejtpërdrejt **-n-** emrat që në të pashquar dalin me zanore të theksuar, emrat që dalin me prapashtesën **-oj** dhe ata që dalin me **-j:** **shin (shiun); vlla:n (vllaun), dhe:n(dheun), shkja:n (shkjaun)** etj.

- **Rasa thirrre.** Veçori dalluese e të folmes së Postribës është dalja e emrit në thirrre me mbaresat **-á** për mashkulloren dhe **è** për femëroren. **Saita, Meta, Hazira, Esata, Kadria, Mine, Valbone, Rabije, Behije, Nafije, Lutfije etj.** Kjo rasë shoqërohet me pjesëzat **o, oj, moj, more, mori** dhe pa këto pjesëza. Pjesëzat **o** dhe **more** **përdoren** për të dy gjinitë. **O Saita, more djala, more vajze etj.**
- Me rasën **rrjedhore** bashkohen disa përdorime me vlerë rrethore pa parafjalë janë togfjalësha të ndërtuar nga një emër në formën e rasës rrjedhore të pashquar, të paraprirë nga ndonjë parafjalë si: *diqa eti, diqa uje, plasa zhegi* (plasa nga zhegu), *diqa t nxeti* shumica e këtyre tregojnë raporte shkaku.

*Ma tha goja tân ditën e lume **diqa eti**.*

*Jato bagti qî ke n vath t **cofen uni**.*

*Sot ka ken kaq xët sa kam **plas zhegi** si gungalla.*

NYJA: Emrat mashkullorë që tregojnë prejardhjen e një banori paraprihen me **nyjën** - i te brezi i vjetër: *i boksor, i domnor, i kullagji, boksort, domnort, kullagjit etj.*

Boksort ja:n zoti na ruj t lujtuj meç krej, dragoçsit jan qefli, drizhja:nt jan menemdhej me iu ra huna n to:k s ulen me e ma:rr.

***I boksor** s tlen me fol kurr keq për vedi. I domnor i ul qe:t me gomar n Shkoder.*

*Burrnia rrin nër male e **i domnor** nuk e cenon kurr qate.*

Tipare të hundorësisë. Një veçori dalluese e të folmes së Postribës është se zanorja **a**, dhe **i** hundore në pozicion të theksuar dëgjohet edhe gojore. Kjo dukuri është relativisht e vjetër që ndeshet edhe në shqipen e vjetër, ndërsa për studiuesin Luli shihet edhe si origjinale (Luli:1974:75). Këtë dukuri e ndeshim në brezin e vjetër. Këtu egzistojnë dy radhë zanoresh: hundore –gojore: *I shkoj **kâma** n shkall t keqe qyqanit, e ra dekun e n tok. Mate qat shami î âsht dy pllâ:m. Jan ha: p tlinat sa **pllama** e nuk i ba:jn mâ. Ma mush is sa:f me **tâmël** t xet me provollit fytin, se s ka fjjet tan naten e mrame. A âsht vlu **ta:mli**?*

Tkurrja e zanoreve. Një dukuri tjetër në këtë të folme është tkurrja e zanoreve të tyre. Shkrija e dy zanoreve në një të vetme ndodh nga ritmi i shpejtë i ligjëritimit, sidomos kur zanoret janë të njëjta. Kjo dukuri te Bardhi: *Ma i nalti gjithëve.* (Topalli:492). Në këtë të folme ndeshim: *Pronī Rasekut.* Me zanore të ndryshme, tkurrja ndodh në të folme ndërmjet zanoreve /a/ dhe /e/, ku e para i takon nyjës së prapme të emrit kurse e dyta i takon nyjës së përparme të

përcaktohet. Rezultati është një /e/ e hapët më e gjatë se zanoret e këtij pozicioni ku janë bashkuar cilësitë e dy zanoreve që janë tkurrur si: *derë madhe, besë burrave* etj.

PËREMRI:

Te brezi i vjetër ndeshim trajta të vjetra përemrash dëftorë që paraqesin interes, si: **jekso, qeksi, njesi, jesi, qeso, njaso, qaso** etj. Në gjinore-dhanore-rrjedhore përemrat ndiqen nga pjesëza -**na**: *ktina, atina, ksajna, asajna, njektina, jektina* etj.

NDAJFOLJA:

Kanë një larmi të madhe të llojeve të ndryshme. Po paraqesim disa që janë më tipike. Vendi: *qatje, njaty, qaty, atynej, qetynej, askunej, ktunej* etj.

Kohe: *parahej, përparanej, itash, masanej* etj.

Mënyre: *qekshtu, njekshtu, qashtu, jeshtunej, kshtunej, njekshtunej, ani, curak, fillak, prej atjehit, s'je kurrkunit, kta tjashtmit* etj.

PASTHIRRMAT: Pasthirrmat janë një element përbërës i gjuhës që vijnë që nga kohët më të lashta. Në krahinën e Postribës ato janë të shumta, por ndeshen edhe elemente të kohës së lashtë. Të tilla janë pasthirrmat **vāj** dhe **kuku**. Shembuj nga banorët e zonës të përdorur në kontekste të ndryshme. *Vāj medet s i i ka ma:rr jeta qesaj vajze. Kuku për ne qa na ka gjet me qat rob, nuk merr vesh kërkend.* Pasthirrma të tjera që paraqesin interes janë: *ofsha, e, oj, haj djala haj, u rrahen hok* etj.

PËRDORIMI I MJETEVE LIDHËSE

Përdorimi i mjeteve lidhëse është një aspekt i rëndësishëm sintaksor në këtë të folme që paraqet disa veçori: E folmja e Postribës dallohet jo vetëm nga asintetizmi, mungesa e mjeteve lidhëse, por edhe nga përdorimi i një sistemi lidhëzor karakteristik për këtë të folme. Lidhëza që paraqesin interes janë: **si**, ffilluese *due si t'shkojm*(=dua që të shkojmë); *menova si t vin*(=menova që të vinë) etj.

Përdoret dendur lidhëza kohore në trajten **te, tek, tu**, të cilat kanë vlerën e lidhëzave kohore “kur”, “sa”, “sapo”, *te ka dal e ka pa djalin, tek u nisi bani za* (=kur u nis i bani za), *tu ka shkue i kan diftue* (=sapo kanë shkue i kanë diftue), *po e t vdes tut e shoh* (=pe e tves kur ta shoh), *tut e prekin tash pe djeg* (=kur ta prekin tash po e djek) etj. Këto ndërtime janë më të përdorura në zonën malore të Postribës, sesa në zonën fushore. Ka edhe lidhëza të tjera që tregojnë fillimin e vazhdimin e veprimit në kohë: *ç, se “qysh se” ç se kje dita eca, ç se ke ardh ban shamatë* etj.

Shkakore: **nkjoftse, nase.**

*M ata kohna vjehrr i hipke n lpoze/ e bake prov nusen si merrke per djale e bake prove a duhet
gja a âsht e bereqetshme a s âsht hipte n lpoze e shiqote ka shin shpin i hidhke kaj i kokërr
kallamoq n toke a po kthehet me e marr tash// nusja **nkjofse** e merr nusja me dor âsht e
bereqetshme e ruen **nkjoftse** iv en shisen e përzin me zhumile t tjera njekja s duhet gja për i kët
dynja. Po shkoj me ba qat gja **nase** po m len nana.*

Vendore: Përdoret si lidhëz vendore trajta “tu” e cila ka vlerën e lidhëzës “ku” , “kudo që” si:
*lype tu tjetë (= lype kudo që të jetë), merre tut e lanë (merre ku e ke lanë), pulat tu t shkojn
veniu mrapa (= pulave ku t shkojn veniu mrapa) etj.*

Mënyrore: “kinse” *baj kinse s’di*; “kin” *ban kin po baj najsen*; “kesh” *ban kesh po qan*; “djas”
ban djas po dal etj.

Përdorimi i lidhëzës **jashta** në vend të **veçse**.

*Nuk kam fjet kurr ditën **jashta** me ken e ligë.*

Lidhëza **manej** përdoret në vend të lidhëzës **pastaj**.

*P.sh. Maqin s’kana pas//jam martu 18 vjeçe//naten e pare kana fjet me një gru kunata, tjeteken
jo//natën e pare hite burri me ba zakonet e moçme, shkelte nenen dorë e shkelte nenen kame
e t puthte n’faqe// **manej** ikte delte jasht// natën e dytë na vite zot e rrite kunata me të shtri
n’dyshek//**manej** ikte jashtë ajo//nusja mu çu heret me nezë zjermin//me pje kafen mu çu njerzve
nëpër oda.*

FORMAT E PASHTJELLUARA:

Pjesorja përdoret në këto funksione sintaksore: a) kallëzuesor i kryefjalës: *rash **ve:sh** e
njiesh; foli **la** e pa **la**, vite pa **da*** etj. b). kallëzuesor i kundrinës: *e gjeta shpi:n myllun, e ke
derën my:ll, e gjieta dekun, e lashë ra:t* etj.

*Njaç shum kjesh lodh sa rash **vesh** e njiesh. I ke ba punt **la pa la** e ske ba kurrqja.*

*E kam rra djalin e kam **la:n rat**, se ka ba sherre.*

Forma e pashtjelluar mohore: Forma e pashtjelluar mohore vjen zakonisht pas kallëzuesit
dhe kuptimisht i referohet të njëjtit subjekt në të cilin dalin dukshëm kuptimet kohore.

*Kam nej **pa hanger** tan ditën e lume, ninushëm; i kam fmit **pa ve:sh, zge:sh** cancurak etj.*

Kjo formë del edhe pas foljes drejtuese në funksion mënyror e kallëzuesor dhe më rrallë në atë kohor. *Erdh **pa prit pa kujtue** bija jeme e dashtun;*

Në funksion kushtor e ndeshim para foljes drejtuese si:

***Pa punue e pa t'dal** shpirti nuk fitohet buka n'arë;*

***Pa kene e shkrume** nuk bahet kurrnga n'ket to:k etj.*

Funksion leJOR: *qajo grue erdh **pa ken e thirrun** n'darzëm etj.*

Përcjellorja: Raporte kudrinore: *marova tuj fo:l, pushoi tuj kja etj.* Në këto raste folja e parë është një folje me vlerë aspektore, gjymtyra e dytë luan rolin kryesor, duke mbajtur kuptimin themelor leksikor.

***Marova tuj fo:l** e kokmushk se kokmu:shk je, si mushka s zen men ku:rr.*

Paskajorja: Për ndërtimin e fjalive në periudhë ka një përdorim të të gjerë **paskajorja gegë e foljes**. Ajo formon fjali të llojeve të ndryshme.

Kryefjalore: *sa koha mu nis në malt, s'a mir me fol ku sa veni;* kundrinore: *ka maras me;* kushtore: *me ra nuj e lam mu myt, me ra shi i fusim mren etj;* qëllimore: *shkuen mu pajtue me te, iku mu ngatrru me te etj.;* kohore: *e dita para se me ma than, e bana masi shkove ti;* rrjedhimore: *ra shi me të myt, fjali kohore, mka ra shiu tuj vu kashten, erdh pa dalë drita, asht çu për pa lej dielli etj.* Në këtë të folme ndeshim ndërtimin me vlerën e së ardhmës **kam+paskajore** me **me** dukuri e autorëve të vjetër (shih:Mansaku:1980), e cila është ruajtur deri në ditët tona. Disa nga format që dalin në këtë krahinë janë: E tashmja e foljes **kam+paskajore** duke dhënë kuptimin e së ardhmës. *Kur t kthehem pej pune **kam me t' dhanë** i thes miell.* Forma pësore e së ardhme **kam+paskajore** duke i vënë pjesëzën **u** karakteristike. *Buka ka me ardhë e ka me u za:n si s ka ma mirë.* E pakryera e foljes **kam +paskajore** duke dhënë një formë me vlerës e së ardhmës së të shkuarës ose të kushtores: *Pse merzitej baba nuk **kish me fitu** ma shumë pej druve qî kish bâ në mal.* Folja **kam** në të kryerën e thjeshtë **+paskajore:** *Mos ta kishe nuc **pa:t me a:rdh** vetë pula e me hī n furrik.*

Shembuj të formave të pashtjelluara:

*Kur shkon n dek nuk ban **me shku** n shpi tjetërkuj **pa pa:s shku** n shpi tane i her **pa la** durt lan durt kur flen in at te i dekni duhet **me u la** krejt, kur vjen prej naka duhet **me la** durt e **me la***

*faqet o shkon me përcjell xhenazen nuk nuk ban **me hi** mren sado ftoht qoftë duhet **me i la** më qit tri her uj, tash vjen pej deket e t hin mren, tash kan rrnu do gjana e si qyr kush do pun, kur don **me u afri** te dekuni e kthejn mar.*

Mënyra habitore karakterizohet nga një forcë e veçantë afektive me të cilin folësi shpreh qëndrimin e tij krahas konstatimit të veprimit foljor. Në këtë të folme format e habitores kanë vlerën e të pakryerës ose të më se të kryerës së mënyrës lidhore.

*Edhe n mos **ardht** dhandri në shpi na ja lam nusen ted dera, nuk ka ba vaki me na lanë nusen n der seqet pushk burrnia. S'po **i vjekeni** gja kujt, çojuni e zhdrivillojuni.*

FJALITË EMËRORE: Përdorim të dendur kanë edhe fjalitë emërore. Këto përdoren për të pohuar praninë, qënien e një sendi ose të një dukurie të emërtuar, përdoren edhe për të tërhequr vëmendjen. Ato në shumicën e rasteve dalin si fjali të mëvetësishme të pavarura. Por mund të dalin edhe si pjesë e nënrenditur e një fjalie, por jo si fjali e varur.

Dalin edhe si pjesë kryesore e një pjese me nënrenditje: *Oj e shkreta, e shkreta u, ça m'ka gjet//m'diq burri e m'la shkret.* (çast vajtimi, gruaja qan të shoqin në vajtim).

Fjalitë emërore pa këpujë gjenden në proverba e përralla që kanë struktura të hershme popullore e ndeshen te brezi i vjetër, si:

Goja llap e shpina dap. Ma mir i gru konakut se i çifllak. Borxhi ma i zi se gjaku. I vetmi, i verbti. Ma mi:r buk that n shpi tane se bu:k e mjalt n shpi thuj. Kampërbaltuni, gojpërmjaltuni.

FJALITË BASHKËRENDITËSE: Në lidhjet e hershme në gjuhën e popullit mbizotëronte bashkërenditja. Në krye të herës bashkërenditja është realizuar pa kurrfarë lidhëse, kurse në një fazë të mëvonshme ajo realizohej me lidheza shtuese (Topalli 2011:1181). Një dukuri të tillë e ndeshim edhe këtu. Bashkërenditja, që numëron veprimet njëri pas- tjetrit, pa bërë përgjithësim dhe pa u ndalur në rrethana të ndryshme, paraqet një shkallë të ulët të zhvillimit mendor. Këta tipa fjalish janë model i gjuhës së popullit kryesish gjenden në këtë të folme.

Lidhja kuptimore midis fjalive të periudhës shprehet jo vetëm me anë të lidhëzave bashkërenditëse, por edhe me mjete të tjera gramatikore.

Nga pikëpamja strukturore periudhat **me fjali këpujore** janë mjaft të larmishme në këtë krahinë, si:

Kau ka than:- m nep t ha si vlla //e muno si shka.

Periudhë me fjali të bashkërenditura këpujore me ngjyrim numërimi, ngjyrim pohues me lidhëzat **dhe, e, ene**, si:

Iku njaj//e preku pika //e shkojnë dynja tjetër.

Fjalitë bashkërenditëse kundërshtore shprehen edhe në mënyrën jolidhëzore.

Të mëdhatë i preu, të voglat i ruajti.

Gjykon puna, // s'gjykon guna.

Ai tha e marr unë, // ky tha e marr unë.

Periudha me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie veçuese ku lidhja veçuese shprehet me anë të lidhëzave *no...no, o...o, as...as*.

*Bagtin **no** maje // **no** vraje.*

***No** puno t'kesh // **no** diq e mos t'jesh.*

*Ushqimet kan ken ma mir qat koh **as** kana pi hapa as shrupna **as** kana ba gjylpana.*

Tërheq vëmendjen për stilin e tregimit popullor përdorimi i fjalive të njëllojta të bashkuara pa lidhëza.

P.sh.: *Ather nuk kana pas sahana kana pas kupza drunit, gëruzhd drunit, kan pas kusijat, me zie gjiell kana qypa kavajet zieshna gjiellen n'te. Buken e kana ba n'magje drunit e kana marre n'qêth e kana fut n'voter e kana pjek e mánëj kana dale e kana hanger t'xët.*

Leksiku

Emra të njerëzve. Mbizotëron elementi mysliman. Gjejmë emra të gurrës së lashtë shqipe sidomos të zonës malore të përqëndruar te brezi i vjetër. Sot brezi i ri nuk i përdor më: **Hanë, Bjeshkë, Diellë, Shpend, Sokol, Sykë, Borë** etj.

Blegtoria është një nga veprimtaritë kryesore të popullit tonë ka një traditë të pashkëputur në vend dhe si rrjedhim një terminologji mjaft të pasur. Çabej është shprehur: “*Për lashtësinë e kësaj dege të pasur flet edhe nomenklatura e pasur e saj*” (Çabej 1977:22). Postriba njihet si një hapësirë e përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë blegtorale. Këtë e përforcon edhe fakti që emërtimet e kafshëve të zonës së Postribës i ndeshim të pasqyruara edhe në mikrotoponomi si: *Kopshti i Dhive* (Mes); *Lugu Derr* (Dragoç); lagjja *Derraj* (Domen); *Shpellë Dosa* (Domen); *Suka e Qeve* (Kullaj); *Lami Mushk* (Drisht); *Lami i Gomarit* (Domen); *Shtegu i Dhive* (Derraj); *Te Shtiren Lopt* (Derraj); *Gjolla e Dhive* (Derraj); *Shpella e Derrajve* (Derraj); *Kodra e Lacës* (Ura e Shtrenjtë) etj.

Postriba është një nga krahinat më të vjetra e më të njohura të Shqipërisë Veriore. **Këtë vjetërsi e përforcojnë disa toponime e patronime të saj që i gjejmë nëpër dokumentet e hershme.** Pothuajse të gjitha katundet e saj ose rrënjët e atyre katundeve na dalin në ato dokumente, si: Mesi(messi) (Çabej *Për historinë e konsonantizmit të shqipes*, BUSHT, SSHSH, nr.58, f.46. 46), Dragoçi, Domni, Boksi (Luli 1974: 69)etj.

PREKALI. Është familja e përmendur Prekali të Drishtit e njohur gjatë shek. XIX, XV, sipas Suflajt e Jireçekut, me origjinë thjesht shqiptare (SSH17, I11. Alb.113). Prekali dëshmohet historikisht si i tillë: *Prechali* më 1447, *Prekal* 1485(AAV, XIX, 5303, DSH 378).

ROSEK më 1485, 1582, ndër anët e Postribës (DSH 402, FSH 143; SH1, 1972, 87). Është lagja e sotme Rrasek (Domën) dhe Prroni i Rrasekut, që i ka dhënë emrin vetë lagjes.

VILZA më 1485, Vilezza 1547, Viliza 1582, Villeza 1614, Vilesa 1632, 1688, etj. Është emri i sotëm Vilëz mbi Drisht. Fran Luli mendon se gjuhësisht kemi të bëjmë me një trajtë zvogëluese me –zë të Vilë-s së Dushmanit, pra njëfarë “Vilë e Vogël”, kur dihet që emri Vilë, sipas Çabejt është një huazim latin villa “shtëpi në katuund, në fshat” (Luli 2005: 64).

URA E SHTRENJTË më 1703, prej *Uret s sctrenjtë* 1685 (Bogdani), Vraestrent “Ponta Stretto” 1688 (RISH, 1964, 166, CP I,I,VI, 17, A116). (F. Luli, SH I, f. 62 v.).

MESI më 1416, Mesi 1485, 1582, Mesii 1547, 1688, 1709 (KSH 76 a, DSH 362, FSH 145, Dok. XVI-XVII, I, 164, SH 2, 1979, 192-194, A 22, 25 82, RISH 1964, 166). Është fshati i sotëm Mes, *Ura e Mesit* nga vetë emri i fshatit, në qendër të Postribës. Shumë i përhapur si patronim historik, brenda e jashtë zonave tona. Më të shpeshtë këta emra dalin në vitin 1416, si: disa Messi-Mes, V. Messi-Kosmac, P. Messi –Shkodër etj. Emri i fshatit *Messi*, me të gjitha patronimet, veçanërisht të 1416-s del më grafitë ss, gjithnjë konseguente, si dhe të viteve 1423, 1424 me x, të cilat flasin mirë për një trajtë më të hershme Meksi, siç mendon edhe M. Shflaj (SSH 45). Grupi ks u zhvillua më tej në ss dhe më tej në s, e pranueshme për fonetikën e shqipes. (F. Luli, SH I, f. 51 v.).

MYSELIMI. Dëshmohet në trajtën Muselem më 1532, Musselin 1614, Musselino Mysselino 1621, Muselin 1628, 1629, Mussolino 1649, Musselimi 1689 (FSH 142, Dok. XVI-XVII, III, 211, RSH, I, 258, 309, 384, 394, II, 376, A 22, 25, 85). (cituar sipas, F. Luli, SH I, f. 54). Fshati *Myselim* ndodhet në kufi me fshatin Mes.

DRISHTI. Drishti si qendër u formua në atë rreth e në të njëjtën kohë me qytetet e tjera të mesjetës si Svaci, Balezo, Deja etj. pas shkretimit që pësoi Doklea romake në shek. VII. Në regjistrin e kadastrës së Shkodrës (viti 1416-1417) shkruhet *Drivastum* (*Regjistri* :227). Në vitin 1553, në një libër të Barletit, përmendet ndër të tjerash edhe comiti *Drivastensi*. (Luka 1999:21). Në dokumentet me burim të huaj emri i Drishtit del gjithnjë në formën *Drivastum*,

duke përjashtuar ato turke, ku ky emër shkruhet *Dergos* (viti 1478), e *Dergos* (viti 1485), grafi të ndërtuara sipas gjasash nga trajta slave *Drivost*. Ky emër është bërë objekt studimi nga një numër studiuesish si: V. Kamsi, *Gjurmime në toponomastikën mesjetare*, në “Studime për nder të A. Xhuvanit”, Tiranë 1986; E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, në “Studime rreth historisë së gjuhës shqipe”, Tiranë, 1973 etj.

Emri *Drisht* paraqet interes të trefishtë për gjuhën shqipe. Së pari shfaqet herët në burime dokumentare “për të parën herë në shek. VIII, po burimet i ka në kohën e vjetër dhe si i tillë rreshtohet me ato toponime që me ndërrimet e pësura gjatë kohëve në gojë të shqiptarëve, shërben për të vërtetuar autoktoninë e tyre në vendin ku banojnë. Ky emër paraqet interes për fonetikën historike, sepse tregon se ilirishtja ka pasur theksin në ballë të fjalës. Ky emër flet në të mirë të mendimit të H. Krahes që ilirishtja mbase ka pasur theksin në ballë të fjalës. Pra *Drishti* paraqet interes për fonetikën historike të shqipes. Së treti, përpjekja për të shpjeguar emrin e *Drishtit* nëpërmjet një fjale vendëse, përmbush kuadrin e studimit të tij duke e vënë në rradhë të parë për rëndësinë që paraqet.

Duke u bazuar në studimet e fundit. Emri i fshatit të sotëm *Drisht*, vjen nga një apelativ i vjetër i shqipes +**Drineste** (drin+/e/ste) me kuptimin “vend me dri/n/, ku dri/n-do të thotë “e çarë”, duke emërtuar kështu për punë të konfiguracionit të vendit. (Luka 1999: 21).

Në *Drisht* dëshmohet emri i familjes mesjetare drishtiane Scapudar, Schipudar, Schipuder gjatë shek. XV, i cili përbën dëshminë e emrit të ri të popullit tonë, duke zëvendësuar atë të mesjetës, Arbënesh. Si shqiptar nuk del në toponimi nga mosha e re e këtij emri. (Luli, 1999:58).

KIRI. Emër lumi që përshkon krahinën e Postribës. Në lashtësi del vetëm te Livi. Del në kadastrën veneciane të vitit 1416 *Kiri* quhet fiume *de la Klia* (Regjisri i kadastrës së Shkodrës 31, fleta origjinale 12/b). Këtë emër në formën *Klausal* e ndeshim të trajtuar nga Luka i cili në studimin e tij “Shënime rreth guturaleve të gjuhës shqipe” (SGJ V1999: 66) e merr si shembull për të treguar se ndër gjuhët *satem* ka fjalë me guttural të ruajtur më vend të një spiranti të pritshëm. Emri *Clausal* krahasohet edhe nga Majeri me një rrënjë kleu-(me k palatale) etj. (Mayer Die sprache II, 65.) Krahasimi i emrit të vjetër *Clausal* me të sotmin *Kir* për Lukën nuk përlligjet. Ai mendon për një lat. claus/um/ “/vend/” që përmbyll që rrethon” (SGJ IX:108).

Mikrotoponimet kanë rëndësi të madhe në jetën e banorëve të Postribës, për jetën e përditshme të banorëve me anë të tyre ato kanë fiksuar emrat e objekteve, sendeve dukurive më të vogla. Krahas emrave të maleve të mëdha, ka edhe emra të pikave të caktuara të tyre më të vogla si: *qafa, gryka, shkëmbinj, rrugë, shtigje, fusha, lëndina, kullota, pyje* etj. që kanë

rëndësi të madhe për banorët. Kjo mikrotoponimi na jep një pasqyrë të historisë ekonomiko-shoqërore dhe kulturore të kësaj krahine.

Kjo lëndë leksikore është një dëshmi e gjallë e visarit të madh gjuhësor që jeton e vepron në gjirin e popullit të zonës së Postribës dhe të njësisë së gjerë e të thellë të gjuhës sonë kombëtare. Këto fjalë e shprehje popullore, të regjistruara drejtpërdrejt nga goja e folësve hedhin dritë mbi disa veçori të leksikut e të fjalëformimit të kësaj të folmeje dhe janë material i rëndësishëm për dialektologjinë dhe leksikografinë krahinore.

Në mënyrë të veçantë për historinë e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe onomastika në përgjithësi e toponimia në veçanti, me fjalët format dhe elementet e ndryshme leksikore e fjalëformuese që ngërthen në to, si dhe me aq gjurmë të tjera që pasqyrojnë ndikime të karakterit gjuhësor e jashtëgjuhësor përbëjnë lëndë të vlefshme e që mund të plotësojë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara, duke marrë kështu një vlerë të rëndësishme dëshmuuese.

Toponimia e kësaj krahine paraqet interes të madh për shumë degë të shkencës si: për gjuhësinë, për etnografinë, studimin e legjendave, problemet mjaft të gjera të prehistorisë, historinë e vendbanimeve etj.

Frazeologjia në këtë krahinë është mjaft e pasur. Aty gjejmë ndërtime të kohës së autorëve të vjetër(Thomai 2017, 1972). Ndërtimet janë të tipit foljor, mbiemëror e emëror dhe ndajfoljor me gjymtyrë foljore, emërore e ndajfoljore, me fjalë shërbyese e pa fjalë shërbyese, me rend tipik e me inversion. Nuk po ndalem këtu për të trajtuar frazeologjinë, sepse e kam trajtuar në një punim të plotë, por po sjell disa shembuj për të vënë në dukje këtë pasuri të gjuhës shqipe. *Mu ru:jt gruja pej t'qijave kur lin fmi:n se vallahi i bâjn mnī e nuk ka qa e qet ma n'vedi.*

Bân bē për kry t fmive qi nuk e ke pa qat punë, se t' vret Allahu me rrejt. Edhe un kur dal n oborr tash e nisi tu n oborr e shof i therr a i krane n oborr mos me e marr e me largu pej rruget thon// se qajo si duhet gja kuj me i fjal me ju bâ bārr kujt kot. Ū me një malcore pej malcie kana shkue me luftue me marr nderin e parve.

Leksiku i zbuluar në këtë krahinë është me mjaft vlerë, sepse aty ruhen mjaft fjalë apelativa që sot nuk ndihen më në brezin e ri, as në mbarë gegërishten. Studimi i lidhjeve midis toponimeve dhe fjalëve të tjera të gjuhës ndihmon të vihet në dukje deri në një farë mase shkalla dhe karakteri i pasqyrimin të fondit leksikor të gjuhës, si dhe kuptimet e ndryshme të fjalëve që gjejnë pasqyrim në toponomi. Me të drejtë Memisha shprehet (Memisha, 2015:140)se “grumbullimi i fjalëve, kuptimeve, njërive frazeologjike, i emërtimeve të pathjeshta, i ndertimeve sintaksore etj. që gjallojnë në dialekte dhe që kanë vlera shënuese e shprehëse dhe

rrisin pasurinë leksiko-semantike të shqipes”. Kjo duhet të realizohet me të gjitha format, mënyrat rrugët e mjetet.

Përfundime:

Postriba është një nga krahinat më të vjetra e më të njohura të Shqipërisë Veriore. Këtë vjetërsi e përforcojnë disa toponime e patronime të saj që i gjejmë nëpër dokumentet e hershme. Mesi(messi), Dragoçi, Domni, Boksi etj. Toponimia e kësaj krahine paraqet interes të madh për shumë degë të shkencës si: për gjuhësinë, për etnografinë, studimin e legjendave, problemet mjaft të gjera të prehistorisë, historinë e vendbanimeve etj.

Në këtë krahinë ndeshim elemente të shqipes së vjetër të cilat janë të pranishme edhe sot në brezin e vjetër të banorëve të Postribës, si: përdorimi i gjinisë asnjëanëse, përdorimi i i formave të vjetra të përemrave, rasat e emrave, tipare të hundorësisë, tkurrja e zanoreve, përdorimi i dendur i fjalive bashkërenditëse, trajta të ndryshme leksikore etj.

Sintaksa popullore përmban një pasuri të madhe ndërtimesh, nga më të larmishmet, me aftësi të veçanta e me vlera të shumta origjinale që nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Ka ndërtime e struktura të vjetra, që janë zhdukur nga shqipja e sotme, por kanë qenë të pranishme në shqipen e lashtë. Nga këto vëmë në dukje përdorimin e rrjedhores pa para-fjalë etj.

Në gojën e banorëve të vjetër ndeshen fjalë e shprehje popullore, që hedhin dritë mbi disa veçori të leksikut e të fjalëformimit të kësaj të folmeje dhe janë material i rëndësishëm për dialektologjinë dhe leksikografinë krahinore. Leksiku i zbuluar në këtë krahinë është me mjaft vlerë, sepse aty ruhen mjaft fjalë apelativa që sot nuk ndihen më në brezin e ri, as në mbarë gegërishten. Frazelogjia është mjaft e pasur. Aty gjejmë ndërtime të kohës së autorëve të vjetër. Ndërtimet janë të tipit foljor, mbiemëror e emëror dhe ndajfoljor me gjymtyrë foljore, emërore e ndajfoljore, me fjalë shërbyese e pa fjalë shërbyese, me rend tipik e me inversion.

Si përfundim, mund të thuhet se në gjuhën e banorëve të Postribës ruhen mjaft tipare që janë zhdukur në shqipen e sotme. E folmja e Postribës ka rëndësi të veçantë për kërkimet në fushën e historisë së gjuhës shqipe.

BIBLIOGRAFIA:

1. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, II Tiranë 1997.
2. Çabej, E. (1977). *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të të vendeve*, Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, f. 15v.

3. Çabej, E. (1977). *Disa aspekte të kulturës popullore në vështrim gjuhësor*, SF/2, f.22.
4. Kamsi, V.(1986). *Gjurmime në toponomastikën mesjetare*, në “Studime për nder të A. Xhuvanit”, Tiranë.
5. Luka, D. (1999) *Shënime rreth guturaleve në gjuhën shqipe I*, në vëll. “Studime gjuhësore V”, (Kontribut për fonetikën historike të shqipes), Shkodër, f.66.
6. Luka. D. (1999). *Rreth prejardhjes së emrit Drisht*, në vëllimin “Shkodra në shekuj” II, Shkodër, 1999, f. 21-24.
7. Luli, F. (1973). *Përpyetje për etimologjinë e disa toponimeve të Postribës*, Buletin Shkencor, Viti X, nr.1(13), f.191-197.
8. Luli, F. (1974). *E folmja e Postribës*, Studime filologjike, nr.3, f.67-102.
9. Luli, F. (1975). *E folmja e Postribës*, Studime filologjike, nr.1, f.79-99.
10. Luli, F. (2005). *Studime për onomastikën historike*, I, Shkodër.
11. Luli. F. (1999), *Disa bashkëpërkime gjuhësore midis toponimisë shqiptare dhe rumune*, Shkodra në shekuj, Vëll. II, Shkodër, 1999, f. 58.
12. Mansaku, Seit. (1980). *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam+paskajore te autorët e vjetër*, “Studime filologjike”, nr. 2, f.137-148.
13. Memisha, V. (2015). *Dialektet dhe norma letrare e shqipes*. Studime për fjalën shqipe II, Tiranë.
14. Pulaka, S. (1974). *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, i vitit 1485, vëllimi I, Tiranë, përkthyer nga Selami Pulaha, f. 362, 405, 398.
15. *Regjistri i kadastrës dhe i konçesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, Tiranë 1972, f.227.
16. Thomai, J. (1972). *Mbi disa togje të qëndrueshme të shqipes së shek. XVI në krahasim me shqipen e sotme*, në “ Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, f.289-304.
17. Thomai, J. (2017). *Mbi disa togje të qëndrueshme në “Mesharin” e Gjon Buzukut, në krahasim me shqipen e sotme*, Studime për gjuhën shqipe II, Tiranë, f, 169-178.
18. Topalli, K. (2011) *Sintaksa e fjalisë*, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, f. 1179-1281.
19. Totoni, M. (1978). *Çështje të studimit të sintaksës dialektore*, në, SF, 4, 78, f.89-95.

KDU: 811.18'36(05)

Elsa BOSHKU

TIPOLOGJIA E SHQIPES DHE PRIRJE TË FJALËFORMIMIT

Abstrakt

Shqipja si një gjuhë sintetiko – analitike, ka mbizotërim të mjeteve sintetike përkundërt atyre analitike. Megjithatë, studimet kanë treguar se sa i përket formëformimit, prirja po shkon drejt analitizmit, ndryshe nga fjalëformimi, i cili ka prirje drejt sintetizmit. Pikërisht, analizimi i kësaj prirje të sistemit të fjalëformimit, në raport me tipologjinë e përgjithshme të shqipes, dhe mandej identifikimi në shtrirje kohore i atyre ligjësive gjuhësore që kanë sjellë në këto rezultate, përbëjnë edhe objektin e punimit tonë.

Një përshkrim i përgjithshëm mbi mënyrat e klasifikimit tipologjik të gjuhëve, na lejon të qartësohemi me tiparet që e afrojnë shqipen përkatësisht me sintetizmin dhe analitizmin.

Një vështrim mbi tipologjinë e përgjithshme të shqipes, duke analizuar mjetet sintetike dhe ato analitike, mënyrën se si ato janë shfaqur në vazhdimësi kohore, na lejon të kuptojmë pikërisht këtë prirje drejt analitizmit që shfaq shqipja, në kontrast me të shkuarën.

Mandej, një qasje krahasuese, duke pasur si burim studimi, gramatikat më të hershme të shqipes, e deri tek ato më të fundit, pa lënë anash edhe artikuj të posaçëm, na ka dhënë mundësinë të ndjekim ecurinë e sistemit fjalëformues të shqipes, që në kohët e studimit përciptazi të tij, deri më sot kur ka mendime për ta mëvetësuar si disiplinë, duke identifikuar ato rrethana që e shpjen këtë sistem drejt kësaj prirje të përkundërt me strukturën e përgjithshme të saj.

Fjalët çelës: klasifikimi tipologjik; mjetet sintetike; mjetet analitike, fjalëformimi; formëformimi

Abstract

Albanian language as a synthetic-analytical language, has a predominance of synthetic means over analytical ones. However, studies have shown that in terms of formulation, the trend is towards analytics, unlike word formation, which has a trend towards synthetics. Precisely, the analysis of this tendency of the word formation system, in relation to the general typology of

Albanian, and then the identification in time span of those linguistic laws that have led to these results, constitute the object of our work.

A general description, through the descriptive method, on the ways of typological classification of languages, allows us to clarify with the features that approach Albanian, respectively with synthesis and analytics.

A look at the general typology of Albanian, analyzing the synthetic and analytical tools, the way they have appeared in the continuum of time, allows us to understand exactly this tendency towards analytics that Albanian shows, in contrast to the past.

Then, a comparative approach, having as a source of study, the earliest published grammars of Albanian, and up to the latest ones, without leaving aside special articles, has given us the opportunity to follow the progress of the Albanian word-formation system, from the times of his cursory study, to the present day when there are thoughts to adopt it as a separate discipline to identify those circumstances that lead this system towards this tendency contrary to its general structure.

Keywords: typological classification, synthetic tools, analytical tools, word formation

1. Hyrje

Që të njohim gjuhën si mjet themelor komunikimi *është e nevojshme të njohim mirë jo vetëm veçoritë e ndërtimit por edhe prirjet themelore të përforcimit e të zhvillimit të gjuhës sonë letrare kombëtare dhe të strukturës së saj, të parë si realizim historik, konkret i këtij sistemi.*¹ Leksiku i një gjuhe është më i prekshmi nga ky proces ndryshimi e zhvillimi. Aty pasqyrohen më gjërësisht dhe në një kohë të shkurtër lëvizjet e saj, mjafton të krahasojmë fjalorë të shqipes që nga ai i vitit 1954 deri te më i fundit. *Kështu, sistemi i sotëm i çdo gjuhe lidhet edhe me të djeshmen, ashtu edhe me të nesërmen e saj.*²

Shqipja ka një sistem të pasur pasur fjalëformimi. Këtë e dëshmon edhe prodhimtaria e pothuajse çdo tipi fjalëformimi. Pikërisht ky sistem i larmishëm dhe prirjet e tij krahasuar me tipologjinë e përgjithshme të shqipes do të jenë edhe objekti i punës sonë.

2. Struktura e punimit

¹ A. Kostallari, Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare , në: *Studime Filologjike 1982/2*, f. 3

² Po aty, f. 4

Punimi është i ndarë në dy pjesë, secila syresh, e përbëre nga nënçështjet përkatëse. Në pjesën e parë është bërë një përshkrim i shkurtër i disa prej klasifikimeve të gjuhëve në bazë të tipareve strukturore të tyre, për të kaluar në një analizë jo të gjatë të tipareve të përgjithshme të tipologjisë së shqipes.

Ndërsa në pjesën e dytë janë analizuar prirjet e fjalëformimit në gjuhën shqipe. Duke ditur se në fjalëformim ekziston një prirje e përkundërt me formëformimin, pra shihet një drejtim i dukshëm drejt sintetizmit, janë marrë në analizë më vete ato tipare që po shpien sistemin fjalëformues drejt kësaj rrjedhe.

2.1 Tipologjia e përgjithshme e shqipes

2.1.1 Klasifikimi tipologjik i gjuhëve

Që herët janë bërë përpjekje të vazhdueshme për një klasifikim të gjuhëve, por vështirësitë kanë qenë të shumta. Ndër klasifikimet më të njohura janë ato në bazë të marrëdhënieve gjenetike, pra klasifikimit gjenealogjik, dhe klasifikimi tipologjik, sipas të cilit gjuhët grupohen në sajë të tipareve të tyre strukturore. Tipologjia gjuhësore është një nënfushë e gjuhësisë që bën këtë lloj klasifikimi duke studiuar tiparet e përbashkta dhe shumëllojshmërinë e gjuhëve që fliten në botë. Klasifikimet më të zakonshme, janë ato sipas kriterëve morfologjike (struktura e fjalës), sintaksore (rendi i fjalëve), fonologjike (veçantitë tingullore).³

Nga pikëpamja morfologjike ekzistojnë disa tipe klasifikimi ndër të cilët përmëndim:

- 1 . Klasifikimin që i grupon gjuhët në: *rrënjore, përngjitëse dhe flektive*.
- 2 .Tjetër klasifikim është ai në *gjuhë parashtesore e prapashtesore* të cilat bazohen në bashkimin e elemnteve ndajshesore me thelbin e fjalës.

³ The classification of human languages into different types on the basis of shared properties which are not due to common origin or geographical contact.[...] The most common classificatory criteria are morphological (word structure), syntactic (word order), and phonological (sound patterns).
<https://www.encyclopedia.com/humanities/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/linguistic-typology>

3.Një tjetër klasifikim i grupon gjuhët në *analitike*⁴, *sintetike*⁵dhe *polisintetike*⁶

5.Ndërkohë që sipas strukturës morfologjike gjuhët klasifikohen në *gjuhë izoluese, gjuhë aglutinative, gjuhë që lakohen* dhe *gjuhë polisintetike*.

Evolucioni i gjuhëve dhe historia e zhvillimit të tyre ka treguar se në përgjithësi, gjuhët sintetike si latinishtja, kanë kaluar në forma analitike, siç është frengjishtja. Ndërkohë që gjuhët aglutinuese si rasti i finlandishtes, kanë kaluar në mënyrë të shkallë - shkallshme në gjuhë flektive.

2.1.2 Tipologjia e shqipes

*Fjala, si formë përfaqësuese, në gjuhën shqipe, përgjithësisht, ka strukturë të mbledhur, të mbyllur (sintetike), si: libër, klasë, shtëpi, njeri, vrapoj, lexoj, trim, besnik, sot, dje afërsisht, ndofta etj., por ka edhe fjalë që kanë strukturë të hapur (analitike), si: e hënë, e martë, i mirë, i gjatë, i cili, i tij etj.*⁷ Dihet se shqipja, gjatë evolucionit të saj historik, si rrjedhojë e ligjësive të brendshme që kanë vepruar në faza të ndryshme të zhvillimit të saj, nga një gjuhë me strukturë gramatikore, dikur thjesht sintetike, gradualisht mori edhe tipare analitike, duke u shndërruar kështu në një gjuhë me forma gramatikore sintetiko- analitike.

Pra, në gjuhën shqipe mbizotëron sintetizmi përkundrejt analitizmit, megjithëse, prirja shkon drejt këtij të fundit. Analitizmi në shqipe paraqitet si analitizëm binar, pra me mjete gramatikore ndihmëse të cilat para- dhe pasvendosen, por qendrueshmëria ndërmjet këtyre dy tipave nuk është e njëlllojtë. Tipi analitik me mjete që paravendosen, është ruajtur gjithmonë si i tillë, ndërkohë që tipi me mjete të pasvendosura ka kaluar në sintetizëm.

Siç tregojnë gjithë format analitike jo vetëm ato të tanishmet por edhe ato më të hershmet të cilat me kohë janë përngjitur, gjuha shqipe, treguesit gramatikorë të paravendosur nuk i

⁴ Gjuhë analitike është ajo që ose s'kombinon fare koncepte të ndryshme në fjalë (kinezishtja), ose i kombinon në një mënyrë fare ekonomike (anglishtja, frengjishtja). Në gjuhën analitike fjalia gjithmonë ka rëndësinë e parë, fjala është me interes më të vogël.

⁵ Në gjuhën sintetike (latinishtja, arabishtja, finlandishtja) konceptet grumbullohen më dendur, fjalët vedosen më mirë, por është një tendencë e përgjithshme që të ruhet rendi i rëndësisë konkrete në fjalë deri në masë mesatare. E. Sapir, Gjuha – Hyrje në studimin e ligjërimit dhe studimet mbi sistemin fonetik, Prishtinë, 1980, f.147

⁶ Gjuha polisintetike është më sintetike se zakonisht dhe analiza e fjalës shkon deri në ekstrem. Në gjuhët polisintetike, raportet sintaksore shprehen me fjalë.

⁷ E. Likaj, M. Çabej, Morfologji e shqipes standarde, Tiranë, 2013, f.12

parangjit. Parangjitja del si veçori gjuhësore e fjalëformimit dhe jo e formëformimit. Këtu ndihmon edhe rrethana e përgjithshme që gjuhët indoevropiane, ndryshe nga gjuhët semite, janë sufiksale e jo prefiksale⁸. Ndërsa treguesin gramatikor të pasvendosur shqipja e prapangjit. Ky duket të jetë një tipar i hershëm i shqipes pasi as në dokumentet e vjetra, studimet e deritanishme, nuk kanë mundur të gjejnë gjurmë të formave analitike me tregues të pasvendosur.

Një shembull tipik i kësaj veçorie morfologjike të shqipes, është pjesëza *u* e zgjedhimit jovepror, në mënyrën urdhërore, e cila kur paravendoset, qëndron e veçuar, (*mos u krij*) ndërsa kur prapavendoset, i prapangjitet fjalës përkatëse (*krij-u*). *Prania e hershme e një dukurie të tillë (e dukurisë së pasngjities së mjeteve gramatikore) dhe ndyshimet e theksuara fonetiko-gramatikore, nganjëherë tepër largvajtëse, siç është rasti i përemrave dëftorë anaforikë, që dhanë nyjat e prapme, lejon të mendohet që edhe mjete të tjera të pasvendosura mund të jenë përfutur në këtë rrugë.*⁹

Pra, përngjitja e ndërtimeve analitike me mjete të pasvendosura del si një fakt gjuhësor i shqipes në kohët e vjetra dhe sot, çka tregon një prirje të hershme për mënyrën e shprehjes së lidhjeve gramatikore të shqipes.

Por, në shqipe vihet re gjithashtu edhe një dukuri tjetër, ajo e kalimit nga përngjitja gramatikore, në sintetizëm.

*Duke ndjekur gjendjen gjuhësore, nga e sotmja në të shkuarën, vëmë re forma gramatikore ku procesi i kalimit nga përngjitja gramatikore e më tej në sintetizëm është i dukshëm.*¹⁰

Për të dëshmuar këtë mjafton të përmendim disa raste gjuhësore, qoftë në sistemin foljor, qoftë në atë emëror, ku faktohen raste të cilat kanë bërë këtë kalim në rrjedhën e zhvillimeve historike gjuhësore.

Kështu, në sistemin foljor, kemi formën e habitores në të cilën edhe sot dallohen trajtat e pjesoreve të shkurtuara si dhe trajtat përgjithësisht të njënjta me foljen ndihmëse *kam*. Kalimi nga ndërtim sintaksor i lirë *pjesore + kam*, në ndërtimin përkatës të sotëm, nuk ka qenë një proces i lehtë. Vihet re në këtë proces kalimi i shkallë- shkallshëm: ndërtim i lirë sintaksor

⁸ E.Çabej, Studime gjuhësore VII, Prishtinë, 2006, f.141.

⁹ E. Likaj, Format analitike në gjuhën shqipe, shblu, 1997, f.156

¹⁰ E. Likaj, Format analitike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1997, f.149

→formë analitike → përnjitje gramatikore →formë foljore sintetike.¹¹ [punuar (e) ke > punuar ke > punuarke].

Po në sistemin foljor, kemi raste të tjera të këtij zhvillimi strukturor në zgjedhimin jovepror: *tregohem, tregohesh, tregohesha*, megjithëse, ka mendime ndër gjuhëtarë si Kamarda apo La Piana, se formantet *-em, esh, -et* etj., në këto raste janë mbaresat e medievalit indoeuropian.

Ndërkaq, në sistemin emëror, gjithëpranohet se format rasore të trajtave të shquara të emrave paraqesin njësi sintetike që e kanë burimin tek evolucioni historik i trajtave rasore të emrit dhe të përemrit dëftor anaforik. Këto forma të emrit, janë, në fakt, edhe zhvillimet gramatikore më të hershme të këtij lloji. Duke parë shumë shkurt këto zhvillime gramatikore nga më të hershmet, që përfaqësohen pra nga trajtat e shquara të emrit, deri në ato më të vonshmet, që janë format e habitores, duket se shqipja vazhdimisht ka qenë dhe është e shoqëruar nga zhvillime të tilla strukturore ku një ndërtim i tipit tog i lirë, i përbërë prej dy elementesh përfundon në një njësi të vetme sintetike ku elementi i dytë merr edhe gjitha veçoritë gramatikore.

Pra, parë nga këto shembuj të thukët në sistemin emëror dhe foljor, duke ditur edhe rastë të pranishme në sistemin përemëror dhe miemëror, mund të themi se, sa i përket vendit që zë sintetizmi dhe analizizmi në sistemin emëror, foljor, mbiemëror e përemëror të shqipes, “*struktura morfologjike e gjuhës shqipe nuk është karakterizuar vetëm nga procese të të njëjtit tip por, në periudha të ndryshme, ka mbizotëruar njëri ose tjetri tip.*”¹²

2.2 Prirje të fjalëformimit në gjuhën shqipe

Një prirje të përkundërt nga ajo formëformuese ka fjalëformimi në shqipe. Në qoftë se në të parën prirja është drejt shtimit të mjeteve, që ndërtojnë forma analitike, në këtë sistem, megjithëse, padyshim nuk mungojnë dhe janë të gjalla edhe ndërtimet analitike, prirja ka qenë dhe vazhdon të jetë drejt sintetizmit.

Raportet historike e tregojnë këtë prirje, ndaj theksojmë se vërehen, procese formimi të analizizmit, që në përgjithësi, është në rrugën e kalimit drejt sintetizmit. Kështu, krahas formimeve lokucionore të reja e të hershme që janë prodhimtare e në zhvillim, të cilat në varësi të kushteve fonetike, morfologjike e sintaksore po kalojnë në përngjitje a kompozita, gjallëria

¹¹ E. Likaj, Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe (Morfologji historike), Tiranë, 2006, f.213

¹² E. Likaj, Format analitike në gjuhën shqipe, 1997, f.169

dhe prodhueshmëria e mjeteve fjalëformuese sintetizuese, është gjithnjë në rritje krahasuar me mjetet e tjera.

Për të parë më qartë prirjen që ka shqipja në krijimin e fjalëve të reja, mjafton të hedhim një vështim përqasës në “Fjalorin e gjuhës shqipe” të vitit 1954 me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” të 1980-ës, e më tej, me “Fjalorin e gjuhës shqipe” të 2006-ës, nga ku shihet se formimet me ndajshesa dhe kompozitat janë kthyer në rrugët kryesore të pasurimit të fjalësit të gjuhës shqipe.

Kanë marrë zhvillim kryesisht formimi i emrave abstraktë përmes ndajshesave *–i, –(ë)ri, –(ë)si*, emrat e veprimit *më–im* dhe *–je*, emrat foljorë *më–esë*, mbiemrat me *–or, e, të, shëm, tar*, ndajfoljet e formuara përmes prapashtesës *–isht*, e po ashtu njëfjalëzimi i togfjalëshave si: *vendpushim, vendqëndrim, vendtakim, këndvështrim, pikëvështrim, fletëlavdërim, fletëshoqërim, fletëthirrje*, fjalë të formuara përmes ndajshesimit dhe përngjitjes njëkohësisht si: *i përbotshëm, i deritanishëm, i deriathershëm, i derikëtushëm etj.*, tipe kompozitash përcaktore e këpujore sidomos në fushën e terminologjisë : *dritëhije, shitblerje, fiziko-kimik, liriko-epik, kërkimor-shkencor etj.*

2.2.1 Njëfjalëzimi i togfjalëshave

Siç e thamë më lart, në gjuhën shqipe ekziston prirja për sintetizim të mjeteve leksikore të shprehjes. Zhvillimi historik tregon qartë se një tog i lirë, i përbërë prej dy fjalësh, përfundon në një njësi të vetme semantike e gramatikore, ku fjala e dytë e lirë mori gjithë veçoritë gramatikore, duke shtresëzuar tani në strukturën e fjalës së re kuptime thjesht gramatikore¹³.

Njëfjalësimi i togjeve, *emër në emërore + emër në rrjedhore* (*vend banimi, fletë kërkese etj.*), (*fleta e kërkesës së studentes ~ fletëkërkesa e studentes*).

Nga ana tjetër kemi formimet parashteso-prapashtesore dhe formimet e përfutuara përmes prapashtesimit të njëtogu *para-fjalë + emër*, si: *pafundësi (pa fund + ësi), mëditje (më ditë + je), pagjumësi (pa gjumë + si)* etj Po ashtu, kemi njëfjalëzime të tjera të ndërtura si më poshtë:

1. Përemër i pacaktuar+ pjesë tjetër ligjërate: *gjithkund, gjithandej, gjithkush, gjithmonë, gjithsesi, asgjësend, gjithfarë, njëfarë, çdolloj, hiçgjë etj.*

2. përemër + ndajfolje: *tjetërkund, tjetërqysh, tjetërpardje*

¹³ E. Likaj, *Format e analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1997, f.155

3. Përemër ai/ ky + emër: *atëkohë, asokohe, atëherë, kësisoj, atëbotë etj. që kanë formuar ndajfolje.*
4. Parafjalë + emër: *pasdite, përballë, parasysh, përmes, përtej, përnatë etj.*
5. Emër ose ndajfolje + emër ose ndajfolje: *afërmendsh, farësend, hiçgjë, kurrsesi, këmbadoras, kurrfarë, etj.*
6. Emër + emër: *luledielli, togfjalësh, qafëmal, gushtovjeshtë, gjëkafshë, gjësend, farësend etj.*
7. Ndajfolje + emër: *mbasqafe, mesditë, paradite, mirëqenie, paradreke etj.*
8. Përemër + folje: *cilido, çfarëdo, kushdo, dicka, dikush etj.*
9. Pjesëz mohuese + emër / folje ose përemër: *asgjë, asnjëri, askush, asgjësend, padije, pakënaqësi etj*
10. Përsëritje e onomatopeve: *tiktak, gërgëre, mishmash, ninananë etj., dhe shumë formime të tjera të tilla.*

2.2.2 Formime të reja me bazë semantike togje te tipit *folje + emër*

Fjalëformimi ka aspektin morfologjik, semantik dhe sintaksor, prandaj dhe problemet e ndryshme që lidhen me të mund të kundrohen nga të tre këto aspekte. Shpesh herë në studimet për fjalëformimin ky aspekt i tretë është lënë pas dore, por që shpesh vlen si parësor, pasi funksioni sintaksor që krijon një fjalë duke u futur në lidhje me fjalë të tjera, duke u lidhur me kuptimin leksikor, mund të shpjegojnë rrugët e formimit të saj. Ka raste kur krijimi i një fjale të re nuk motivohet kënaqshëm vetëm në aspektin morfologjik e semantik pa marrë parasysh dhe rrethanat sintaksore në të cilat lind ajo. Kjo vlen jo vetëm për përngjitjen, që njihet si një procedë sintaksore e formimit të fjalëve, por edhe për disa raste të tjera qoftë të fjalëve të përbera, qoftë të fjalëve të prejardhura.¹⁴

Në gjuhën shqipe, sidomos në dhjetëvjeçarët e fundit, janë krijuar shumë fjalë të reja, folje, të cilat janë krijuar mbi bazën morfologjike të një emri me prapashtesë dhe mbi bazën semantike e funksionale të një togu *folje + emër*. Kështu janë krijuar folje si: *drekoj, darkoj, bishtnoj, dredhoj, lëvdoh, nderoj, këshilloj etj.,* të cilat përdoren krahas gjegjëseve sinonimike në trajtëtogu: *ha drekë, ha darkë, bëj bisht, bëj dredha, jap lavd, jap nder, jap këshillë etj.* Por

¹⁴ S. Mansaku, Foljet delokutive në gjuhën shqipe, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1989, f.823,

duket se krijime të tilla analoge janë shumë të heshme. J. Thomai, bazuar në transkriptimin e prof. E. Çabej, ka evidentuar te “Meshari” i Gj. Buzukut raste kur paralel me përdorimet e togjeve frazeologjike përdoret edhe një fjalë e vetme e barabartë p.sh krahas togjeve: *baj/kam mëni, kam besë, baj/bie në mëkat, merr formë, ap/baj/za frujt* etj., përdoren edhe *mënihem, besoj, përkatënohem, formohet, frujton*.¹⁵ Përdormimi i njëkohshëm i tyre duket të ketë qenë për arsye shmangie monotonia a në ndonjë rast tjetër për nuanca kuptimore, megjithatë shumica dërrmuese e frazeologjizmave të përdorur aty, nuk kanë përgjegjëse njëfjalëshe, ato janë formuar më vonë.

Kështu te “Meshari” nuk gjenden fjalët gjegjëse si: *shpresoj, betohem, çnderoj, dorëzoj, mëshiroj* etj, ndërkohë që janë përdorur formimet: *kam shpresë, baj be, marr nder, jap ndër duor, baaj mishërier* etj. Ky rast, kur togut i mungon njesia njëfjalëshe gjegjëse na lejon të mendojmë që të parat me shumë gjasë janë krijime popullore dhe më të hershme. Dhe në të vërtetë, studimet e mëvonshme kanë treguar se sa i përket pikëpamjes kronologjike, zakonisht është bërë kalimi nga togjet *folje + emër*, në folje të thjeshtë, pasi të parat janë më afër gjuhës së popullit si edhe shprehin një shkallë më konkrete të të menduarit, kundrejt formimeve të dyta që përfaqësojnë një shkallë më të lartë abstraksioni. Kjo tregon edhe një rast tjetër, të prirjes drejt sintetizmit që ka shqipja në sistemin fjalëformues të saj, në këtë rast të shtrirë që në periudhat e hershme të dokumentimit të shqipes. Megjithatë, nuk mund të përjashtojmë se, tek- tuk, ka edhe raste kur ka ndodhur e kundërta, ndoshta për analogji me modelet ekzistuese, apo për të shprehur nevoja sqaruese.

2.2.3 Foljet delokutive

Një tjetër shprehje e prirjes sintetizuese të shqipes në aspektin fjalëformues, janë foljet delokutive. Janë quajtur të tilla folje të formuara nga fjalë që kanë si temë fjalëformuese një lokucion. Termi është krijuar nga gjuhëtari francez E. Beneviste, ndërsa në shqipë është përdorur për herë të parë nga E. Çabej për folje si: *vërej, bëzaj, shtëzaj* etj., të përfutuara nga përngjitja e togjeve përkatëse: *vë re, baj za, shtoj zot. Foljet delokutive në gjuhën shqipe janë përgjithësisht disa folje të krijuara mbi bazën e disa shprehjeve të qëndrueshme të ligjërimit të përditshëm me ngarkesë të theksuar shprehëse – emocionale që shprehin një gjendje*

¹⁵ J. Thomai, mbi disa togje të qëndrueshme të shqipes së shek. XVI në krahasim me shqipen e sotme, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1972, f. 290

*të brendshme të subjektit folës në formë urimi, përshëndetjeje, keqardhjeje etj.*¹⁶ Foje të tilla janë: *falënderoj, lamtmirem, ngjatjetoj etj.*, të cilat janë formuar nga lokucionet pasthirmore përkatëse si: *faleminderit, tungjatjeta, lamtumirë*. Krijimi i këtyre foljeve, vjen si pasojë e nevojës leksikoreë për të emërtuar në mënyrë sa më sintetike, veprime që shprehen në forma analitike, përmes formulave urimi a përshëndetjeje. Duhet të themi se ngarkesa emocionale nuk është e njëjntë në të dyja krijimet

Më të zakonshme janë kalimet nga togjet *folje + emër* në folje delokutive ndërsa nga togjet *ndajfolje + emër* kalime të tilla, për shkak edhe të formës, janë më të vështira, por megjithatë nuk mungojnë. E tillë është p.sh. folja delokutive *mirëserdhe* e formuar nga togu *mirë se erdhe*.

2.2.4 Kalime të njësive frazeologjike në fjalë

Prirja e përgjithshme e gjuhës shqipe për njëfjalëzimin e disa togfjalëshave dhe lokucioneve, por edhe togjeve frazeologjike qoftë këta me marrëdhënie bashkërenditjeje por edhe nënrenditjeje është tanuimë e dukshme

Në shqipe, ekziston një grup i tërë kompozitash të cilat janë formuar mbi bazën e njësive frazeologjike ose drejtpërdrejt prej tyre. Në përgjithësi këto kompozita janë eufemistike, urdhërore, dëshirore apo edhe asnjansë ndonjëherë.

Kalimi i njësive frazeologjike në fjalë është një dukuri që *përputhet me natyrën e shqipes si gjuhë flektive me prirje të forta sintetizmi në fushën e formimit të fjalëve, si edhe me ligjin e përgjithshëm të gjuhës: të japësh sa më shumë informacion me sa më pak mjete të shprehjes gjuhësore*¹⁷

Fjalët e formuara mbi bazën e njësive frazeologjike a drejtpërdrejt prej tyre mund të klasifikohen sipas llojit të formimit (të përbëra ose të përngjitura), sipas rendit të gjymtyrëve, sipas ndërtimit të njësive frazeologjike burimore, sipas vlerës leksiko-gramatikore që merr fjala e krijuar etj.

Jani Thomai ka bërë një klasifikim në grupe të këtyre fjalëve duke i ndarë përkatësisht në:

1. Fjalë që formohen kryesisht me përngjitje të togfjalëshit frazeologjik, ku futen të ashtuquajturat fjalë delokutive që kemi përmendur më lart, si dhe fjalët e formuara me përngjitje të drejtpërdrejtë të togfjalëshave frazeologjikë, gjatë bashkëpërdorimit të

¹⁶ S. Mansaku, Foljet delokutive në gjuhën shqipe, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II , Akademia e Shkencave Tiranë, 1989, f. 825

¹⁷ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 214

gjymtyrëve të këtyre njësive frazeologjike Të tilla janë; *ec e jak ~ ecejake-e, farë e fis~ farefis-i, thashë e them~thashethem-e*.

2. Togfjalëshat prej nga e kanë burimin këto fjalë sa vijnë e po rrallohen në përdorim. Si ndajfolje mund të përmendim: *rreth e rrotull~ rretherrotull, shkel e shko~ shkeleshko, anë e mbanë~ anembanë* etj. në rastin e ndajfoljeve lidhja me togfjalëshat burimore mbetet ende e gjallë dhe të dyja përdorimet përdoren paralelisht. Po njëfjalëzohen gjithashtu edhe togje frazeologjike me marrëdhënie nënrenditjeje si: *dorë për dorë~ dorëpërdorë, sy ndër sy ~ syndërsy, krah për krah ~ krahpërkrah, ballë për ballë ~ ballëpërballë* etj.
3. 2. Një tjetër grup e përbëjnë fjalët e formuara nga togfjalëshat frazeologjikë që nisin me parafjalën *me*.
4. struktura e njësive frazeologjike burimore përgjithësisht është: *me + emër + mbiemër*, si: *me duar thatë ~ duarthatë, me fytyrë të qeshur ~ fytyrëqeshur, me zemër tëçelur ~ zemërçelur, me fytyrë të qeshur ~ fytyrëqeshur, me gjak të ftohtë ~ gjakftohtë* etj.
5. 3. Grupi tjetër sipas J. Thomait përfshin fjalët e formuara nga njësitë frazeologjike foljore, të cilat në trajtë fjalie marrin vlera cilësuese : *e ka gojën si shpatë ~ gojëshpatë, ka hije të rëndë ~ hijerëndë, e ka zemrën gur ~ zemërgur, e ka mendjen të lehtë ~ mendjelehtë* etj. Edhe këto bashkëpërdoren paralelisht me njësitë frazeologjike prej nga formohen. megjithatë duhet të theksojmë se njësitë frazeologjike të këtij tipi nuk shpiten domosdoshmërisht në krijimin e fjalëve të reja, p.sh. nga *me dorë në zemër* nuk është formuar fjalë e re.
6. 4. Një grup tjetër përbëjnë fjalët e formuara nga njësitë frazeologjike foljore, por me rend të përkundërt të gjymtyrëve: *heq dorë ~ dorëheqje, lidh besën ~ besëlidhje, marr hak ~ hakmarrje, ngul këmbë ~ këmbëngulës*. Në këto raste njësitë frazeologjike kanë shërbyer vetëm si bazë pasi të tilla krijime gjejnë paralele edhe në njësi të tjera që nuk kanë kuptim të figurshëm, si: *rendit bashkë ~ bashkërendit, punoj bashkë ~ bashkëpunoj, ngjit bashkë ~ bashkëngjit* etj.

2.2.5 Shtimi dhe gjallërimi i disa parashtesave, prapashtesave dhe kompozitave

Ndër parashtesat më prodhueset, në vëzhgimet që kanë bërë studiues të ndryshëm, janë vërejtur : *për-, mos-, stër-, nën-, pas-, ndër-, kundër-, jashtë-, tej-, një-, shumë-, gjysmë-* etj. Pos tyre, është vërejtur se nëse në fjalorin e '54-ës nuk ka fare fjalë të përbëra me gjymtyrë të parëbrenda-, në atë të '80-ës ka një varg fjalësh të tilla, çka tregon edhe njëllëj forcimi të simetrisë mes tipave të fjalëformimit.

Po ashtu, në procesin e krijimit të fjalëve të reja, po luajnë rol të madh edhe një varg i tërë mjetesh ndajshesore, të cilat janë e vazhdojnë të specializohen në rrafshin semantik e stilistikor, të tilla si: dallimet ose lidhjet sinonimike, p.sh. krs. *-ar* dhe *-or* (*shkollar~shkollor; mishtar~ mishtor; krahinor~krahinar* etj.)

Është vënë re, gjithashtu, në fjalorin e 1954-ës, edhe krijimi i disa vargjeve leksikore që më parë nuk vepronin si të tilla, siç janë p.sh. vargjet me parashtesa *mbi-, nën-, pa-, mos-, jo-* etj., apo vargje të fjalëve të përbëra, me tema antonimike si gjymtyrë të dyta, p.sh. *-gjatë dhe -shkurtër, -gjerë dhe -ngushtë, -madh dhe -vogël, -hollë dhe -ngushtë, -bardhë dhe -zi* etj.

*Në aspektin fjalëformues, elementet e rinj të vargjeve sinonimike janë më së shumti kompozita (si kallëkeq, caknaltë, këmbëlehtë etj.) dhe fjalë të formuara me prapashtesa (si spicëtar, brumç, vjedhurisht, kaçakçë, emnak etj.), më pak fjalë të parme dhe fjalë të formuara me parashtesim.*¹⁸

2.2.6 Zëvendësimi i disa emrave të paranyjzuar me mjete sintetike

Në stukturën e fjalëformimit, megjithëse zëvendësimi i emrave asnjans të paranyjzuar dhe emrave prejfoljorë me emra me prapashtesa, nuk është normë, vihet re një përdorim i konsiderueshëm i tyre sidomos në media. Në sistemin foljor, foljet me *-oj* Po bëhen tipi më prodhimtar duke tërhequr kështu thuajse gjithë formimet e reja.

2.2.7 Formimet e reja në terminologji, huazimet dhe formimet me prejardhje dialektore

Një nga format e pasurimit të fjalorit të një gjuhe janë edhe huazimet nga gjuhët e huaja. Po të vëmë re, huazimet foljore prej gjuhëve të tjera po formësohen në analogji me foljet e tipit me *-oj*, p.sh: *masivizoj, afishoj, kodoj, kimizoj, mineralizoj* etj. Përpos huazimeve të disa parashtesave të huaja, të ashtuquajtura ndajshtesa apo sindajshtesa, të cilat kanë hyrë në shqipe ndër vite, e që janë mjaft prodhimtare, sidomos në fushën e terminologjisë teknike e shkencore, si: *de-(deformim), trans-(transformim), auto-, bio-, filo-foto-, gjeo-, hidro-, hiper-, mikro-, makro- mono-, pan-, radio-, termo* etj., edhe në ato mjete fjalëformuese të cilat janë me prejardhje dialektore ose krahinore, që tanimë kanë zënë vend me vlerë në pasurimin e sistemit fjalëformues të shqipes, mbizotërojnë kryesisht prapashtesat. P.sh. prapashtesa *-shëm (shme)* e cila përveçse si prapashtesë mbiemërore, përmes saj formohen edhe ndajfolje që tregojnë gjendje a veprim (*habitshëm, pendueshëm, kujtueshëm, vajtueshëm, hovshëm, turpshëm* etj.)

¹⁸ A. Hidi, Pasurimi i vargjeve sinonimike në gjuhën letrare shqipe, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1989, f.373

Krijime të tilla, të cilat janë mjete të sintetizmit, zgjerojnë edhe sinoniminë fjalëformuese të shqipes. Kështu krahas *zemërueshëm* kemi *zemëruar*, krahas *mendueshëm* kemi *menduar* etj. Po ashtu kemi formimet me pjesore të gegërishtes –ue + prapashtesën –s(*kallësues, përgjues, dëftues* etj.) Prapashtesën –ajë të gegërishtes dhe –urina të torskërishtes që formojnë ato që quhen emra përmbledhës (*gjethurina, akullnajë, qelqurina, elbnajë*etj.)

Përmes prapashtesës –imë formohen emra që shënojnë zhurmën tingullimituese që bën dikush a diçka si: *gumëzhimë, bërtimë, bubullimë* etj. Kemi gjithashtu formime me parashtesën për- e cila shërben si përforcuese, apo –stër.

Ndërkaq, sa i përket kompozitave të formuara me mjete popullore, edhe ato janë të shumta, si p.sh. kompozitat dëshirore *emër + pjesore*, që kanë bazë frazeologjike *barktharë – iu thaftëbarku, farëshuar- iu shoftë fara*, apo kompozitat *faqebardhë- me faqe të bardhë, syprush – e ka syrin prush* etj. Pra të tilla kompozita tregojnë dukshëm prirjen e formimit të fjalëve drejt sintetizmit duke shprehur një nocion sado të ndërlikuar me një fjalë të vetme.

Duke parë pra, këtë gjallërim të parashtesave, prapashtesave dhe të fjalëve të përbëra e të përngjitura, parë këto edhe në krahasime që janë bërë mes fjalorëve të shqipes, mund të themi se ajo çfarë na vjen si rezultat i formimit të këtyre njësive kompakte, është forcimi i sintetizmit në sistemin gramatikor të shqipes.

Edhe fakti i marrëdhënieve shumë të gjalla aq sa ndonjëherë nuk mund të vendoset një kufi i prerë midis parashtesimit dhe përngjitjes nga njëra anë dhe parashtesimit e kompozimit nga ana tjetër është një tjetër tregues i prirjes që ka shqipja për fjalëformimin.

2.2.8 Thjeshtimi

Me kalimin e kohës, struktura morfologjike e fjalëve pëson ndryshime të cilat pasqyrohen edhe në fjalëformim. Morfemat mund të bashkohen me morfemat fqinje apo me pjesë të tyre duke formuar kështu një morfemë më vete apo mund të ndodhë e kundërta, pra që morfema të humbë mëvetësinë e të mos dallohet më si pjesë e mëvetësishme e fjalës.

Thjeshtimi është shndërrimi i një teme jo të parme në temë të parme ose bashkimi i dy ndajshitesave në një Thjeshtimi morfemë të vetme si pasojë e humbjes së lidhjeve motivuese me rrënjën a ndajshitesën prej të cilave është formuar, megjithëse nga pikëpamja formale ato mund të mbeten të dallueshme. Një formë e thjeshtimit është edhe bashkimi i dy prapashtesave në një të vetme. Kështu janë formuar prapashtesat: –acak nga –ac dhe –ak, –acuk nga –ac dhe –uk, –almaq nga –al dhe –aq, –alash nga –al dhe –ash, –alec nga –al dhe –ec, –alug nga –al dhe

–uq, –shmëri nga –shmë (shëm) dhe –ri etj., p.sh.: burracak khs. burrac; endacak khs. end-em; verdhacuk; kuqalosh khs. kuqal; shtrembaluq; ndershmër khs. i ndershëm etj. Formimi i prapashtesave të përbëra i ka zgjeruar mjaft mundësitë e prejardhjes prapashtesore, rrjedhimisht të mjeteve fjalëformuese të sintetizmit, në gjuhën e sotme.

2.2.9 Roli i rendit të fjalëve në sistemin fjalëformues të shqipes

Por prirja drejt sintetizmit domosdo që ka lidhje edhe me mjete të tjera gjuhësore, siç është p.sh. rendi i fjalëve.

Mbi rendin e fjalëve dhe pasojat që sjell ai në formimin e fjalëve të një gjuhe, vlen për tu përmendur vepra e E. Sapir i cili ndër të tjera thotë se: *“Tashmë kemi parë diçka nga procesi i përbërjes, i bashkimit të dy ose më shumë elementeve rrënjore në një fjalë të vetme. Nga pikëshikimi psikologjik, ky proces është i lidhur ngushtë me atë të rendit të fjalëve, nëse raporti midis fjalëve nënkuptohet, por nuk thuhet në mënyrë eksplicite. Ç...} Gjuhët e tilla si kinezishtja dhe anglishtja, në të cilat parimi i rënditjes së rreptë zbatohet mirë, tentojnë bukur shpesh të zhvillojnë fjalë të përbëra.”*¹⁹

Në gjuhën shqipe, në përgjithësi, gjymtyrët e fjalisë nuk kanë rend të detyrueshëm. Në varësi të peshës në kumtim dhe ngarkesës emocionale, duke iu nënshtruar kryesisht normës stilistikore, ato mund të pozicionohen në vende të ndryshme në fjali. Në veprën “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, prof. Shaban Demiraj cilëson:

*Si një tipar i sintetizmit është edhe ruajtja e pjesshme e rendit të lirë të gjymtyrëve në fjali. Mjafton të përmendet këtu fakti që kryefjala dhe kundrinat, megjithëse rregullisht vendosen para përkatësisht pas foljes kallëzues, në rrethana të caktuara sintaksore- stilistike mund të përdoren edhe me renditje të përkundërt.*²⁰

Me përjashtim të disa rasteve si p.sh. dëftorët, përemrat pyetës e disa përemra të pacaktuar, numërorët themelorë apo edhe kundrinat në përgjithësi të cilat përdoren rregullisht përpara emrit, liria e rendit të fjalëve është ruajtur. Por, megjithatë, ka mjaft sintagma të qëndrueshme e të zakonshme, të cilat janë pikërisht pikënisja e kalimeve graduale në formime lokucionesh që më tej kalojnë në përngjitje e kompozime. Ruajtja e pjesshme e rendit të fjalëve, pra, është një tjetër tipar i prirjes së formimeve sintetizuese në leksik.

¹⁹ E. Sapir, Gjuha - Hyrje në studimin e ligjërimit dhe studimet mbi sistemin fonetik, Prishtinë, 1980, f.78

²⁰ Sh. Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1983, f.82

3. Metoda

Punimi është realizuar duke përdorur metodat përshkruese, analizuese dhe krahasuese. Nëpërmjet metodës përshkruese është bërë e mundur dhënia e një pasqyre të përgjithshme mbi mënyrat e klasifikimit tipologjik të gjuhëve që na lejon mëpastaj, të qartësohemi me tiparet që e afrojnë shqipen përkatësisht me sintetizmin dhe analitizmin.

Një vështrim mbi tipologjinë e përgjithshme të shqipes, nëpërmjet metodës analizuese mbi mjetet sintetike dhe ato analitike, mënyrën se si ato janë shfaqur në vazhdimësi kohore, na lejon të kuptojmë pikërisht këtë prirje drejt analitizmit që shfaq shqipja, në raporte të ndryshme kohore.

Mandej, përmes metodës krahasuese, duke pasur si burim studimi, gramatikat më të hershme të botuara të shqipes, e deri tek ato më të fundit, kemi mundur të ndjekim ecurinë e sistemit fjalëformues të shqipes, që në kohët e studimit përciptazi të tij, deri më sot kur pretendohet të zërë vendin e saj si disiplinë më vete duke identifikuar ato rrethana që e shpien këtë sistem drejt kësaj prirje të përkundërt me strukturën e përgjithshme të saj.

4. Përfundimet

Shqipja është gjuhë sintetiko – analitike, pra mbizotërojnë mjetet sintetike, megjithatë, duket se prirja shkon drejt mjeteve analitike sa i përket formëformimit. E njëjta gjë nuk vlen për fjalëformimin, ku kemi një prirje të përkundërt

Si veçori themelore të përgjithshme në strukturën fjalëformuese të shqipes, ishte siç e pamë, mbizotërimi i theksuar i prapashtesave dhe i formimit të fjalëve me kompozita. Jo vetëm dominimi i këtyre të fundit por edhe një varg mjetesh të tjera, ndër të cilat njëfjalëzimi i togfjalëshave apo rendi i fjalëve ndikojnë në forcimin e prirjeve sintetike në këtë fushë.

Referencat

Çabej E. (2006). Studime gjuhësore VII, Prishtinë

Demiraj Sh. (1983). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë

Hidi A. (1989). *Pasurimi i vargjeve sinonimike në gjuhën letrare shqipe*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III, Tiranë

Kostallari A. (1982/2). *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës*

Likaj E. (1997). *Format e analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë

Likaj E. (2006). *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe (Morfologji historike)*, Tiranë

Mansaku S. (1989). *Foljet delokutive në gjuhën shqipe*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II , Tiranë

Sapir E. (1980). *Gjuha - Hyrje në studimin e ligjëritimit dhe studimet mbi sistemin fonetik*, Prishtinë

Thomai J. (1972). *Mbi disa togje të qëndrueshme të shqipes së shek. XVI në krahasim me shqipen e sotme*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë

Thomaj J. (2011). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë

Referenca në web

<https://www.encyclopedia.com/humanities/encyclopedias-almanacs-transcripts-and-maps/linguistic-typology>

REFERIME

KDU: 811.18'36(05)

Flamur SHALA

E ARDHMJIA E SË SHKUARËS SË DËFTORES DHE E TASHMJIA E KUSHTORES TË FOLJEVE TË GJUHËS SHQIPE

Abstrakt

Sipas gramatikës tradicionale të gjuhës shqipe janë të njëjta format foljore të dy kohëve të ndryshme dhe mënyrave të ndryshme: e ardhmja e së shkuarës e mënyrës dëftore (do të mësoja) dhe e tashmja e mënyrës kushtore (do të mësoja) të gjuhës shqipe, sikur edhe e ardhmja e përparme e së shkuarës e dëftores (do të kisha mësuar) dhe e kryera e kushtores (do të kisha mësuar).

Këtu e kam parasysh tiparin themelor të kohës, marrëdhënien në mes veprimit a gjendjes, të gjërave që u referohet fjalia dhe kohës së shprehjes, çastit të ligjëritimit.

Nga prototipi i së tashmes së lidhore (të mësoj), e pakryera e lidhore me pjesëzën ***do***, përveç së ardhmes në të shkuarën, të pakontestueshme, mundëson krijimin e një modaliteti të ri (do të mësoja), që përdoret në situata të një çasti aktual të ligjëritimit, e që quhet “e tashme e mënyrës kushtore”. Gjithsesi pa të drejtë quhet kohë e tashme. Rrjedhimisht, nëse nuk ka kohë të tashme të kushtores, mënyra shpreh modalitetin, zbërthimi i mëtejme i të cilit nxjerr në pah aspektin ***deontik*** “që përfshin qëndrimin e folësit ndaj shkallës së obligimit që folësi ia mvesh shprehjes së veprimit të caktuar” (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015, f. 178, sipas Simpson, 1993:47.).

Përfundimet e këtij punimi nxjerrin tipare të modaliteteve foljore, të kohës, mënyrës dhe për aspektin e këtyre dy “kohëve foljore”.

Fjalët kyçe: E ardhmja e së shkuarës, kushtorja, çasti i ligjëritimit, modaliteti, koha, aspekti.

Abstract

In the traditional grammar of the Albanian language, we find the same forms of verbs expressing different grammatical meanings. They are the same verbal forms of two different times and different ways: the future of the past of the form (I would learn) and the present of the Demonstrative form (I would learn) of the Albanian language, as well as the future of the the past (I would have learned) and the perfect tense of conditionals (I would have learned).

I have in mind the basic feature of the tense, the relationship between action or situation, of the things the sentence refers to, and the time of expression, the moment of discourse.

From the prototype of the present tense of the conjunction (to learn), the perfect of the conjunction “**do**” Im, in addition to the future in the past, undisputed, enables the creation of a new modality (I would learn), used in situations of a current moment of lecturing, which is now called the "conditional present tense". However, it is unjustly called the present tense. Consequently, if there is no present tense of the conditional, the mode expresses the modality, the further decomposition of which highlights the deontic aspect "which includes the speaker's attitude towards the degree of obligation that the speaker places on the expression of a certain action" (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015, p. 178, according to Simpson, 1993: 47.).

The conclusions of this paper reveal features of verbal modalities, of time, manner and for the aspect of these two "verbal tenses".

Keywords: Future of the past, conditional, moment of discourse, modality, time, aspect.

1. Hyrje

Gramatika tradicionale e gjuhës shqipe (Grup autorësh, 1985, f. 229, 230; 2002, f. 290, 291.), jep forma të njëjta të foljeve që shprehin kuptime të ndryshme gramatikore: kohore dhe mënyrore. Deri tani nuk janë sqaruar sa duhet situatat (morfo)sintaksore në të cilat përdoret njëra ose forma tjetër. Ka pasur dhe ka persiatje të studiuesve që janë marrë me këtë temë. Mendimet janë të ndryshme.

Ajo që thuhet për to, për trajtat foljore të së ardhmes në të shkuarën e dëftores dhe të “së tashmes së kushtores”, të tipit “*do të laja*”, duke qenë e diskutueshme,

nxit trajtimin edhe më tej deri në përfundime të tjera. Ndërkaq, shtjellimin nga pikëpamja historike të zhvillimit të së ardhmes me *do* e ka bërë Shaban Demiraj (1988.), Besim Bokshi (1998, 2012), Ethem Likaj (2015.), Kolec Topalli (2010.), Bardh Rugova e Lindita Sejdiu-Rugova (2015), Bardh Rugova (2019) etj.

Në këtë punim përfshihet rishikimi i literaturës lidhur me kohën e ardhme, të ardhmen e së shkuarës së dëftores dhe “të tashmen e kushtores”. Metoda e hulumtimit përmes një korpusi të dhënash nxjerr pyetjet që shtrohen për zgjidhje deri te rezultatet dhe përfundimet që jepen në këtë punim.

1.1. Rishikimi i literaturës

1.1.1. Koha e ardhme

Përgjithësisht, gjuha indoevropiane nuk ka pasur forma të veçanta të së ardhmes. Për të shprehur të ardhmen janë përdorur format e lidhore ose të dëftores të shoqëruara me njësi leksikore me kuptimin kohor të së ardhmes (Likaj, 2015, f. 38.).

Lidhur me të ardhmen “*do të lexoj*”, në shqipen ka ekzistuar një “*arketip sintaksor*”, që nuk mungon as sot, ndërtimi me foljen *dua* (*dua të lexoj*). Këso ndërtimesh, me trajta të shkurtra, gjejmë edhe te autorët e vjetër: “...*se duo të të përkas, o biri em...*” (Likaj, 2015, f. 38.). Këto ndërtime dalin me foljen *dua* me vlerë të plotë semantike. Me kalimin e kohës, “*dua*” u gramatikalizua shkallë-shkallë. Arketipi sintaksor p.sh. *dua të them* u zhvillua në *do të them*, si formë “e kushtëzuar” nga disa rrethana: E ardhmja u ndërtua mbi bazën e lidhore *të them*, e cila për nga modaliteti

kryesor i referohet së ardhmes; Shndërrimi i *dua* në *do*, në mjetin gramatikor *të së ardhmes* dhe përgjithësimi i trajtës *do* për tri vetat e njëjësit dhe shumësit; Trajta me *do* shënon shkallën e fundit të gramatikalizimit (Likaj, 2015, f. 38.).

Lidhur me *do*, Bokshi thotë se “duke qenë pikërisht folje me kuptim të plotë është shndërruar në pjesëz të formës së kohës së ardhme: *do të shkoj...* dhe formimi i kësaj trajte nuk e nxori nga përdorimi togfjalëshin *dua + lidhore* në të cilin folja *dua* e ruan kuptimin e saj foljor” (Bokshi, 1998, f. 120.). Lidhur me *do* me pjesore thotë se “mbasi folja *dua* si formë e veprores nuk qe, siç nuk është, folje gjysmëndihmëse, përfitimi i funksionit gjysmëndihmës modal i formës njëvetore të saj (*do*) del të jetë i vonshëm dhe i përfutur në ndikimin e trajtës joveprore *duhet*.

(të dyja janë të vetës së tretë, *duhet* si folje pavetore; *duhet* është forma pësore e foljes *dua* dhe *ai, ajo do* është forma veprorë e foljes *dua*). Kështu, kallëzuesi modal *duhet thënë* dhe *do thënë*, janë plotësisht sinonimikë” (Bokshi, 1998, f. 120.). Topalli thotë se format e mëvonshme analitike të së ardhmes me foljen *dua* janë quajtur *futurum voluntatis*. Ato kanë shprehur dëshirën a vullnetin e folësit, nevojë a domosdoshmëri. Më vonë, folja *dua* në veten e tretë *do (të shkojë)* po humbte kuptimin *volutiv* për të kaluar me kuptim kohor të së ardhmes për të gjitha vetat. E ngjashme është edhe trajta me *kam*, ku *kam* ka pasur kuptim *posesiv*, siç e ka edhe sot, por me kalimin e kohës merr kuptimin më abstrakt *kam “duhet”*, atë të detyrimit dhe domosdosë. Është për t’u përmendur se forma me *kam* ruan, e shënon kategorinë gramatikore, sepse paskajorja nuk mund ta ruajë atë. Përkundër, me *do* nuk ruhet. Atë e bën dhe e ruan trajta e lidhore nëpër veta të caktuara (Topalli, 2010, f. 232, 233.).

Te arbëreshët gjejmë prirjen për ngurtësimin e foljes *kam* nëpër veta si në San Marcano (*u ka të dalë, ne ka të dalim, ato ka të dalinë*) (Topalli, 2010, f. 234, sipas Shkurtaç, SF 4, 1979, 131.).

1.1.2. E ardhmja e së shkuarës me “do”

Lidhur me ndërtimin sintaksor “*do të shkoja*”, është vënë në pah se “në gjuhën shqipe nuk kanë munguar ndërtime sintaksore me foljen *dua* në të pakryerën e dëftores

doja me lidhoren në të pakryerën *të punoja, doja të punoja*. Vlera paradigmatiske e këtyre formave foljore herë anonte kah kushti herë kah kuptimi kohor i së shkuarës” (Likaj, 2015, f. 45.). Këto forma u gramatikalizuan, duke u zëvendësuar forma *dua* në të pakryerën *doja* nga forma *do* (Likaj, 2015, f. 44, 45.), të përgjithësuara në të gjitha vetat e foljeve në të ardhmen e së shkuarës, në këtë rast.

Ky mendim nuk është shumë bindës, pikërisht nga fakti se ky “arketip” gjallon ende dhe ruan vlerën e saj semantike dhe gramatikore të foljes *dua* (Bokshi, 1998, f. 120.) në të pakryerën “*doja*”.

Shaban Demiraj thotë se format *do të punoja* dhe *do të punoj* qëndrojnë në raport kohor të ngjashëm të së pakryerës *punoja* ndaj kohës së tashme *punoj*. Sipas Demirajt (1988, f. 831.), „nëpërmjet këtij zëvendësimi mekanik është bërë i mundur

krijimi i një forme foljore, për të shprehur një kuptim kohor, i cili ndaj një çasti të caktuar të së shkuarës qëndron në një raport të ngjashëm të së ardhmes me atë të kohës së tashme të ligjëritit“. Se në trajtat *do të shkoja, do+të shkoja, të shkoja* është zëvendësim mekanik sipas formës *do+të shkoj*, këtë e thotë Demiraj (1988, f. 831.), Topalli (2010, f. 235.), Likaj (2015, f. 44.).

1.1.3. E ardhmja e së shkuarës me **do** dhe “e tashmja e kushtores”

Lidhur me këto kohë foljore, Demiraj thotë se “format e tipit *do të punoja* dhe *do të kisha punuar*, të përdorura me vlerën e së ardhmes në të shkuarën, përkatësisht të së ardhmes së përparme në të shkuarën, përdoren rregullisht nëpër *fjali të nënrenditura*, kurse me vlerën e së tashmes dhe të së kryerës së *të ashtuquajturës mënyrë kushtore* ato përdoren rregullisht nëpër apodosa (fjali kryesore) të periudhave *hipotetike*”. Format e së ardhmes në të shkuarën e dëftores përdoren si „*e tashme e kushtores*“, për të shprehur modalitetin e veprimit, realizimi i të cilit varet nga një kusht i caktuar. Si rrjedhim, modaliteti e ka mbizotëruar kuptimin kohor. Kështu, kushtorja ka një kuptim kohor të papërcaktuar, thotë Demiraj (Demiraj, 2015, f. 254.).

Një gjë që përmend Demiraj është se homofonia e këtyre kohëve vë në pikëpyetje njohjen e këtyre dy formave. (Demiraj, 2015, f. 254.).

Kolec Topalli thotë se shkaku i kalimit të kësaj forme foljore nga sfera kohore e së shkuarës në sferën e së tashmes është *ndryshimi i pikës së referimit kohor*. Ndërsa

me *të ardhmen e së shkuarës* së dëftores, veprimi foljor vështrohet nga një çast i së shkuarës (i shprehur me të pakryerën, me të kryerën e thjeshtë etj. v. j.), në mënyrën dëftore, me „*të tashmen e kushtores*“ veprimi foljor vështrohet nga pozicioni i së tashmes; sipas Topallit, nga fjalia *Ai tha se do të nisej, po të pushonte shiu*, ku folja ka kuptimin e së ardhmes në të shkuarën, duke pasur si pikë referimi një folje të *kohës së shkuar (ai tha, v. j.)*, është kaluar në fjalinë: *Ai (tani, v. j.) do të nisej, po të pushonte shiu*, ku folja ka kuptimin „e së tashmes së kushtores“ dhe shikohet nga çasti i ligjëritit (Topalli, 2010, f. 242.).

Kalimi nga një kohë në tjetrën mund të shërbejë për dallimin në mes narracionit dhe komentimit të ngjarjeve nga enoncuesi (thënësi) (Kelmendi, 2008,

f. 63.) dhe se kalimi e ka burimin te kundërvënja ligjëratë:rrëfim, dhënë me *të kryerën, të tashmen dhe të ardhmen e përparme* si kohë të ligjëratës dhe me *të kryerën e thjeshtë, të pakryerën dhe me të ardhmen e së shkuarës*, kjo e fundit e përdorur si *prospektiv*, si një kohë *anticipimi, paralajmërimi, parashikimi*, si një *pseudofutur*, si kohë e rrëfimit (Kelmendi, 2008, f. 63.).

2. Metoda

Metoda e përshkruese dhe e analizës shpërndarëse e lidhjeve sintagmatike të njësive gjuhësore, duke pasur parasysh atë që është thënë deri tani mbi këto trajta foljore që shprehin mënyra dhe kohë të ndryshme të veprimit foljor, bazuar në korpusin kualitativ, përfshin jo vetëm analizën e njësive strukturore të gjuhës, por edhe të njësive tekstore brenda një konteksti të caktuar, me të cilin merret gjuhësia e tekstit. Metoda e punës këtu bazohet në korpusin e teksteve, me funksionin tekstor të kategorive siç është modaliteti, koha dhe aspekti i foljeve me forma të njëjta, që shprehin veprime jo të njëjta, sipas kohës e mënyrës.

2.1. Mostra/Pjesëmarrësit

Në analizën shpërndarëse të lidhjeve sintagmatike të njësive gjuhësore (dhe tekstore), si metodë hulumtuese, renditet një grup studimesh të autorëve të ndryshëm si Demiraj (1988), Bokshi (1998, 2012), Topalli (2010), Likaj (2015), Bardh Rugova e Lindita Sejdiu-Rugova (2015), Bardh Rugova, 2019), varësisht nga këndvështrimi ndaj këtyre dy kuptimeve jo të njëjta gramatikore, të shprehura me formë të njëjtë foljore. Këta studiues kanë dhënë mendime të ndryshme lidhur me këtë dukuri gjuhësore, e që kanë nxitur edhe më hulumtimin sipas teorive të reja mbi modalitetin si “gjuhë në funksion”, për t’u shkëputur nga ai modaliteti që “dikur karakterizohej në përgjithësi sipas kritereve deskriptive me të vetmin qëllim: klasifikimin e foljeve dhe të shprehjeve modale” (Bardh Rugova e Lindita Sejdiu-Rugova, 2015, f. 177)

2.2. Instrumentet

Korpusi kualitativ i të dhënave përfshin fjali që janë nxjerrë nga tekste letrare (Kadare, Darka e gabuar, 2009) për shtjellimin e temës për punim dhe të teksteve të autorëve që flasin për këto dy kohë e mënyra si në 2.1, në të cilat gjejmë shtjellime

më ndryshe nga ato që dalin të bazuara në teori të reja mbi mënyrën dhe modalitetin, lidhur me format e së ardhmes të së shkuarës dhe të “tashmes së kushtores”.

2.3. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Në të dhënat në Gramatikën e gjuhës shqipe II (2002), lidhur me kushtoren thuhet: „Periudhat me fjali të varur kushtore në gjuhën shqipe janë shumë të larmishme nga ana strukturore dhe kuptimore. Ndër mjetet kryesore për shprehjen e marrëdhënieve kushtore janë edhe trajtat mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues të fjalisë së varur e të fjalisë drejtuese dhe bashkëlidhja e tyre.“ (Grup autorësh, 2002, f. 582.) për të vazhduar, „Kur folja kallëzues e fjalisë kushtore është në të pakryerën e

lidhore, në fjalinë drejtuese folja-kallëzues është rregullisht në të tashmen e kushtores: *po të ishte* poete *do t'i bënte* një poezi (atij). Dhe unë e kam ndihmuar lëvizjen; *po ta dija* kështu, *do të rrëmbeja* pushkën me kohë.“ (Grup autorësh, 2002, f. 586.). Në periudhën, *Po ta dija (atëherë, v.j.) do të rrëmbeja (atëherë, v.j.)* i referohen së shkuarës, kohës kur është „ndihmuar lëvizja“. *Do të rrëmbeja* nuk është „e tashme e kushtores“ por *e ardhme e së shkuarës*. „Në qoftë se thëngjilli do të qëndronte mbi ujë, kjo do të thoshte se dyshimi *qe* i kotë“ (Domi, 2016, f. 253.). Në këtë fjali është folja *qe* (folje rrëfimi), e cila orienton modalitetin e kushtit të foljeve që dalin, jo „në kushtore“, por në të ardhmen e së shkuarës të dëftores.

Në një qasje ndryshe, në diskutimin përmbljedhës për “E ardhmja në bast – futuri i shqipes”, B. Rugova thotë se nuk është vetëm *do* + lidhore për të shprehur të ardhmen-futurin. Ka edhe folje të tjera që shkojnë bashkë me lidhoren: “marr, vendos, ngutem, kam dëshirë, në të cilën folja është në paradigmen e saj të plotë. Lidhorja është mjeti që shpreh një veprim ireal. Ndryshe nga “do”, foljet para lidhore nuk e humbin mëvetësinë funksionale (Rugova, SNGJLKSH-2019. f. 46.). Kështu, një qasje tjetër lidhur me këto „kohë foljore“ të dy mënyrave të ndryshme e ka Bardh Rugova e Lindita Sejdiu Rugova (2015). Ata thonë se mënyra është kategori gramatikore ndërkaq modaliteti është kategori kuptimore (aspekti është i lidhur me veprimin në kohë, si i vazhdueshëm, i pakryer a i kryer) dhe „gramatikalizimi i modalitetit brenda sistemit flektiv foljor është vetë kategoria e

mënyrës“ (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015, f. 176.). Kështu, lidhur me mënyrën kushtore, thonë se „nuk është asgjë më shumë se *një veprim i shprehur në imperfektin e së kryerës së lidhore* (e ardhmja e së shkuarës, një kusht i mundshëm, por i paretalizuar në të shkuarën, kundërfaktik)“, se „kushtorja nuk ka tregues tipik vetëm për kushtoren, është *një lidhore e së shkuarës*“ (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015, f. 180.). Kështu, modaliteti i kushtores „së ashtuquajtur“ *ka për bazë lidhoren e pakryer „të shkoja“*, sikurse edhe lidhoret e tjera te *do+të shkoj, do+të kem shkuar, do+të kisha shkuar*, korrespondente me *shkoj, shkoja, kam shkuar dhe kisha shkuar*.

3. Rezultatet

Trajta *do të shkoja*, si e ardhme e së shkuarës, tashmë e gramatikalizuar, shpreh veprim në të shkuarën, me pëkenisje nga një pikë referimi në të shkuarën. Është e diskutueshme se kur është arritur që „*do të shkoja*“ të shprehte veprim me modalitet kushti, që ka për bazë mundshmërinë dhe dëshirën. Të dyja format me kuptime të ndryshme kanë në thelb veprimin e paretalizuar deri në një „të ardhme“. Saktësia e modalitetit (kuptimit që shpreh dëshirë, mundësi, kusht, domosdoshmëri, qëllim) lidhet me mënyrën (modalitet i gramatikalizuar) dhe me aspektin (kohën, veprim i kryer, a i pakryer). Kur flitet për të trija këto elemente na del përpara teksti, përkatësisht „gramatika e tekstit“ („shumësia e tekstit“), që nënkupton veprimet e shprehura në raport me *çastin e ligjërit dhe me pikën e referimit kohor*; teksti është rrëfim a ligjëratë. Është ndërtimi sintaksor që nxjerr këtë trajtë foljore sipas *modaliteteve*, që kjo të shprehë modalitetin përkatës.

Të mund të bëhet dallimi i kuptimit të këtyre kohëve foljore, i qasemi tekstit. Këto ndërtime gjuhësore, pra tekstet, tregojnë më shumë për përndarjen e kohëve foljore sipas mënyrave. Modaliteti foljor merr kuptimin tekstor të përndarjes kohore brenda tekstit. Kështu dy kohët foljore të sipërpërmendura shfaqin modalitetin e tyre për të shprehur komunikimin nëpërmjet tekstit. Gjithsesi koncepti i tekstit tejkalon atë të fjalisë dhe periudhës (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015, f. 14.).

Përndarja e kohëve foljore të gjuhës shqipe është e lidhur me tekstin. Brenda tekstit përdoren njësitë gjuhësore kohore, që e bëjnë atë të jetë ligjëratë (diskours) a rrëfim (historie). R. Ismajli përmend se “Distribucioni i kohëve të foljeve në tekst

është i ndryshëm, sepse këto kohë funksionojnë si shenja si të gjitha shenjat e tjera të gjuhës (Ismajli, 1980, f. 96.). “Se koha nuk është morfemë bazore, po morfemë e tematizuar, përmend edhe Hjelmslevi, i cili bazohet në përshkrimin e njësive gjuhësore” (Ismajli, 1980, f. 96.). Ndryshe, tipari themelor i kohës është marrëdhënia në mes veprimit, ngjarjes a gjendjes, të gjërave që u referohet fjalia dhe kohës së shprehjes, çastit të ligjërit (Lyons, 2001, f. 284.). Përndarjet e kohëve, si të tilla, tekstet i ndajnë në ligjëratë e rrëfim.

3.1. Çasti i ligjërit dhe pika e referimit kohor

Baza e marrëdhënieve kohore në gjuhën e folur dhe në gjuhën e shkruar është çasti i ligjërit, përkatësisht çasti kur shkruajmë, ose një çast tjetër i përfytyruar (Grup autorësh, 2002, f. 273.). Veprimi që pritët të kryhet pas çastit të ligjërit, shprehet me foljen në kohën e ardhme. Çasti i ligjërit është pikënisje eventuale dhe është bazë e marrëdhënies kohore të formave foljore.

Kalimi i formës foljore nga sfera kohore e së shkuarës në sferën e së tashmes është *ndryshimi i pikës së referimit kohor*. E *ardhmja e së shkuarës* së dëftores, vështrohet nga një çast i së shkuarës në dëftore, ndërsa *me „të tashmen e kushtores“*, veprimi foljor vështrohet nga pozicioni i së tashmes; nga fjalia *Ai tha se do të nisej, po të pushonte shiu*, ku folja ka kuptimin e së ardhmes në të shkuarën duke pasur si pikë referimi një folje të *kohës së shkuar (ai tha, v. j.)*, është kaluar në fjalinë: *Ai (tani, v. j.) do të nisej, po të pushonte shiu*, ku folja ka kuptimin „e së tashmes së kushtores“ dhe shikohet nga çasti i ligjërit (Topalli, 2010, f. 242.).

Në tekstin i ndërtuar me rrëfim, çasti i ligjërit dhe pika e referimit kohor janë të rrëfimitarit, që ka një perspektivë folëse në të shkuarën, në raport me pikën e referimit kohor. „Një mysafir i lartë, më i larti i të lartëve, *do të vinte*“ (Kadare, 2009, f. 117.). Edhe sikur vetëm *të mbetej*, ai *do t'i vazhdonte* përpjekjet deri në fund (fjali kryesore).

Pikat e shënuara në „boshtin dydimensional“ të B. Rugovës, kur flet për futurin e shqipes (Rugova, SNGJLKSH i 38/1, 2019, f. 10), shënojnë pikën O-çastin e ligjërit, pikën A dhe C, që përfaqësojnë të shkuarën dhe pika B, që përfaqëson të ardhmen. Trajtën *do të shkoja* të së ardhmes në të shkuarën e nxjerrin në dy pika referimi kohor, në të shkuarën (A dhe C), që në raport me çastin e ligjërit dhe

pikën e referimit kohor, janë: *do të shkoja* e ardhme e së shkuarës dhe *do të kisha shkuar* e ardhme e përparme e së shkuarës dhe *do të shkoja* „e tashme e kushtores“, si një e ardhme e së tashmes së lidhore (kohë e ligjëratës, v.j.), në „kokë komete“ (Rugova, 2019, f. 14.), është një e ardhme që „po vjen“ kah e tashmja.

Në boshtin kohor dydimensional (B. Rugova, Seminari 38/1, 2019, 10) pika referimi janë, p.sh. *Ai tha* (pika A) se *do të vinte*, po të pushonte shiu; *Ai pati thënë*

(pika C) se *do të kishte ardhur*, po të kishte pushuar shiu. Kështu, çasti i kumtimit përbën kategorinë e kohës, pra çastin e ligjëritimit. Koha në çastin e kumtimit është në marrëdhënie me kohën e realizimit të veprimit (Rugova, 2009, f. 183, sipas Memushajt, 2004, f. 238). Siç është thënë, në tërë këtë marrëdhënie kohët ndahen në tri boshte informative: *çasti i ligjëritimit, perspektiva folëse dhe relievizimi i tekstit*. (Ismajli, 1980, f. 96., sipas Harald Weinrichut, 2001, (1964)).

3.2. Paskohësia

Është për t'u veçuar aspekti i *paskohësisë* i të dy kohëve, në raport me pikën e referimit kohor. Ndërsa e ardhmja e së shkuarës vështrohet nga një çast me pikë referimi kohor të së shkuarës kah e ardhmja (e së shkuarës), e „tashmja e kushtores“ vështrohet me pikënisje nga e tashmja në çastin e tashëm të ligjëritimit dhe me pikë referimi kohor kah e ardhmja që „*do të vijë*“ të mund të bëhet e tashme, e asnjëherë të mos mund të bëhet e tashme.

Lidhur me *paskohësinë* nga pika e referimit në të shkuarën, të shprehur me të ardhmen e së shkuarës „*do të punoja*“ dhe paskohësinë nga çasti i së tashmes, të shprehur me të tashmen e kushtores, po ashtu me „*do të punoja*“, e tashmja dhe e kryera e kushtores, shihen si kohë me burim nga e ardhmja e së shkuarës (*do të punoja*) dhe nga e ardhmja e përparme e së shkuarës (*do të kisha punuar*). Me kalimin e kohës këto forma kanë marrë kuptimin modal të mundshmërisë, duke e dobësuar kuptimin e së ardhmes të së shkuarës dhe të së ardhmes së përparme të së shkuarës (Demiraj, 2015, f. 253, 254.). Paskohësia mbetet tipar i veprimit që vjen pas pikës së referimit kohor.

E tashmja e kushtores, përmend Topalli, është një e ardhme e së shkuarës e cila i ka këputur lidhjet me pikën e referimit në të shkuarën dhe është lidhur me një pikë tjetër referimi, me çastin e ligjëritimit në të tashmen. Kështu, e ardhmja e së shkuarës është kohë relative dhe përdoret në stilin rrëfimtari, kurse e tashmja e

kushtores është formë kohore absolute dhe përdoret në stilin e ligjëratës (Topalli, 2010, f. 242.). Këputja e lidhjes me pikën e referimit në të shkuarën, e së ardhmes të së shkuarës, çvendos edhe paskohësinë e veprimit në raport me çastin e ligjëritimit. *Ai tha se do të shkonte po të kishte punë dhe Do të shkonte po të kishte (të ketë) punë.*

3.3. Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë

Siç mund të dihet, e ardhmja në ligjëratën e drejtë (LD) bëhet e ardhme e së shkuarës në ligjëratën e zhdrejtë (LZH) (Gramatika 1, Grup autorësh, 2002, f. 317). Ai tha: *Do të shkoj* në Prishtinë (LD) dhe Ai tha se *do të shkonte* në Prishtinë (LZH).

U tha po ashtu më lart se “e tashmja e kushtores ka dalë nga e ardhmja e së shkuarës” (Topalli, Demraj). Pra, nga e ardhmja e së shkuarës (në ligjëratën e zhdrejtë!), nga shkëputja, nga pika e referimit kohor në të shkuarën, paska dalë e tashmja e kushtores (rrjedhimisht nga L. e zhdrejtë në L. e drejtë! në fjali kryesore, sipas Demirajt). Ai tha: *Unë do të vij, po të pushojë shiu* (nëse pushon shiu). (e ardhmja e dëftores); *Ai tha* (pika A e boshtit dydimenzional) *se do të vinte, po të pushonte shiu* (nëse do të pushonte shiu-LZH). (e ardhmja e së shkuarës); Rrjedhimisht, *Ai do të vinte, po të pushonte shiu* (nëse do të pushonte shiu), del me “të tashmen e kushtores”?)

Do të vinte (do të vija) në apodozë, nuk ka arritur të bëhet kushtore, për dy arsye: E para, kushti nuk shprehet përmes strukturës „së kushtores“, por përmes një fjalie tjetër (të varur kushtore) jashtë saj dhe e dyta, format e kushtores „nuk janë format e vetme gjuhësore që mund të paraqiten në apodozë“ (B. Rugova), p.sh.: Nëse shkon, *merrmë me vete*; Po mori pjesë ai, *unë nuk vij*; Në u vonofsha, *mos prit më*; Nëse ke dhimbje, *shko te mjeku* etj.

Këto përdorime janë në mënyra të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Në asnjërin rast nuk ka kusht të gramatikalizuar.

3.4. Modaliteti dhe aspekti

Ndërsa pika e referimit kohor është e ndërlidhur me marrëdhënien në mes veprimit, ngjarjes a gjendjes, të gjërave që u referohet fjalia dhe kohës së shprehjes (Lyons, 2001, f. 284.), modaliteti “si gjuhë në funksion” është qenësor i kuptimit kohor dhe mënyror, “është më i rëndësishëm se sa mënyra...”. Modaliteti, siç u tha,

“gjuha në funksion”, trajtohet si kualifikim i gjendjes dhe konsiderohet superkategori *abstrakte*, më abstrakte se koha e foljes dhe aspekti (Rugova & Sejdiu Rugova, f. 177, 178, sipas Nuyts 2006:1).

Në thelb të së “tashmes së kushtores” “do të shkoja” mbetet trajta e lidhore “të shkoja”, me modalitet dëshire, mundësie, kushti të hapur. Aty ku ka lidhore ka modalitet të mundësisë dhe dëshirës dhe jo vetëm, për veprime ende „të pafilluara“.

Modaliteti është një anë e rëndësishme e kuptimit kohor dhe mënyror. Zbërthimi i mëtejshëm i modalitetit nxjerr në pah aspektin *deontik* “që përfshin qëndrimin e folësit ndaj *shkallës së obligimit* që folësi ia mvesh shprehjes së veprimit të caktuar” si dhe *epistemik* “që lidhet me të pasurit ose jo *të besimit folës* ndaj një koncepti të shprehur nga folësi” (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015, f. 178, sipas Simpson, 1993:47.), ndërsa modaliteti *perceptiv* në të vërtetë e paraqet aftësinë e folësit për ta besuar ose jo një koncept të shprehur. Sipas Rugova-Sejdiu, “përveç foljeve modale si: mund, duhet e do; gjysmëmodale si: le, lejon, di dhe guxoj, janë edhe foljet sipas mënyrave: dëshirorja, habitorja dhe *lidhorja* (me kuptim jo real) që shprehin modalitet” (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015, f. 178.).

Modaliteti *deontik* “që përfshin qëndrimin e folësit ndaj *shkallës së obligimit* që folësi ia mvesh shprehjes së veprimit të caktuar”, të ashtuquajturën „kushtore“ *do të shkoja* e afron kah e tashmja, por asnjëherë nuk e bën të tashme.

Modulimi, sipas Halliday, (përmend B. Rugova e L. Sejdiu Rugova, 2015), që paraqet *dëshirueshmërinë* e folësit ndaj një koncepti, dhe *modalizimi*, që paraqet *vlerësimin* e folësit ndaj një koncepti (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015, f. 178.), janë anë që „do të shkoja“ të kuptohet si e ardhme e lidhore.

Aspekti kohor në „do të vija“ shpreh kohë vijueshmërie me modalitet mundësie, dëshire dhe kushti; me të tria këto kuptime modalitetesh nuk kryhet veprimi, por parashihet, pretendohet drejt asaj që mund të kryhet në të ardhmen. Aspekti kohor i „do të vija“ në një rast shpreh kohë në të shkuarën e dëftores dhe në një rast tjetër shpreh kohë në „të tashmen e kushtores“; kushti nuk është brenda „kushtores“. Duke qenë forma e së tashmes së „kushtores“ „do+të shkoja“ me formën e së pakryerës së lidhore brenda, „të shkoja“, që për nga aspekti është e njëjtë me të tashmen e lidhore „të shkoj“, e që të dyja lidhen me aspektin *i pakryer*, në bërthamë „do+të shkoja“, në kontekstet e caktuara sintaksore, në „fjalitë hipotetike“, ruan brenda vetes aspektin „i

pakryer“, që e ka edhe e tashmja, që e njëjtëson me të gjithnjë, edhe në këto përdorime. Në fjalinë „hipotetike“ „do të shkoja, nëse vjen (po të vish) edhe ti“ është aspekti „i pakryer“ në „të shkoja“ që korrespondon një përdorim të tillë, ku „e tashmja e kushtores“, *do të shkoja* (tani), në fjalinë kryesore korrespondon me të tashmen e dëftores *vjen a po të vish* e lidhores, në *nëse vjen (tani) edhe ti* si fjali e varur kushtore.

Zanafilla e së pakryerës s’është gjë tjetër veçse një e tashme e kohës së shkuar. Kështu, e tashmja dhe e pakryera është një model i mirë, që, siç thotë prof. Demiraj, “për nga ngjyrimi aspektor këto dy kohë shkojnë së bashku, duke qenë se që të dyja e paraqesin veprimin në rrjedhën e zhvillimit të tij” (Demiraj, 1988, f. 740.).

4. Diskutim përmbledhës

Gramatika tradicionale nuk i trajton këto forma (të ardhmen e së shkuarës dhe “të tashmen e kushtores”) sipas koncepteve bashkëkohore për modalitetin.

Te të dy kohët foljore të një trajte „do të vija“ dhe jo vetëm te këto „kohë“, karakteri kompleks i lidhores ka shtyrë që të zgjerohet trajtimi mbi formimin e trajtave kohore dhe mënyrore të së ardhmes së dëftores dhe të së ashtuquajturës „e tashme e kushtores“. Lidhorja (e pakryer „të vija“) del të jetë bërthama e formave, modalitetit dhe aspektit kohor lidhur me qëndrimin folës në një situatë komunikimi tekstor.

Pjesëza *do* e gramatikalizuar është shkëputur nga kuptimi i foljes *dua* dhe është ngjeshur me modalitetin e lidhores, duke e marrë e ruajtur kuptimin e së ardhmes-irealis.

Lidhorja *të shkoja* shpreh një veprim në kohën e shkuar. Ajo shpreh (modalitet) një dëshirë a mundësi dhe (aspekt) veprim që vazhdon në një çast në të shkuarën. Modaliteti i mundshmërisë dhe dëshirës, si dhe aspekti i vazhdimësisë që shpreh koha e pakryer e lidhores mbetet përcaktues i kuptimit kohor të foljeve në të ardhmen e së shkuarës dhe në “të tashmen e kushtores”.

Në shqipen ka forma të njëjta me funksion të ndryshëm kohor, dihet të pagramatikalizuara. Bie fjala, është e tashmja që përfaqëson çastin e ligjëritimit, e tashmja historike dhe e tashmja në funksion të së ardhmes. Çështja është se të dyja

këto të fundit nuk kanë arritur markimin gramatikor të një kategorie gjuhësore-gramatikalizimin. Modaliteti i tyre nuk është bërë mënyrë. Janë edhe me funksion stilistikor (gjuha e folur: *Djali del e pret një kerr dru. Kur vjen e hyn n'dyer, çka me pa, ish mërdehi*).¹ “Homofonia“ e këtyre kohëve nuk vë ”në pikëpyetje përdorimin e këtyre formave“. Demiraj përmend se homofonia e këtyre kohëve vë në pikëpyetje njohjen e këtyre dy formave (1.1.3.). Ka edhe raste që një formë kohore e një mënyre përdoret në kuptimin e një mënyre tjetër (lidhorja si dëshirore dhe si urdhërore, *të shkosh-shkofsh, të shkosh e të vish menjëherë-shko e eja menjëherë*).

Për trajtën foljore „do të shkoja“ të „kushtores“ Rugova & Sejdiu-Rugova thonë se është „e ardhmja e së shkuarës së lidhore, por edhe kusht i hapur dhe real, pa tregues gramatikor tipik vetëm për kushtoren“ (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015, f. 180.). Kushti shprehet jo vetëm me këtë trajtë foljore; shprehet me bashkëpërkime të foljeve në fjalitë hipotetike, të trajtave të kohëve dhe mënyrave të tjera: „do të vij, po të më ftosh“ me te ardhmen e dëftores, dhe *Nëse shkon, merrmë me vete; Po mori pjesë ai, unë nuk vij; Në u vonofsha, mos prit më; Nëse ke dhimbje, shko te mjeku*, etj.

Gramatikalizimi-markimi gramatikor i një kategorie gjuhësore e bën të pakonkurrencë përdorimin e asaj trajte. P.sh. dëshirorja me elementin e dëshirës-është markuar gramatikisht – punofsh, prandaj ka dëshirore (Rugova, SNGJLKSH i 38/1, 2019, f. 27).

Në fjalitë kushtore, *vetëm pasi të përfundojë kushti*, fillon e bëhet veprimi. Deri sa ka kusht s’ka të tashme, por ka të ardhme. E ardhmja është irealis. Thelbi i saj është lidhorja. Ka ende punë me lidhoren

5. Përfundime

1. Gramatika tradicionale nuk i trajton këto forma (të ardhmen e së shkuarës dhe “të tashmen e kushtores”) sipas koncepteve bashkëkohore për modalitetin.
2. Përndarja e kohëve foljore të gjuhës shqipe është e lidhur me tekstin.

¹ Kemi po ashtu forma të mbiemrit me tri funksione: funksioni atributiv (djalë i mirë), funksioni predikativ (është i mirë) dhe funksioni epitetik (i miri djalë).

3. Modaliteti “si gjuhë në funksion” është qenësor i kuptimit kohor dhe mënyror; ai trajtohet si kualifikim i gjendjes dhe konsiderohet superkategori.
4. Gramatikalizimi-markimi gramatikor i një kategorie gjuhësore e bën të pakonkurrencë përdorimin e asaj trajte.
5. Trajta „do të vija“ në apodosë nuk është kushtore, për dy arsye: E para, kushti nuk shprehet përmes strukturës „së kushtores“, por përmes një fjalie tjetër (të varur kushtore) jashtë saj dhe e dyta, format e kushtores „nuk janë format e vetme gjuhësore që mund të paraqiten në apodozë“.
6. Modaliteti *deontik* “që përfshin qëndrimin e folësit ndaj *shkallës së obligimit* që folësi ia mvesh shprehjes së veprimit të caktuar”, kushtoren „do të shkoja“ e afron kah e tashmja, por asnjëherë nuk e bën të tashme.
7. Modaliteti i mundshmërisë dhe dëshirës, si dhe aspekti i vazhdimësisë që shpreh koha e pakryer e lidhore mbetet përcaktues i kuptimit kohor të foljeve në të ardhmen e së shkuarës dhe “të tashmen e kushtores”.
8. Në fjalitë e varura kushtore, *vetëm pasi të përfundojë kushti*, fillon e bëhet veprimi. Deri sa ka kusht s’ka të tashme, por ka të ardhme. E ardhmja është irealis. Thelbi i saj është lidhorja.

Literatura

- Bokshi, B., 1998, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë.
- Demiraj, Sh., 1988, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- Demiraj, Sh., 2015, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Domi, M., 2016, *Vepra II Studime sintaksore*, Tiranë.
- Grup autorësh, 1985, *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, Prishtinë.
- Grup autorësh, 2002, *Gramatika e Gjuhës shqipe 2*, Tiranë.
- Ismajli, R., 1980, *Shumësia e tekstit*, Prishtinë.
- Kelmendi, T., 2008, *Studime sintaksore*, Prishtinë.
- Komrie, B., 1985, *TENSE*, Cambridge University Press, London.
- Likaj, E., 2015, *Zhvillime të mjeveve gramatikore të shqipes*, Tiranë.
- Lyons, J., 2001, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë.
- Rugova, B. & Sejdiu-Rugova, L., 2015, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Prishtinë.

- Rugova, B. 2019, *E ardhmja në bast – futuri i shqipes*, Seminari Nërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 38/1, Prishtinë.
- Tomoko I. S., 2002, *Reporting discourse, Tense, and cognition*, Elsevier.
- Topalli, K., 2010, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Weinrich H., 1973, *Le temps*, Ed. Du Seul, Paris.